

KURRIKULA E BAZUAR NË KOMPETENCA

(Përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë, si dhe
nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimeve)

KURRIKULA E BAZUAR NË KOMPETENCA

*(Përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për
mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve)*

Dhjetor, 2019

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Nezir Çoçaj, drejtor

Ekipi hulumtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës:

Selim Mehmeti, udhëheqës i projektit

Lirije Bytyçi

Haxhere Zylfiu

Ismet Potera

Skender Mekolli

Bashkim Azemi

Agim Bujari

Arbnesha Mexhuani

Bekim Morina

Luljeta Shala

Mevlude Aliu

Safete Shala

Sahare Reçica

Zehrije Plakolli

Autorët e raportit:

Selim Mehmeti

Lirije Bytyçi

Haxhere Zylfiu

Ismet Potera

Korrektues gjuhësor:

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

Shtypi:

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE	8
EXECUTIVE SUMMARY	10
Lista e tabelave	12
Lista e grafikëve.....	14
SHKURTESAT	15
I. HYRJE.....	17
1.1. Vështrim i përgjithshëm i problemit.....	18
1.2. Deklarimi i problemit	19
1.3. Nevoja për këtë studim.....	20
1.4. Objekti dhe qëllimi i studimit	21
1.5. Pyetjet kërkimore.....	22
II. ANALIZA E SITUATËS DHE SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	23
2.1. Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave	23
2.2. Zbatimi i kurrikulës së re.....	25
2.2.1. Udhëheqja e zbatimit të kurrikulës së re në shkolla	29
2.2.2. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës.....	35
2.2.3. Planifikimi mësimor për zbatim të kurrikulës	37
2.2.4. Planifikimi i PIA-s sipas kurrikulës së re	40
2.2.5. Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies	41
2.2.6. Vlerësimi i nxënësve	46
2.2.7. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore	49
2.2.8. Kurrikula me zgjedhje	53
2.3. Studime dhe publikime që lidhen me reformën kurrikulare	56
KAPITULLI III - METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	61
3.1. Modeli i hulumtimit.....	61
3.2. Popullata dhe mostra	62
3.3. Instrumentet e hulumtimit	65
3.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave.....	67

3.5. Besueshmëria e pyetësorit të realizuar me mësimdhënës/personelin e shkollës.....	68
3.6. Kufizimet.....	69
3.7. Aspekti etik i studimit	70
KAPITULLI IV - REZULTATET E HULUMTIMIT.....	73
4.1. Rezultatet nga hulumtimi sasior	73
4.1.1. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës së re/ programeve të reja mësimore	73
4.1.2. Konsultimet dhe mbështetja profesionale gjatë zbatimit të kurrikulës.	75
4.1.3. Pranimi apo besimi në kurrikulën e re.....	78
4.1.4. Praktika e zbatimit të kurrikulës.....	82
4.1.4.1. Ndryshimet në qasje të punës në nivel të institucionit/shkollës në zbatimin të kurrikulës së re	83
4.1.5. Ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve, sipas kërkesave të kurrikulës së re..	89
4.2. Rezultatet nga hulumtimi cilësor	102
4.2.1.Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e komunitetit arsimor për arritjet në zbatimin e kurrikulës, sfidat e problemet kryesore, mundësitë dhe nevojat për mbështetje.....	102
4.2.1.1. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e mësimdhënësve.....	102
4.2.1.2. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e drejtuesve të shkollave, koordinatorëve të cilësisë dhe udhëheqësve të aktiveve profesionale.....	113
4.2.1.3. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e koordinatorëve të cilësisë në DKA	133
4.2.1.4. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e zyrtarëve arsimorë në MASHT	146
4.2.1.5. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare për zbatimin e kurrikulës	161
4.2.2. Rezultatet nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore dhe dokumentimit të shkollave për zbatimin e kurrikulës	181
4.2.2.1. Gjetjet nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore	181

4.2.2.2. Analiza e gjetjeve nga dokumentimi i shkollave për zbatim të kurrikulës.....	190
Gjetjet nga analiza mbi dokumentimin e shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës.....	190
Gjetjet nga analiza mbi dokumentimin e planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës.....	197
Analizë e gjetjeve mbi planifikimin mësimor për klasën përgatitore.....	201
Analizë e gjetjeve mbi planifikimin mësimor për klasën e dytë	204
Analizë e gjetjeve mbi planifikimin mësimor për klasën e shtatë	206
Analizë e gjetjeve mbi dokumentimin e PIA-s.....	219
KAPITULLI VI: DISKUTIM I REZULTATEVE.....	225
5.1. Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës	225
5.2. Informimi dhe konsultimet për kurrikulën e re /programet e reja mësimore	229
5.3. Zhvillimi profesional – trajnimet dhe mbështetja profesionale për zbatimin e kurrikulës	230
5.4. Ndryshimet në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re	234
5.5. Ndryshimi i qasjes në mësimdhënie	238
5.6. Pranimi apo besimi i mësimdhënësve për kurrikulën e re	242
5.7. Monitorimi i zbatimit të kurrikulës	245
5.8. Dokumentimi nga ana e shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës.....	246
5.9. Dokumentimi i planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës	248
5.10. Përmbledhje e arritjeve në zbatimin e kurrikulës së re, sfidave dhe problemeve	250
5.11. Parashikimi për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle	253
KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	257
6.1. Konkluzione	257
6.2. Rekomandime	270
BIBLIOGRAFIA.....	278
Shtojcat	286
Shtojca 1: Pyetësori për mësimdhënës - personelin e shkollës	286

Shtojca 2: Pyetjet udhëzuese për diskutim me drejtorët e shkollave, koordinatorë të cilësisë dhe kryetarë të aktiveve profesionale në shkolla.....	294
Shtojca 3: Pyetjet udhëzuese për diskutim me zyrtarët komunalë të arsimit	295
Shtojca 4: Pyetjet udhëzuese për diskutim me inspektorët e angazhuar në vlerësimin e performancës së shkollës dhe vlerësimin individual të performancës së mësimeve.....	297
Shtojca 5: Pyetjet udhëzuese për diskutim me zyrtarët arsimorë të MASHT-it	298
Shtojca 6: Pyetjet udhëzuese për diskutim me njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare	300
Shtojca 7: Listë kontrolli për analizë/ vlerësim të dokumentimit të institucionit arsimor/shkollës për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës	302
Shtojca 8: Listë kontrolli për analizë të udhëzimeve metodologjike në programet mësimore lëndore.....	306
Shtojca 9: Listë kontrolli për analizë /vlerësim të planifikimit mësimor	308
Shtojca 10: Listë kontrolli për analizë/ vlerësim të mostrave për planet individuale për arsim (PIA).....	311
Shtojca 11: Lista e bashkëpunëtorëve të kurrikulës të përfshirë në analizën e planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës (për klasën përgatitore, klasat 2 dhe 7).	314
Shtojca 12: Lista e hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës të përfshirë në analizën dhe shqyrtimin e dokumenteve dhe politikave arsimore që lidhen me reformën kurrikulare.....	315
Shtojca 13: Lista e institucioneve arsimore/shkollave pjesëmarrëse në studim.....	316
Shtojca 14: Lista e pjesëmarrësve në fokus-grupe:	318
Shtojca 15: Lista e pjesëmarrësve të intervistuar, pjesëmarrësve që kanë dhënë përgjigje në pyetjet udhëzuese përmes e-mailit	319

Falënderim

Ky studim u financua dhe u realizua nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, duke iu referuar Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021. Studimi nuk do të mund të realizohej pa mirëkuptimin dhe përkrahjen e zyrtarëve të MASHT-it, Inspektorëve të arsimit, zyrtarëve arsimorë dhe koordinatorëve të cilësisë në Drejtoritë Komunale të Arsimit, drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve, si dhe njohësve të çështjeve të arsimit dhe të reformës kurrikulare të përfshirë në këtë studim.

Më këtë rast, shprehim falënderim për të gjithë ata që përkrahën dhe mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi. Në veçanti nxënësit, të cilët ishin pjesë e diskutimeve joformale, dhe përfaqësuesit e shkollave, ata që kanë koordinuar vizitat hulumtuese në shkolla dhe që kanë kontribuar në përfshirjen e mësimdhënësve në studim dhe në sigurimin e dokumentimit të punës së shkollës për zbatimin e kurrikulës.

Ky studim është produkt dhe kontribut i veçantë i IPK-së dhe stafit të tij, për reformën arsimore të Republikës së Kosovës.

PËRMBLEDHJE

Studimi paraqet një analizë të zhvillimeve në procesin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, në vitet 2016-2019. Evidenton dhe vlerëson progresin e arritur në zbatimin e kurrikulës, me fokus zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, identifikon sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin efektiv të kurrikulës.

Studimi përfshin analizën e politikave arsimore dhe dokumenteve tjera të lidhura me reformën kurrikulare, analizën e kurrikulave lëndore për klasën përgatitore, klasën e dytë dhe klasën e shtatë, përgatitjet e shkollave për zbatimin e kurrikulës, analizën e dokumentimit të punës së shkollave për zbatimin e kurrikulës, si dhe perceptimet e një mostre prej 576 respondentëve, duke përfshirë mësimdhënës që zbatojnë kurrikulën e re, drejtues të shkollave, zyrtarë arsimorë që kanë rol dhe përgjegjësi për mbarëvajtjen dhe zbatimin e kurrikulës në Kosovë, si dhe njohës të arsimit dhe të reformës kurrikulare në Kosovë. Qasja hulumtuese e përdorur në këtë studim është e bazuar në të dhëna sasiore dhe cilësore, si dhe në modelin krahasues dhe modelin vlerësues zhvillimor.

Rezultatet e studimit tregojnë se zbatimi i kurrikulës në shkallë vendi ka arritur një nivel të ndjeshëm institucionalizimi, nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave lëndore për klasë, trajnimit të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, organizimit të procesit mësimor në bazë të planit mësimor për kurrikulën e re, zbatimit të sistemit të vlerësimit të nxënësve sipas kurrikulës së re dhe periudhave mësimore, si dhe dokumentimit të punës së shkollave në zbatimin e kurrikulës.

Studimi identifikoi disa mangësi që kanë të bëjnë me udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, nga niveli qendror deri në nivel shkolle, cilësinë e trajnimeve dhe mbështetjes gjatë përgatitjes, fillimit dhe vazhdimin të zbatimit të kurrikulës, si dhe efektivitetin dhe ndryshimet në nivel shkolle referuar kërkesave të kurrikulës së re.

Nga studimi vihet re se gjatë viteve 2016-2019, MASHT-i ishte më aktiv në rishikimin e dokumenteve kurrikulare, zhvillimin e kurrikulave lëndore dhe organizimin e trajnimeve. Në anën tjetër, roli i MASHT-it përshkruhet nga

një tendencë e largimit nga udhëheqja e procesit dhe bashkëpunimit ndërsektorial. Kjo qasje ka reflektuar në punën e DKA-ve dhe të shkollave. DKA-të gjatë këtyre viteve kanë treguar një rol më të shtuar në koordinimin e trajnimeve, por akoma nuk kanë arritur të sigurojnë angazhim të mjaftueshëm në procesin e zbatimit të kurrikulës. Organizimi, funksionimi i DKA-ve, dhe qasja ndaj procesit të zbatimit të kurrikulës përshkruhen me burime dhe kapacitete të kufizuara.

Zbatimi i kurrikulës në nivel shkolle vazhdon me një rritje të punës së aktiveve profesionale, por me pak ndryshime organizative, të fokusuara më shumë në zbatim sesa në të kuptuarit e konceptit, mundësive dhe qasjeve që duhen aplikuar nga mësimmshënësist. Shfrytëzim i pamjaftueshëm i autonomisë së shkollës për zbatimin e kurrikulës vazhdon të karakterizojë punën e shkollave. Ato pothuajse janë të vetme në procesin e zbatimit, me mbështetje dhe burime të pakta. Megjithatë, vërehet gatishmëri shpresëdhënëse e udhëheqësve të shkollës dhe mësimmshënësve për marrjen e përgjegjësisë mbi vete sa i përket zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, gatishmëri e relativizuar në masë të madhe nga mungesa e mekanizmave mbështetës, dilemat e ngritura gjatë procesit të zbatimit dhe mungesa e përgjigjeve institucionale ndaj tyre.

Rekomandimet nga ky studim i referohen nevojës për ndërrim të qasjes në zbatimin e reformës kurrikulare, ndërrim të qasjes në përmbushjen/marrjen e rolit dhe përgjegjësisë të institucioneve arsimore në reformën kurrikulare, me qëllim përmirësimin dhe avancimin e udhëheqjes së procesit dhe të praktikave të zbatimit të kurrikulës. Rekomandimet do të shërbejnë si udhërrëfyes për MASHT-in, DKA-të dhe shkollat, për të ndërmarrë masa të nevojshme për të përmbushur rolin e tyre në procesin e zbatimit të kurrikulës, proces të cilin duhet ta ndërlidhin ngushtë me parimet e kurrikulës, pritshmeritë dhe kërkesat e kurrikulës, kontekstin për të siguruar qasje dhe mjedis mundësues për të gjithë fëmijët dhe për të siguruar qëndrueshmëri të procesit, cilësi dhe efikasitet në zbatimin e kurrikulës.

Fjalë kyçe: Kurrikula e bazuar në kompetenca, trajnimi dhe mbështetja e vazhdueshme, kurrikula lëndore/programi mësimor, zbatim i kurrikulës.

EXECUTIVE SUMMARY

This study represents an analysis of developments related to curriculum reform process in the Pre-University Education in Kosovo during 2016-2019. It identifies and assesses the progress made in curriculum implementation particularly focusing on implementation at the school level. In addition, it highlights challenges and opportunities, as well as needs to continuously support schools and teachers for an effective curriculum implementation process.

The study includes: analyze of educational policies and other documents that are linked with curriculum reform, analysis of subject curricula for the preparatory grade, grades two and seven; school preparations for curriculum implementation; documentation of school work related to curriculum implementation; and, perceptions of a sample of 576 participants including teachers implementing the new curriculum, school leaders, education officials who have a role and responsibility for the ensuring implementation of curricula in Kosovo, as well as education and curriculum reform experts in Kosovo. The research approach utilized in this study was based on quantitative and qualitative data. It followed a comparative and developmental evaluation model.

Results of the study show that implementation of the curriculum at the national level has reached a significant level of institutionalization through the development of subject curricula for specific grade level, training of teachers for curriculum implementation, organization of teaching and learning process based on the new curriculum teaching plan, implementation of student assessment system according to the new curriculum teaching periods, as well as documenting the work of the schools during implementation of the curriculum.

The study identifies several shortcomings related to leading the curriculum implementation process from central to school level, the quality of trainings and support provided during the preparatory phase, initiation and continuation with curriculum implementation, effectiveness and changes at school level as per new curriculum requirements.

The study notes that during 2016-2019, MEST was more active in revising curriculum documents, developing subject curricula and organizing trainings. On the other hand, the role of the MEST is described by a tendency

to move away from leading the process and cross-departmental cooperation. This approach has been reflected in the work of MEDs and schools. However, over the past years MEDs have taken an increased role in coordinating trainings, but have not yet managed to provide sufficient engagement in the curriculum implementation process. Organization, functioning and MED's approach to curriculum implementation process is described with limited resources and capacities.

Implementation of curricula at the school level continues with an increased involvement of professional actives (curriculum departments), but with few organizational changes, focused more on implementation aspects rather than on understanding the concept, opportunities and approaches that teachers need to apply. Insufficient use of school autonomy for curriculum implementation continues to characterize school performance. They are almost alone in the implementation process, with little support and few resources. However, there is a promising willingness of school leaders and teachers to take more responsibility related to curriculum implementation at the school level, a willingness which is largely limited by the lack of support mechanisms, dilemmas raised during the implementation process and lack of institutional responses to address them.

Recommendations from this study highlight the need for changing the approach to curriculum reform and changing the approach to fulfilling/assuming the role and responsibilities of educational institutions to improve and enhance the curriculum leadership process and implementation practice. Recommendations will serve as guides for MEST, MEDs and schools to take the necessary measures in fulfilling their role related to curriculum implementation process, which should be closely linked to principals of the new curriculum, expectations and curriculum requirements, school contexts to provide access and an enabling environment for all children and ensure sustainability, quality and efficiency in implementing the new curriculum.

Keywords: Competency-based curriculum, continuous training and support, subject curriculum/teaching program, curriculum implementation.

Lista e tabelave

Tabela 1.	<i>Pozita/roli i respondentëve të përfshirë në studim</i>	63
Tabela 2.	<i>Të dhënat përshkruese për shkallën e shpeshtësisë së leximit të dokumenteve e materialeve tjera për kurrikulën</i>	76
Tabela 3.	<i>Të dhëna përshkruese për mbështetjen e marrë nga udhëheqësit e shkollave</i>	77
Tabela 4.	<i>Të dhëna përshkruese lidhur me besimin e mësimdhënësve në kurrikulën e re</i>	79
Tabela 5.	<i>Shkalla e pajtueshmërisë së mësimdhënësve lidhur me pranimin apo besimin e kurrikulës së re</i>	80
Tabela 6.	<i>Dallimet në shkallën e pajtueshmërisë sipas pozitës së punës në shkollë për pranimin/besimin në kurrikulën e re</i>	81
Tabela 7.	<i>Të dhëna përshkruese për praktikat e përgjithshme të institucioneve arsimore në zbatim të kurrikulës së re</i>	84
Tabela 8.	<i>Të dhëna përshkruese për ndryshimet në shkolla përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re</i>	85
Tabela 9.	<i>Të dhëna përshkruese për ndryshimet në shkolla sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re</i>	89
Tabela 10.	<i>Të dhëna përshkruese për ndryshimet e përgjithshme në praktikën e mësimdhënies, duke iu referuar zhvillimit të kompetencave</i>	90
Tabela 11.	<i>Të dhëna përshkruese për rëndësinë (evidencën) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies</i>	94
Tabela 12.	<i>Të dhëna përshkruese për rëndësinë (evidencën) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies dhe vështirësitë e zbatimit praktik të ndryshimeve, sipas pozitës/rolit të mësimdhënësve në shkollë</i>	98
Tabela 13.	<i>Të dhëna përshkruese për vështirësitë në zbatimin e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies</i>	99
Tabela 14.	<i>Numri i mësimdhënësve të trajnuar për zbatimin e kurrikulës, sipas viteve</i>	153

Tabela 15.	<i>Numri i orëve mësimore javore, temave mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) – Klasa përgatitore dhe klasa e dytë</i>	184
Tabela 16.	<i>Numri i orëve mësimore javore, temave mësimore, dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) – Klasa e shtatë</i>	185
Tabela 17.	<i>Fushat e dokumentimit të shkollave dhe kërkesat/ treguesit e dëshmimeve për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës</i>	191
Tabela 18.	<i>Të dhëna përshkruese për nivelet e dëshmimeve për dokumentimin e punës së shkollës, për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës</i>	195
Tabela 19.	<i>Të dhëna përshkruese për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, shprehur në mesatare dhe në përqindje</i>	197
Tabela 20.	<i>Kërkesat/treguesit për dokumentimin e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës së re</i>	198
Tabela 21.	<i>Të dhëna përshkruese për plotësimin e kërkesave për planifikim mësimor në arsimin parashkollor- klasën përgatitore, shprehur në përqindje për fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi dhe Matematikë</i>	203
Tabela 22.	<i>Të dhëna përshkruese për plotësimin e kërkesave për planifikim mësimor në klasën e dytë (2), shprehur në përqindje për fushat kurrikulare;</i>	206
Tabela 23.	<i>Të dhëna përshkruese për plotësimin e kërkesave për planifikim mësimor në klasën e shtatë (7), shprehur në përqindje</i>	218
Tabela 24.	<i>Të dhëna përshkruese për nivelin e përgjithshëm të plotësimit të kërkesave të planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës</i>	219

Lista e grafikëve

Grafiku 1.	<i>Përqindja e shkollave të përfshira në studim sipas viteve shkollore të fillimit me kurrikula lëndore/programe të reja mësimore dhe lokacioni i shkollave</i>	64
Grafiku 2.	<i>Përshkrimi i kualifikimit të mësimeve të përfshirë në studim (në %)</i>	65
Grafiku 3.	<i>Përshkrimi i qëndrimeve të mësimeve për mbështetjen e ofruar gjatë trajnimeve</i>	74
Grafiku 4.	<i>Rëndësia (evidenca) e ndryshimeve në praktikën e mësimit sipas viteve të zbatimit të Kurrikulës së re</i>	97
Grafiku 5.	<i>Përshkrimi i përgjithshëm i qëndrimeve të mësimeve për vështirësitë e zbatimit praktik të ndryshimeve sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re</i>	100
Grafiku 6.	<i>Përshkrimi i qëndrimeve të mësimeve për vështirësitë e zbatimit praktik të ndryshimeve sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re</i>	101

SHKURTESAT

AP	Aktivet/Departamentet Profesionale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KC	Koordinatori i Cilësisë
KDSh	Këshilli Drejtues i Shkollës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KKAP	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO)
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PISA	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
PSAK	Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë
PVV	Plani Vjetor i Veprimit
PZhSh	Plani Zhvillimor i Shkollës
PZhKA	Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit
SC	Sigurimi i Cilësisë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
UA	Udhëzim Administrativ
VPSH	Vlerësimi i Performancës së Shkollës
ZhPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

I. HYRJJE

Ky studim për reformën e arsimit në Kosovë, në veçanti për zbatimin e Kurrikulës së re, është më gjithëpërfshirësi i bërë ndonjëherë te ne. Me anë të këtij studimi, analitik dhe përshkrues, synohet të sheshohen çështjet më të rëndësishme, të cilat e kanë përcjellë zbatimin e kësaj reforme në tri vitet e fundit.

Procesi i ndryshimit të kurrikulave në arsimin parauniversitar në Kosovë, të cilat lidhen me objektin e këtij studimi, filloi pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës (2008). Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), në vitin 2011, miratoi dokumentin themelor të emërtuar Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë, e cila ka për bazë zhvillimin e kompetencave, ndërsa në vitin 2012 miratoi Kurrikulat Bërthamë për tri nivele të arsimit parauniversitar. Këto dokumente, së bashku me kurrikulat lëndore të zhvilluara nga vetë shkollat (temat dhe rezultatet e të nxënësve të hartuara nga shkollat në bazë të kurrikulave bërthamë), u pilotuan për tri vite me radhë¹, proces i cili përfundoi fillimisht me rishikimin e Kornizës Kurrikulare, duke u bazuar në përvojat nga pilotimi në 95 shkolla të vendit (MASHT, /KKAP/, 2016, f. 7).

Bazuar në rishikimin dhe përcaktimet e dokumentit të Kornizës Kurrikulare², gjatë vitit 2016, janë rishikuar edhe Kurrikulat Bërthamë: (i) Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor; (ii) Kurrikula

¹ Në vitin e parë pilotimi u realizua në 10 shkolla, ndërsa në dy vitet tjera vazhdoi pilotimi edhe me përfshirje të 85 shkollave, mesatarisht 2-3 shkolla në një komunë.

²Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë (2016), përcaktohen: (i) Qëllimet e arsimit parauniversitar, realizimi i të cilave obligon të gjitha institucionet arsimore dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës në procesin edukativ në Republikën e Kosovës; (ii) Kompetencat kryesore, të cilat duhet të zhvillohen dhe arrihen nga të gjithë nxënësit deri në përfundim të shkollimit të mesëm të lartë; (iii) Parimet kryesore për të udhëhequr procesin e hartimit dhe të zbatimit të Kurrikulës në Republikën e Kosovës; (iv) Nivelet formale dhe profilet e arsimit nga perspektiva e reformës së Kurrikulës; (v) Fushat Kurrikulare dhe lëndët mësimore, fushëveprimin e tyre nëpër shkallët kurrikulare dhe minimumin e kohës së ndarë për secilën fushë gjatë një shkalë kurrikulare; (vi) Hierarkia e dokumenteve kurrikulare, përfshirë funksionin, përmbajtjen dhe çështjet qenësore që duhet të trajtohen në kuadër të dokumenteve të ndryshme që e përbëjnë tërësinë e Kurrikulës; (vii) Parimet, llojet, koha dhe mënyra e vlerësimit – sistemin e vlerësimit të nxënësve; (viii) Orientimet për hartimin e materialeve të reja të mësimdhënies dhe nxënies; si dhe (ix) Roli i shkollës në funksion të zbatimit të Kurrikulës (MASHT, /KKAP/, 2016, f. 14).

Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët; dhe (iii) Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (gjimnaze). Procesi i rishikimit të dokumenteve kryesore kurrikulare, në vitin 2016, ka ruajtur substancën e konceptit dhe filozofisë së dokumenteve kurrikulare (2011 dhe 2012), të përcaktuar për një qasje të bazuar në arritjen e kompetencave, përkatësisht qasje të orientuar nga rezultatet e të nxënit, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit, në periudha të ndryshme të shkollimit.

Kompletimi i pakos së dokumenteve kurrikulare, gjatë vitit 2016, vazhdoi me zhvillimin e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore për klasën përgatitore, klasat 1, 6 dhe 10 (gjimnaze), nën udhëheqjen e Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT³. Pastaj, hapi i radhës ishte fillimi i zbatimit të kurrikulave lëndore/programeve mësimore në shkolla, në vitin shkollor 2016/2017, vetëm në shkollat që ishin pjesë e pilotimit të kurrikulës së re.

1.1. Vështrim i përgjithshëm i problemit të studimit

Në arsimin parauniversitar në Kosovë, nga viti shkollor 2016/2017, filloi një fazë e re e reformës kurrikulare, faza e zbatimit të kurrikulave lëndore/programeve të reja mësimore, të hartuara në bazë të kurrikulës së bazuar në arritjen e kompetencave. Në këtë vit shkollor, 72 shkolla, të cilat ishin të përfshira në fazën e pilotimit të kurrikulës së re, u bënë shkollat e para që filluan të punojnë me kurrikulat e reja lëndore/programet e reja mësimore të hartuara nga MASHT-i në bazë të kurrikulës së re. Në këtë fazë të zbatimit të kurrikulave lëndore, të hartuara nga MASHT-i, nuk janë përfshirë shkollat profesionale, për të cilat është akoma në zhvillim dokumenti i Kurrikulës Bërthamë për këtë nivel të shkollimit.

Në vitin shkollor 2017/2018, në të gjitha shkollat e Kosovës, që janë pjesë e sistemit arsimor parauniversitar, ka filluar zbatimi i kurrikulës së re, përkatësisht kurrikulave lëndore/programeve të reja mësimore në klasën përgatitore, klasat 1, 6 dhe 10 (gjimnaze). Ndërsa në shkollat që ishin pjesë

³ Emërtimi: Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, i referohet Organogramit të ri të MASHT-it. Më gjerësisht shih: <https://masht.rks-gov.net/organigrami>

e pilotimit të kurrikulës së re, në këtë vit shkollor, vazhduan të punojnë me kurrikula lëndore të hartuara nga MASHT-i edhe në klasat 2, 7 dhe 11.

Krahas zhvillimit të dokumenteve kurrikulare, MASHT-i, me mbështetje të Projektit të Binjakëzimit, i financuar nga Këshilli i Evropës, përgatiti edhe udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021 (MASHT, 2016/b), i cili është pikë referimi për të gjitha institucionet arsimore dhe bartësit e tjerë që kanë rol në zbatimin e kurrikulës në shkallë vendi, dhe, në mënyrë të veçantë, për shkollat dhe mësimdhënësit që drejtpërdrejt e zbatojnë kurrikulën e re.

Viti shkollor 2018/2019 ishte viti i dytë i zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi, me përfshirje të klasës përgatitore dhe klasave 1, 2, 6, 7, 10 dhe 11 (në klasat 10 dhe 11 janë përfshirë vetëm gjimnazet), ndërsa në shkollat që ishin pjesë e pilotimit të kurrikulës së re zbatimi i kurrikulës vazhdoi edhe në klasat 3, 8 dhe 12, me programe të hartuara nga vetë shkollat, pa një analizë dhe vlerësim nga ndonjë autoritet institucional i nivelit qendror. Fillimi i zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi ka ngjallur shumë dilema dhe diskutime, si nga ana e zbatuesve të drejtpërdrejtë, ashtu edhe nga prindërit dhe nxënësit (Poter, I. & Shala, L., 2019, f. 73).

1.2. Deklarimi i problemit

Për të vlerësuar zbatimin në praktikë të kurrikulës së re, MASHT-i, me Planin Strategjik të Arsimit 2017-2021, autorizoi Institutin Pedagogjik të Kosovës për këtë studim, qëllimi i të cilit është që, përmes analizës së dokumentacionit pedagogjik të lidhur me kurrikulën, studimeve të viteve të fundit për zbatimin e kurrikulës, si dhe perceptimeve të përfaqësuesve të institucioneve arsimore të lidhura me zbatimin e kurrikulës, të ofrojë një informacion tërësor dhe analitik për përvojat e shkollave dhe mësimdhënësve në zbatimin e programeve të reja mësimore të hartuara në frymën e kurrikulës së bazuar në arritjen e kompetencave, sfidat dhe problemet në dy vitet e para të zbatimit të kurrikulës në shkallë vendi dhe nevojat e mundësitë për mbështetje të vazhdueshme të shkollave dhe të mësimdhënësve.

Të kuptuarit për progresin e zbatimit të kurrikulës është bërë një fushë e rëndësishme kërkimore në shkallë kombëtare, për shkak të ndryshimeve që sjell kurrikula e re dhe rritjes së kërkesave për ndërrimin e qasjes së punës nga shkollat dhe mësimdhënësit.

Hulumtimet dhe analizat e realizuara gjatë dhe në përfundim të fazës së pilotimit të kurrikulës së re, flasin për sfida në udhëheqjen e proceseve për zbatimin e kurrikulës, sfida në pranueshmërinë e kurrikulës së re nga shkollat dhe mësimdhënësit, zbatimin në praktikë të qasjes së re që ofron kurrikula e bazuar në kompetenca, si dhe sfida në konsolidimin e praktikave për mbështetje të vazhdueshme të shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Në anën tjetër, parimet e vendosura për të udhëhequr procesin e zbatimit të kurrikulës u referohen rishikimit të kurrikulës dhe sistemeve të vlerësimit, rishikimit të rolit të mësimdhënësve dhe ndërtimit të një kulture të re organizative dhe pedagogjike të shkollës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Nga shkolla pritet që t'i përgatisë nxënësit për mësim gjatë gjithë jetës, duke kultivuar kureshtjen e natyrshme të të rinjve për informata të reja, duke zhvilluar interesimin për të nxënë dhe duke i përgatitur nxënësit për mësim të pavarur (Boshtrakaj, L., 2018, f. 6). Të gjitha këto çështje janë me interes të hulumtohen edhe tani, kur në masë të madhe mungojnë raporte, analiza dhe dëshmi për punën e bërë këta dy vjet, progresin e arritur, si dhe sfidat e problemet në këtë fazë të zbatimit të kurrikulës në shkallë vendi.

1.3. Nevoja për këtë studim

Reforma kurrikulare e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, përkatësisht zhvillimi i kurrikulave lëndore/programeve mësimore, ende nuk ka përfunduar dhe nuk është bërë shtrirja e zbatimit të kurrikulës në të gjitha klasat. Në anën tjetër, zbatimi i kurrikulës është një proces i vazhdueshëm, për të cilin gjithmonë nevojiten impute shtesë për të bërë përmirësimet e nevojshme për zbatim të suksesshëm. Kjo shtrihet nevojën për studime të lidhura me zbatimin e kurrikulës. Këtë e ka referencë edhe ky studim, rezultatet e të cilit pritet t'u shërbejnë të gjitha institucioneve që lidhen me

procesin e zbatimit të kurrikulës, në mënyrë të veçantë MASHT-it, komunave/DKA-ve dhe institucioneve edukativo-arsimore/ shkollave.

Studimi përfshin analizën krahasuese të dokumentimit të udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës bazuar në udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës 2016-2021, dokumentimin e planifikimit shkollor dhe planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës. Po ashtu, merr për bazë perceptimet e subjekteve nga institucione arsimore dhe perspektiva të ndryshme të subjekteve të lidhura me zbatimin e kurrikulës, lidhur me përvojat gjatë zbatimit, sfidat, mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme, me qëllim ofrimin e orientimeve dhe rekomandimeve për përmirësimet e nevojshme, për të siguruar zbatimin e plotë dhe të suksesshëm të kurrikulës së re. Studimi paraqet një tablo të plotë të procesit të zbatimit të kurrikulës, nga shtatori i vitit 2016 deri në gusht të vitit 2019.

1.4. Objekti dhe qëllimi i studimit

Objekt i studimit në këtë hulumtim është zbatimi i kurrikulës së re në arsimin bazë, në klasat ku ka filluar të zbatohet kurrikula e re, në kohën e realizimit të studimit (klasa përgatitore, klasat 1, 2, 6 dhe 7, në vitin shkollor 2018/2019), gjegjësisht praktikat e udhëheqjes së procesit dhe zbatimit të kurrikulës dhe format e mbështetjes, jo mësimdhënësit dhe nxënësit që zbatojnë kurrikulën në këto klasa.

Ndërsa, qëllimi i këtij studimi është të evidentojë dhe të vlerësojë progresin e arritur në zbatimin e kurrikulës, me fokus zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, të identifikojë sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të shkollave dhe të mësimdhënësve për zbatimin efektiv të kurrikulës. Dokumentimi i punës së shkollave për zbatimin e kurrikulës, perceptimet e mësimdhënësve, drejtuesve të shkollave dhe të zyrtarëve arsimorë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zbatimin e kurrikulës në Kosovë, janë analizuar dhe trajtuar thellësisht dhe gjerësisht në këtë studim. Gjithashtu, studimi ka për qëllim të analizojë ndikimin që kanë trajnimet dhe format e tjera të mbështetjes së ofruar për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, si dhe të ofrojë rekomandime të bazuara në evidencë për veprimet

e nevojshme, që duhen ndërmarrë për të siguruar zbatim efektiv në fazat e tjera të zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës.

Rekomandimet nga ky studim do të shërbejnë si udhërrëfyes për institucionet arsimore të nivelit qendror, komunal dhe në nivel shkolle, për të marrë masat e nevojshme në funksionalizimin e mekanizmave që sigurojnë mbështetje të vazhdueshme, monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të zbatimit të kurrikulës nga shkollat.

1.5. Pyetjet kërkimore

Siç është përshkruar më sipër, ky studim synon të eksplorojë dokumentimin e zbatimit të kurrikulës nga shkollat, si dhe perceptimin e mësimdhënësve, drejtuesve të shkollave dhe zyrtarëve arsimorë, njohësve të arsimit, për udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, mbështetjen e ofruar për zbatim të kurrikulës, pranimin/besimin që kanë për kurrikulën e re, praktikatat e përvojat në zbatimin e kurrikulës dhe marrëdhëniet ndërmjet mbështetjes, pranimi dhe praktikës së zbatimit të kurrikulës së re. Pyetjet kryesore kërkimore që e kanë udhëhequr këtë studim janë si në vijim:

- 1. A është udhëhequr procesi i zbatimit të kurrikulës së re sipas udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës 2016-2021?*
- 2. Deri në çfarë shkalle i kontribuojnë zbatimit të kurrikulës së re/programeve të reja mësimore trajnimet dhe mbështetja e ofruar për zbatimin e kurrikulës?*
- 3. Sa janë të dukshme kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca, në proceset që zhvillohen në shkollë, në planifikimin shkollor dhe planifikimin mësimor për zbatimin e kurrikulës?*
- 4. A ka përputhje ndërmjet perceptimit të mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për zbatimin e kurrikulës/programeve të reja mësimore, në raport me rolin e tyre në shkollë dhe vitin e fillimit të zbatimit të kurrikulës së re?*

II. ANALIZA E SITUATËS DHE SHQYRTIMI I LITERATURËS

Konteksti i analizës së situatës dhe shqyrtimit të literaturës që e udhëheq këtë studim përbëhet nga tri pjesë kryesore. Pjesa e parë përmbledh aspektet kryesore që lidhen me zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulave, me fokus në kontekstin e Kosovës. Pjesa e dytë elaboron aspektet që lidhen me përkufizimin e zbatimit të kurrikulës, udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re në shkolla, planifikimin mësimor për zbatim të kurrikulës, aspektet e metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies, vlerësimit të nxënësve, tekstet shkollore dhe materialet mësimore, si dhe aspektet që lidhen me zbatimin e kurrikulës me zgjedhje. Pjesa e tretë përmbledh aspektet kryesore të trajtuara në hulumtimet e viteve të fundit, që lidhen me reformën kurrikulare në Kosovë.

2.1. Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave

Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave është proces që lidhet me ndryshimet në arsim dhe ka për qëllim t'u përgjigjet sfidave, me të cilat ballafaqohet shoqëria, apo t'u përshtatet kaheve të zhvillimeve në shoqëri, arritjeve në shkencë, teknologji, si dhe arritjes së vizionit që e përcakton shoqëria për të ardhmen. Arsyeshmëri të tilla, të përafërta me këtë, gjejmë në shumicën e kurrikulave të zhvilluara vitet e fundit. Këtë e gjejmë edhe në hyrje të dokumentit të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë, ku theksohet se zhvillimi i kurrikulës së re është bërë me qëllim të ballafaqimit me sfidat, si: nevoja për ndërtimin e një shoqërie të dijes, integrimi në epokën digjitale, rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë, të mësuarit për të jetuar së bashku, zhvillimi i qëndrueshëm, si dhe nevojat për diasporën dhe mërgatën (MASHT/KK, 2016, f. 10 -12).

Procesi i zhvillimit dhe i rishikimit të Kurrikulit/Programeve mësimore kalon nëpër faza të ndryshme, të cilat e kompletojnë ciklin e procesit të ndryshimeve dhe e plotësojnë atë në të gjitha hallkat e zhvillimit të tij. Autoritetet e vendeve të ndryshme ndjekin përvoja të ndryshme. Vlen të veçohen përvojat e vendeve të ndryshme, që janë të përafërta, si: Angli, Finlandë, Skoci, SHBA, Australi etj. Për shembull, në Australi procesi përfshin katër faza: Forma e Kurrikulumit; Të shkruarit e Kurrikulumit;

Implementimi/zbatimi dhe Vlerësimi dhe rishikimi i Kurrikulumit (sipas Devetaku-Gojani, 2011, f. 154). Sipas Tyler, zhvillimi i kurrikulës duhet të shikohet si një cikël: cilësia dhe ndikimi i funksioneve të kurrikulës duhet të monitorohen, duke vëzhguar me kujdes rezultatet dhe të dhënat nga këto vëzhgime duhet të përdoren për të bërë ndryshimet e duhura. Kurrikula është koncept, gjithnjë në zhvillim (sipas Karameta, 2014, f. 71).

Raportet e studimeve të analizuara për trendët e zhvillimit të kurrikulave të reja tregojnë se dokumentet kurrikulare dallojnë nga shteti në shtet, dallime vërehen si në strukturë të dokumenteve kurrikulare, ashtu edhe në qëllime, në parime, në organizimin e përmbajtjes mësimore, vendosjen e rezultateve të të nxënësve, numrin e fushave të kurrikulës apo lëndëve mësimore etj. Ato dallojnë edhe në qasjen e bazuar në kompetenca dhe numrin e kompetencave kryesore, qasjen e integritit të lëndëve në fusha kurrikulare dhe numrin e lëndëve të përfshira brenda një fushe kurrikulare. Gjithashtu, dokumentet kurrikulare në vende të ndryshme promovojnë dhe kërkojnë përfshirjen e teknologjisë në mësimdhënie, aplikimin e sistemit dhe formave të ndryshme të vlerësimit, ofrojnë orientim për fondin e orëve mësimore për fusha kurrikulare apo lëndë mësimore, si dhe qartësojnë përgjegjësitë dhe autonominë e shkollës gjatë zbatimit të kurrikulës shtetërore (Education Scotland, 2015).

Nevojat për ndryshim të kurrikulës ndërliken me nevojën për tejkalimin e sfidave në shoqëritë përkatëse. Zhvillimi i hovshëm shoqëror, ekonomik, shkencor e teknologjik, ka ndikuar që tendencat në zhvillimin e teorisë dhe praktikës pedagogjike të jenë të sfiduara nga nevoja për aftësimin e nxënësve për mësim gjatë gjithë jetës (Boshtrakaj, L., 2016, f. 5). Në kurrikulat për arsimin bazë, të zhvilluara në vitet e fundit, vërehet rritje e pritshmërive për të nxënësit gjatë gjithë jetës, aftësitë, dhe jo një përmbajtje e detajuar (Llambiri, S., Abdurrahmani, T., & Mulla, A., 2011, f. 8).

Në shumë sisteme arsimore, zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave bëhet duke iu referuar kompetencave evropiane. Sipas CASE Network Reports (Nr. 87, 2009), përfshirja e kompetencave kryesore evropiane në kuadër të politikave arsimore të shteteve të BE-së është bërë kryesisht përmes ndryshimeve në legjislacionin e arsimit dhe përmes rishikimit të kurrikulës (cituar nga Boshtrakaj, L., 2016, f. 32).

Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë është e ndërtuar në bazë të kompetencave, duke iu referuar kompetencave evropiane, përmes së cilave synohet të zhvendoset fokusi nga presioni për realizimin e përmbajtjes së përcaktuar me programe mësimore dhe tekste shkollore në zhvillimin e kompetencave kryesore, të zbërthyera nëpërmjet rezultateve të të nxënit. Zhvillimi i kompetencave të përcaktuara në kuadër të kurrikulës synohet të bëhet nëpërmjet fushave të kurrikulës lëndëve/moduleve me zgjedhje, projekteve, aktiviteteve ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe formave tjera inovative të udhëhequra nga shkollat (Mehmeti & Buleshkaj, 2017, f. 10).

Në bazë të Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, janë hartuar Kurrikulat Bërthamë për tri nivelet formale të arsimit parauniversitar në Kosovë (arsimin fillor - klasat 1-5, arsimin e mesëm të ulët - klasa 6-9, dhe arsimin e mesëm të lartë - klasat 10-12). Dhe, në frymën e tyre janë hartuar programet mësimore për lëndë dhe klasë, të cilat i referohen strukturës në bazë të udhëzimeve në Kurrikulat Bërthamë, me këtë përmbajtje: Hyrja, qëllimi, temat dhe rezultatet e të nxënit për tema, udhëzime metodologjike, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, udhëzime për vlerësim dhe udhëzime për materialet dhe burimet mësimore.

2.2. Zbatimi i kurrikulës së re

Zbatimi në praktikë i kurrikulumit/programit mësimor është objektivi përfundimtar i procesit të zhvillimit të kurrikulumit. Mësimdhënësit janë zbatuesit kryesorë të kurrikulit, në praktikën e mësimdhënies dhe të nxënit me nxënës, por gjithsesi ata janë të ndihmuar dhe të përkrahur nga drejtuesit e shkollës dhe sektorët e tjerë të arsimit, që kanë rol dhe përgjegjësi në mbikëqyrje dhe përkrahje të shkollave në zbatimin e kurrikulës.

Sipas Colin J. Marash (2009), termi zbatim ka të bëjë me përdorimin në praktikë të një kurrikulumi ose programi mësimor, gjegjësisht vënien në praktikë të programeve dhe lëndëve mësimore. Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i kurrikulit nuk mund të bëhet pa nxënës. Gjithashtu, është e rëndësishme të thuhet se zbatimi i kurrikulës varet në masë të madhe

nga funksionaliteti dhe serioziteti i mekanizmave institucionalë dhe në nivel shkollë, që janë të lidhur me zbatimin e kurrikulës.

Zbatimi i kurrikulës bëhet i suksesshëm atëherë kur mësimdhënësit fitojnë përvojat e duhura, njohuritë, shkathtësitë, idetë dhe qëndrimet e drejta për kurrikulën, apo programin mësimor që do ta përdorin në praktikë. Vetëm kur pranohet plotësisht nga mësuesit e një shkollë dhe kur veprimtaritë e lidhura me të kthehen në rutinë, mund të thuhet se kurrikulumit ka arritur fazën e “institucionalizimit” (Marash 2009, f. 93). Mësimdhënësit janë filtrat nëpërmjet të cilëve kalojnë kurrikulat e planifikuara. Ata luajnë rol vendimtar në planifikimin e kurrikulit shkollor, edhe pse vendimmarrja shpesh cenohet nga përpjekja për të kontrolluar dhe standardizuar gjithçka në emër të ngritjes së efikasitetit (Hyseni, Mita, Salihaj, & Pupovci 2003, f. 271). Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca, e rishikuar dhe e miratuar në vitin 2016, ka për bazë arritjen e kompetencave dhe është e mbështetur në pesë parime kryesore. Njëri nga parimet e kurrikulës bazë ka autonominë dhe fleksibilitetin, mbi bazën e të cilit shkollat dhe mësimdhënësit kanë autonominë e tyre në procesin e zbatimit të kurrikulës, mbi bazën e orientimeve të dhënave në dokumentet kurrikulare.

Praktikat e zbatimit të reformës kurrikulare në nivel shkollë kërkojnë udhëheqje efektive në zbatimin e kurrikulës, sidomos në fazat e para të procesit. Për të udhëhequr ndryshimin brenda frymës dhe kërkesave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulare, drejtori i shkollës duhet që fillimisht ta kuptojë ndryshimin që sjell kurrikula dhe ndikimin e tij në punën e përgjithshme të shkollës. Menaxhmenti i shkollës nuk shihet më si zbatues i urdhrave lart-poshtë, por si strukturë vendimmarrëse, që duhet të përqendrohet në proceset e udhëheqjes, qeverisjes, mësimdhënies e nxënies, si dhe në rezultatet mësimore të shkollës përmes një procesi gjithëpërfshirës. Rrjedhimisht, fushëveprimi i udhëheqjes së shkollës duhet të ketë në fokus mësimin dhe të nxënit, ndërsa qasja në zbatim duhet të jetë gjithëpërfshirëse (IPK, 2016, Udhëzuesi për zbatim të kurrikulës).

Elementet kryesore të lidhura me përgatitjet e shkollës për zbatimin e kurrikulës janë: (i) analiza e kontekstit të shkollës dhe krijimi i kushteve bazë për zbatimin e kurrikulës, (ii) informimi i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve me qëllimet, mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re, (iii) informimi i mësimdhënësve mbi strukturën dhe organizimin e programeve

të reja mësimore; (iv) trajnimi i mësimdhënësve dhe stafit e shkollës që mbështet zbatimin e kurrikulës së re; (v) përgatitja e materialeve përkatëse mësimore; (vi) riorganizimi i strukturave në nivel shkolle dhe menaxhimi efikas i procesit të zbatimit të kurrikulës; (vii) monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të procesit mësimor dhe mentorimi i mësimdhënësve gjatë zbatimit të kurrikulës së re; dhe (viii) bashkëpunimi me prindërit dhe partnerët e tjerë që mbështesin zbatimin e kurrikulës.

Përcaktimi i kompetencave të mësimdhënësve në Kosovë për aspektet bazë, që lidhen me kurrikulën, e ka bazën në dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (2017). Me këtë dokument përcaktohen standardet e mësimdhënësit, të cilat janë referenca kryesore për përgatitje të mësimdhënësve, përkrahje dhe zhvillimin profesional, vlerësim të performancës dhe për promovim të mësimdhënësve në karrierë. Nga shtatë standarde për mësimdhënës, tri prej tyre janë të lidhura ngushtë me zbatimin e kurrikulës: (i) demonstroi njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës; (ii) planifikon zbatim efektiv të mësimdhënies dhe mësim-nxënies; dhe (iii) planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyesë dhe raporton sa i përket mësimit të nxënësve. (MASHT, 2017, f. 17).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë që nga fillimi i procesit të zbatimit të kurrikulës ka ofruar përkrahje për shkollat dhe mësimdhënësit në forma të ndryshme, përmes punëtorive në nivel shkolle dhe rajoni për informim dhe sensibilizim lidhur me kërkesat e kurrikulës së re, trajnimit të mësimdhënësve në fazën e fillimit të pilotimit dhe zbatimit të kurrikulës, si dhe përmes ofrimit të doracakëve me udhëzime për praktikat e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re. Raporti i BE-së (2018) thekson se programet e trajnimit të mësimdhënësve deri më tani ishin të shpërndara dhe të mbështetura me projekte, zbatimi i kurrikulës së re kërkon një sërë aftësish të reja që kërkojnë burime të shumta të mësimdhënies dhe të nxënies. Për më tepër, kurrikula e re kërkon harmonizimin e trajnimit para shërbimit dhe në shërbim (Potera & Shala 2018, f. 74).

Studimet e mbështesin fuqizimin e mësimdhënësve përmes pjesëmarrjes në zhvillimin e kurrikulit. Fullan (2001) shprehet se përfshirja e mësimdhënësve në zhvillimin e kurrikulumit çon në arritjen efektive të

reformës arsimore (Fullan 2001, f. 405). Në rastin e Kosovës, kurrikulat - programet mësimore për klasë dhe lëndë përkatëse hartohen nga grupet punuese për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore, nën udhëheqjen dhe përkujdesjen e Divizionit për Kurrikula në MASHT. Kjo kërkon trajnime cilësore për mësimdhënës, në mënyrë që të sigurohet zbatimi efektiv i qasjes së re kurrikulare.

Zbatimi i kurrikulës në nivel shkolle kërkon edhe ngritje të kapaciteteve të drejtuesve të shkollave për udhëheqje të zbatimit të kurrikulës dhe përkrahje profesionale të mësimdhënësve. Përcaktimi i bazës së njohurive dhe shkathtësive të drejtorëve të shkollave për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle referohet në dokumentin Standardet e praktikës profesionale për drejtorë të shkollave në Kosovë (2012), specifikisht në standardin Mësimdhënia dhe nxënia cilësore. Brenda këtij standardi listohen disa tregues në nivel të njohurive dhe në nivel të shkathtësive, për të cilët drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri për të kuptuar zbatimin, përshtatjen, pasurimin dhe vlerësimin e kurrikulës. Në treguesit e performancës së këtij standardi, ndër të tjera, kërkohet që drejtori të inkurajojë një kulturë pritjesh të mëdha për nxënësit dhe personelin, si dhe të përshtatë dhe të zbatojë programe kurrikulare, ndër-kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, të cilat janë të disponueshme për të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë (MASHT, 2012).

Drejtnesit e shkollave në Kosovë kanë obligim të përfundojnë një program trajnimi, brenda të cilit janë përfshirë edhe kërkesat në nivel të njohurive dhe të shkathtësive që duhet të zotërojnë një drejtues shkolle për aspektet e njohjes së ndryshimeve që sjell kurrikula e re dhe për qasjen praktike që duhet të ndjekin drejtuesit e shkollave në udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle.

Një numër studimesh kanë argumentuar ndikimin e fuqishëm të drejtuesve të shkollave që mund të kenë në zbatimin e kurrikulës, Prandaj, drejtorët e shkollave, mësimdhënësit dhe stafi mbështetës duhet të punojnë drejt një qëllimi të përbashkët për të shfrytëzuar autonominë që ofron kurrikula e re, e bazuar në kompetenca, dhe kështu të përmirësojë arritjet e nxënësve (Buleshkaj 2017, f. 694).

2.2.1. Udhëheqja e zbatimit të kurrikulës së re në shkolla

Për zbatimin e reformës kurrikulare në nivel shkolle kërkohet nivel i lartë i përgatitjeve, organizimit dhe udhëheqjes së shkollës, përmbushje e funksionit themelor të shkollës për krijimin e një mjedisi që mundëson zhvillim të kompetencave të nxënësve.

Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit të shkollës për mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës

Informimi dhe përfshirja e gjithë komunitetit shkollor (udhëheqja, nxënësit, prindërit, kuadri mësimor dhe profesional, kuadri teknik dhe administrativ) që në fazën fillestare të planifikimit për zbatimin e kurrikulës është parakusht për rritjen e përfshirjes në zbatim dhe shton përgjegjësinë dhe llogaridhënien në këtë proces.

Informimi dhe sensibilizimi duhet të ndërliiden me mundësitë dhe kërkesat e reja të Kurrikulës së re, implikimet e saj në praktikat shkollore, përgjegjësia në arritjen e qëllimeve, aktivitetet përgatitore të shkollës, afatet kohore të realizimit, format e angazhimit në këtë proces, etj. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet të kuptuarit të përbashkët të ndryshimit që sjell fryma e re e kurrikulës dhe ndikimit të saj në punën e përgjithshme të shkollës, si dhe njohjes dhe ndërgjegjësimit për rolin dhe përgjegjësinë që ka secili në këtë proces.

Orientime e udhëzime për shkollat në përgatitjen e tyre për zbatimin e kurrikulës së re dhe për informimin e sensibilizimin e komunitetit të shkollës për mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës janë dhënë në dokumentet kurrikulare e udhëzuesit për mësimdhënës, Udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021, Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës dhe të udhëzuesve për zbatimin e dokumentit (IPK a, 2016, si dhe në Udhëzuesin për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë (IPK b, 2016).

Referuar dokumentit të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (MASHT, 2016), *udhëheqja e shkollës* ka rol të rëndësishëm në sigurimin e një mjedisi të favorshëm në shkollë për zbatimin e kurrikulës. Sipas dokumentit, udhëheqja e shkollës siguron që shkolla të jetë një mjedis mësimor miqësor, i sigurt dhe i këndshëm për nxënësit, ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së

arsimit në shkollë dhe llogaridhënies së mësimdhënësve, siguron që kultura e përgjithshme e shkollës dhe atmosfera në klasë të kontribuojnë në kultivimin e vlerave dhe qëndrimeve të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë, etj. (KKK, f 57).

Udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re, 2016-2021, i hartuar në kuadër të Twinning Education Project (më tutje në tekst udhërrëfyesi), (MASHT, 2016), fillon me informimin e të gjitha palëve të interesit dhe përgatitjen e shkollës për zbatimin e kurrikulës me bazë në shkollë, riorganizimin e punës së shkollës, mbështetjen për mësimdhënës, planifikimin për zbatim të kurrikulës, udhëheqjen e procesit të vlerësimit, integrimin e prindërve si partnerë aktivë në programet zhvillimore të shkollës, etj.

Pakaja e dokumenteve dhe udhëzimeve për performancën e shkollës është ndërlidhur me parimet e KKAP-së, të cilat duhet të shërbejnë si fundament dhe pika reference gjatë planifikimit, realizimit dhe vlerësimit të iniciativave që ndërmerren në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re shtetërore... Kjo nënkupton që të gjitha iniciativat dhe masat që planifikohen dhe realizohen në nivel shkolle duhet të jenë në përputhje me parimet kryesore të KKAP-së (IPK b, 2016, f. 13).

Sipas orientimeve në Udhëzuesin për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, udhëheqja e shkollës për të formësuar një vizion të përbashkët dhe për të siguruar përfshirjen e të gjithë komunitetit shkollor (përfaqësuesve të organeve qeverisëse dhe profesionale, kuadrit mësimor, prindërve, nxënësve) në procesin e zbatimit të kurrikulës, duhet të sigurojë fillimisht që gjithë komuniteti shkollor (IPK b, 2016. f. 32.):

- të jetë i njoftuar me mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës;
- t'i ketë të qarta implikimet e kurrikulës së re në praktikat shkollore të shprehura në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës;
- të jetë i vetëdijshëm për pjesën e vet të përgjegjësisë në arritjen e atyre qëllimeve;
- të jetë i njoftuar me aktivitetet përgatitore të shkollës, afatet kohore të realizimit të tyre dhe format e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces

Në përgjithësi, procesi i informimit dhe sensibilizimit të komunitetit të shkollës për mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës duhet të ofrohet nga përgjegjësit dhe në forma të ndryshme, varësisht se kujt i dedikohet informimi. Kryesisht, ky informim duhet të ndodhë përmes takimeve informative dhe konsultative, fletushkave informative, ueb-faqes së shkollës, materialeve informative, debateve me aktorët e përfshirë, etj.

Raporti i MASHT-it, i hartuar në vitin 2017, për Zbatimin e PSAK-ut 2011-2016, sjell një përmbledhje të rezultateve të monitorimit të zbatimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë, dhe, ndër të tjera, edhe informata për zhvillimet në Zbatimin e kurrikulës së re, në periudhën 2011-2016. Sipas raportit, informimi i prindërve rreth kurrikulës së re është konsideruar i rëndësishëm në planin e veprimit të PSAK-ut. Nga të dhënat e mbledhura kuptohet se janë organizuar 7 takime rajonale me drejtorë të shkollave, DKA dhe përfaqësues të tjerë të arsimit, lidhur me informimin për kurrikulën e re, mirëpo nuk dihet nëse prindërit kanë qenë të përfshirë. (pika 4.5.1. Zbatimi i kurrikulës së re, f. 57).

Përgatitja e shkollës për zbatimin e kurrikulës

Pjesa e dytë e dokumentit të KKK (2016) i referohet zbatimit të Kornizës kurrikulare, me fokus të veçantë sigurimit të një mjedisi të favorshëm në shkollë për zbatimin e kurrikulës. Sipas këtij kapitulli, për t'u zbatuar kurrikula e re kërkon angazhim të të gjithë stafit të shkollës dhe aktorëve që lidhen me shkollën. Në frymën e këtij orientimi, korniza ofron informacione për kërkesat e kurrikulës, referuar të gjitha palëve kryesore në procesin mësimor, duke filluar nga nxënësi, mësimdhënësi, shërbimi profesional i shkollës, drejtori i shkollës, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Prindërve dhe Këshilli Drejtues i Shkollës (KKK, 2016, f. 56-58).

Në pjesën e dytë e dokumentit të KKK nuk përvijohen informacione dhe orientime për punën e organeve profesionale të shkollës – për Aktivet profesionale, Këshillin e Klasave, koordinatorë të cilësisë në shkollë, etj. Mirëpo, në disa udhëzues të tjerë gjejmë orientime për punën e këtyre organeve, si: Udhëzuesi për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë (IPK, 2016); Udhëzuesit për mësimdhënës për zbatimin e kurrikulës (MASHT/IPK, 2016); Udhëzuesi për Aktivet Profesionale në shkollat e

Kosovës - Roli dhe funksioni i tyre (GIZ, 2018); dhe Manualin për sigurimin e cilësisë në shkollë (MASHT & Kultur/Kontakt Austria, 2016).

Përgatitja e shkollës për zbatimin e kurrikulës, përveç ndarjes së përgjegjësi në nivel shkolle, në raport me mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës, kërkon që shkolla të bëjë një analizë të kontekstit të përgjithshëm të shkollës, të bëjë vetëvlerësimin e performancës së shkollës, në mënyrë që të sigurohet një mjedis i favorshëm në shkollë për zbatimin e kurrikulës. Se si duhet të bëhet analiza e kontekstit të përgjithshëm të shkollës dhe e procesit të vetëvlerësimit të shkollës, në funksion të përgatitjes më të mirë të shkollës për zbatimin e kurrikulës, Instituti Pedagogjik i Kosovës, në vitin 2016, ka hartuar Udhëzuesin për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë dhe Udhëzuesin për vetëvlerësimin e performancës së shkollës (2016) – hapat kryesorë të procesit të vetëvlerësimit.

Referuar dokumentit të kurrikulës së re dhe udhëzuesve mbështetës për shkollat, shihet se gjatë procesit të zbatimit të kurrikulës vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe krijimit të një kulture të vlerësimit të vazhdueshëm, që nënkupton idenë që ndjekja e progresit në zbatimin e kërkesave të kurrikulës të bëhet kulturë e punës së shkollave. Arritja e këtij qëllimi sfidohet nëse nuk sigurohet mbështetja e duhur dhe e vazhdueshme. Raporti për vlerësimin e zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit 2017-2021, raporti për vitin 2017, thekson se ka filluar zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha shkollat, por nuk është siguruar mbështetje adekuate në harmonizim të praktikës pedagogjike, teksteve mësimore dhe praktikës së vlerësimit të nxënësve. Kushtet e mësimdhënies dhe mungesa e mjeteve adekuate të konkretizimit vazhdojnë të sfidojnë progresin në mësimdhënie dhe nxënie (MASHT, Raporti i vlerësimit të PSAK-ut, mars 2018, f. 28).

Planifikimi shkollor për zbatimin e kurrikulës së re

Zbatimi i mundësive të reja, kërkesave të kurrikulës, është i mundur vetëm me kontributin e shkollave, përmes një planifikimi shkollor gjithëpërfshirës për zbatimin e kurrikulës, i cili në nivel shkolle mbështetet në analizën e kontekstit të përgjithshëm të shkollës dhe raportin e vetëvlerësimit të shkollës. Gjithnjë, duke siguruar qasje integrale me planifikimet e MASHT-it dhe DKA-së për zbatimin e kurrikulës së re. Udhëzime dhe

orientime nga MASHT-i për procesin e planifikimit shkollor janë dhënë në Udhëzimin Administrativ: Plani Zhvillimor i Shkollës (MASHT 2016). Në vitin 2016, MASHT-i ka miratuar edhe Udhëzimin Administrativ 23/2016 për Planin Zhvillimor të Shkollës, si një dokument i obligueshëm për të gjitha shkollat.

Në udhëzuesin për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë (IPK, 2016) janë dhënë dy orientime të rëndësishme për shkollat lidhur me planifikimin shkollor për zbatim të kurrikulës: (i) ku duhet të fokusohen intervenimet në nivel shkolle⁴ dhe (ii) çka duhet pasur parasysh në kuadër të përgatitjeve/planifikimit për zbatim të kurrikulës. Në bazë të këtyre orientimeve, shkollat janë udhëzuar që të hartojnë kalendarin e aktiviteteve përgatitore për zbatimin e kurrikulës së re.

Edhe pse Plani Zhvillimor i Shkollës është potencialisht instrument për të nxitur zhvillimin e cilësisë institucionale, studimet e deritanishme kanë treguar se në këto dokumente ka përqendrim të fuqishëm në përmirësimin e infrastrukturës, pajisjeve dhe objekteve shkollore dhe materialet mësimore (Projekti i Binjakëzimit KS 11 IB OT 02, 2014). Sa u përket prioritetëve të shkollës për zbatimin e kurrikulës së re, studim i IPK-së për realizimin e PZSHS-së në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, rezultatet e anketimet të 29 drejtorëve të shkollave kanë treguar se prioritet e vendosura nga shkollat në këtë dokument ndërlidhen me rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në shkollë (93,10%), gjithëpërfshirjen (86,21%) dhe parandalimin e braktisjes (86,21%). Përgatitja e stafit për zbatimin e kurrikulës, sipas studimit, bën pjesë ndër prioritetet ‘tjera’ të parapara në PZSHS (Morina, B. 2017, f. 108).

Udhëheqja e zbatimit të kurrikulës së re

Kurrikula e re siguron nivel të rritur të autonomisë së shkollës, për të planifikuar dhe realizuar zbatimin në pajtim me kushtet specifike të kuadrit të saj mësimor, infrastrukturën e shkollës dhe karakteristikat e lokalitetit ku

⁴ Disa nga këto intervenime të sugjeruara në udhëzues: (i) Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve për zbatimin e kurrikulës; (ii) Sigurimi i një mjedisi mundësues për zbatim të kurrikulës; (iii) Funksionalizimi i organeve qeverisëse të shkollës; (iv) Funksionalizimi i organeve profesionale të shkollës dhe (v) Vendosja dhe konsolidimi i shërbimeve profesionale.

funksionon shkolla. Personeli udhëheqës i shkollës është përgjegjës për performancën arsimore të shkollës, respektivisht për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe për avancimin e arritshmërisë së nxënësve. Për aq sa rritet autonomia e shkollës, aq rritet edhe përgjegjësia e udhëheqjes për të siguruar që kjo autonomi shfrytëzohet për kërkesat e zbatimit të kurrikulës. Cilësia e menaxhimit të shkollës ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e procesit të zbatimit të kurrikulës së re, sidomos në fazat e para të procesit. Funkcioni kryesor i udhëheqjes në këtë fazë ka të bëjmë me udhëheqjen e ndryshimit. Për ta bërë këtë, fillimisht udhëheqësi i shkollës duhet ta kuptojë ndryshimin dhe ndikimin e këtij ndryshimi në punën e përgjithshme të shkollës.

Roli i udhëheqjes së shkollës në menaxhimin efektiv të procesit të zbatimit të kurrikulës, roli i organeve profesionale të shkollës, koordinatorit të cilësisë, dhe organeve të tjera të shkollës, është i përshkruar mjaft mirë në dokumentet kurrikulare: Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, Udhërrëfyesin për zbatim të kurrikulës 2016-2021, në udhëzues të ndryshëm, si: Udhëzuesi për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë; Udhëzuesi për Aktivet Profesionale në shkollat e Kosovës - Roli dhe funksioni i tyre; Manualin për sigurimin e cilësisë në shkollë; Udhëzuesi për përmirësimin e praktikave në klasë - udhëzues për drejtorët e shkollave, etj.

Studimi i realizuar nga IPK-ja me drejtorët e shkollave që ishin pjesë e pilotimit të kurrikulës së re, për rolin udhëheqës të tyre në zbatimin e kurrikulës, ka treguar se drejtorët e shkollave nuk janë të informuar sa duhet për përmbajtjet dhe kërkesat e kurrikulës së re, në mënyrë që t'i mbështesin mësimdhënësit në këtë proces. Sipas studimit, drejtorët i ndërldhin sfidat për zbatimin e suksesshëm të kurrikulës së re me: infrastrukturën dhe mjetet jo të mjaftueshme në shkolla për zbatimin e kurrikulës së re, trajnimet dhe mbështetjen e pamjaftueshme për zbatimin e kurrikulës së re, si dhe paqartësitë për planifikimin e mësimi dhe vlerësimin të nxënësve karshi kërkesave të kurrikulës së re, etj. (Shala, L. 2017, f. 68).

2.2.2. Zhvillimi profesional i mësimeve për zbatimin e kurrikulës

Zbatimi i kurrikulës bëhet i suksesshëm atëherë kur mësimeve fitojnë përvojat e duhura, njohuritë, shkathtësitë, idetë dhe qëndrimet e drejta për kurrikulën apo programin mësimor që do ta zbatojnë në praktikë. Vetëm kur kurrikula pranohet plotësisht nga mësimeve e një shkolle dhe kur veprimtaritë e lidhura me të kthehen në rutinë, mund të thuhet se kurrikulumi ka arritur fazën e “institucionalizimit” (Marsh, J. Colin, 2009, f. 18.) Mësimeve janë filtrat, nëpërmjet të cilëve kalojnë kurrikulat e planifikuara. Ata luajnë rol vendimtar në planifikimin e kurrikulit shkollor, edhe pse vendimarrja shpesh cenohet nga përpjekja për të kontrolluar dhe standardizuar gjithçka në emër të ngritjes së efikasitetit (Hyseni, H., Mita, N. Salihaj, J. & Pupovci, D., 2003, f. 271). Siç citohet nga Buleshkaj, O., (2018), Hargreaves dhe Fullan (2012, 2013) i referohen rolit të kapitalit profesional si themelor për transformimin e mësimit në shkolla dhe në sistemet shkollore në shumë pjesë të botës.

Procesi i zbatimit të kurrikulës së re, zhvillimi i kompetencave kryesore të nxënësve, nuk mund të jenë të suksesshëm nëse nuk shoqërohen me përgatitjen dhe zhvillimin e kapacitetit të mësimeve për zbatim efektiv të qasjes së bazuar në kompetenca. CASE Network Reports (Nr. 87, 2009), trajton pesë aspekte të përgatitjes së mësimeve, përfshirë: a) sistemet e kualifikimit të mësimeve, b) vlerësimin e kompetencave të mësimeve, c) zhvillimin e kompetencave specifike të mësimeve, d) kapacitetin udhëheqës dhe e) rolin qendror të mësimeve për jetësimin e qasjes së bazuar në kompetenca (cituar nga Boshtrakaj, L., 2016, f. 43).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, me ndihmën e partnerëve mbështetës, që nga fillimi i procesit të zbatimit të kurrikulës, ka bërë përpjekje të ofrojë përkrahje për shkolla dhe mësimeve, në forma të ndryshme: përmes punëtorive në nivel shkolle dhe rajoni për informim dhe sensibilizim lidhur me kërkesat e kurrikulës së re, trajnimit të mësimeve në fazën e fillimit të pilotimit dhe zbatimit të kurrikulës, si dhe përmes ofrimit të doracakëve me udhëzime për praktikën e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re.

Ka shumë debate dhe dilema për cilësinë e trajnimeve, kohëzgjatjen e tyre, qasjen e shkollës ndaj zhvillimit profesional të mësimeve dhe mbështetjes së tyre për zbatimin e përvojave nga trajnimet, përfshirë edhe trajnimet për zbatimin e kurrikulës së re. Sipas studimit Sfidat e zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, mësimeve kanë shprehur shqetësimin për rënien e cilësisë së trajnimeve (krahasuar me fazën e parë të trajnimeve), përkrahja në nivel shkolle ka munguar dhe, si rrjedhojë, përgatitja e mësimeve për zbatim të kurrikulës konsiderohet e pamjaftueshme (Boshtrakaj, L., 2019, f. 21).

Eksptë të kurrikulës dhe të zhvillimit profesional të mësimeve vlerësojnë se reforma kurrikulare nuk zbatohet me masa afatshkurtra dhe nga mësimeve nuk mund të kërkohej t'u nënshtrohen trajnimeve për ndryshimet e vazhdueshme dhe jokonsistente. Qëllimi duhet të jetë që mësimeve të përgatiten për zbatimin e çfarëdo kurrikule dhe jo për një kurrikulë të caktuar, duke shmangur qasjen tekno-rationale ndaj profesionit. Zhvillimi profesional i mësimeve duhet të marrë një kuptim më të gjerë, përtej trajnimeve dhe qasjeve formale (Mehmeti, S. 2019, f. 72).

Zhvillimi profesional i mësimeve në Kosovë vazhdon të jetë i dominuar vetëm me trajnime dhe punëtori, të ndërlidhura me programet e akredituara, që rezultojnë në certifikata të njohura nga MASHT-i për sistemin e licencimit. Kjo ka ndikuar që mësimeve të jenë të kufizuar ndaj zhvillimit profesional me bazë në shkollë dhe të orientohen vetëm në plotësimin e nevojave dhe kërkesave për licencë (Mehmeti, S. 2019, f. 75). Investimi në zhvillimin profesional të mësimeve, vlerësimin e performancës së mësimeve në klasë, si dhe sigurimin e një komunikimi ndërveprues ndërmjet mësimeve dhe nxënësve, janë të ndërlidhura dhe ndikojnë në rezultatet e nxënësve në test (Qehaja, L. & Aliu, J., 2018, f. 3).

Referuar rezultateve të studimit për qëndrimet e mësimeve ndaj kurrikulës së re, rezultojnë se shkollat dhe mësimeve, të cilët kanë marrë informata të mjaftueshme dhe të sakta, por edhe trajnim të mirëfilltë për kurrikulën, shprehin qëndrim pozitiv ndaj kurrikulës, trajnimit dhe reformës në përgjithësi, në krahasim me ata që nuk i kishin këto informata (Potera, I. & Shala, L. 2018, f. 71).

Nëse u referohemi rezultateve të studimit për përvojat e para të vlerësimit të performancës së shkollës, shkollat, kur i referohen zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë, më shumë përshkruajnë llojet e trajnimeve dhe numrin e orëve të trajnimit që kanë ndjekur mësuesit sesa përqendrimin rreth një sistemi aktivitetesh, përdorimit të përvojave dhe reflektimit për të treguar mësimet nga trajnimet dhe format tjera të zhvillimit profesional, dhe për të përmirësuar mësimin dhe të nxënës (Mehmeti, S., Boshtrakaj, L., Bytyqi, L., Zylfiu, H. & Potera, I. (2018, f. 150).

Në anën tjetër, dokumentet si Korniza për Sigurim të Cilësisë së Performancës së Shkollës (MASHT & IPK, 2016), Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimeve në Karrierë (MASHT, 2017), Udhëzuesi për Udhëheqjen dhe Zbatimin e Kurrikulës në Shkollë (IPK, 2016) ofrojnë një orientim të mirë për shkollat, se si duhet të udhëhiqet dhe të zbatohet procesi i zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë, në funksion të zbatimit me sukses të kurrikulës së re.

2.2.3. Planifikimi mësimor për zbatim të kurrikulës

Procesi i planifikimit për zbatim të kurrikulës përfshin një sërë masash e aktivitetesh në organizimin e përgjithshëm të punës në shkollë: parapërgatitjet për organizimin e procesit mësimor, parashikimin e kushteve dhe veprimtarive mësimore për një nxënie të suksesshme të nxënësve. Zhvillimi i kompetencave kërkon ndërrim të qasjes në planifikimin mësimor për zbatim të kurrikulës, përkatësisht angazhim kreativ në planifikim dhe realizim të proceseve mësimore (Boshtrakaj, L., 2016, f. 47.). Për të arritur këtë kërkohet njohje e mirë e dokumenteve kurrikulare dhe udhëzuesve për zbatim të kurrikulës, përvojë dhe praktikë profesionale në planifikim, njohje të kontekstit të shkollës, klasës, nxënësve, të mundësive përkrasë, etj.

Në përpjekje për t'i kontribuar ndërrimit të qasjes në planifikim mësimor, zhvilluesit e dokumenteve kurrikulare, në të gjitha dokumentet e zhvilluara, ofrojnë informacione të shumta për metodologjinë e mësimit, ndërsa më pak lidhur me planifikimin për zbatim të kurrikulës. Udhëzimet lidhur me planifikimin për zbatim të kurrikulës kryesisht ofrohen në Udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës - Material ndihmës për mësuesin, të hartuar në

fazën e pilotimit të kurrikulës dhe të rishikuar pas hartimit të kurrikulave lëndore/programeve mësimore.

Korniza Kurrikulare promovon kompetencat, të cilat kërkojnë planifikim të mësimdhënies dhe nxënies së bazuar në kompetenca, planifikim të integruar, përkatësisht planifikim të bazuar në të gjitha parimet e kurrikulës, duke marrë parasysh kërkesat e gjithëpërfshirjes - nevojat, përvojat dhe stilet e ndryshme të mësimnxënies së secilit nxënës, zhvillimin e kompetencave dhe qasjen e integruar dhe koherente, planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të kurrikulës, si dhe përgjegjësisë e llogaridhënies, duke iu referuar gjithë procesit të zbatimit të kurrikulës (KK, f. 25-27). Këto kërkesa jepen më në detaje në Kurrikulat Bërthamë – në kapitullin metodologjia e përgjithshme, ndërsa Kurrikulat lëndore ofrojnë udhëzime specifike, konkrete për secilën lëndë, duke mundësuar lidhjen ndërmjet fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore për klasat përkatëse.

Në të gjitha dokumentet kurrikulare (KK, KB dhe KL) është paraqitur plani mësimor për fusha kurrikulare, në mënyrë të baraspeshuar, duke marrë parasysh moshën e nxënësve dhe nevojat e tyre zhvillimore. Në Kurrikulat Bërthamë, të tri niveleve të arsimit parauniversitar, plani mësimor zërthehet për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore për secilin klasë. Gjithashtu, në Kurrikulat Bërthamë, përshkruhet autonomia e shkollës në raport me planin mësimor, në një masë të caktuar, për organizimin e planit mësimor brenda fushave kurrikulare. Mbi këtë bazë lejohet përcaktimi i orëve shtesë (mbi minimumin e orëve mësimore), për lëndët përkatëse, duke ofruar arsyeshmërinë për kontributin e orëve shtesë në rezultatet e të nxënësve, si dhe orientimet për realizimin e orëve shtesë gjatë viteve që mbulon shkalla kurrikulare. (IPK - udhëzuesi për zbatim të kurrikulës, f. 52). Te klasa përgatitore nuk është e caktuar koha për fusha kurrikulare, vetëm thuhet se *“nxënësit gjatë javës kalojnë nëpër të gjitha fushat kurrikulare”*.

Kurrikulat lëndore/programe mësimore, të hartuara nga grupet punuese të udhëhequra nga MASHT/Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve, përmbajnë: pjesën e hyrjes, qëllimin, temat dhe rezultatet e të nxënësve, udhëzimet metodologjike, udhëzime për zbatimin e çështjeve

ndërkurrikulare, udhëzime për vlerësim, si dhe udhëzimet për materialet dhe mjetet mësimore, të nevojshme për të arritur rezultatet e lëndës.

Në kurrikulën lëndore për secilën klasë është paraqitur plani mësimor për klasën përkatëse, ku përcaktohet fondi i orëve javore për fushat kurrikulare, përveç klasës përgatitore, ku sugjerohet që plani mësimor të jetë i integruar. Për klasën përgatitore është përcaktuar totali i orëve javore, ndërsa përcaktimi i fondit të orëve për fusha kurrikulare mbetet në kompetencë të edukatoreve. Shkollës i mbetet të përcaktojë fondin e orëve për lëndë mësimore dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

Gjithashtu, në kurrikulat lëndore janë dhënë udhëzime të përgjithshme për përfshirjen e çështjeve ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare në planifikimin mësimor, udhëzime pothuajse të njëjta për klasën përgatitore, klasën e parë, të dytë, të gjashtë dhe të shtatë, me disa dallime në disa kurrikula lëndore. Janë dhënë udhëzime për përzgjedhjen e temave me të cilat përballet shoqëria tani dhe mund të përballet edhe në të ardhmen.

Siç u përshkrua më lartë, udhëzime më në detaje lidhur me planifikimin mësimor janë dhënë në Udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës - Material ndihmës për mësimdhënës, të përgatitur nga MASHT-i dhe IPK-ja në fazën e pilotimit të kurrikulës, të cilët pastaj janë rishikuar pas zhvillimit të kurrikulave lëndore. Udhëzuesit e hartuar për shtatë fushat kurrikulare, udhëzuesi për kurrikulën me zgjedhje dhe udhëzuesi për klasën përgatitore dhe nivelin fillor, ofrojnë udhëzime të nevojshme për mësimdhënësit, për ndërlidhjen e programeve lëndore, përgatitjen, planifikimin dhe zbatimin në praktikë të kurrikulës, për hapat në të cilët duhet të kalohet gjatë planifikimit, duke filluar nga planifikimi mësimor për shkallë kurrikulare, planifikimi mësimor vjetor, planifikimi për periudha mësimore/ planifikimi dymujor, hapat që duhet ndjekur gjatë planifikimit javor dhe planifikimit të orës mësimore, si dhe aspektet tjera që duhet të përmbajë secili nivel i planifikimit mësimor.

Udhëzime për planifikim mësimor, për zbatim të kurrikulës, gjejmë edhe në udhëzuesit tjerë, të hartuar në kuadër të projekteve nga partnerët që mbështesin MASHT-in, si: EU, GIZ, USAID, UNICEF, Save the Children,

etj. Ndërsa, hapat dhe procedurat e planifikimit të aktiviteteve jashtëshkollore përshkruhen në udhëzimin administrativ (nr. 02/2016) për aktivitetet jashtëshkollore, sipas të cilit drejtoria e shkollës dhe aktivet e mësimdhënësve duhet të organizojnë aktivitete të ndryshme, që janë kërkesë edhe e kurrikulës së arsimit, me ç'rast aktivizohen të gjithë nxënësit, pa dallim, sipas planifikimit vjetor të shkollës.

2.2.4. Planifikimi i PIA-s sipas kurrikulës së re

”Një plan individual nuk është përsëritje e planeve të tjera, por duhet të jetë pjesë plotësuese e planifikimit shkollor”, PEI.

PIA është dokument zyrtar pedagogjik, që shërben për planifikimin sistematik të edukimit dhe arsimit, mësimdhënies dhe nxënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës (UA nr. 18/2013, neni 2.3). PIA duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, nxënësit (kur është e arsyeshme) dhe personelin tjetër përkatës. PIA është një dokument i besueshëm (konfidencial) dhe pa lejen e prindit nuk mund të ketë qasje askush tjetër, përveç ekipit hartues. PIA i referohet përshtatjes së kurrikulës dhe fokusohet në nevojat me prioritet të fëmijës/nxënësit. Ky dokument duhet të hartohet për secilin fëmijë, për të cilin ekipi vlerësues komunal apo ekipi në nivel institucioni ka marrë vendim për mbështetje individuale arsimore përmes PIA-s.

PIA është në harmoni me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, e cila udhëhiqet nga parimi i gjithëpërfshirjes, që nënkupton ofrimin e mundësisë për përfshirje dhe qasje të barabartë të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve në arsim cilësor. PIA është modifikuar, përshtatur, sipas kurrikulave lëndore - planeve dhe programeve mësimore, standardeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme, njëkohësisht duke respektuar nevojat, mundësitë dhe interesimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, varësisht nga niveli i aftësive të kufizuara. PIA ngërthen në vete gjithë procesin e mbështetjes së fëmijës, që nga marrja e vendimit për PIA.

Sipas hulumtimeve të bëra nga IPK-ja, për të gjithë nxënësit e përfshirë në Qendra Burimore hartohen PIA, ndërsa për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, 69% e mësimdhënësve

deklarohen se plotësojnë PIA (Reçica/Havolli. S, 2017,f. 89), por është vërtetuar se ka mangësi në hartimin dhe zbatimin e tyre. Ndërsa, rreth 92% e edukatoreve mbështetëse në institucionet parashkollore gjithëpërfshirëse hartojnë PIA për fëmijët, prindërit e të cilëve pranojnë PIA për fëmijët e tyre, por ka prindër të cilët nuk pranojnë të punohet me këtë dokument (Reçica/Havolli. S.& Mekolli. S,2018, f. 108). Sipas gjetjeve në raportin e hulumtimit: *Analiza e situatës- Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë*, ka shumë fëmijë me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e rregullta dhe shpeshherë regjistrohen pa u identifikuar si të tillë, pa vlerësim paraparak, ose plan të individualizuar arsimor (BE & UNICEF, 2017 f. 88).

2.2.5. Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies

Metodologjia e mësimdhënies është pjesë përbërëse e dokumenteve kurrikulare, referuar parimeve të kurrikulës, rezultateve të të nxënit, përshkrimit të shkallëve kurrikulare, kapitujve të veçantë në Kurrikulat Bërthamë për nivele, Kurrikulat lëndore/programet mësimore, si dhe Udhëzuesve për zbatimin e kurrikulës. Arsyeja e përfshirjes së çështjeve metodologjike në të gjitha dokumentet është bërë me qëllim orientimi të mësuesve në aspektet kryesore të zbatimit të përmbajtjeve kurrikulare. Fokusi i orientimeve të përvijuara në dokumentet kurrikulare për metodologjinë e mësimdhënies dhe nxënies përfshin aspekte për:

- mësimdhënie dhe nxënie me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirje;
- mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar;
- mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave;
- mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar;
- çështje/tema ndërkurrikulare; dhe
- çështje jashtëkurrikulare.

Referuar analizës së Kornizës Kurrikulare dhe Kurrikulave Bërthamë për nivelet e arsimit (KB 1; KB 2 dhe KB3), mund të konstatohet se çështjet metodologjike të mësimdhënies dhe të zbatimit të përmbajtjeve kurrikulare janë adresuar mjaftueshëm, edhe pse në formë të përgjithësuar.

Në anën tjetër, duke iu referuar udhëzimeve për metodologjinë e mësimdhënies në Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, shohim se ofrohen sugjerime dhe propozime për aspektet metodologjike nga perspektiva e lëndës mësimore përkatëse, jo shumë nga fryma dhe filozofia e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Ka kurrikula lëndore për lëndë specifike që fare shkurt ofrojnë udhëzime metodologjike. Për shembull, në programin mësimor Gjuhë shqipe fare shkurt jepen udhëzime metodologjike, thuhet se vetëm duhet të përdoren strategji dhe teknika të ndryshme, aktivitete kreative, por nuk jepen shembuj praktikë të qasjes metodologjike për arritjen e rezultateve të nxënit dhe zhvillimin e kompetencave, në ndërlidhje me specifikat e lëndës së Gjuhës shqipe. Nuk vërehen dallime të mëdha sa i përket fushës së gjuhës as në klasën e parë dhe të dytë, e po ashtu edhe në klasën e gjashtë dhe të shtatë nuk vërehet ndonjë dallim sa i përket Gjuhës shqipe. Në klasën e gjashtë dhe të shtatë dallime vërehen te programet e gjuhëve të huaja, pasi kanë një metodologji më të qartë dhe më të zgjeruar në përmbajtje.

Edhe në programin mësimor Edukatë figurative thuhet pak për metodologjinë në klasën përgatitore dhe në klasën e parë dhe të dytë. Thuhet që përzgjedhja e metodave bëhet nga mësimdhënësi, por nuk thuhet se çfarë metodash të përdoren, mungojnë shembujt. Megjithatë, më shumë sqarime sa i përket metodologjisë në këtë fushë jepen në klasat gjashtë dhe shtatë.

Në programin mësimor Edukatë muzikore thuhet se përzgjedhja e metodave bëhet nga mësimdhënësi, në përputhje me standardet e zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe kurrikulës bërthamë. Në këtë program jepen më gjerësisht udhëzimet për mësimdhënësin, në krahasim me fushat e tjera.

Në programin mësimor të Matematikës, në klasën përgatitore thuhet se metodologjia bazohet në parimet e Kurrikulës bërthamë, megjithëse fare shkurt jepen udhëzime metodologjike, më tepër në cilat aspekte duhet të përqendrohet edukatorja gjatë punës. Në fushën e Matematikës po ashtu kemi pjesën e udhëzimeve metodologjike, në të cilën thuhet se mësimi i matematikës bëhet me metoda të avancuara dhe forma moderne. Jepen udhëzime se çfarë duhet të bëjnë mësuesit, si të ndërtojnë punën dhe në cilat aspekte të përqendrohen.

Në programin Njeriu dhe natyra, te pjesa e metodologjisë, jepen më tepër udhëzime metodologjike për mësimdhënësit, se çfarë metodash dhe teknikash duhet të përdorin, me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore. Fusha Shoqëria dhe mjedisi përmban pjesën e udhëzimeve metodologjike, në të cilën kërkohet të përdoren një varg teknikash dhe metodash të mësimdhënies, në pajtim me moshën dhe interesin e nxënësve.

Programi mësimor Edukatë fizike, Sportet dhe Shëndeti kërkon udhëzime metodologjike që i ofrojnë nxënësve gjithëpërfshirje, përmes mjeteve përkatëse didaktike, që lidhen me sportin, pastërtinë, kujdesin për higjienën dhe aktivitetin fizik, me qëllim të arritjes së rezultateve të kompetencave.

Në programin Shkathësi për jetën, te pjesa e udhëzimeve metodologjike, rekomandohet puna në grupe, përmes projekteve, dhe jepen sugjerime se në cilat metoda duhet të përqendrohet edukatorja në klasën përgatitore. Në fushën Shkathësi për jetën po ashtu jepen udhëzime për mësimdhënësit, lidhur me metodologjinë e mësimdhënies, metodave dhe teknikave që duhet të përdoren. Në këtë fushë mësimdhënësit udhëzohen se çfarë teknikash të përdorin. Metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies edhe në lëndët e Historisë dhe Gjeografisë janë ndër pikat kyçe të programit për një mësimdhënie të suksesshme, megjithëse nuk vërehen dallime të mëdha ndërmjet klasave.

Për arritjen e rezultateve të parapara në programin e lëndës së Edukatës qytetare thuhet se përdoren një sërë metodash dhe teknikash të mësimdhënies, por nuk jepen shembuj se çfarë metodologjish duhet të përdoren.

Në lëndën e Fizikës thuhet se kërkimi shkencor është baza e kompetencave dhe metodat që mund të përdoren, si vëzhgimi, metodat eksperimentale dhe empirike, formimi i një ideje (hipotezës) për përdorimin e TIK-ut etj. Në përgjithësi, në kurrikulat lëndore nuk ka ndonjë dallim të madh ndërmjet klasave sa i përket pjesës së metodologjisë së mësimdhënies.

Fusha e Arteve dhe ajo e Matematikës qëndrojnë më mirë sa i përket pjesës së metodologjisë, por, në krahasim me lëndët e tjera, edhe te Gjuhët e huaja dhe fizika vërehet një dallim për të mirë sa u përket udhëzimeve metodologjike për zbatim.

Në të gjitha fushat thuhet se përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënës të lëndës. Nga mësimitdhënësi kërkohet të bëjë përshtatjen e metodologjisë me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve, etj.

Kuadri i udhëzimeve për metodologji të mësimitdhënies dhe nxënies plotësohet edhe me udhëzuesit për përmirësimin e praktikave në klasë, të hartuara me mbështetje nga projekti SWAP dhe nëntë udhëzuesit (sipas fushave kurrikulare, për nivelin fillor dhe kurrikulën me zgjedhje) për zbatimin e kurrikulës, të përgatitur nga MASHT-i dhe IPK-ja. Në anën tjetër, zhvillimi i kurrikulave lëndore për klasë nuk është përcjellë me udhëzues të veçantë, me idenë e ruajtjes së qasjes së integruar dhe me idenë se botimi i teksteve të reja do të përcillet me libra për mësues, të cilat në parim duhet të përmbajnë edhe udhëzime metodologjike.

Marrë në përgjithësi, mund të konstatohet se çështjet metodologjike janë adresuar në dokumentet bazë dhe udhëzuesit mbështetës për realizimin e mësimitdhënies në zbatim të kurrikulave. Duke pasur parasysh filozofinë e kurrikulës së re, ndihet nevojë më e madhe për ofrimin e mundësive shtesë për qasje metodologjike në përputhje me këtë filozofi, meqenëse arritja e rezultateve të të nxënies, sidomos arritja e kompetencave, kërkon më shumë qasje kreative nga ana e mësimitdhënësve. Udhëzimet për një qasje më kreative ndaj mësimitdhënies për arritjen e kompetencave nuk janë adresuar sa duhet në të gjitha burimet e analizuara. Një pjesë e tyre ka mbetur që të arrihet gjatë trajnimit për zbatimin e kurrikulës dhe pjesa tjetër në shkathtësinë dhe gjeturinë e mësuesit.

Zbatimi i metodologjive dhe të praktikave të mësimitdhënies në funksion të zbatimit të kurrikulës është trajtuar në studime dhe raporte të ndryshme, që lidhen me kontekstin e Kosovës, por edhe në studime të tjera. Për kontekstin e Kosovës, lidhur me zbatimin e metodologjive dhe të praktikave të mësimitdhënies me interes është Raporti i Institutit të Londrës (2005), i cili është mjaft gjithëpërfshirës dhe aktual edhe për reformën e fundit. Në pjesën për metodologjinë dhe pedagogjinë e zbatimit raporti konstaton:

“Kishte disa raste të mësimitdhënies dhe nxënies së shkëlqyeshme me stil më pjesëmarrës të mësimitdhënies, si në

nivelin fillor ashtu edhe në atë të mesëm. Megjithatë, sidomos lidhur me qasjet më pjesëmarrëse, hasëm në shumë dëshmi se kishte edhe shumë nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të nivelit të kuptimit, të shkathtësive të mësimdhënies, dhe të mendimit kritik për metodologjitë pjesëmarrëse të nxënies” (Instituti i Edukimit, IE, 2005, f. 31).

Prandaj, qysh në reformën e parë, Kurrikulin e vitit 2001, sipas Raportit të IE (2005), janë vërejtur ndryshime pozitive në qasje, si rezultat i reformës, sidomos ‘...roli i mësimdhënësve në klasë ka ndryshuar skajshëm’ (ibid.,33). Gjithashtu, edhe ‘nxënësit janë gjithnjë e më të inkurajuar që të jenë përgjegjës për nxënien e vet (IE, f. 33). Megjithatë, sipas raportit, ende ka nevojë të ndryshojë roli i nxënësit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Edhe sa u përket formave të punës me nxënës, edhe pse kurrikula e ri i adreson, megjithëse jo në nivel të zbatimit, gjë që do duhej të bëhej me udhëzuesit për zbatim të kurrikulës, IE konstaton se ‘puna grupore është metoda e mësimdhënies që më së shpeshti shoqërohet me metodologjitë e reja të mësimdhënies, por ... duhej që nuk kuptohej se efektiviteti i kësaj metode varet nga lidhja e saj me objektivat e nxënies dhe me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura të nxënies (IE, f. 33).

Të njëjtat gjëra, ose të përafërta, janë konstatuar edhe me rastin e vizitës në shkolla, gjatë grumbullimit të materialeve për këtë studim, kur edhe në rastet joadekuate përpiqej të organizohej puna në grupe, ose mësimdhënësit kanë numër të madh materialesh didaktike të punuara nga nxënësit dhe të cilat nuk gjenin përdorim. Kishte shkolla në të cilat në çdo kënd kishte materiale të mira për demonstrim, në funksion të zbatimit të KB, por që pak shfrytëzoheshin, ose kishin hezitim, pasi nuk e kishin të qartë se arritjen e cilës kompetencë e ndihmojnë. Qasja metodologjike e zbatimit, ose vetë filozofia e Kurrikulës aktuale, kërkon shkathtësi të reja dhe autonomi profesionale/ pedagogjike të mësuesit për realizimin e parimeve të saj (Potera, 2017, f. 64).

Kurrikula e re kërkon ambient dhe qasje mundësuese për secilin fëmijë që të zhvillohet maksimalisht në bazë të potencialeve dhe mundësive të tij/saj. Hulumtime në këtë fushë, hulumtime për metodologji specifike të mësimdhënies për fëmijët me nevojë të veçanta, janë bërë edhe në Kosovë

(Reqica-Havolli, S., 2017). Sipas gjetjeve, mësimdhënësit kanë identifikuar metodologji specifike të punës me fëmijë me nevoja të veçanta. Po ashtu, një hulumtim është realizuar edhe nga mësimdhënësit udhëtues të Qendrave Burimore, me qëllim të identifikimit të praktikave të mira për gjithëpërfshirje dhe metodologjive të punës (MASHT, Praktika të mira të gjithëpërfshirjes, 2017).

2.2.6. Vlerësimi i nxënësve

Ndryshimi i vlerësimit të nxënësve, nga një qasje tradicionale e vlerësimit të bazuar në informata për përmbajtjen e mësuar dhe në numër të kufizuar të instrumenteve për të vlerësuar se sa nxënësi ka mbajtur mend faktet e të dhënat, drejt një ndryshimi të qasjes në vlerësim me bazë kompetencat, ku në fokus është nxënësi, përdorimi i një spektri të gjerë të instrumenteve për të vlerësuar kompetencat e nxënësve: shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre, dhe jo vetëm dijen e njohuritë e tyre, etj., është ndryshimi më i madh në sistemin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë.

Zbatimi i qasjes së bazuar në kompetenca vështirë se mund të arrihet nëse kompetencat përkatëse nuk janë të adresuara si duhet në sistemet e vlerësimit. Gjithsesi, procesi i vlerësimit të nivelit të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave është shumë i komplikuar dhe sfidues (Boshtrakaj, L., 2016, f. 38). Aspektet përmbajtjesore të reformës në vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së re përvijohen në dokumentet kurrikulare dhe në udhëzimin administrativ që rregullojnë sistemin e vlerësimit të nxënësve⁵. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës përcakton qëllimet, parimet dhe llojet e vlerësimit, të cilat sigurojnë ndërlidhjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vlerësimit.

Sipas Kornizës Kurrikulare (2016), qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënit të nxënësve. Përmes sistemit të vlerësimit të nxënësve, të përcaktuar me Kornizën Kurrikulare, kërkohet të sigurohen informacione të vazhdueshme për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit, përshtatshmërinë

⁵ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.(2016). Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 08/2016 për Vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve.pdf>

e kurrikulës dhe përmirësimin e shkollës. Mbi bazën e këtyre informacioneve, synohet të merren vendime dhe planifikohen veprime në përkrahje të nxënësve, për zotërim të kompetencave dhe përmirësim e avancim të procesit të vlerësimit në përgjithësi.

Ashtu sikurse për aspektet metodologjike, tekstet dhe materialet mësimore, në Kurrikulat Bërthamë për nivele të arsimit, ofrohen informacione dhe orientime edhe për vlerësimin e nxënësve. Ato në masë të madhe janë përcaktuese, por me gjuhë të përgjithshme dhe orientuese për mësimdhënës dhe përgjegjës të tjerë që kanë rol në vlerësimin e nxënësve. Kryesisht u referohen parimeve të vlerësimit, llojeve të vlerësimit, qëllimeve të vlerësimit dhe dokumentimit të vlerësimit. Përshkrimi i vlerësimit të nxënësve në Kurrikulat Bërthamë, përgjithësisht, është i njëjtë, me dallime fare të vogla për specifikat e niveleve të arsimit, apo të shkallëve kurrikulare.

Në anën tjetër, edhe në programin mësimor të secilës lëndë mësimore për klasat përkatëse janë dhënë udhëzime për vlerësimin e nxënësve. Udhëzimet në programet mësimore dallojnë shumë në përdorimin e koncepteve për vlerësim, në shtrirjen e udhëzimeve për mësimdhënës dhe në strukturim. Në përgjithësi, udhëzimet në programet mësimore lëndore nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm se si mësimdhënësit i qasën vlerësimit të bazuar në kompetenca.

Një konfuzion i përgjithshëm është krijuar me vlerësimin e fëmijëve në klasën përgatitore. Si në Udhëzimin Administrativ (UA), nr. 08/2016, për Vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në kurrikulat lëndore/programet mësimore, nuk ka një specifikim të qartë të vlerësimit të fëmijëve në këtë klasë, kundrejt klasave 1 dhe 2, të shkallës së parë të kurrikulës. Kjo ka çuar në përgatitjen e ditareve të klasës të njëjtë dhe në vlerësimin e njëjtë, pavarësisht specifikave dhe dallimeve në moshën e fëmijëve parashkollorë, të klasës përgatitore.

MASHT/Divizioni për Vlerësim dhe Standarde, në përpjekje për të përkrahur mësimdhënësit në komponentin e vlerësimit të nxënësve bazuar në kurrikulën e re, kanë bashkëpunuar me partnerët që mbështesin MASHT-in në zhvillimin e manualeve të ndryshme për vlerësimin e nxënësve dhe të

programeve për trajnimin e mësimeve⁶. Mirëpo, në programet e trajnimit për mësime, në fushën e vlerësimit të nxënësve, nuk kanë marrë pjesë të gjithë mësime. Në anën tjetër, nuk ka raporte për shpërndarjen e udhëzuesve të zhvilluar për këtë fushë tek të gjithë mësime.

Cilësia e vlerësimit të nxënësve, në radhë të parë, është e lidhur me kompetencat e mësime në këtë fushë. Në dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësime në Kosovë janë përvijuar fushat e mësime, standardet dhe treguesit e performancës. Vlerësimi i nxënësve është një nga shtatë standardet e mësime për mësuesit në Kosovë. Ka filluar procesi i vlerësimit të performancës së mësimeve, mirëpo akoma nuk ka raporte përmblendhëse për të analizuar kompetencat e mësimeve në fushën e vlerësimit të nxënësve.



⁶ Disa nga manualët/doracakët e përgatitur për mësime, lidhur me vlerësimin e nxënësve, janë si në vijim:

- Basic Education Program (2012). Vlerësimi Formativ - Udhëzues për mësime. Botimi i dytë, shkurt, 2013, Prishtinë.
- Divizionit për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim (MASHT, 2016). Vlerësimi sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca - udhëzues për mësime. Basic Education Program – USAID, Prishtinë.
- Zhitija- Gj., M. & Mulolli- J., M. (2015). Vlerësimi i nxënësve bazuar në portfolio - doracak për mësime. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë.
- GIZ (2015). Vlerësimi përmblendhës dhe hartimi i testit si pjesë e rëndësishme e tij për klasat 1- 9 - Doracak për mësime.
- MASHT & GIZ IS (2013). Moduli 5 për Aftësimin e Mësimeve në Shërbim: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). Udhërrëfyesi për kurrikulë 2016 – 2021. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/udherrefyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>
- Udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës (Material ndihmës për mësime / sipas fushave kurrikulare / MASHT & IPK, 2016);

Lidhur me vlerësimin e nxënësve janë ngritur shqetësime të shumta si nga prindërit ashtu edhe nga komuniteti i mësimdhënësve. Edhe në raportin e studimit nga Instituti i Londrës, për Planet dhe programet kombëtare në Kosovë – vlerësimi i hapave të parë (2005), pasqyron disa konstatime lidhur me problemet që lidhen me vlerësimin e nxënësve, të cilat janë akoma aktuale, si: vlerësimi i brendshëm i nxënësve nuk monitorohet në shkallë kombëtare; nuk ka pasur theksim të duhur për rishikimin e qasjes së vlerësimit për t’u përputhur më mirë me filozofinë e kurrikulës, shumica e vlerësimit në klasë përkonte me mbamendjen e informacioneve ose aftësinë për llogaritje të numrave; dallojnë shumë standardet e vlerësimit, p.sh. nxënësit nga zonat rurale nuk arrijnë t’i arsyetojnë notat e veta në provimet pranuese, etj.

Problemet dhe të metat e sistemit të arsimit parauniversitar në Kosovë në përgjithësi, dhe të praktikës së vlerësimit të nxënësve në veçanti, janë reflektuar edhe në testin PISA 2015. Raporti i publikuar nga MASHT-i, (dhjetor, 2016), tregon se nxënësit 15-vjeçar të Kosovës kanë arritur mesatare në shkencë, 378 pikë, krahasuar me mesataren prej 493 pikësh në vendet e OBZHE-së; në matematikë 362 pikë, krahasuar me mesataren prej 490 pikësh në vendet e OBZHE-së; dhe në lexim 347 pikë, krahasuar me mesataren prej 493 pikësh në vendet e OBZHE- së.

2.2.7. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore

Teksti shkollor është libër (që ndryshon nga librat e tjerë në përdorim) themelor për secilën lëndë, i shkruar në bazë të planit dhe të programit mësimor, në të cilin përmbajtjet i ofrohen nxënësit me aparaturë didaktike të rregulluar, me qëllim që nxënësit t’i përvetësojnë dituritë e nevojshme, t’i zhvillojnë aftësitë e tyre dhe kulturën e punës, duke ofruar material për punë të pavarur dhe krijuese. Tekstet shkollore janë pjesë përbërëse dhe shumë e domosdoshme e procesit mësimor. Shikuar historikisht, teksti mësimor është vlerë pedagogjike, tradicionalisht e verifikuar mjaft nga pikëpamja e funksionit dhe e vlerës së tij didaktike.” (Ramaj, A. 2001, f. 18).

Sipas UNESCO-s, tekstet shkollore duhet të nxisin çdo element të procesit të nxënies dhe roli i tyre të mos kufizohet vetëm mbi nxënien e njohurive

faktike, si cilësi që nxit aktivisht nxënësin drejt procesit të ndërtimit të dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për t'u bërë qytetar i përgjegjshëm në komunitetin që jeton.

Në traditën e punës së shkollave, teksti shkollor është dokumenti bazë dhe më i rëndësishmi në duar të nxënësit dhe mësimitdhënësit, i cili përdoret në të gjitha fazat e realizimit të një ore mësimore, nga mësimitdhënësit dhe nxënësit, por, gjithashtu, mund të përdoret edhe jashtë procesit mësimor të rregullt, në procesin e vetëpërgatitjes së nxënësit për mësim, në shtëpi etj. Teksti shkollor u shërben njëkohësisht:

- Arsimtarëve, për përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e mësimitdhënies dhe shtjellim të diturive, në formë të sistematizuar dhe të përmbledhur;
- Nxënësve, për përdorim të përditshëm, për arsimimin e tyre, si burim themelor për përvetësimin e diturive për lëndën e caktuar në shkollë dhe për përsëritje dhe ushtrime në shtëpi.

Studime të shumta flasin për tekstet shkollore, si një nga burimet kryesore që lehtëson punën e mësimitdhënësve dhe nxënësve, por jo si një burim të vetëm. Nevoja e hartimit të teksteve të reja duhet të ndërlidhet edhe me futjen e teknologjisë informative, përshtatjen e mësimitdhënies me metodat dhe teknikat e reja të të mësuarit (të mësuarit problemor, sipas roleve, me projekte etj).

Për zbatimin e dokumenteve kurrikulare në nivel shkolle dhe klase, përveç tjerash, nevojiten edhe tekstet shkollore, si dhe materialet plotësuese të mësimitdhënies dhe nxënies. Këtë e orienton edhe Ligji Nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, por që akoma nuk është rishikuar pas aprovimit të dokumenteve të reja kurrikulare dhe fillimit të zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi. Ligji për tekste shkollore “tekstin shkollor” e përcakton si libër themelor dhe të obligueshëm, që shërben si mjet themelor dhe burim i dijes për fushën e caktuar, me përdorimin e të cilit

arrihen objektivat edukativo-arsimore të përfshira në plan dhe program mësimor⁷.

Në funksion të teksteve shkollore janë hartuar edhe standardet për tekstet shkollore. Dokumenti i standardeve (UA nr. 05/2011) përmban 15 standarde të përgjithshme, të ndara në 4 fusha, me gjithsej 72 tregues, si dhe standardet sipas lëndëve apo fushave lëndore, për vlerësimin e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar⁸. Standardet janë një bazë e mirë edhe për hartimin e teksteve shkollore bazuar në kurrikulën e re.

Për përdorimin e teksteve shkollore, në funksion të kurrikulës së re, gjejmë udhëzime në Kurrikulat Bërthamë, në planet dhe programet mësimore për lëndë dhe klasë, në udhëzuesit për fushat kurrikulare, që përdoren në trajnimin e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re, si dhe në udhëzimet e përgatitura nga hartuesit e planeve dhe programeve mësimore.

Sipas udhëzimeve të Kurrikulës Bërthamë, tekstet shkollore duhet të përdoren në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe informacionet mund të merren nga çdo burim, i cili ndihmon arritjen e kompetencave. Mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të rezultateve, mundësive psikofizike të nxënësve, përvojave, kulturës dhe stileve të nxënies së tyre, varësisht prej kërkesave që ka secila fushë mësimore.

Në të gjitha planet dhe programet mësimore për klasë dhe lëndë mësimore, të hartuara sipas kurrikulës së re, ofrohen udhëzime për materialet didaktike dhe burimet e mjetet mësimore, përfshirë edhe tekstet shkollore. Udhëzimet kanë dallime në programe të lëndëve të ndryshme të klasës së njëjtë, disa janë më të detajuara, ndërsa disa janë shumë të përgjithshme, si p.sh. në lëndën e Gjuhës shqipe (klasa 2): *Nga mësimdhënësi mund të përdoren të gjitha burimet, mjetet dhe materialet që ndihmojnë arritjen e rezultateve dhe kompetencave të lëndës për këtë klasë. Mësimdhënësi mund të krijojë materiale të ndryshme didaktike, të cilat ndihmojnë arritjen e rezultateve të të nxënit.* Udhëzimet e njëjta janë dhënë edhe në programin e klasës

⁷ Ligji Nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, Dispozitat e përgjithshme.

⁸ UA 05/2011 Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore.

përgatitore dhe klasat 3, 6 dhe 7. Kjo qasje uniforme në udhëzime vërehet edhe në lëndët tjera mësimore.

MASHT-i, duke e parë nevojën e domosdoshme për t'i ndihmuar mësimdhënësit në përdorimin e teksteve aktuale (teksteve të hartuara sipas programeve mësimore të zhvilluara në vitet 2001-2006), sipas kërkesës së kurrikulës së re, ka hartuar disa udhëzues për secilën fushë të Kurrikulës, në të cilët jepen sugjerime dhe udhëzime se si të përdoren tekstet aktuale për zbatimin e programit arsimor, në fushat: Gjuha dhe Komunikimi, Jeta dhe puna, Matematika, Ed. Fizike, Shoqëria dhe mjedisi, dhe Shkencat natyrore.

Kalendari i zhvillimit të teksteve të reja shkollore, sipas kurrikulës së re, është pjesë e udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. Pavarësisht orientimeve në këtë dokument, që zhvillimi i teksteve të reja për klasat e para të nivele të arsimit që fillon zbatimin i kurrikulës të bëhet gjatë vitit shkollor 2016/2017, një gjë e tillë nuk është arritur. Për këtë vit shkollor (2019/2020) janë përgatitur tekstet e reja për klasën përgatitore, klasat 1, 2, 6, 7 dhe 10, 11. Ndërsa kurrikula e re në shkallë vendi vazhdon të zbatohet edhe në klasat 3, 8 dhe 12, por me tekste të vjetra, të cilat nuk janë të bazuara në frymën e kurrikulës së re, përkatësisht në kurrikulat lëndore për këto klasa.

Mungesa e teksteve të reja, për klasat në të cilat zbatohet kurrikula e re, në masë të madhe ka sfiduar punën e mësuesve dhe nxënësve. Zhvillimet aktuale në përgatitjen e teksteve të reja mësimore nuk sigurojnë që shpejt të bëhet kompletimi i tyre për të gjitha klasat që punojnë me kurrikulën e re, programet të reja mësimore. Zhvillimet mund të pengohen nga mangësitë në kuadrin ligjor për tekstet shkollore. Studimi *Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë* (Boshtrakaj, L., Rraci, E., & Bajrami, K., 2019) identifikon disa mangësi kryesore në kuadrin rregullativ, në bazë të të cilit është duke u bërë hartimi dhe vlerësimi i teksteve të reja, si: Mungesa e përputhshmërisë ndërmjet dokumenteve që rregullojnë procesin e hartimit, vlerësimit dhe miratimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore; boshllëqet në trajtimin e aspekteve esenciale që rregullojnë këto procese dhe paqartësi të shumta procedurale; anashkalimi i masave të rëndësishme në procesin e përgatitjeve për hartimin e teksteve të reja dhe në procesin e vlerësimit të

tyre; dhe moskonsolidimi i mekanizmave për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore.

Publikimi i teksteve të reja dhe fillimi i përdorimit të tyre kanë ngritur debate, polemika dhe shqetësime për cilësinë e teksteve. Këto kritika meritojnë studime më të thelluara për të verifikuar problemet evidente dhe për të orientuar adresimin e tyre.

Në anën tjetër, studimi *Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë* (Boshtrakaj, L., Rraci, E., & Bajrami, K., 2019)⁹ nxjerr në sipërfaqe shqetësime të shumta të mësimdhënësve lidhur me tekstet e vjetra, që janë duke i përdorur në klasat ku zbatohet kurrikula e re. Ato lidhen me mungesë të aktualitetit, relevancës dhe përputhshmërisë me kurrikulën e re, mbingarkesë me tema, tekst, fakte, formula, mungesë të referencës në burime të tjera për informata shitesë, mospërshtatje me nivelin kognitiv të nxënësve, mungesë të ndërlidhjes/mundësisë me informatat dhe përvojat paraprake të nxënësve, mungesë të korrelacionit ndërkurrikular; fokusi në informata/fakte dhe reproduktim, ilustrime joadekuate, jofunksionale dhe joatraktive për nxënësin, etj. Shqetësimet e ngritura nga mësimdhënësit në këtë studim janë në linjë me problemet e identifikuara nga studimi *Problemet dhe te metat e teksteve shkollore - Analizë e teksteve shkollore të Kosovës, të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët (klasat VI, VII, VIII dhe IX)* (Thaçi, J., 2012), sipas të cilit një numër i konsiderueshëm i teksteve të analizuara (Biologji, Gjeografi, Histori, Edukatë qytetare) kanë probleme dhe të meta sa u përket saktësisë shkencore, ngarkesës me përmbajtje, aparaturës didaktike, trajtimit të aspekteve gjinore, por edhe me përmbajtje dhe me metodologji¹⁰.

2.2.8. Kurrikula me zgjedhje

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulave në sisteme të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të arsimit. Në shumicën e sistemeve arsimore zhvillohet brenda kohës mësimore të detyruar, mirëpo ka edhe përvoja kur kurrikula me zgjedhje ofrohet me orë shtesë. Lista e lëndëve të kurrikulës

⁹ http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1466/cilesia_e_teksteve_shkollore_ne_kosove_alb-1.pdf

¹⁰ Më gjerësisht, shih: http://jetanekosove.com/repository/docs/Tekstet_ANALIZA_shqip_339320.pdf

me zgjedhje ose përcaktohet nga autoritetet qendrore dhe u dërgohet shkollave, ose përcaktohet nga autoritetet lokale, bazuar në udhëzime të dërguara nga qendra, dhe u dërgohet shkollave, apo u lihet shkollave për të vendosur në përputhje me udhëzime të dërguara nga qendra ose nga autoritetet lokale (Llambiri, S., Abdurrahmani, T., & Mulla, A., 2011, f. 33).

Në Kosovë, kurrikula me zgjedhje është pjesë e Kornizës Kurrikulare dhe Kurrikulave Bërthamë, në të tri nivelet e arsimit parauniversitar. Në kapituj të veçantë të Kurrikulave Bërthamë ofrohen informacione për qëllimin, organizimin, strukturën e kurrikulës me zgjedhje për klasë të caktuara, procedurat e përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit, si dhe zbatimit dhe vlerësimit të nxënësve për kurrikulën me zgjedhje. Për dallim nga programet mësimore/lëndore, të cilat hartohen nga grupet punuese të udhëhequra nga MASHT-i, hartimi i programit të kurrikulës me zgjedhje mbetet kompetencë e shkollës¹¹.

Sipas përshkrimeve në Kurrikulat Bërthamë, për nivelet e arsimit parauniversitar, hartimi i programit mësimor bëhet në përputhje me mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve, duke pasur në konsideratë mundësitë kadrovike të shkollës dhe të komunës. Gjithashtu, për përcaktimin e saj duhet të merren në konsideratë edhe interesat e komunitetit. Vendimi për përcaktimin e kurrikulës me zgjedhje del si rezultat i një procesi konsultativ, përfshirë nxënësit, prindërit, komunitetin, shkollën dhe komunën. MASHT-i mund të sugjerojë programe të ndryshme, që janë me interes për vendin dhe shoqërinë në përgjithësi. Shkolla e bën zgjedhjen, duke përfillur nevojat dhe kërkesat individuale të nxënësve. Këto orientime lejojnë hapësirë për një veprimtari më të individualizuar në shkollë, njëkohësisht ofrojnë standarde për një proces arsimor më cilësor dhe të barabartë, pavarësisht nga dallimet ndërmjet nxënësve.

Sipas dokumenteve kurrikulare, kurrikula me zgjedhje mund të organizohet në lëndë mësimore, modul dhe projekt, me një strukturë të përafërt si programet e lëndëve mësimore të obligueshme. Lënda mësimore me

¹¹ Udhëzues për zbatimin e kurrikulës, (material ndihmës për mësimdhënësit e klasës përgatitore dhe arsimit fillor), 2018

zgjedhje i referohet organizimit didaktik të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave në një fushë të caktuar, që është me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë. Moduli mësimor me zgjedhje i referohet organizimit didaktik të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, për një apo disa tema të një fushe të caktuar, që është me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë. Projekti mësimor me zgjedhje i referohet zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave në një fushë apo në disa fusha që janë me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë, përmes mësimdhënies dhe nxënies hulumtuese, krijuese dhe zgjidhjes së problemeve të caktuara¹².

Për tri llojet e organizimit të mësimimit me zgjedhje, shkolla duhet të hartojë programet mësimore apo të adaptojë programe të sugjeruara nga MASHT-i. Gjatë një viti shkollor nxënësit mund të marrin një apo dy programe mësimore, qoftë lëndë, modul apo projekt. Në rastin kur nxënësit marrin dy programe mësimore, njërin e ndjekin nga fillimi i vitit shkollor/mësimor deri në pushimet dimërore dhe tjetrin pas pushimeve dimërore, deri në përfundim të vitit shkollor/ mësimor. Procedura e përzgjedhjes dhe realizimit rregullohet me akte nënligjore/udhëzim administrativ¹³.

Qëllimi i kurrikulës me zgjedhje është që nxënësve t'u ofrohen mundësi më të mëdha për të përmbushur veten me dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, sipas mundësive, nevojave dhe interesave të tyre, drejt zotërimit të kompetencave të përcaktuara me KK, përkatësisht arritjes së rezultateve të të nxënësve për kompetenca, për shkallë kurrikulare.

Në këtë kontekst, sipas orientimeve që ofrojnë Kurrikulat Bërthamë, kurrikula me zgjedhje nxënësve u mundëson të thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë, të zhvillojnë shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat:

- në fushat e kurrikulës, respektivisht në lëndët mësimore të përcaktuara në dokumentet kurrikulare;
- në lëndë të reja, që nuk janë paraparë në dokumentet kurrikulare;

¹²Kurrikula Bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës, 2016.

¹³Po aty

- në tema që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore dhe natyrore, dhe
- në temat që janë me interes për nivelin lokal dhe ndërkombëtar.

Procedurat e përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit nga shkolla të kurrikulës me zgjedhje janë rregulluar në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 32/2013, Organizimi i kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë (MASHT). Ndërsa, udhëzime metodologjike për zhvillimin e programit të kurrikulës me zgjedhje dhe planifikimin për zbatim ofrohen në Udhëzuesin për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje (material ndihmës për mësimdhënës), të hartuar nga MASHT-i dhe IPK-ja (2016).

Në anën tjetër, vlerësimi i nxënësve në kurrikulën me zgjedhje (lëndë mësimore, modul apo projekt) bëhet sipas kriterëve të vlerësimit të mësimin të rregullt, llogaritet në suksesin e përgjithshëm të nxënësit dhe realizohet vetëm si vlerësim i brendshëm, nuk përfshihet në vlerësimin e jashtëm (neni 10, paragrafët 2, 3 dhe 4 të UA nr. 32/2013).

Sipas studimit *Sfidat e zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë*, shfrytëzimi i pamjaftueshëm i autonomisë së shkollave për zbatimin e kurrikulës, në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor, nevojat e nxënësve, infrastrukturën e shkollës dhe specifikat e lokalitetit në të cilin vepron shkolla, është ndër sfidat kryesore në zbatimin e reformës kurrikulare, të identifikuar (Boshtrakaj, L., 2019, f. 5). Edhe në studimin *Zgjedhja dhe planifikimi i mësimin zgjedhor në arsimin fillor* pasqyrohen sfida të shumta lidhur me zbatimin e kurrikulës me zgjedhje, duke filluar nga të kuptuarit e autonomisë së shkollës, zhvillimi i programit të kurrikulës me zgjedhje dhe planifikimi për zbatim. (Bytyqi-Beqiri, L., Gajraku, G., Binaku, A., 2013).

2.3. Studime dhe publikime që lidhen me reformën kurrikulare

Në vitin 2005, Instituti i Edukimit të Londrës bëri një vlerësim për planet dhe programet kombëtare në Kosovë – Vlerësimi i hapave të parë dhe deri të ndryshimi i qasjes së re. Qëllimi i studimit ishte të vlerësohen hapat e parë të procesit të studimit dhe të zbatimit të planeve dhe programeve të reja në Kosovë, në veçanti përputhja ndërmjet planeve dhe programeve,

metodologjisë dhe vlerësimit në shkencat natyrore dhe shoqërore, gjuhë amtare, dhe në arsimin profesional.

Studimi në fjalë ofroi gjetje të rëndësishme dhe evidenca për fushat e hulumtuara, identifikoi problemet në metodologji të mësimdhënies, zhvillim profesional të mësimdhënësve, vlerësim të nxënësve etj., si dhe ofroi rekomandime të rëndësishme për institucionet udhëheqëse të reformës kurrikulare, shkollat dhe mësimdhënësit. Sipas studimit, zhvillimi i sistemit mund të arrihet përmes reformave, të cilat reflektojnë filozofinë demokratike dhe pjesëmarrëse të planeve dhe programeve kombëtare. Aspektet thelbësore në këtë drejtim janë: (i) më shumë autonomi për të gjitha shkollat; (ii) dallime në pagat e mësimdhënësve që reflektojnë përgjegjësinë, përkushtimin, iniciativën dhe cilësinë e mësimdhënies dhe të drejtimit; si dhe (iii) partneriteti në mes të arsimit dhe komunitetit (Peffers, Reid, Stylianidou, Walsh & Young 2005, f. 03).

Nga viti 2008, filloi procesi i zhvillimit të kurrikulës së re në Kosovë, i cili ka kaluar në faza të ndryshme dhe të tejzgjatura, deri në fillimin e shtrirjes së zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi, në vitin shkollor 2017/2018. Në vitin 2014, në fazën e pilotimit të kurrikulës, MASHT-i organizoi konferencën ndërkombëtare Qasja e re kurrikulare – sfidë e së ardhmes. Në konferencë, përveç përvojave të Kosovës dhe të Shqipërisë, u prezantuan studime dhe përvoja në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave nga Sllovenia, Finlanda dhe Skocia.

Projekti i binjakëzimit (KS 11 IB OT 02), në vitin 2014, bëri një vlerësim cilësor të hapave të parë të zbatimit të kurrikulumit të ri të Kosovës. Referuar këtij raporti, niveli kombëtar në këtë periudhë përshkruhet të jetë aktiv, pas një fillimi të ngadalshëm në raport me planin fillestar. Niveli komunal përshkruhet të jetë i neglizhuar dhe me burime të pakta, ndërsa niveli i shkollës dhe klasës në këtë fazë përshkruhet të ketë rritje të punës në ekipe, me burime të pakta. Ndërsa, perceptimet e palëve të interesit përshkruhen nga pozitive në frikë nga ndryshimi (Jyri Manninen, 2014, f. 10).

Hulumtimet e viteve të fundit, që lidhen me reformën kurrikulare në Kosovë, kryesisht kanë një përqendrim të trajtimit tematik, disa prej tyre kanë përshkrim të zbatimit dhe disa bëjnë përpjekje për të matur shkallën e

zbatimit. Sipas Colin J. Marash (2009), përpjekjet për të përshtatur zbatimin e kurrikulave paraqesin një varg me vështirësi dhe varen nga përqendrimi, te udhëheqja e procesit, planifikimi, mësimdhënia dhe nxënia, materialet e kurrikulës etj. Ndërsa, sipas Desimone (2002), përpjekja për të matur shkallët e zbatimit të kurrikulës është edhe më e vështirë sesa përpjekja për t'i përshtatur ato. Duhet marrë vendime se çfarë lloji të dhënash të mbledhen, si për shembull të dhëna nga vëzhgimet, nga analiza e dokumenteve, apo edhe vetë-raportimet.

Raporti final i vlerësimit për zbatimin e kurrikulës në Zelandën e Re (2008-2009), i hartuar në vitin 2011, prezanton një shembull të mirë të përpjekjeve për të matur zbatimin e kurrikulës, duke iu referuar shkallës së pranimi nga shkollat dhe mësimdhënësit, progresit të zbatimit në praktikë dhe argumentimit për progresin e zbatimit, dobisë për mbështetjen e ofruar dhe nevojave për mbështetje të mëtejme. Këtë raport dhe instrumentin për grumbullimin e të dhënave ekipi hulumtues i IPK-së e mori si bazë orientuese për të përcaktuar fokusin e problemit të studimit dhe zhvillimin e instrumenteve për grumbullimin e të dhënave.

Publikimi Refleksione arsimore (vështrim kritik për zhvillimet në sistemin e arsimit, 2000-2017), prezanton sfida të shumta në sistemin arsimor, një pjesë e madhe e së cilave lidhen me reformën kurrikulare dhe kapacitetet për zhvillimin dhe zbatimin e saj, si diskrepanca ndërmjet programit qeverisës të MASHT-it dhe strukturës së saj organizative, qasja e aplikuar ndaj reformës kurrikulare, kapacitetet e mësimdhënësve për zbatimin e reformës kurrikulare, buxheti i pamjaftueshëm për zbatimin e plotë të reformës kurrikulare etj. (Azemi, A., 2014, f. 257-258). Gjithashtu, publikimi ofron edhe rekomandime për çështjet kryesore që duhet të adresohen në sistemin arsimor, përfshirë edhe rekomandimet për aspektet që lidhen me zbatimin e reformës kurrikulare.

Projekti Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN, gjatë vitit 2018, publikoi disa raporte të studimeve që lidhen me zbatimin e kurrikulës, si: sfidat e zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë; Edukimi parashkollor në Kosovë; Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë; Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë etj. Studimet ofrojnë një pasqyrë të arritjeve, sfidave dhe problemeve të identifikuara, si

dhe rekomandime për adresimin e tyre. Vlen të veçohen disa nga sfidat kryesore në zbatimin e reformës kurrikulare, të identifikuara, si: Qasja e fragmentuar dhe jokoherente e zbatimit të elementeve të reformës; moskonsolidimi i mekanizmit të mbikëqyrjes, përkrahjes dhe llogaridhënies në procesin e zbatimit të kurrikulës; mungesa e konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë; shfrytëzimi i pamjaftueshëm i autonomisë së shkollave për zbatimin e kurrikulës, në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor, nevojat e nxënësve, infrastrukturën e shkollës, specifikat e lokalitetit në të cilin vepron shkolla etj.

Instituti Pedagogjik i Kosovës, nga fillimi i pilotimit të kurrikulës së re, ka realizuar 11 hulumtime që lidhen me zhvillimin, pilotimin dhe zbatimin e kurrikulës së re. Rezultatet e pjesës më të madhe të hulumtimeve janë publikuar në vjetarin e IPK-së “Kërkime Pedagogjike” (<http://ipkMASHT.rks-gov.net/>), disa janë publikuar në botime të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe për disa hulumtime janë përgatitur vetëm raporte për MASHT-in, nuk janë publikuar rezultatet.

Gjetjet nga këto studime u përdorën për të fokusuar hulumtimin në disa fusha, të vlerësuara të nevojshme për thellimin e trajtimeve që lidhen me zbatimin e kurrikulës, me fokus zbatimin e kurrikulës në 2-3 vitet e fundit. Gjithashtu, gjetjet nga këto studime u përdorën për diskutimin e rezultateve të këtij studimi.

KAPITULLI III - METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky kapitull prezanton metodologjinë hulumtuese të përdorur në këtë studim. Zhvillimi i metodologjisë dhe përgatitja për hulumtim janë bërë duke u bazuar në qëllimin e studimit dhe pyetjet kërkimore. Çështjet tjera, që janë marrë në konsideratë për zhvillimin e metodologjisë hulumtuese për këtë studim, janë shqyrtimi i literaturës, dokumenteve kurrikulare dhe raporteve të hulumtimit për zbatimin e kurrikulës, si dhe konteksti i reformës kurrikulare në Kosovë dhe zbatimit të saj në shkallë vendi. Në pjesën në vijim do të pasqyrohen: modeli i studimit, popullata dhe mostra e studimit, instrumentet e studimit, procedura e mbledhjes së të dhënave dhe analiza e të dhënave.

3.1. Modeli i hulumtimit

Qasja hulumtuese e përdorur në këtë studim është e bazuar në të dhëna sasiore dhe cilësore, si dhe në modelin krahasues dhe modelin vlerësues zhvillimor. Përmes modelit krahasues të hulumtimit, u bë një shqyrtim i hollësishëm i zbatimit të kurrikulës sipas udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës 2016-2021 (objektivat e përcaktuara për vitet 2016-2019), dokumentimit të punës së dy grupeve të shkollave për zbatimin e kurrikulës, perceptimeve të mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave, të të dyja grupeve, si dhe perceptimeve të subjekteve tjera të përfshira në studim, për çështje që lidhen me praktikën e udhëheqjes së proceseve që lidhen me zbatimin e kurrikulës. Qasja krahasuese ndërlidhet me qasjen vlerësuese zhvillimore, me qëllim vlerësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës dhe adresimin problemeve të identifikuara në fazat e tjera të zbatimit. Zakonisht, modelet vlerësuese pyesin nëse një program ose projekt ka arritur qëllimet e parapara, vlerëson se sa mirë ka funksionuar një proces, nëse një ndërhyrje apo ndryshim i caktuar ka sjellë rezultatet e synuara, për të parë se çfarë funksion, çfarë nuk funksionon dhe pse, etj. (Matthews & Ross, 2010). Ndërsa, modeli i vlerësimit zhvillimor është i bazuar në parimet se vlerësimi është i vazhdueshëm dhe se rezultatet tregohen për të gjitha palët e interesit (Manninen, J., 2014, f. 5), në mënyrë që rezultatet e studimit të merren në konsideratë gjatë fazave të tjera të zbatimit.

3.2. Popullata dhe mostra

Popullata e këtij studimi përbëhet nga mësimdhënës të klasës përgatitore, mësimdhënës të klasave 1, 2, 6 dhe 7, nga drejtorë të shkollave dhe zyrtarë arsimorë, në nivel qendror dhe lokal. Në raport me popullatën nga shkollat, numri i shkollave të përfshira në këtë studim është 35 shkolla publike të arsimit bazë, apo mbi 6% të shkollave amë, si dhe 3 çerdhe publike apo rreth 7% e çerdheve publike. Në mënyrë që të kemi mostër sa më përfaqësuese të popullatës së synuar nga shkollat, kemi përdorur dy lista të shkollave. Lista e parë e shkollave përmban listën e shkollave të arsimit bazë, që ishin pjesë e pilotimit të kurrikulës në grupin e dytë të shkollave pilotuese dhe që tani janë shkolla prijëse në zbatimin e kurrikulave lëndore, si dhe listën dytë të shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re në vitin shkollor 2017/2018 dhe kanë përfunduar trajnimin e ekipeve të shkollave për vetëvlerësimin e performancës së shkollës.

Nga dy listat e shkollave siç u përmendën më sipër, janë përzgjedhur shkollat për të realizuar këtë studim, në bazë të tri kritereve: i) numrit të barabartë të shkollave nga grupi i parë dhe grupi i dytë i shkollave që u përshkruan më lart; (ii) përfaqësimit të shkollave nga zonat urbane dhe rurale; dhe (iii) numrit të nxënësve në shkolla (shkolla deri në 300 nxënës, shkolla me 301-600 nxënës; shkolla me 601-1000 nxënës dhe shkolla me mbi 1000 nxënës).

Referuar raportit të statistikave për arsim, të vitit shkollor 2018/2019, popullacioni i mësimdhënësve në vitin shkollor 2018/2019, që punonin me kurrikula të reja lëndore/programe mësimore në klasën përgatitore dhe klasat 1, 2, 6 dhe 7, përbëhet prej 8320 mësimdhënësve (burimi: SMIA/MASHT statistikat 2017-2018, f. 66). Nga shkollat e përfshira në studim, kanë marrë pjesë 511 mësimdhënës apo mbi 6% e numrit të mësimdhënësve të shkollave publike që punojnë me kurrikula lëndore të reja (duke përfshirë edhe koordinatorë të cilësisë dhe kryetarë të aktiveve profesionale), 38 drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të shkollave, apo rreth 6 % të drejtuesve të shkollave publike në arsimin bazë dhe në çerdhe.

Ndërsa, përfaqësimi i zyrtarëve arsimorë dhe njohësve të kurrikulës është bërë nga 11 zyrtarë arsimorë/koordinatorë të cilësisë në komunat e shkollave të përfshira në studim, 10 zyrtarë arsimorë nga niveli qendror, prej tyre 6 zyrtarë arsimorë nga MASHT-i, që kanë rol në zhvillimin e kurrikulave dhe

në trajnimet për mësimdhënës, dhe 4 inspektorë arsimorë. Pjesë e studimit janë edhe 6 njohës të arsimit dhe të reformës kurrikulare, të identifikuar se kanë pasur rol në faza të ndryshme të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë.


Për shkak të natyrës së studimit, për të eksploruar pyetjet kërkimore në thellësi, mostra e respondentëve ishte e qëllimshme, sipas rolit që kanë në zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle. Përbërja e mostrës sipas karakteristikave nga pozitat e përshkruara më lart ishte:

Tabela 1. Pozita/roli i respondentëve të përfshirë në studim (në numër)

Nr	Pozita/roli i respondentëve	Numri
1	Drejtorë/zëvendësdrejtorë të shkollës	38
2	Pedagogë shkolle, koordinatorë të cilësisë/ koordinatorë të kurrikulës	68
3	Kryetarë të aktiveve profesionale	53
4	Mësimdhënës - klasa përgatitore, klasa e parë dhe klasa e dytë	224
5	Mësimdhënës të arsimit të mesëm të ulët (klasa e gjashtë dhe klasa e shtatë)	129
6	Mësimdhënës që nuk kanë specifikuar klasën në të cilën punojnë	37
7	Zyrtarë arsimorë/koordinatorë të cilësisë në DKA	11
8	Zyrtarë arsimorë nga MASHT - që kanë rol në zhvillimin e kurrikulave dhe trajnimin e mësimdhënësve	6
9	Inspektorë të arsimit	4
10	Njohës të arsimit dhe të reformës kurrikulare	6
Gjithsej respondentë të përfshirë në studim		576


Pra, në studim janë përfshirë shkollat që ishin pjesë e fazës së dytë të pilotimit të kurrikulës (jo grupi i 10 shkollave të para) dhe që punën me kurrikula të reja lëndore/programe të reja mësimore, në klasën përgatitore, klasën e parë dhe të gjashtë, e filluan në vitin shkollor 2016/2017, si dhe shkollat të cilat nuk kanë qenë të përfshira në pilotim, por që zbatimin e kurrikulës re/ programeve të reja mësimore në klasa të njëjta e filluan në

vitin shkollor 2017/2018. Të dhënat e mbledhura nga studimi tregojnë se 52.9% e pjesëmarrjeve në studim vijnë nga shkollat që filluan të punojnë me kurrikula të reja lëndore/programe të reja mësimore në vitin shkollor 2016/2017, ndërsa 45.7% e pjesëmarrësve vijnë nga shkollat që punën me programet e reja mësimore e filluan në vitin shkollor 2017/2018. Pjesëmarrësit nga shkollat e përfshira në studim u përkasin lokacioneve urbane (64%) dhe rurale (36 %).



Grafiku 1. Përqindja e shkollave të përfshira në studim, sipas viteve shkollore të fillimit me kurrikula lëndore/programe të reja mësimore dhe lokacioni i shkollave

Lidhur me nivelin e kualifikimit, përbërja e mostrës nga shkollat ishte: 4% mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike (janë gjeneratat e fundit të mësimdhënësve, para pensionimit, që nuk e kanë ndjekur programin e rikualifikimit të mësimdhënësve, për të arritur në kualifikimin bachelor), 30 % e mësimdhënësve që kanë marrë pjesë në studim kanë kryer studime bachelor, 45 % fakultetin katërvjeçar, 20 % master dhe rreth 1 % me studime të doktoratës ose kandidatë për PhD.



Grafiku 2. Përshkrimi i kualifikimit të mësimehdhënësve të përfshirë në studim (në %)

3.3. Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit janë përdorur instrumente dhe metoda që mundësuan të sigurohen të dhëna sasiore dhe cilësore, në ndërlidhje me pyetjet kërkimore. Për mbledhjen e të dhënave, kemi zhvilluar dhe përdorur pyetësorët në vijim:

- a) *Anketimi me mësimehdhënës dhe udhëheqës të shkollave.* Pyetësori i anketës është i ndarë në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë janë përfshirë të dhënat e përgjithshme për shkollën dhe të anketuarin që e plotëson pyetësorin, si: gjinia, mosha, kualifikimi, përvoja e punës, pozita në shkollë, lënda mësimore që e mban dhe trajnimi për kurrikulën e re. Në pjesën e dytë, janë përfshirë pyetje/kërkesa të organizuara në katër fusha: I. Mbështetja e ofruar; II. Pranimi/besimi në kurrikulën e re; III. Praktika e zbatimit të kurrikulës; dhe IV. Sfidat /problemet kryesore në zbatimin e kurrikulës dhe kërkesat për mbështetje të mëtejme¹⁴;

¹⁴ Më gjerësisht, shih shtojca nr. 1: Pyetësori për mësimehdhënës / personelin e shkollës

- b) *Fokus-grupi, intervista gjysmë të strukturuar, pyetësi me pyetje udhëzuese, me përfaqësues nga shkollat, DKA-të, MASHT-i, dhe njohës të arsimit dhe reformës kurrikulare. Pyetësi me pyetje udhëzuese, përkatësisht protokoli i intervistës, përmban pyetje/kërkesa për: Udhëheqjen e procesit të zbatimit; Programet mësimore, materialet e informimit, informimi dhe raportimi; Trajnimet për zbatimin e kurrikulës dhe format tjera të mbështetjes; Monitorimin e procesit të zbatimit të kurrikulës; Pranimin/besimin në kurrikulën e re; Ndryshimet në shkollë dhe në mësimdhënie; Parashikimin për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës; dhe çështje të tjera me interes për temën e studimit, të ngritura nga të intervistuarit¹⁵;*
- c) *Listë kontrolli për analizë/vlerësim të dokumentimit të institucionit arsimor/shkollës për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës. Listë kontrolli është organizuar në gjashtë fusha, me gjithsej 34 tregues/kërkesa për vlerësim të dëshmive të dokumentimit të punës të punës së shkollës. Fushat e instrumentit: (i) Materiale informuese të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re; (ii) Plani Zhvillimor i Shkollës; (iii) Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019; (iv) Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës; (v) Plane vjetore dhe raporte pune që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle; (vi) Plane vjetore dhe raporte pune të organeve profesionale të shkollës¹⁶;*
- d) *Listë kontrolli për analizë të udhëzimeve metodologjike në programet mësimore lëndore. Instrumenti përmban shtatë tregues/ kërkesa për analizë dhe vlerësim të udhëzimeve metodologjike në programin mësimor për shtrirjen e planifikimit mësimor brenda vitit mësimor, respektimin e rendit logjik dhe përmbajtjesor të shtrirjes së temave dhe mbarështrimit të tyre brenda vitit mësimor, metodologjinë e mësimdhënies dhe nxënies, udhëzimet për çështjet ndërkurrikulare,*

¹⁵ Më gjerësisht, shih shtojcat nr 2 – 6.

¹⁶ Më gjerësisht, shih shtojcën nr. 7.

udhëzimet për metodologjinë e vlerësimit, si dhe udhëzimet për përdorimin e burimeve dhe planeve mësimore¹⁷;

- e) *Listë kontrolli për analizë /vlerësim të planifikimit mësimor*. Instrumenti është organizuar në tri pjesë: (i) Plani vjetor për fusha kurrikulare/lëndë mësimore; (ii) Planet për periudha mësimore / planet dymujore dhe (iii) Planifikimet për orë mësimore. Instrumenti për analizë ka përfshirë gjithsej 27 tregues/kërkesa për dëshmi të planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës¹⁸;
- f) *Listë kontrolli për analizë/ vlerësim të mostrave për planet individuale për arsim (PIA)*. Instrumenti është organizuar në 6 fusha: (i) Pjesa administrative; (ii) Pjesa pedagogjike; (iii) Pjesa rehabilituese; (iv) Planifikimi i tranzicionit; (v) Raporti i përgjithshëm vjetor i vlerësimit të arritjes së rezultateve të nxënit; dhe (vi) Rishikimi i parë dhe rishikimi i dytë. Instrumenti për analizë ka përfshirë gjithsej 23 tregues/kërkesa¹⁹.

3.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat për këtë studim janë mbledhur në bazë të udhëzuesit të përgatitur për hulumtuesit e terrenit. Udhëzuesi përmbante një përshkrim të shkurtër të qëllimit të studimit, formën e prezantimit para respondentëve të studimit, instrumentet dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave, si dhe planin dinamik për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat për këtë studim u mbledhën nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, gjatë periudhës mars–qershor 2019. Ndërsa procesi i të dhënave, përpunimi dhe analizimi i tyre, u realizuan sipas planit dinamik për analizën e të dhënave dhe duke përdorur programin Paketa Statistikore për Shkencat Sociale, për të dhënat sasiore, ndërsa metodën e analizës së përmbajtjes për të dhënat cilësore.

Sipas Grbich (2007), analiza është procesi i segmentimit, kategorizimit dhe rilidhjes së aspekteve të të dhënave përpara interpretimit të tyre përfundimtar (cituar nga Matthews & Ross, 2010). Këtë proces e kemi ndjekur gjatë analizës së të dhënave sasiore dhe cilësore, të mbledhura në kuadër të këtij

¹⁷ Më gjerësisht, shih shtojcën nr. 8.

¹⁸ Më gjerësisht, shih shtojcën nr. 9.

¹⁹ Më gjerësisht, shih shtojcën nr. 10.

studimi. Përpunimi dhe analiza e të dhënave sasiore, të mbledhura me pyetësonin e anketës, u realizuan nëpërmjet paketave të programeve kompjuterike SPSS, versioni 20, dhe Excel. Analiza e të dhënave është kryer kryesisht nëpërmjet analizës përshkruese, të përshtatshme për të paraqitur tabela të shpërndarjes së frekuencave, diagrame dhe figura, për të përmbledhur gjetjet kryesore, për t'i diskutuar, interpretuar dhe vlerësuar krahas me të dhënat cilësore.

Analizën e të dhënave cilësore e bazuam në metodën e analizës së përmbajtjes (Gläser & Laudel, 2013). Aspektet pozitive, ato negative dhe problemet që u ngritën gjatë diskutimit në fokus-grup dhe intervistave e pyetësorëve me pyetje të hapura, u klasifikuan, u interpretuan dhe u përshkruan. Përgjigjet u interpretuan sipas pyetjeve udhëzuese, duke dhënë një përshkrim të detajuar dhe kur ishte e nevojshme duke cituar ashtu si janë shprehur subjektet përkatëse. Kjo qasje mundësoi që të dhënat e mbledhura të grupohen në kategori tematike dhe të lidhen me pyetjet kërkimore, për të cilat pastaj u bënë interpretime dhe përshkrime brenda një strukture të temave që e karakterizojnë këtë studim.

Në anën tjetër, analizën e të dhënave nga dokumentimi i punës së shkollës dhe mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës e kemi realizuar përmes qasjes së kombinuar, sasiore dhe cilësore, duke u bazuar në instrumentet e përgatitura për këtë qëllim dhe kriteret për vlerësim të treguesve të vendosur në instrumente. Analiza dhe vlerësimi për secilin tregues në fushat e analizuar është bërë në tri nivele: nivel i lartë; nivel mesatar dhe nivel minimal. Për treguesit që nuk ka pasur dëshmi është evidentuar si mungesë e dëshmive. Pastaj, bazuar në vlerësimin për secilin tregues, është nxjerrë vlerësimi i përgjithshëm.

3.5. Besueshmëria e pyetësonit të realizuar me mësimdhënës/personelin e shkollës

Pyetësoni për mësimdhënës u pilotua me 25 mësimdhënës nga shkolla të ndryshme, të cilët ishin pjesë e një punëtorie për sigurimin e cilësisë në shkollë, dhe më pas u modifikuan aspektet që nuk funksionuan për të qenë pyetësoni i besueshëm dhe i vlefshëm.

Për matjen e besueshmërisë, është bërë analiza e koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha). Analiza është bërë ndaras për pesë faktorët, brenda të cilëve janë organizuar kërkesat/pyetjet lidhur me zbatimin e kurrikulës. Të dhënat e analizës rezultojnë të jenë më vlera të larta të besueshmërisë për analiza të tjera faktoriale. Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha), sipas faktorëve të analizuar, janë si në vijim:

1. Mbështetja profesionale para fillimit të zbatimit të kurrikulës: $\alpha=.88$
2. Konsultimet dhe mbështetja profesionale gjatë zbatimit të kurrikulës $\alpha=.87$
3. Pranimi apo besimi për kurrikulën e re: $\alpha=.62$
4. Ndryshimet në qasje të punës së institucionit/shkollës për zbatimin e kurrikulës së re: $\alpha=.93$
5. Ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe të nxëniet: $\alpha=.84$

3.6. Kufizimet

Studimi është i përshkruar me disa kufizime, të cilat duhet të merren parasysh në përgjithësimin e rezultateve.

Së pari, periudha e realizimit të studimit në terren ka qenë periudhë e atakuar nga dy-tri zhvillime në nivel të të gjitha shkollave, si përgatitja e portfoliove nga mësimdhënësit për certifikim në programin e trajnimit për zbatimin e kurrikulës, garat nacionale të diturisë, të organizuara nga koordinatori nacional për kulturë, dhe vlerësimi për shkallë kurrikulare, i organizuar në klasat 2 dhe 7, të cilat ishin pjesë e objektit të studimit tonë. Këto zhvillime kanë bërë që shkollat dhe mësimdhënësit të jenë mbingarkuar dhe të jenë të përmbajtur për të evidentuar sfidat dhe problemet reale, ose të ndikuar nga ngarkesa dhe të mos jenë të sinqertë në plotësimin e pyetësorit;

Së dyti, lidhen me faktin se në studim nuk janë marrë gjimnazet publike dhe shkollat private në arsimin bazë në Kosovë, të cilat punojnë me kurrikulën e re. Prandaj, përgjithësimi i rezultateve të studimit për zbatimin e kurrikulës për gjithë arsimin parauniversitar në Kosovë paraqet vështirësi;

Së treti, edhe pse ekipi hulumtues u mundua që të shpjegojë në mënyrë të detajuar kërkesat për dokumentimin e punës së shkollës për zbatimin e kurrikulës, përsëri disa shkolla nuk kanë ofruar dokumentimin e nevojshëm, si të planifikimeve të mësimdhënësve ashtu edhe të raporteve të punës në nivel shkolle, duke pamundësuar marrjen e plotë të informacionit nga disa shkolla për punën e tyre dhe të mësimdhënësve. Situatë e përafërt u përshkrua edhe me plotësimin e plotë të instrumentit nga mësimdhënësit. Pavarësisht informatave të ofruara, përsëri disa alternativa të pyetësorëve janë lënë të paplotësuara, duke cenuar marrjen e plotë të informacionit dhe duke ndikuar në vlefshmërinë dhe besueshmërinë e studimit.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, mendojmë se ky studim mbetet një burim i mirë informacioni për të gjitha institucionet arsimore që lidhen me procesin e zbatimit të kurrikulës, i bazuar në perceptimet e subjekteve nga institucionet dhe përvoja të ndryshme, të cilët i referohen përvojës autentike të tyre me zbatimin e kurrikulës. Gjithashtu, studimi është i bazuar edhe në analizën e dokumentimit të punës së shkollës, analizë e cila vlerësojmë se do të jetë një burim i mirë i informacionit për shkollat dhe mësimdhënësit, për të orientuar përmirësimin dhe avancimin e punës së tyre në procesin e zbatimit të kurrikulës.

3.7. Aspekti etik i studimit

Studimi është kryer duke iu përmbajtur etikës hulumtuese për të marrë të dhëna relevante për objektin e studimit – zbatimin e kurrikulës së re në arsimin bazë. Për kryerjen e këtij studimi, jemi mbështetur në përgjegjësinë e përcaktuar nga MASHT-i me Planin Strategjik të Arsimit 2017-2021, i cili IPK-në e përcaktoi bartës të studimit për zbatimin e kurrikulës dhe përcaktoi vitin 2019 vit për ta realizuar këtë studim, me qëllim analizën e situatës nga një vlerësim afatmesëm i zbatimit të kurrikulës në shkallë vendi. Bazuar në këtë përgjegjësi, IPK-ja ka përgatitur projektin e studimit dhe ka bashkëpunuar me institucionet arsimore dhe subjektet përkatëse për realizimin e studimit. Para vizitës në çdo shkollë të përfshirë në studim, kemi kontaktuar me drejtorin e shkollës përkatëse, kemi dhënë informacionin e nevojshëm rreth studimit dhe qëllimit të tij, kemi caktuar kohën e realizimit të vizitës hulumtuese në shkollë dhe miratimin për përfshirje të

mësimdhënësve sipas kriterëve të përcaktuara për përfaqësim dhe me pajtim të vet mësimdhënësve. Gjatë vizitës hulumtuese në shkollë, çdo mësimdhënësi i është informacioni i nevojshëm për studimin dhe qëllimin e tij, si dhe janë siguruar që do ruhen konfidencialiteti dhe plotësimi i pyetësorit.

Nisur nga fakti se hulumtues nga IPK-ja kanë qenë të angazhuar në fazën e pilotimit të kurrikulës, në mbështetje të MASHT-it (vitet shkollore 2013/2014 – 2015/2016), si dhe në fazën e rishikimit të dokumenteve kurrikulare (janar – korrik 2016), ekipi hulumtues është përmbajtur nga trajtimi i periudhës dhe aspekteve të hulumtimit kur hulumtuesit e IPK-së kanë qenë pjesë e procesit dhe është fokusuar vetëm në periudhën pas miratimit të dokumenteve kurrikulare të rishikuara, përkatësisht periudhën nga fillimi i vitit shkollor 2016/2017, kur IPK-ja më nuk ka pasur asnjë rol në zbatimin e kurrikulës.

KAPITULLI IV - REZULTATET E HULUMTIMIT

4.1. Rezultatet nga hulumtimi sasior

Në këtë pjesë raportohen rezultatet për qëndrimet e shprehura nga mësimezhënësit dhe udhëheqësit e shkollave në instrumentin e anketimit lidhur me tri aspekte kryesore të studimit, mbështetjen për zbatimin e kurrikulës së re/ programeve të reja mësimore, pranimin apo besimin për kurrikulën e re dhe praktikën e zbatimit të kurrikulës.

4.1.1. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës së re/ programeve të reja mësimore


Pas përpunimit të pyetësorit, pjesën e pyetjeve që lidhen me mbështetjen për zbatimin e kurrikulës së re/ programeve të reja mësimore, gjetjet e fituara raportohen në dy segmente kryesore: (i) Përfshirja dhe mbështetja profesionale në trajnimet para fillimit të zbatimit të kurrikulës dhe (ii) Konsultimet dhe mbështetja profesionale gjatë zbatimit të kurrikulës.

Përfshirja dhe mbështetja profesionale në trajnimet para fillimit të zbatimit të kurrikulës

Vlerat e analizës së Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për tetë pyetjet, të cilat lidhen me trajnimet e mësimezhënësve dhe stafit udhëheqës të shkollës para fillimit të zbatimit të kurrikulës, tregojnë se ka lidhje të mirë mes pyetjeve dhe ka besueshmëri të rëndësishme. Vlerat e Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) janë $\alpha = .88$, me KMO dhe Barlett's Test=.82, dhe Sig =.000.

Pas përpunimit të pyetësorit, lidhur me ndjekjen e programit të trajnimit për zbatimin e kurrikulës së re dhe numrin e ditëve të trajnimit, rezulton se rreth 96% e personelit mësimor të shkollës e kanë ndjekur programin e trajnimit për zbatimin e kurrikulës së re, ndërsa rreth 4% nuk janë trajnuar për zbatimin e kurrikulës së re, megjithëse japin mësim në klasat në të cilat zbatohet kurrikula e re. Numri më i madh i tyre, rreth 59%, kanë ndjekur 5-6 ditë trajnimi, rreth 8 % kanë ndjekur 7-10 ditë trajnimi, ndërsa mbi 33% kanë ndjekur më shumë se 10 ditë trajnimi për zbatimin e kurrikulës së re.

Qëndrimet e mësimeve për mbështetjen e ofruar gjatë trajnimeve për zbatimin e kurrikulës janë matur me pyetjen për këtë qëllim, e cila ka përmbajtur 9 kërkesa me mundësi të vlerësimit për secilën kërkesë, bazuar në 5 shkallët e vlerësimit: Likert (1= *Aspak e vërtetë*, 2= *Jo shumë e vërtetë*, 3= *Kam dilema/disi e vërtetë*, 4= *E vërtetë*, 5= *Shumë e vërtetë*). Rezultatet e përpunuara lidhur me vlerësimet për trajnimet e ofruara për zbatimin e kurrikulës së re janë mjaft pozitive sa i përket nevojës për të marrë pjesë në trajnime, vlefshmërisë së tyre, mirëpo rezultatet lidhur me atë se a kanë qenë të mjaftueshme, sa kanë rezultuar me rezultate të kënaqshme dhe sa kanë qenë nxitëse e praktike, janë mjaft të shpërndara. Qëndrimet e mësimeve për këto aspekte pasqyrohen në figurën në vijim.



Grafiku 3. Përshkrimi i qëndrimeve të mësimeve për mbështetjen e ofruar gjatë trajnimeve

4.1.2. Konsultimet dhe mbështetja profesionale gjatë zbatimit të kurrikulës

Nga pjesëmarrësit në studim kemi marrë edhe mendimet e tyre lidhur me konsultimet dhe mbështetjen profesionale të ofruar gjatë zbatimit të kurrikulës së re. Vlerat e analizës së Alfës së Kronbahut (Cronbach Alpha) për pyetjet, të cilat lidhen me konsultimet dhe mbështetjen profesionale të ofruar gjatë zbatimit të kurrikulës së re, tregojnë se ka lidhje të mirë mes pyetjeve dhe besueshmëri të rëndësishme. Vlerat e Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) janë $\alpha = .87$, me KMO dhe Barlett's Test=.83, dhe Sig =.000.

Lidhur me konsultimet dhe mbështetjen profesionale të ofruar gjatë zbatimit të kurrikulës së re, pyetësi i realizuar me stafin e shkollës përmban 5 pyetje lidhur me leximin dhe shqyrtimin e dokumenteve, botimeve e publikimeve tjera, 4 pyetje lidhur me konsultimet dhe mbështetjen e ofruar brenda shkollës dhe 6 pyetje lidhur me konsultimet dhe mbështetjen e ofruar jashtë shkollës.

a) Leximi dhe shqyrtimi i dokumenteve, botimeve dhe publikimeve tjera

Në pyetjen e drejtuar pjesëmarrësve se sa shpesh kanë qenë në gjendje të lexojnë dhe të shqyrtojnë dokumentet dhe materialet tjera, nga 5 shkallët e shpeshtësisë së leximit dhe shqyrtimit të dokumenteve dhe publikimeve tjera (1=Asnjëherë, 2=1-2herë, 3=3-5herë, 4=6-8 herë, 5=Më shumë se 8 herë), rezultatet tregojnë se mesatarja e përgjithshme e leximit të dokumenteve dhe materialeve tjera për kurrikulën është $M=3.52$. Marrë në tërësi, dokumentet dhe materialet tjera mesatarisht janë lexuar 3- 5 herë. Tabela në vijim paraqet të dhëna përshkruese për shkallën e shpeshtësisë së secilit dokument, material apo publikim për kurrikulë.

Tabela 2. *Shkalla e shpeshtësisë së leximit të dokumenteve e materialeve tjera për kurrikulën*

Dokumentet dhe materialet tjera	N	Rangimi	Minimum	Maximum	Mesatarja		Devijimi standard	Variance
	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Gabimi standard	Statistic	Statistic
Dokumentet e kurrikulës	393	4	1	5	3,59	,058	1,151	1,325
Kurrikulën lëndore	390	4	1	5	3,61	,059	1,160	1,345
Udhëzuesin e kurrikulës	403	4	1	5	3,51	,059	1,189	1,415
Botimeve të tjera për kurrikulë	378	4	1	5	2,56	,065	1,267	1,606
Publikimeve tjera të MASHT-it për kurrikulë	377	4	1	5	2,72	,065	1,254	1,573

b) Konsultimi dhe mbështetja e ofruar brenda shkollës

Në pyetjen se sa shpesh kanë pasur konsultime dhe mbështetje brenda shkollës, nga 5 shkallët e shpeshtësisë së ofrimit të konsultimeve dhe mbështetjes profesionale (1=Asnjëherë, 2=1-2herë, 3=3-5herë, 4=6-8herë, 5=Më shumë se 8 herë), rezultatet tregojnë se 77.9% e personelit të shkollës pohojnë se kanë përfituar nga konsultimet dhe iu është ofruar mbështetje profesionale brenda shkollës, ndërsa 22.1% e personelit të shkollës pohojnë se gjatë zbatimit të kurrikulës asnjëherë nuk u është ofruar asnjë mbështetje profesionale brenda shkollës.

Rezultatet e studimit treguan se gjatë zbatimit të kurrikulës së re, mësimdhënësit mbështetje dhe konsultime kanë marrë nga drejtori/zëvendësdrejtori i shkollës N= 341 ose 86.8%, pedagogu i shkollës N=124 ose 40.7%, kryetarët e aktiveve profesionale N=335 ose 88.5% dhe kolegët e shkollës N= 391 ose 97.8%. Nga të dhënat shohim se mbështetje më e madhe për mësimdhënësit në zbatimin e kurrikulës u ofrua nga kolegët e shkollës, kryetarët e aktiveve profesionale dhe udhëheqësit e shkollës. Udhëheqësit e shkollës ishin ndër tre mbështetësit kryesorë, të cilët ofruan mbështetje për mësimdhënësit.

Në pyetjen tonë drejtuar mësimdhënësve, lidhur me vlerësimin e tyre për mbështetjen e marrë nga udhëheqja e shkollës, nga pesë shkallët e vlerësimit, nga 1(*mbështetje e mjaftueshme*) deri 5 (*mbështetje maksimale*), mësimdhënësit mbështetjen e marrë nga udhëheqësit e shkollës e vlerësojnë mbi mesatare (M=3.79), (DS=1.13), ndërsa gabimi standard i mesatares së mostrës (SE=0.59).

Tabela 3. Të dhëna përshkruese për mbështetjen e marrë nga udhëheqësit e shkollave

N	Rangimi	Minimum	Maximum	Mesatarja		Devijimi standard	Varianca
Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Gabimi standard	Statistic	Statistic
363	4	1	5	3,79	,059	1,130	1,276

c) Konsultimi dhe mbështetja e ofruar jashtë shkollës

Në pyetjen lidhur me shpeshhtësinë e konsultimeve dhe mbështetjes profesionale të ofruar nga aktorët jashtë shkollës (kolegë nga shkollat tjera, trajnerë të kurrikulës, lehtësues e trajnerë nga iniciativa dhe programe tjera, zyrtarë të arsimit në komunë, inspektorë të arsimit, ekspertë të arsimit), nga 5 shkallët e shpeshhtësisë së ofrimit të mbështetjes profesionale dhe konsultimeve (1=Asnjëherë, 2=1-2herë, 3=3-5herë, 4=6-8herë, 5=Më shumë se 8 herë), rezultatet tregojnë se 53.3% e personelit të shkollës kanë përfituar nga konsultimet dhe mbështetja e jashtme profesionale, në forma të ndryshme (pjesëmarrje në trajnimet tjera, punëtori, takime formale dhe joformale), ndërsa 46.7% e personelit të shkollës asnjëherë nuk kanë pasur konsultime e as mbështetje tjetër të jashtme profesionale.

Ata që kanë përfituar më shumë nga mbështetja e jashtme janë koordinatorët e cilësisë (83.3%), mësimdhënësit e arsimit të mesëm të ulët (58.9%) dhe drejtorët/zëvendësdrejtorët (54.5%).

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se mbështetja e jashtme u ofrua nga kolegët e shkollave tjera N=344 ose 86.4%, trajneri i kurrikulës N=302 ose 77.2%, lehtësues/trajnerë nga iniciativa dhe programe tjera N=175 ose 49.4%, zyrtarë të arsimit në komunë N=146 ose 39.9%, inspektorë të arsimit N=132 ose 36.1%, ekspertë të arsimit N=121 ose 33.3%. Mësimdhënësit kanë shfrytëzuar edhe burimet tjera nga interneti, si nga faqja zyrtare e MASHT-it N= 328 ose 86.3%, dhe faqe tjera, si: faqja zyrtare e Institutit Pedagogjik të Kosovës, faqja zyrtare e Albasit, etj.

4.1.3. Pranimi apo besimi në kurrikulën e re

Vlera e analizës së koeficientit të Kronbahut (Cronbach's Alpha) është bërë për 12 pyetjet lidhur me pranimin apo besimin që kanë mësimdhënësit për kurrikulën e re, të bazuar në kompetenca. Vlerat e Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) janë $\alpha = .62$, me KMO dhe Barlett's Test=.82, dhe Sig =.000. Vlerat tregojnë besueshmëri të moderuar dhe lidhje të mirë mes pyetjeve.

Në 12 pyetjet e paraqitura në pyetësorin e anketës, lidhur me pranimin apo besimin për kurrikulën e re bazuar në kompetenca, mësimdhënësit kanë

shprehur nivele të ndryshme të pajtueshmërisë, besimit apo mosbesimit për zbatimin e kurrikulës në kontekstin e tyre të punës. Nga pesë shkallët e vlerësimit Likert (1-Aspak nuk pajtohem, 2-Nuk pajtohem, 3-Kam dilema/disi pajtohem, 4-Pajtohem, 5-Plotësisht pajtohem), mesatarja e përgjigjeve të tyre është (M= 3.52), që do të thotë se respondentët në masë të madhe shprehin pozitivisht pranimin apo besimin e tyre në kurrikulën e re.

Tabela 4. Të dhëna përshkruese lidhur me besimin e mësimdhënësve në kurrikulën e re

N	Rangimi	Minimum	Maximum	Mesatarja	Devijimi standard	Variance
Statistikat	Statistikat	Statistikat	Statistikat	Statistikat	Gabimi standard	Statistikat
416	4	1	5	3,52	,030	,371

Në anën tjetër, ekziston një përqindje relativisht e lartë e mësimdhënësve që përmes mendimit të tyre shprehin mospranim/ mosbesim ndaj kurrikulës së re, përkatësisht në disa prej kërkesave specifike lidhur me kurrikulën, si: (i) Rreth 56 % e mësimdhënësve shprehën se kurrikula e re ka pritshmëri tepër të larta; (ii) Rreth 39 % e mësimdhënësve shprehën se kurrikula e re ka ngarkesa të paarsyeshme; (iii) Mbi 32% e mësimdhënësve shprehën se kurrikula e re ka kërkesa të paarritshme; (iv) Mbi 37% e mësimdhënësve shprehën se kurrikula e re është tepër sfiduese; (v) Mbi 16% e mësimdhënësve shprehën se kurrikula e re është e vështirë për t'u kuptuar etj.

Tabela në vijim prezanton shkallën e pajtueshmërisë së të gjithë mësimdhënësve dhe dallimet e tyre lidhur me pranimin apo besimin e kurrikulës së re në raport me kërkesat specifike për matjen e qëndrimeve të tyre në këtë kategori të studimit

Tabela 5. *Shkalla e pajtueshmërisë së mësimdhënësve lidhur me pranimin apo besimin e kurrikulës së re*

Nr	Nga përvoja juaj me kurrikulën e re dhe informacionin që keni, si e shihni kurrikulën e re?	Aspak nuk pajtohem / Nuk pajtohem		Kam dilema / Disi pajtohem		Pajtohem/ Plotësisht pajtohem	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	Më e avancuar se kurrikula e mëparshme	37	9.1	91	22.5	277	68.4
4	Substancialisht/ shumë e ndryshme nga kurrikula e mëparshme	68	17.2	119	30.1	208	52.7
5	Kërkon ndryshimin e qasjes së punës nga mësimdhënësit	25	6.2	52	12.9	326	80.9
6	Ka pritshmëri tepër të larta	54	13.5	122	30.5	224	56.0
7	Ka kërkesa të paarritshme	152	38.6	115	29.2	127	32.2
8	Është fleksibile	40	10.1	133	33.6	223	56.3
10	Nxitëse për të mësuar	32	8.2	100	25.7	257	66.1
11	E komplikuar dhe jo praktike	197	50.3	125	31.9	70	17.9
12	E vështirë për t'u kuptuar	230	58.5	99	25.2	64	16.3
13	E vështirë për t'u zbatuar	186	47.6	96	24.6	107	27.36
14	Tepër sfiduese	147	36.9	103	25.9	148	37.2
15	Ka ngarkesa të paarsyeshme	150	37.13	97	24.0	157	38.87

Të dhënat nga tabela 5 tregojnë se shumica e të anketuarve pajtohen se kurrikula e re është më e avancuar se kurrikula e mëparshme (68.4%), substancialisht shumë ndryshe nga kurrikula e mëparshme, kërkon ndryshimin e qasjes së punës së mësimdhënësit, ka pritshmëri tepër të larta,

është fleksibile, kreative për mësimdhënës dhe nxënës dhe nxitëse për të mësuar, por në anën tjetër është edhe sfiduese dhe me ngarkesa. Një fakt shumë i rëndësishëm është pajtimi i plotë i mësimdhënësve se kurrikula e re është nxitëse për të mësuar (66.1%).

Aktorët e ndryshëm brenda shkollës kanë qëndrime të ndryshme për kurrikulën e re. Tabela 6 paraqet dallimet rreth pranimit/besimit që kanë për kurrikulën e re.

Tabela 6. Dallimet në shkallën e pajtueshmërisë sipas pozitës së punës në shkollë për pranimin/besimin në kurrikulën e re

	Pranimi apo besimi në kurrikulën e re (1-Aspak... 5-Plotësisht)					
Pozita e punës në shkollë	1	2	3	4	5	
	%					Gjithsej N
Drejtor/zv.drejtor shkolle	0,0	0,0	69,2	30,8	0,0	13
Koordinator i Kurrikulës në nivel shkolle	0,0	0,0	85,7	14,3	0,0	7
Koordinator i cilësisë	0,0	0,0	55,2	44,8	0,0	58
Kryetar i aktivitet të klasës përgatitore	0,0	0,0	25,0	66,7	8,3	12
Kryetar i aktivitet të klasës së parë	0,0	0,0	40,0	46,7	13,3	15
Kryetar i aktivitet të klasës së dytë	0,0	6,2	31,2	62,5	0,0	16
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi	0,0	0,0	69,2	30,8	0,0	13
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Matematika	0,0	0,0	75,0	25,0	0,0	4
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Shkencat e natyrës	0,0	0,0	50,0	50,0	0,0	8
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi	0,0	0,0	25,0	75,0	0,0	4
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	0,0	0,0	40,0	40,0	20,0	5
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Jeta dhe puna	0,0	0,0	25,0	75,0	0,0	4
Mësimdhënës, kujdestar i klasës së gjashtë	0,0	0,0	56,0	40,0	4,0	25
Mësimdhënës, kujdestar i klasës së shtatë	2,4	0,0	31,0	66,7	0,0	42
Vetëm mësimdhënës, pa ndonjë pozitë tjetër në shkollë	1,3	1,3	42,5	52,9	2,0	153

Lidhur me besimin apo pranimin e kurrikulës së re, pajtueshmëri më të lartë kanë shprehur mësimezhënësit, ndërsa drejtorët/zëvendësdrejtorët, koordinatorët e kurrikulës dhe koordinatorët e cilësisë në shkollë kanë dilema rreth pranimin apo besimin në kurrikulës së bazuar në kompetenca. Sipas të dhënave, dilemat e tyre lidhen me pritshmëritë e kurrikulës, ngase një përqindje bukur e lartë e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve pohojnë se kurrikula e re ka pritshmëri tepër të larta (61,8%), e që mendimin e njëjtë e ndajnë edhe shumica e koordinatorëve të cilësisë (54,4%), koordinatorët e kurrikulës në nivel shkolle (54,4%), kryetarët e aktiveve profesionale të fushës Gjuhët dhe komunikimi (61,5%) dhe të fushës së Matematikës (50.0%).

4.1.4. Praktika e zbatimit të kurrikulës

Zbatimi me sukses i Kurrikulës së re në arsimin parauniversitar në Kosovë kërkon angazhim të të gjithë stafit të shkollës dhe aktorëve tjerë mbështetës, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi kanë rol në procesin e zbatimit. Brenda autonomisë dhe fleksibilitetit në dispozicion, shkollat kanë mundësinë të bëjnë ndryshime në qasjet organizative, planifikuese e zbatuese, në funksion të përmbushjes së kërkesave të kurrikulës së re dhe pritshmërive për punën dhe organizimin e shkollës.

Në hulumtim, në fokus të studimit për praktikën e zbatimit të kurrikulës kemi pasur identifikimin e asaj se sa shkollat i kanë përshtatur dhe avancuar qasjet organizative dhe praktikën e punës e të mësimezhënies në përmbushje të kërkesave për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re. Në mënyrë specifike ndryshimet e mundshme në shkollë i kemi hulumtuar në rrafsh kryesore: a) ndryshimet organizative në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re, ndryshimet në punën me mësimezhënës, nxënës dhe prindër, si dhe b) ndryshimet në praktikën e mësimezhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës së re. Për ta bërë këtë, në pyetësin e anketës, të realizuar me mësimezhënës/stafin e institucioneve arsimore të përfshira në studim, kemi parashtruar tri kërkesa/ pyetje kryesore për praktikën e zbatimit të kurrikulës, gjithsej 58 kërkesa specifike të tipit të mbyllur për: (i) Ndryshimin në qasje të punës në nivel të institucionit/shkollës në zbatimin të kurrikulës së re; (ii) Praktikën

e mësimdhënies në funksion të zhvillimit të kompetencave; dhe (iii) Vështirësitë në zbatimin e praktikës së mësimdhënies në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për të gjitha kërkesat/pyetjet e parashtruara kanë treguar se kemi një lidhje të mirë në mes të pyetjeve për hulumtimin e aspekteve kryesore lidhur me praktikën e zbatimit të kurrikulës dhe besueshmëri të rëndësishme të pyetësorit të zbatuar në hulumtim me $\alpha = .91.$, me KMO dhe Bartlett's Test është $=.82$ dhe Sig $= .000$.

4.1.4.1. Ndryshimet në qasje të punës në nivel të institucionit/shkollës në zbatimin të kurrikulës së re

Pyetësi i anketës, i realizuar me mësimdhënës/personelin e shkollës, lidhur me ndryshimet në qasjen e punës së shkollave për zbatimin e kurrikulës së re, përmban 18 pyetje të mbyllura, me gjashtë alternativa për përgjigje: 1= *Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet*, 2= *Konsiderohen ndryshime të nevojshme, por vendosëm të mos ndryshojmë*, 3 = *Kemi ndërmend të bëjmë ndryshime*, 4= *Kemi bërë ndryshime të vogla*, 5= *Kemi bërë ndryshime të moderuara dhe* 6=*Kemi bërë ndryshime thelbësore*.

Me kërkesat e parashtruara në pyetësor synuam identifikimin e praktikave të institucioneve arsimore në zbatim të kurrikulës së re, respektivisht me ndryshimet e bëra në shkollë lidhur me aspektet:

- Organizative;
- Planifikimin e mësimin;
- Ndryshime në klasë;
- Ndryshime në punën me prindër.

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për pyetjet e parashtruara kanë treguar se kemi një lidhje të mirë në mes të pyetjeve për hulumtimin e këtij faktori dhe besueshmëri të rëndësishme të pyetësorit të zbatuar në hulumtim me $\alpha = .94.$, me KMO dhe Bartlett's Test $=.93$, dhe Sig $= .000$.

Rezultatet e përgjithshme për praktikat e institucioneve arsimore në zbatim të kurrikulës së re të shprehura në vlera numerike dhe në % janë të pasqyruara te tabela 7.

Tabela 7. Rezultati mesatar dhe devijimi standard për praktikat e institucioneve arsimore në zbatim të kurrikulës së re

N	Range	Minimum	Maximum	Mean		Std. Deviation	Variance
Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Std. Error	Statistic	Statistic
310	5,0	1,0	6,0	4,826	,0551	,9698	,940

Duke u bazuar në analizën e rezultateve dhe paraqitjen e tyre në tabelën 7, vërehet se sipas mendimit të përfaqësuesve të shkollave të përfshira në këtë studim dominon numri i shkollave që kanë bërë ndryshime të vogla dhe ndryshime të moderuara në kuadër të përgatitjes, organizimit dhe zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle. Mesatarja e respondentëve që kanë dhënë përgjigje në të gjitha alternativat për ndryshimet e bëra në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re ishte 4.8, nga maksimumi 6, i cili tregon për ndryshimet thelbësore në nivel shkolle në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re, kurse DS është 96. Kjo tregon se personeli i shkollës i përfshirë në studim shpreh pajtueshmëri të lartë lidhur me nivelin e ndryshimeve për zbatimin e kurrikulës së re, përfshirë ndryshimet organizative, ndryshimet në planifikimin e mësimi, ndryshimet në klasë dhe në punën me prindër.

Duke pasur parasysh se ndryshimet në qasjen e punës së shkollave për zbatimin e kurrikulës së re janë hulumtuar përmes 18 pyetjeve, kërkesave të mbyllura, përmes gjashtë alternativave për përgjigje, rezultatet janë analizuar për secilën pyetje/kërkesë. Ato prezantohen në tabelën në vijim.

Tabela 8. Të dhëna përshkruese për ndryshime në shkolla, përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re

A keni bërë ndryshime në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re?	Alternativat për përgjigje dhe rezultatet në % ²⁰ :						Nr.
	1	2	3	4	5	6	
1. Riorganizimin e brendshëm të shkollës	4,5	2,2	7,5	39,3	40,0	6,5	402
2. Monitorimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës	2,8	4,6	11,6	30,9	40,8	9,4	395
3. Format e përkrahjes kolegjiale	3,7	1,7	7,7	29,2	41,6	16,1	404
4. Mënyrat e punës në kuadër të aktivitetit profesional	3,0	2,5	9,3	29,3	35,9	19,9	396
5. Mënyrat e qasjes ndaj të mësuarit të mësimdhënësve për kurrikulën e re	2,0	4,0	8,5	28,8	44,1	12,5	399
6. Format e planifikimit mësimor – planet vjetore dhe planet tjera	2,2	2,5	5,2	11,3	33,3	45,6	406
7. Shtirjen e temave të programit mësimor dhe zbërthimin e tyre në njësi mësimore	3,0	1,7	5,0	18,6	37,7	34,0	403
8. Qasjen ndaj referimit në dokumente kurrikulare, në qëllime dhe parime	3,5	2,5	9,8	27,2	34,8	22,2	397

²⁰ **Alternativat për përgjigje:**

1. Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet
2. Konsiderohen ndryshime të nevojshme, por vendosëm të mos ndryshojmë
3. Kemi ndërmend të bëjmë ndryshime
4. Kemi bërë ndryshime të vogla
5. Kemi bërë ndryshime të moderuara
6. Kemi bërë ndryshime thelbësore

9.	Qasjen e integruar në planifikim dhe në mësimdhënie	2,5	3,0	8,1	27,0	38,4	21,0	396
10.	Praktikën e planifikimit për orë mësimore dhe të reflektimit	2,3	1,8	6,0	23,8	43,5	22,8	400
11.	Qasjen pedagogjike / aktivitetet e përdorura gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve	2,5	2,5	6,5	29,1	39,4	19,8	398
12.	Qasjen për përdorimin e teksteve dhe burimeve tjera mësimore	2,5	1,5	12,7	30,7	34,9	17,7	401
13.	Qasjet dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve	2,7	2,0	3,7	19,9	38,5	33,3	403
14.	Qasjen ndaj përdorimit të TIK-ut	3,8	1,3	11,3	26,3	37,3	20,1	399
15.	Rolin që nxënësit marrin në klasë	2,5	2,8	4,8	27,8	43,1	19,0	399
16.	Mënyrat e raportimit për prindër	3,3	3,8	6,4	24,4	44,4	17,7	390
17.	Përmbajtjen e raporteve për prindër	4,6	2,8	11,6	27,5	35,2	18,3	389
18.	Përdorimin e informatave kthyesë të marra nga prindërit	3,1	1,8	10,2	28,8	39,0	17,0	382

Bazuar në analizën e rezultateve dhe paraqitjes së tyre në tabelën 8, janë nxjerrë përshkrimet në vijim për ndryshimet organizative në shkollë, ndryshimet në planifikim të mësimin, ndryshimet në klasë dhe ndryshimet në punën me prindër.

a) **Ndryshimet organizative**

Lidhur me ndryshimet organizative në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re, pyetësi i realizuar me stafin e shkollës përmban pesë

pyetje. Referuar gjetjeve, nga 1 (*Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet*) deri në 6 (*Kemi bërë ndryshime thelbësore*), përgjigje të të anketuarve kemi pothuajse në të gjitha shkallët e vlerësimit, por që përqindje më të larta kemi te vlerësimi 5 (*Kemi bërë ndryshime të moderuara*).

Sipas rezultateve, ndryshimet organizative, të bëra në shkolla për zbatimin e kurrikulës së re, ndërliken me mënyrat e qasjes ndaj të mësuarit të mësimdhënësve për kurrikulën e re (44,1%) dhe në format e përkrahjes kolegjiale (41,6%). Ndryshime janë bërë edhe në monitorimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës (40,8%) dhe në riorganizimin e brendshëm të shkollës (40,0%), edhe pse te kjo e fundit kemi përqindjen më të lartë të të përgjigjurve për vlerësimin se *Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet* (4,5%). Mënyrat e punës në kuadër të aktivitetit profesional janë konsideruar gjithashtu si ndryshime të bëra në shkolla, me 35,9% të të përgjigjurve për këtë aspekt.

b). Planifikimi i mësimit

Për të parë nëse shkollat kanë në fokus ndryshimet për praktikën e planifikimit të mësimit, në pyetësor kemi shtruar pesë pyetje drejtuar mësimdhënësve/personelit të shkollës. Referuar përqindjeve më të larta të të përgjigjurve, *Ndryshime thelbësore*, në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re janë bërë sa i përket formave të planifikimit të mësimit – planet vjetore dhe planeve tjera (45,6%), ndërsa *Ndryshime të moderuara* kemi në praktikën e planifikimit për orë mësimore dhe të reflektimit (43,5%), qasjes së integruar në planifikim dhe në mësimdhënie (38,4%), shtrirjes së temave të programit mësimor dhe zbërthimit të tyre në njësi mësimore (37,7%), si dhe qasjes ndaj referimit në dokumente kurrikulare, në qëllime dhe parime (34,8%).

c) Ndryshime në klasë

Zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re, ndër të tjera, kërkon edhe ndryshime që duhet bërë në klasat dhe ambientet që zhvillohet mësimi, përfshirë ndryshimet në qasjen pedagogjike të mësimdhënësve, deri te roli i nxënësit në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Pyetësi i realizuar me stafin e

shkollës për këto aspekte përmban pesë pyetje, me mundësi të përgjigjes nga 1 (*Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet*) deri në 6 (*Kemi bërë ndryshime thelbësore*).

Përqindje më të lartë të të përgjigjurve kemi te vlerësimi *Kemi bërë ndryshime të moderuara* dhe atë lidhur me rolin që nxënësit marrin në klasë (43,1%), qasjen pedagogjike/aktivitetet e përdorura gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve (39,4%), qasjet dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve (38,5%), qasjen ndaj përdorimit të TIK-ut (37,3%), si dhe qasjen për përdorimin e teksteve dhe burimeve tjera mësimore (34,9%). Vlen të theksohet që përqindje më të lartë të të përgjigjurve për vlerësimin *Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet*, me 3,8%, kemi për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

d) Puna me prindër

Janë tri pyetje të shtruara në pyetësor lidhur me ndryshimet e bëra në shkolla në raport me punën me prindër në përmbushje të kërkesave të kurrikulës së re. Ndryshime të moderuara janë bërë në shkolla sa i përket përdorimit të informatave kthyesë të marra nga prindërit për zbatimin e kurrikulës së re (39%), mënyrës së raportimit me prindër (44,4%) dhe përmbajtjen e raporteve për prindër (35,2), edhe pse te kjo e fundit deklarimet se *Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet* kanë përqindjen më të lartë të të përgjigjurve, me 4,6%.

Referuar vitit shkollor në të cilin shkollat kanë filluar të punojnë me plane dhe programe të reja mësimore, të hartuara sipas kurrikulës së re, rezultatet e studimit treguan se nuk është pasqyruar ndonjë diferencë e madhe në ndryshimet e bëra nga shkollat, që zbatimin e filluan në vitin 2016/17 dhe atyre në vitin 2017/2018. Shprehur në përqindje, një epërsi të lehtë kemi te shkollat që zbatimin e filluan në vitin 2016/17 (*Kemi bërë ndryshime të moderuara*=46% dhe *Kemi bërë ndryshime thelbësore* = 25,2%). Rezultatet për ndryshimet në shkolla sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re pasqyrohen në tabelën në vijim.

Tabela 9. Të dhëna përshkruese për ndryshimet në shkollë, sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re

Viti i fillimit të zbatimit të kurrikulës së re	Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet	Konsiderohen ndryshime të nevojshme, por vendosëm të mos ndryshojnë	Kemi ndërmend të bëjmë ndryshime	Kemi bërë ndryshime të vogla	Kemi bërë ndryshime të moderuara	Kemi bërë ndryshime thelbësore	Gjithsej
2016/2017	,7%	2,7%	4,7%	20,7%	46,0%	25,3%	150
2017/2018	,7%	1,4%	4,9%	27,3%	42,0%	23,8%	143

4.1.5. Ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve, sipas kërkesave të kurrikulës së re

Pjesa e pyetësorit të anketës për ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve, sipas kërkesave të kurrikulës së re, është realizuar vetëm nga mësimdhënësit që japin mësim në klasat që zbatohet kurrikula e re, përkatësisht kurrikulat lëndore (n=408), por jo edhe nga udhëheqësit e saj (drejtori apo zv.drejtori). Kjo pjesë e pyetësorit të realizuar me mësimdhënës ka në fokus evidentimin e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës së. Është i orientuar në dy aspekte kryesore të hulumtimit, gjegjësisht në pasqyrimin e asaj se: a) Deri në çfarë mase aspekte të praktikave të mësimdhënies dhe nxënies janë të dukshme (evidente) në praktikën e mësimdhënies? dhe 2) Sa e konsiderojnë të lehtë apo të vështirë të anketuarit/mësimdhënësit zbatimin praktik të këtyre ndryshimeve?

Vlerat e analizës së koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) për 20 kërkesat/pyetjet e parashtruara kanë treguar se kemi një lidhje të mirë në mes të pyetjeve për hulumtimin këtyre aspekteve dhe besueshmëri të rëndësishme të pyetësorit të zbatuar në hulumtim me $\alpha = .88$., me KMO dhe Bartlett's Test është $=.84$ dhe Sig= $.000$.

Rezultatet e përgjithshme për këtë komponentë, të shprehura në vlera numerike dhe në %, janë të pasqyruara te tabela numër 10, në vijim:

Tabela 10. Të dhëna përshkruese për ndryshimet në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies, duke iu referuar zhvillimit të kompetencave

(Pyetja) Deri në çfarë mase aspektet vijuese janë të dukshme(evidente) në praktikën tuaj? Alternativat për përgjigje: <i>1. Nuk është evidente. Nuk është diçka që unë e konsideroj si një aspekt i rëndësishëm i praktikës sime</i> <i>2. Evidente në kohë, por jo diçka që unë ndihem se duhet të bëj gjithmonë</i> <i>3. Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë</i> <i>4. Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht.</i>							(Pyetja) Sa e shihni të vështirë t'i zbatoni në praktikë? Alternativat për përgjigje: <i>1. Shumë e vështirë</i> <i>2. E vështirë</i> <i>3. E lehtë</i> <i>4. Shumë e lehtë</i>					
		1.	2.	3.	4.	Nr		1.	2.	3.	4.	Nr
		%						%				
1	Unë i modifikoj praktikatat e mësimdhënies me qëllim që nxënësit të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit dhe të shprehurit.	0,5	13,6	49,3	36,6	374		2,1	32,1	57,4	8,4	359
2	Unë i angazhoj nxënësit që të shprehen në mënyrë adekuatë, nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, teksteve dhe formave tjera shprehëse.	2,1	13,6	44,7	39,6	374		3,6	24,5	55,7	16,2	358
3	Unë i përkrah nxënësit që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.	0,0	6,4	34,7	58,9	375		2,2	15,1	62,0	20,7	358

4	Unë i përkrah nxënësit në zhvillimin e kapaciteteve për t'iu qasur informatave dhe burimeve në mënyrë kritike, kreative (krijuese) dhe ndërvepruese.	0,8	5,9	42,4	50,9	375	2,3	23,5	56,9	17,3	353
5	Nxënësit angazhohen dhe bëjnë gjëra praktike me njohuri në kontekste dhe situata nga jeta	0,8	15,9	+	35,8	372	2,6	28,2	52,5	16,7	348
6	Nxënësit nxiten të marrin vendime dhe veprime për të zgjidhur probleme në mënyrë të vetëdijshme për ndikimin dhe pasojat e tyre.	1,6	13,9	49,7	34,8	368	3,5	31,2	57,5	7,8	346
7	Unë kam lexuar dhe përdorur hulumtimet e botuara për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies ndaj të mësuarit të nxënësve.	1,9	12,2	47,2	38,7	370	4,0	24,4	58,2	13,4	352
8	Unë kujdesem që nxënësve t'u krijojë shprehje, kushte dhe mundësi për t'u përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës.	0,3	4,9	33,8	61,0	369	2,6	25,1	52,0	20,3	342
9	Unë angazhohem me nxënës për të kultivuar vazhdimisht kërkshërinë edhe interesimin e tyre për të nxënë.	0,0	5,5	39,1	55,4	366	1,8	27,4	54,6	16,2	339
10	Unë mbledh sistematikisht të dhëna për përparimin e nxënësve, i analizoj ato për të kuptuar dhe për të dhënë përkrahje për nxënës në mësim.	0,8	6,2	39,6	53,4	369	3,0	23,7	56,8	16,5	338
11	Angazhohem që nxënësit të vetëdijesohen për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.	0,5	6,6	35,2	57,7	364	0,6	22,8	58,1	18,5	331
12	Nxënësit përkrahen që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvlerësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore.	0,8	13,4	48,6	37,2	366	3,6	33,5	52,9	10	331

13	Nxënësit përgatiten që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.	1,1	18,4	45,0	35,5	358	4,3	36,5	45,9	13,3	329
14	Unë punoj me prindër dhe komunitet, me qëllim përfshirjen e nxënësve në jetën familjare dhe shoqërore	1,9	20,5	39,5	38,1	365	7	33,3	44,3	15,4	327
15	Nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për shëndetin e tyre, të kujdesen për veten dhe të kenë vetëbesim	0,3	7,1	38,1	54,5	365	2,7	22,7	55,5	19,1	335
16	Nxënësit nxiten të jenë të hapur dhe të kenë besim për të tjerët dhe te të tjerët.	0,8	8,7	34,4	56,1	357	1,2	25,8	55,9	17,1	329
17	Unë mbështetem në përvojën e kolegëve për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies.	0,3	11	46,3	42,4	363	1,5	19,3	62,5	16,7	336
18	Unë angazhohem rreth nevojave të nxënësve në mësim dhe veproj në bazë të përgjegjësisë për të përkrahur zhvillimin maksimal të nxënësve	0,8	4,4	36,2	58,6	362	2,4	25,2	53,2	19,2	333
19	Unë praktikoj përfshirjen e nxënësve në vendimet lidhur me format e mësimi dhe masat tjera rreth të nxënësve të tyre.	0	8,8	44,6	46,6	363	2,7	27,5	54	15,8	335
20	Unë praktikoj punën me projekte, me qëllim vlerësimin e nxënësve në më shumë se një kompetencë	0,8	9,8	42,1	47,3	357	4,9	25	52,7	17,4	328

Bazuar në analizën e rezultateve dhe paraqitjes së tyre në tabelën 10, janë nxjerrë përshkrime për ndryshimet në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies, duke iu referuar zhvillimit të kompetencave, në fokus për rëndësinë dhe vështirësitë e zbatimit të ndryshimeve në mësimdhënie dhe nxënie, në punën me nxënës. Përshkrimet e analizës së rezultateve janë përmbledhur në pikat në vijim:

A. Rëndësia (evidenca) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies;

B. Vështirësitë në zbatimin praktik të ndryshimeve.

a) Rëndësia (evidenca) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies

Për të identifikuar se deri në çfarë mase ndryshimet në procesin e mësimdhënies dhe nxënies janë të rëndësishme (evidente) në shkolla, në pyetësoin e anketës janë integruar 20 pyetje të mbyllura, me katër shkallë vlerësimi: 1=*Nuk është evidente. Nuk është diçka që unë e konsideroj si një aspekt i rëndësishëm i praktikës sime*, 2= *Evidente në kohë, por jo diçka që unë ndihem se duhet të bëj gjithmonë*; 3=*Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë, dhe* 4= *Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht*.

Tabela numër 3 shihet se shkalla e pajtueshmërisë nga 1 (*Nuk është evidente. Nuk është diçka që unë e konsideroj si një aspekt i rëndësishëm i praktikës sime*) deri në 4 (*Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht*), mostra e përfshirë në studim shpreh pajtueshmëri të mirë lidhur me rëndësinë (evidencën) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies, në funksion të zbatimit të kurrikulës së re ($M=3,3$), ($DS=.48$), tabela 11.

Tabela 11. Të dhëna përshkruese për rëndësinë (evidencën) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies

N	Minimum	Maximum	Mean		Std. Deviation	Variance
Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Std. Error	Statistic	Statistic
383	1	4	3,33	,025	,480	,230

Referuar përqindjeve të të përgjigjurve, ka ndryshime evidente në qëndrimet e të anketuarve për rëndësinë e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies në shkolla. Shkallë të pajtueshmërisë nga 1 (*Nuk është evidente. Nuk është diçka që unë e konsideroj si një aspekt i rëndësishëm i praktikës sime*) deri në 4 (*Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht*) me përqindje më të lartë kemi tek vlerësimi 3 (*Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë*) dhe 4 (*Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht*). Në këtë pikë, bazuar në aspektet e hulumtuar, analizën dhe raportimin e rëndësisë së ndryshimeve e kemi ndërlidhur me ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies dhe ndërlidhjen e mundshme me arritjen kompetencave bazë që i thërret kurrikula e re. Rezultatet e dala, shprehur në përqindjen më të lartë të të përgjigjurve, janë si në vijim:

Kompetenca Komunikimi dhe të shprehurit – Komunikues efektiv, të anketuarit e deklarojnë se për ta është shumë e qartë, evidente dhe e rëndësishme dhe ata vazhdimisht përkrahin nxënësit që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit (58,9%); shumë evidente dhe e rëndësishme dhe ata shpesh modifikojnë praktikat e mësimdhënies, me qëllim që nxënësit të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit dhe të shprehurit (49,3%), dhe angazhim të nxënësve që të shprehen në mënyrë adekuate, nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, teksteve dhe formave tjera shprehëse (44,7%).

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik. Të anketuarit deklarojnë se për ta është shumë e qartë, evidente dhe e rëndësishme dhe ata vazhdimisht përkrahin nxënësit në zhvillimin e kapaciteteve për t'iu qasur informatave dhe burimeve në mënyrë kritike, kreative (krijuese) dhe ndërvepruese (50,9%); shumë evidente dhe e rëndësishme dhe ata shpesh nxisin nxënësit për të marrë vendime dhe veprime për të zgjidhur probleme në mënyrë të vetëdijshme për ndikimin dhe pasojat e tyre (49,7%) dhe angazhimin e nxënësve për të bërë gjëra praktike me njohuri në kontekste dhe situata nga jeta (47,5%).



Kompetenca e të mësuarit - Nxënës i suksesshëm. Të anketuarit deklarojnë se për ta është shumë e qartë, evidente dhe e rëndësishme dhe ata vazhdimisht kujdesen që nxënësve t'u krijojnë shprehi, kushte dhe mundësi për t'u përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës (61%), angazhohen me nxënës për të kultivuar vazhdimisht kërkueshmërinë edhe interesimin e tyre për të nxënë (55,4%) dhe mbledhin sistematikisht të dhëna për përparimin e nxënësve, i analizojnë ato për të kuptuar dhe për të dhënë përkrahje për nxënës në mësim (53,4%); shumë evidente, e rëndësishme dhe ata shpesh lexojnë dhe përdorin hulumtimet e botuara për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies ndaj të mësuarit të nxënësve (47,2%).


Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv. Të anketuarit deklarojnë se për ta është shumë e qartë, evidente dhe e rëndësishme dhe ata vazhdimisht angazhohen që nxënësit të vetëdijesohen për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit (57,7%); shumë evidente, e rëndësishme dhe ata shpesh përkrahin nxënësit që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvlerësinë ndërmjet fenomeneve

shoqërore dhe natyrore (48,6%), të përgatiten që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale (45%) dhe se ata shpesh punojnë me prindër dhe komunitet, me qëllim përfshirjen e nxënësve në jetën familjare dhe shoqërore (39,5%).

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë. Të anketuarit deklarojnë se për ta është shumë e qartë, evidente dhe e rëndësishme dhe ata vazhdimisht nxisin nxënësit që të jenë të hapur dhe të kenë besim për të tjerët dhe te të tjerët (56,1%) dhe ata përkrahin nxënësit që të vetëdijesohen për shëndetin e tyre, të kujdesen për veten dhe të kenë vetëbesim (54,5%) .

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm. Të anketuarit deklarojnë se për ta është shumë e qartë, evidente dhe e rëndësishme dhe ata vazhdimisht angazhohen rreth nevojave të nxënësve në mësim dhe veprojë në bazë të përgjegjësisë për të përkrahur zhvillimin maksimal të nxënësve (58,6%), praktikojnë punën me projekte, me qëllim vlerësimin e nxënësve në më shumë se një kompetencë (47,3%) dhe përfshirjen e nxënësve në vendimet lidhur me format e mësimin dhe masat tjera rreth të nxënësve të tyre (46,6%); shumë evidente, e rëndësishme dhe ata shpesh mbështeten në përvojën e kolegëve për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies (46,3%).

Referuar përqindjes së të përgjigjurve për rëndësinë (evidencën) e ndryshimeve në praktikën e mësimdhënies si total, gjetjet e studimit kanë treguar se nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh në qëndrime të mostrës nga shkollat që zbatimin e kurrikulës së re e filluan në vitin 2016/17 dhe atyre që këtë zbatim e filluan në vitin 2017/2018. Te të dyja kategoritë, tendencat e qëndrimeve pozitive për evidencën e ndryshimeve përqendrohen tek vlerësimi 3 (*Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë*) dhe 4 (*Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht*).



Grafiku 4. Rëndësia (evidenca) e ndryshimeve në praktikën e mësimdhënies, sipas viteve të zbatimit të Kurrikulës së re

Më tutje, në studim kemi vazhduar me analizën dhe raportimin e gjetjeve për këto aspekte, krahasuar me pozitën e punës së të përgjigjurve në shkollë.

Gjetjet e studimit kanë treguar se në përqindje më të lartë për rëndësinë e ndryshimeve në shkollë (vlerësimi 3 - *Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëjë shpesh këtë gjë*, dhe vlerësimi 4 - *Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëjë këtë vazhdimisht*) janë deklaruar të emëruarit në cilësinë e koordinatorit apo kryetarit për çështje të ndryshme në shkollë (10 nga 12 gjithsej). Në anën tjetër, mësimdhënësit e angazhuar në cilësinë e kujdestarit të klasës, apo vetëm mësimdhënës, pa ndonjë pozitë tjetër në shkollë, janë deklaruar më skeptikë në raport me rëndësinë e ndryshimeve, meqenëse përqindje më të lartë të të përgjigjurve të tyre kemi tek vlerësimi 1 (*Nuk është evidente. Nuk është diçka që unë e konsideroj si një aspekt i rëndësishëm i praktikës sime*) dhe 2 (*Evidente në kohë, por jo diçka që unë ndihem se duhet të bëjë gjithmonë*).

Tabela 12. Të dhëna përshkruese për rëndësinë (evidencën) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies dhe vështirësitë e zbatimit praktik të ndryshimeve, sipas pozitës/rolit të mësimdhënësve në shkollë

	Rëndësia (evidenca) e ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies					Vështirësitë në zbatimin praktik të ndryshimeve				
Pozita e punës në shkollë						Shumë e vështirë	E vështirë	E lehtë	Shumë e lehtë	
	1	2	3	4						
	%				Nr	%				Nr.
Koordinator i Kurrikulës në nivel shkolle	0,0	20,0	40,0	40,0	5	0,0	33,3	50,0	16,7	6
Koordinator i cilësisë	8,3	38,3	33,3	20,0	60	0	35,0	50,0	15,0	40
Kryetar i aktivitet të klasës përgatitore	0,0	14,3	42,9	42,9	7	0,0	22,2	55,6	22,2	9
Kryetar i aktivitet të klasës së parë	0,0	18,2	27,3	54,5	11	0,0	9,1	72,7	18,2	11
Kryetar i aktivitet të klasës së dytë	0,0	10,0	40,0	50,0	10	0,0	12,5	75,0	12,5	8
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi	28,3	43,6	11,4	16,7	13	0,0	50,0	33,3	16,7	6
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Matematika	40,0	0,0	40,0	20,0	5	0,0	0,0	50,0	50,0	2
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Shkencat e natyrës	25,0	12,5	37,5	25,0	8	0,0	0,0	100	0,0	4
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi	0,0	0,0	100,0	0,0	1	0,0	0,0	0,0	100	1
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	35,0	35,0	15,0	15,0	5	0,0	0,0	100	0,0	1
Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare Jeta dhe Puna	0,0	0,0	66,7	33,3	3	0,0	0,0	100	0,0	3
Mësimdhënës, kujdestar i klasës 6	42,3	29,8	12,6	15,3	25	0,0	28,6	42,9	28,6	14
Mësimdhënës, kujdestar i klasës 7	34,5	25,3	20,1	20,1	40	4,0	32,0	40,0	24,0	25
Vetëm mësimdhënës, pa ndonjë pozitë tjetër në shkollë	28,5	22,4	23,0	26,1	154	2,2	33,0	51,6	13,2	91
Koordinator i cilësisë dhe mësimdhënës	58,2	15,2	15,2	11,4	6	0,0	60,0	40,0	0,0	5

B) Vështirësitë në zbatimin praktik të ndryshimeve


Për 20 pyetjet/kërkesat e anketës, të analizuar dhe të raportuara pak më lart, tek pika 2, nënpika a, në pyetësor është ofruar edhe mundësia që të anketuarit të japin qëndrimet e tyre për shkallën e vështirësisë, të realizimit të aspekteve përkatëse në praktikën e punës së tyre në shkollë.

Janë katër alternativa për përgjigje: 1= *Shumë e vështirë*, 2.=*E vështirë*, 3=*E lehtë*, 4=*Shumë e lehtë*. Në tabelën numër 13 shihet se shkalla e pajtueshmërisë nga 1 (*Shumë e vështirë*) deri në 4 (*Shumë e lehtë*), ndërsa mostra e përfshirë në studim shpreh pajtueshmëri të mirë lidhur me rëndësinë (evidencën) dhe vështirësitë në zbatimin praktik të ndryshimeve në shkollë në funksion të zbatimit të kurrikulës së re ($M=2,82$), ($DS=.50$).

Tabela 13. Të dhëna përshkruese për vështirësitë në zbatimin e ndryshimeve në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies

N	Range	Minimum	Maximum	Mean		Std. Deviation	Variance
Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Statistic	Std. Error	Statistic	Statistic
381	3	1	4	2,82	,026	,508	,259

Është me rëndësi të përmendet që në 20 pyetjet/kërkesat e parashtruara në pyetësor përqindjet më të larta të të përgjigjeve i kemi te vlerësimi 3 (*E lehtë*), përcjell pastaj me përqindje pak më të ulëta tek vlerësimi 2 (*E vështirë*). Grafiku në vijim pasqyron përgjigjet e mësimdhënësve lidhur me vështirësitë e tyre në zbatimin e ndryshimeve në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies.




Grafiku 5. Përshkrimi i përgjithshëm i qëndrimeve të mësimitdhënësve për vështirësitë e zbatimit praktik të ndryshimeve, sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re

Referuar tabelës 13, rezultatet e përgjithshme në nr. dhe % për rëndësinë dhe vështirësitë e zbatimit të ndryshimeve në praktikën e mësimitdhënies dhe nxënies, në përqindje më të lartë të të përgjigjurve, lehtë të realizueshme, të përgjigjurit konsiderojnë *mbështetjen e tyre në përvojën e kolegëve për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën e mësimitdhënies* (62, 5%) dhe *përkrahjen e nxënësve që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit* (62%), përderisa vështirësi në zbatim konsiderojnë *përgatitjen e nxënësve që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale* (36,5%) dhe *përkrahjen e nxënësve që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet* (33,5%).

Krahasuar me përqindjet për rëndësinë (evidencën) e ndryshimit, kemi rezultatet në vijim:

Disa praktika të mësimdhënies, të lidhura me zhvillimin e kompetencave të nxënësve	Rëndësia (evidenca) e ndryshimeve - sipas mësimdhënësve	Vështirësia e zbatimit praktik të ndryshimeve -sipas mësimdhënësve
Unë mbështetem në përvojën e kolegëve për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies.	(3) Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë (46,3%)	(3) E lehtë (62,5%)
Unë i përkrah nxënësit që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative, mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të shprehurit.	(4) Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht. (58,9%)	(3) E lehtë (62%)
Nxënësit përgatiten që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.	(3) Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë (45%)	(2) E vështirë (36,5%)
Nxënësit përkrahen që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvlerësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore	(3) Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë (48,6%)	(2) E vështirë (33,5%)

Referuar vitit të zbatimit, gjetjet treguan se shkollat që me zbatim të kurrikulës së re filluan në vitin 2017/18 deklarojnë vështirësi më të mëdha në zbatimin praktik të ndryshimeve, krahasuar me ato që këtë zbatim e filluan një vit më herët.



Grafiku 6. Qëndrimet e mësimdhënësve për vështirësitë e zbatimit praktik të ndryshimeve sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re, sipas viteve të zbatimit të kurrikulës së re

Bazuar në pozitën e punës në shkollë, më lart pamë se mësimdhënësit (përfshirë dhe kujdestarët e klasave) ishin më skeptikë lidhur me rëndësinë e ndryshimeve në shkolla. Krahastuar me deklaratimet e tyre për vështirësitë në zbatimin praktik të ndryshimeve, shohim se të njëjtit, edhe pse nuk i konsiderojnë si të rëndësishme (evidente) ndryshimet në mbështetje të zbatimit të kurrikulës së re, megjithatë vlerësojnë se ato ndryshime janë të lehta dhe mund të gjejnë zbatim në shkollat ku ata punojnë. Në anën tjetër, të emëruarit në cilësinë e koordinatorëve apo kryetarit për çështje të ndryshme në shkollë (10 nga 12 gjithsej) edhe më tutje vazhdojnë të deklarojnë si të lehtë procesin e zbatimit praktik të ndryshimeve në funksion të zbatimit me sukses të kurrikulës së re në shkolla, tabela nr. 6 në raport.

4.2. Rezultatet nga hulumtimi cilësor

Siç është theksuar edhe në kapitullin e metodologjisë, krahas përpunimit dhe interpretimit të dhënave sasiore të studimit, është realizuar edhe përpunimi dhe interpretimi të dhënave cilësore të tij. Gjetjet/rezultatet nga analiza tematike e të dhënave nga studimi cilësor janë organizuar në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin gjetjet nga përpunimi dhe interpretimi i të dhënave të siguruar me pyetësorë dhe intervistat gjysmë të strukturuar, të realizuara me udhëheqës nga shkollat, koordinatorë të cilësisë në DKA, zyrtarë dhe inspektorë të arsimit nga MASHT-i, si dhe me njohës të reformës kurrikulare dhe të arsimit parauniversitar. Në pjesën e dytë janë përfshirë të dhëna nga analiza e kurrikulave lëndore/programet mësimore, dokumentimit të planifikimeve të mësimdhënësve dhe dokumentimit të punës së shkollës në udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës.

4.2.1. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e komunitetit arsimor për arritjet në zbatimin e kurrikulës, sfidat e problemet kryesore, mundësitë dhe nevojat për mbështetje

4.2.1.1. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e mësimdhënësve

Në këtë pjesë pasqyrohen rezultatet e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtimin sasior, të cilët kanë dhënë përgjigje në pyetjet e hapura në

pyetësoin që është administruar me mësimdhënës. Pyetësoi i realizuar me mësimdhënës nga pozita të ndryshme në shkollë përbëhej edhe nga pesë pyetje të hapura, përmes së cilave është synuar të mblidhen mendime, pikëpamje të mësimdhënësve për përmirësimin e zbatimit të kurrikulës. Në pyetjet e hapura kanë dhënë përgjigje 403 mësimdhënës. Një numër syresh kanë dhënë përgjigje jo të saktë, gjysmake, si p.sh. nuk kemi vështirësi, ose do duhej ndryshuar infrastruktura e shkollës, e të ngjashme. Për analizë tematike, pjesëmarrësit në hulumtim, që kanë dhënë përgjigje në pyetjet e hapura, janë koduar me numër nga 1-403. Numri në kllapa, pas fjalisë, është kod.

Konceptet kryesore të identifikuara

Nga analiza tematike, bërë përgjigjeve të dhëna nga mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim, janë identifikuar disa tema me rëndësi, për të cilat ata mendojnë se përmirësimi i tyre do ta përmirësonte zbatimin e kurrikulës në shkollë. Përzgjedhja e mendimeve të tyre është bërë në bazë të tematikës dhe përmbajtjes së propozuar. Është me interes të ceket se mësimdhënësit e së njëjtës shkollë japin sugjerime dhe propozime shumë të ngjashme. Ka raste edhe identike. Në shumicën e rasteve, mësimdhënësit nuk bëjnë parashikime për përmirësim, por paraqesin sfida dhe gjendje, siç janë: mungesa e teksteve, numri i madh i nxënësve në klasa, mungesa e mjeteve dhe kabineteve etj. Kryesisht, si faktorë të rëndësishëm për përmirësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës, përmendin: bashkëpunimin ndërmjet kolegëve brenda shkollës, brenda fushës kurrikulare, ndërmjet shkollave, fuqizimin e Aktiveve profesionale, bashkëpunimin me prindër, ndërgjegjësimin e palëve të interesit etj.

Bashkëpunimi ndërmjet kolegëve, me shkollat tjera dhe me prindër

Numër i madh i mësimdhënësve përmirësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës e shohin në cilësinë e bashkëpunimit dhe të këmbimit të përvojave ndërmjet mësimdhënësve brenda shkollës, si dhe bashkëpunimit me shkollat tjera. Ky është moment i rëndësishëm i theksimit të rëndësisë së bashkëpunimit ndërmjet kolegëve, por në të njëjtën kohë brengos fakti i mungesës së bashkëpunimit. *"Bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve është*

faktor shumë i rëndësishëm për përmirësimin e kurrikulës (10)”. Ndërsa tjetri e zgjeron rëndësinë e bashkëpunimit edhe ndër shkolla dhe kolegë të tjerë për përmirësimin e zbatimit të kurrikulës: “... të bashkëpunimi me kolegët apo dhe bashkëpunimit me shkollat tjera konsideroj që kemi me pasë sukses (22)’. Por, kemi edhe disa mendime se për përmirësimin është i nevojshëm edhe “bashkëpunimi ndërkolegial, duke bërë monitorime të kolegët, duke u konsultuar për çdo paqartësi të kurrikulës” (264), ku ceken edhe monitorimi dhe konsultimet.

Kishte edhe të tillë që përmirësimin e shohin “kur rritet niveli i bashkëpunimit të mësimdhënësve, udhëheqjes së shkollës, komunitetit/prindërve, për gjetjet e vështirësive dhe përmirësimin e tyre, duke komunikuar hapur dhe në mënyrë konstruktive (396). Mund të shihet diçka pozitive në kërkesat e këtilla kur kërkohet një sinergji midis aktorëve të shkollës. Në të njëjtën kohë kjo mund të shihet edhe si sfidë dhe alarm për mungesën e bashkëpunimit ndërmjet këtyre aktorëve. “Përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën tonë e parashikojmë duke bashkëpunuar me kolegët, po ashtu edhe me prindërit (324). Ky mund të jetë një konstatim kontekstual, pasi që në shumicën e shkollave është gjendje e përafërt. Mungesë bashkëpunimi, por shumica e shohin si të domosdoshëm për arritjen e suksesit.

Fuqizimi i Aktiveve profesionale

Aktivitetet profesionale në shkollë nuk janë koncept i panjohur, por funksionimi i tyre i mirëfilltë dallon nga shkolla në shkollë. Rëndësinë e funksionimit dhe të funksionalizimit të tyre e shohin si kusht për përmirësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës. Një numër syresh e shohin vetëm si organi profesional, por kemi të tillë që e ndërlidhin edhe me funksionimin e menaxhmentit, si “Bashkëpunim kolegial, bashkëpunim në mes të AP-ve, bashkëpunim me menaxhmentin e shkollës (153). Këtu mund të vërehet bashkëpunimi si nevojë, por edhe si mungesë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre organeve brenda shkollës. “Bashkëpunimi ndërmjet organeve qeveritare të shkollës dhe organeve profesionale”(215. Theksimi i nevojës për bashkëpunim ‘ndërmjet udhëheqjes dhe aktiveve profesionale’ tregon

mungesën e këtij bashkëpunimi, i cili në kushte normale do të ishte jonormal.

Ndërgjegjësimi i nxënësve

Një element me rëndësi në mendimet dhe propozimet e mësimdhënësve të përfshirë në mostër është theksimi i rolit të nxënësit në proces, por kjo përfshirje kërkohet më shumë në aspektin e ndërgjegjësimit të tyre, ose njëfarë disiplinimi i tyre për nxënie. Ose edhe në kërkesat për kushte më të mira për nxënës, si dhe “vajtimi” për mungesë të teksteve, mjeteve mësimore dhe laboratorëve. *Krijimi i vetëbesimit që ky proces është i suksesshëm, krijimi i një mjedisi stimulues për mësimdhënie dhe nxënie cilësore, bashkëpunimi kolegjial, pasoja e shkollës me mjete konkretizimi dhe tekste të përshtatshme* (326). Prandaj, nuk shihet roli i nxënësit në proces të zbatimit të Kurrikulës, ose të përmirësimit të procesit. *Angazhim i mëtutjeshëm i mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës, ndërgjegjësimin e nxënësve, qasja e tyre në punë dhe angazhim më i madh i prindërve* (288). Në asnjërën deklaratë nuk shihet përfshirja e drejtpërdrejtë e nxënësve.

Kohëzgjatja e orarit të mësimëve ditore

Disa e shohin si të rëndësishëm për përmirësimin e procesit të zbatimit “*aplikimin e sistemit tërëditor, që mundëson dhe bën të mundur bashkëpunimin, ofron kohë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrave, punës pa shpëputje dhe zhvillimin e aktiviteteve në shkollë*” (365). Kohëzgjatja e orarit shihet si e rëndësishme për përmirësim. Ndërsa shkollat e mbingarkuara me nxënës si pengesë dhe si propozim për përmirësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës e shohin shkarkimin nga numri i madh i nxënësve. Prandaj, në kuadër të kushteve të tjera për përmirësim parashohin edhe “*reduktimin e numrit të nxënësve nëpër klasa, trajnimet shtesë ose trajnimin me bazë në shkollë, takimet më të shpeshta mes aktiveve, hospitimet nëpër orë mësimore etj.*” (357). Këta faktorë të përmendur, nga disa mësimdhënës, nuk kanë ndonjë lidhje ndërmjet tyre, por ndërlidhen me kushtet e përmirësimit.

Pajisja me mjete konkretizimi dhe tekste shkollore

Elementi më i përforur, përsëritur, në deklaratat e mësimdhënësve janë mjetet mësimore dhe tekstet shkollore për nxënës. Bile, ka edhe mendime të tilla, si p.sh., sigurimi i projektorëve, që fare nuk lidhen drejtpërdrejt me zbatimin dhe përmirësimin e procesit. *“Meqenëse kemi një kurrikulë mjaft moderne dhe me kërkesa që u përshtaten zhvillimeve të kohës, atëherë koha e qëndrimit në objekte shkollore duhet të jetë më e gjatë. Qëndrimi vetëm pesë apo dhe gjashtë orë në shkollë, nxënësve po u kushton me ngarkesa tjera... dhe pjesa tjetër e plotësimit mësimor po u mbetet në shtëpi (318).* Nuk ka ndonjë propozim më konkret lidhur me nevojën për mjetet e konkretizimit, të cilat ndërlidhen me efikasitetin e zbatimit ose përmirësimin e procesit.

Nevoja për trajnime shtesë

Nga mendimet e mësimdhënësve shihet se kanë shumë kërkesa për qasjen ndaj trajnimit. Shumë prej tyre kërkojnë trajnime ose sqarime shtesë për dokumentin e kurrikulës, ose për zbatimin e tij, aspektet metodologjike. Por, hasen edhe mendime të rëndësishme, si: *Mësimdhënësit të lexojnë me kujdes udhëzuesit e kurrikulës, si dhe ta zbatojnë në praktikë në mënyrën më të mirë të mundshme (278).* Kjo sigurisht ka dalë gjatë trajnimeve ose edhe diskutimeve që po bëhen për dhe kundër formatit të dokumentit, sidomos për metodologjinë e zbatimit. Tjetër tregues me interes është kërkesa për trajnim nga ekspertët. Sigurisht që kanë parë mangësi në trajnimet paraprake, të cilat nuk i kanë plotësuar kërkesat metodologjike. Kërkesa për *“trajnime adekuate për mësimdhënës, thjeshtëzimin e kurrikulës, thjeshtëzimin e formateve të planeve ditore, javore 3 mujore dhe vjetore”(334).* Kjo është një kërkesë e vazhdueshme e mësimdhënësve, “ngarkesa administrative”, siç e quajnë ata. Por, kemi edhe qëndrime të tjera, si: *“Përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të KK-së në shkollën tonë e shoh nëpërmjet planifikimeve zhvillimore adekuate, vlerësimin e rregullt të punës që bëhet, analizimin e rezultateve të punës dhe suksesit të nxënësve, kontrollin më të madh të punës dhe planifikimet e ardhshme për intervenimin aty ku ka nevojë më shumë” 337.* Kjo është një kërkesë e llojit të vet për përgjegjësi dhe mbikëqyrje nga menaxhimi i shkollës. Është me rëndësi këtu

kërkesa për identifikim të nevojës për intervenim. Ka raste kur kërkesat për përmirësim janë shumë gjithëpërfshirëse, si: *Organizime shitesë të trajnimeve për zbatimin e kurrikulës së re, bashkëpunimi kolegjial brenda fushës dhe fushave në tërësi, hartimi i projekteve të caktuara dhe përputhshmëria e tyre në zbatim, roli i Arsimit Profesional, përgatitja e instrumenteve vlerësuese sipas fushave, përgatitja e fokus-grupit, bashkëpunimi i zbatimit të trekëndëshit prind-nxënës-mësimdhënës etj. (367).*

Marrë në përgjithësi, mendimet dhe propozimet e mësimdhënësve të përfshirë në mostër janë sa të ndryshme edhe të ngjashme. Të paktë janë ata që kanë propozime shumë konkrete, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e procesit për zbatimin e kurrikulës. Megjithatë, kanë dhënë ide dhe mendime me interes për hulumtimin.

Ndihma individuale/ personale për një proces të suksesshëm

Nga gjithsej 403 mësimdhënës të përfshirë në mostër që kanë dhënë përgjigje në pyetjet e hapura, është vështirë të gjesh ndonjë propozim, mendim për rolin individual/personal në përmirësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës. Shihet një ngjashmëri e madhe me përgjigjen e dhënë në pyetjen paraprake (20), ku theksohet shumë kërkesa për bashkëpunim ndërmjet kolegëve, si dhe trajnimet dhe mjetet mësimore, si kusht për përmirësimin e procesit të zbatimit të kurrikulës. Shkëputëm disa mendime pak më ndryshe: *“Ta pranojmë si realitet, të shkëmbejmë përvoja, të ndihmojmë njëri-tjetrin, të kërkojmë ndihmë nga persona adekuatë. Trajnimet të mbahen nga personat që e njohin mirë problemin (45). Por, ndoshta i ndërlidhur tërthorazi me pyetjen mund të jetë mendimi: “Përkushtimi, vullneti për të ndryshuar, angazhimi për mësim gjatë gjithë jetës, funksionalizimi i aktiveve profesionale, ngritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia individuale e kolektive për mossuksesin”(326). As këtu nuk mund të nxjerrim ndonjë përfundim për vendosjen e individit në krye të përgjegjësisë për përmirësimin e procesit. Ka shumë raste të hedhjes së përgjegjësisë te të tjerët, si p.sh:*

“Ne punojmë edhe në mënyra të ndryshme për ta realizuar këtë, por përgjegjësia më e madhe bie te Drejtoria Komunale, si dhe Ministria e Arsimit, të cilat janë edhe përgjegjëse (37).

Kërkesat dhe sugjerimet për ndryshime në planet dhe programet mësimore

Nga 403 pjesëmarrës në mostër që kanë dhënë përgjigje në pyetjet e hapura, jo të gjithë kanë dhënë ndonjë sugjerim të qartë për ndryshime në planet dhe programet mësimore. Shumica prej tyre janë të përgjithësuara: *‘duhet të..., janë të ngarkuara, janë të ngjashme’*, por pa dhënë argumente të sakta. Disa prej tyre, të cilat adresojnë më qartë nevojën për ndryshime, paraqiten në vijim. *“Plani dhe programi më se i ngarkuar dhe joadekuat për nivelet. Për nivelin klasor më shumë lidhshmëri me fenomene dhe punë praktike. Plani dhe programi i stërngarkuar, nuk lejon që të angazhohemi sa duhet me aktivitete dhe punë praktike (45).* Pra, nuk kemi sugjerim specifik se çfarë duhet ndryshuar. Më shumë sugjerime më konkrete kemi te fusha gjuhët dhe komunikimi, si dhe te TIK-u.

Programet lëndore 1-5 duhet të rishikohen, sidomos rezultatet e fushave Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Shkencat e natyrës janë disa shumë të paarritshme për moshën e nxënësve kur specifikohet klasa I (67). Nuk ka të dhëna se përse REN janë të paarritshme, për mendimin individual apo bazuar në argumentet e praktikës së zbatimit. Është sugjerim për analizë të këtyre rezultateve. Janë disa sugjerime dhe dilema të shprehura lidhur me fondin e orëve për lëndë të caktuara, si të pamjaftueshme. Sugjerime të këtilla kemi sidomos për lëndët Gjeografi dhe Edukatë fizike dhe sportet.

Disa pjesëmarrës kanë dhënë sugjerime më specifike për programin lëndor, ose edhe tema të caktuara, si për shembull gabime ose mospërputhje ndërmjet lëndës dhe rezultateve.

Në programe lëndore ka gabime, të cilat nuk janë specifikuar sa duhet, si në Gjuhë amtare nuk përputhet tema me rezultate, nuk është e qartë tek zgjedhimi i foljeve. Po ashtu te Matematika një rezultat thotë të mësohet tabela e shumëzimit deri me 5 e tjetra jo deri me 10. Kemi kërkuar vazhdimisht sqarim nga ekspertët e

komunës, por kemi marrë përgjigje se bëni qysh t'ua merr mendja, nëse e mësojmë deri me 5, mësoni deri me 10 (138).

Ky mësimdhënës shihet që ka informacion të mirë për përmbajtjen. Nuk dihet nëse adresimi është bërë në vend të duhur dhe kush janë ekspertët e komunës.

Të rishikohen temat mësimore, ndërlidhja e periudhave dhe rajoneve të ngjarjeve historike, rishikimi dhe përmirësimi ku historia botërore ka njësi të ekzagjeruar, që nuk ngjall interesim tek nxënësit.(165).

Është një sugjerim me interes, por nuk është specifikuar se për cilën lëndë/nivel kurrikular është fjala. Nënkuptohej që është histori, por do të duhej specifikuar ndërlidhjen me rezultatet e të nxënës dhe shkallën kurrikulare. Një mendim dhe sugjerim më të zgjeruar për lëndë të veçantë ka dhënë njëri nga mësimdhënësit:

Mendoj se në lëndën time, Gjuhë shqipe e letërsi, duhet t'i jepet më shumë hapësirë gramatikës së gjuhës shqipe, sepse në të gjitha planet e gjimnazit i jepet hapësirë e madhe letërsisë, e në anën tjetër duhet pasur parasysh se interpretimet dhe analizat letrare, sot, bëhen nëpërmjet metodës strukturaliste, prandaj një nxënës që nuk e njeh gjuhën dhe gramatikën e saj mirë, nuk mund të ketë sukses. Në të njëjtën kohë mendoj që lënda e Gjuhës shqipe duhet t'i ketë 4 orë në javë, pa marrë parasysh drejtimin në shkollën e mesme, duke pasur parasysh edhe testin e maturës, në të cilin 50 pyetje janë nga kjo lëndë, kurse ka klasë që ka vetëm 2 orë në javë. (329).

Sugjerim mjaft specifik kemi edhe për lëndën e TIK-ut, Jeta dhe puna, ku mësimdhënësi paraqet dilemat dhe argumentet e tij për ndryshim.

Ka RNL që janë vështirë të realizueshme dhe të matshme, ka RNL ku nuk i përkasin moshës së nxënësve, sidomos tek klasat e 6-ta, nuk janë rezultate bazë te tema e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit – ka edhe rezultate të lëndës edhe te klasat 7 dhe 8 që nuk mund të plotësohen apo arrihen në atë nivel shkollimi. Udhëzimet për vlerësim tek kjo fushë pjesës praktike duhet dhënë

hapësirë apo përqindje më të madhe, sepse vetë fusha kontribuon në shkathtësi, e këto shkathtësi vërehen shumë mirë gjatë punës praktike në perioda dhe nivel shkalle. (353).

Thjeshtësimi i programeve mësimore është kërkuar/sugjeruar nga një numër pjesëmarrësish. Përveç thjeshtësimit, kërkohet dhe sugjerohet, edhe këtu, që të ketë trajnime nga njohësit e kurrikulës, pastaj reduktim të administratës, për planifikimin, e të ngjashme.

Kërkesat për mbështetje specifike të nevojshme për mësimdhënës që të zbatojnë me sukses programet e reja mësimore

Konceptet kryesore të shprehura nga pjesëmarrësit në mostër, lidhur me kërkesat specifike, janë afërsisht të ngjashme me kërkesat në pyetjet paraprake, si: kërkesa për mbështetje nga faktorët jashtë shkollës, kërkesa për trajnime specifike, kërkesa për bashkëpunim ndërmjet mësimdhënësve brenda shkollës, kërkesa për mjete dhe pajisje, tekste shkollore dhe doracak për mësimdhënës, monitorim, kërkesa për shkarkim nga administrata e tepërt (planifikimi), etj. Disa prej tyre janë si në vijim. “*Mendoj se duhet të pajisen kabinetet me mjete mësimore të lëndëve përkatëse, mjete konkretizuese, e gjithsesi me llaptopë në kabinete (23).* Është një ndër kërkesat më të pranishme të shumica e pjesëmarrësve. Një kërkesë tjetër pak më specifike se të tjerat është kërkesa për “*mbështetje me tekste të reja mësimore dhe literaturë bazike për mësimdhënie, si dhe literaturë ndihmëse për fushat kurrikulare; mbështetje teknike dhe teknologjike në klasat mësimore (31),* pra literatura bazike dhe ndihmëse është më specifike që nuk haset tek të tjerët.

Trajnerët duhet të jenë më të përgatitur për kurrikula dhe të jetë një vendim për njoftimet dhe kërkesat, për arsye se po ka dilema dhe mosmarrëveshje, për shkak të interpretimeve dhe kërkesave të ndryshme në mes të mësimdhënësve të fushave të ndryshme. Kohëzgjatja e trajnimit të jetë më e gjatë, jo vetëm 5 ditë, dhe të jetë me pauza të gjata ndërmjet moduleve, që të ketë kohë të lexojë dhe të analizojë vetë mësimdhënësi materialet, si dhe hapësirë që hap pas hapi të zbatojë individualisht çdo pjesëmarrës. Në fund të

trajnimin të ketë test vlerësues apo ndonjë formë tjetër të vlerësimit për pjesëmarrësit. Kush nuk e kalon pragun e kalueshmërisë, mos të certifikohet. Vetëm dosja e fotokopjuar të mos jetë kriter i vlerësimit, por të ketë forma të ndryshme dhe në fund të certifikohet (132).

Është një ndër kërkesat më të përsëritura në të gjitha pyetjet e hapura, por ky propozim ka disa specifika, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e rekomandimeve, sidomos për organizuesit e trajnimeve dhe për vetë trajnerët. Kërkesë tjetër specifike është organizimi i seminareve dhe i konferencave për të diskutuar çështjet me rëndësi për zbatim të kurrikulës. *Organizim i seminareve, konferencave apo edhe takimeve, të niveleve të ndryshme, ku do të diskutohen sfidat dhe problemet e organizimit të mësimin sipas kurrikulës, apo tema më të ngushta në interes të implementimit me sukses të kurrikulës së re (343).* Kërkesa të këtilla dëshmojnë për prezencë të paqartësive dhe dilemave ndërmjet mësimdhënësve lidhur me zbatimin, por edhe për mundësinë e trajtimit edhe të përparësive në nivele të ndryshme profesionistësh.

Qasje shumë ndryshe nga kjo e deritashmja! LARG INSPEKTIMIT – për të kryqëzuar, apo për të lartësuar dikë?! Evitim urgjent, rrënjësor dhe i domosdoshëm, i anës formale dhe burokratike, pa përmbajtje, që fatkeqësisht mbizotëron në institucione arsimore. Nxjerrja e udhëzuesve të rinj për zbatimin e kurrikulës së re, të cilët do të zbërthenin çështjet kryesore në mënyrë të përpiktë. Të paktën nga viti 2019, duhet ta kuptojë secili se shkolla duhet të jetë e pajisur me literaturë dhe mjete tjera përcjellëse. Interneti nuk e zëvendëson literaturën bazë, eventualisht e mbështet. Ndryshim urgjent i mënyrës, formave dhe shkallës, së vlerësimit të nxënësve. Nga ajo që kanë parë ekspertët finlandezë, gjermanë dhe austriakë, është me defekte, jo të vogla (403).

Kërkesa e këtillë (403) është një thirrje për qasje ndryshe edhe ndaj zbatimit, por edhe ndaj aspekteve të tjera që ndërlidhen me procesin. Nuk do shumë komente, por do analizë të procesit dhe të qasjes institucionale ndaj tij.

Kërkesat dhe mendimet shitesë të mësimeve për procesin e zbatimit të kurrikulës

Përveç pyetjeve të hapura, nga mësuesit është kërkuar të shtojnë edhe ndonjë kërkesë, çështje shitesë për procesin e zbatimit të kurrikulës, si dhe përmirësimin e tij. Shumica e pjesëmarrësve shprehin pothuajse kërkesat, dilemat dhe sfidat e njëjta, me tri pyetjet tjera. Veçohen sidomos tri temat kryesore të identifikuar më parë, siç janë: rritja e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve, pajisja me mjete mësimore, si dhe trajnime shitesë, për sqarimin e kurrikulës. Gjithashtu, kishte edhe vlerësime për dhe kundër, si: kurrikulë e mirë dhe e zbatueshme, deri te është kopje e kurrikulave të vendeve skandinave, prandaj edhe nuk është e zbatueshme. Megjithatë, sugjerimet e tyre duhet marrë në konsideratë, si rekomandime për përmirësim.

Një çështje shumë e rëndësishme, që mendoj se duhet të trajtohet edhe më tutje, është vlerësimi i nxënësve. Në udhëzimin administrativ për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së re janë përcaktuar 3 periudha vlerësimi, që kanë rëndësi të barabartë. Mendoj se kjo nuk është në rregull, meqë periudhat mësimore nuk janë të gjitha të barabarta. P.sh., në shkollat e mesme të larta periudha e parë mësimore ka 4 muaj të plotë mësimi, e dyta ka 2 muaj e gjysmë, kurse e treta 2 muaj të plotë. Në anën tjetër, për vlerësimin e nxënësve të gjitha periudhat kanë rëndësi të njëjtë dhe vlerësimi i nxënësve në fund të vitit bëhet sipas mesatares së tri periudhave. Në këtë kontekst, mendoj se periudha e parë duhet të jetë 40 % të vlerësimit vjetor, kurse e dyta dhe e treta nga 30 % të vlerësimit vjetor (329).

Çështjen e vlerësimit të njohurive të nxënësve e kanë prekur shumë mësues, si sfidë dhe çështje për trajtim. Ende ka vështirësi dhe paqartësi lidhur me zbatimin e udhëzimit administrativ për vlerësim sipas kërkesave të kurrikulës.

Specifika e fushës kërkon që çdoherë të jemi në hap me teknologjinë aktuale, që bie në ndesh me tekstet aktuale, por kur shton edhe mungesën e kompjuterëve apo pajisjen e kabinetit me kompjuter, del që si fushë është vështirë të arrihen rezultatet e lëndës, apo

arrihen vetëm tek ata nxënës që posedojnë kompjuter familjar. Duhet punuar shumë ne si mësimdhënës që t'i nxisim nxënësit të praktikojnë njohuritë dhe shkathtësitë në këtë fushë, mirëpo mangësitë që i përmenda më lart bien ndesh edhe në vlerësim të shkathtësive të tyre dhe matjen e rezultateve (353).

Përfundime. Dhënia e përgjigjeve në formë të hapur ishte një mundësi e mirë për të shprehur dhe dhënë sugjerime për çështjet me rëndësi sa i përket zbatimit të kurrikulës. Prandaj, janë shprehur kërkesa, dilema e sfida, si dhe janë dhënë sugjerime të rëndësishme, për të cilat duhet të mendohet dhe të trajtohen seriozisht, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Mangësi të theksuar në vetë procesin e zbatimit të kurrikulës, përfshirë këtu edhe trajnimet e mësimdhënësve. Shqetësimet e tyre për mangësi në trajnim, si dhe kërkesat për trajnime shtesë nga ekspertë të kurrikulës, janë adresim i rëndësishëm për përmirësim të procesit.

4.2.1.2. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e drejtuesve të shkollave, koordinatorëve të cilësisë dhe udhëheqësve të aktiveve profesionale

Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e drejtuesve të shkollave, koordinatorëve të cilësisë dhe udhëheqësve të aktiveve profesionale (AP), lidhur me zbatimin e kurrikulës në shkolla, janë produkt i analizës së pyetësorit dhe intervistave gjysmë të strukturuar, të organizuara me së paku dy përfaqësues nga këto pozita udhëheqëse, në nivel të secilës shkollë të përfshirë në këtë hulumtim. Qëllimi ishte që hulumtimi sasior, i realizuar me mësimdhënës që punojnë me programe të reja mësimore, të plotësohet edhe me hulumtim cilësor, me përfshirje të subjekteve të shkollave që kanë rol udhëheqës në zbatimin e kurrikulës së re. Rezultatet janë përmbledhur në nëntema të lidhura me rolin e shkollës në zbatimin e kurrikulës së re dhe me pyetjet e diskutuara me drejtues të shkollave dhe udhëheqës të AP, siç prezantohet në pjesën më poshtë, si:

- Informimi për kurrikulën e re /programet e reja mësimore
- Përkrahja profesionale që kanë marrë shkollat për zbatimin e kurrikulës së re

- Angazhimi dhe ndryshimet e bëra në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle dhe mentorimi i mësimdhënësve
- Pranimi apo besimi i mësimdhënësve për kurrikulën e re
- Arritjet në zbatimin e kurrikulës së re, sfidat dhe problemet
- Parashikimi për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle
- Mbështetja e kërkuar për të shtyrë përpara zbatimin e suksesshëm të kurrikulës së re

Informimi për kurrikulën e re /programet e reja mësimore

Informimi për kurrikulën e re /programet e reja mësimore është diskutuar në dy drejtime, me drejtues të shkollave dhe udhëheqës të AP. Në pjesën e parë janë trajtuar aspektet që lidhen me informimin e tyre lidhur me kërkesat e kurrikulës së re dhe format e marrjes së informacioneve, ndërsa në pjesën e dytë janë trajtuar praktikatat e shkollës në informimin e mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit, për risitë dhe ndryshimet që sjell kurrikula e re.

Rezultatet e analizuara tregojnë se shkollat janë pajisur me dokumente kurrikulare, udhëzuesit për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave, në dy vitet e fundit edhe me programet mësimore lëndore në formë elektronike. Informimi i udhëheqësve të AP është bërë kryesisht gjatë trajnimit për zbatimin e kurrikulës të organizuar nga MASHT-i dhe DKA-të. Këtë e konfirmojnë me përgjigjet e tyre mbi 80 % e udhëheqësve të AP. Ndërsa, rreth 20 % e kryetarëve të AP u referohen edhe informimit gjatë studimeve të tyre në master, diskutimeve me kolegë, informacioneve nga interneti, etj. Në anën tjetër, drejtuesit e shkollave (drejtorët dhe zv.drejtorët), mbi 90 % e tyre, u referohen informimit përmes takimeve të organizuara nga MASHT-i, DKA-të dhe takimeve me kolegë të tyre. Janë më pak se 50 % e drejtuesve të shkollave që i referohen informimit përmes leximit të dokumenteve kurrikulare, pjesëmarrjes në debate dhe diskutime në nivel shkolle. Sipas përgjigjeve të disa prej drejtuesve, në informimin e tyre ka rol edhe leximi

që u kanë bërë dokumenteve të kurrikulës, udhëzuesve dhe informacioneve tjera të publikuara në media.

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të informimit që lidhet me kurrikulën e re, kërkesat e saj, risitë, ndryshimet, mundësitë dhe rolin e tyre, ka një shpërndarje të përgjigjeve të këtyre subjekteve. Një numër relativisht jo i madh shprehen se kanë informim të mjaftueshëm, një pjesë tjetër (pjesa më e madhe) shprehen se kanë informim bazik, por që u duhen informacione shtesë. Në mesin e tyre ka drejtorë të shkollave, por edhe udhëheqës të AP, të cilët shprehen se kanë mungesë të informacioneve për disa segmente të kurrikulës, më shumë iu referohen vlerësimit të nxënësve, qasjes së integruar në mësimdhënie dhe matjes së kompetencave.

Nga mënyra se si përshkruhet praktika e informimit të tyre, mund të konkludohet nga subjektet e shkollës, të cilat ishin pjesë e këtij hulumtimi, se është përdorur kryesisht informacioni që është marrë nga trajnimet dhe dokumentet e udhëzuesit për kurrikula, mirëpo nuk reflektohet një sistem i brendshëm i shkollave lidhur me informimin, debatet e brendshme për kurrikulën dhe programet e reja mësimore, për të siguruar të kuptuarit e drejtë dhe të përbashkët për ndryshimet që sjell kurrikula e re.

Kjo reflektohet edhe në pyetjet lidhur me informimin nga shkolla të mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit për kurrikulën e re/programet e reja mësimore. Kryesisht raportohet se janë praktikuar takimet me organet e shkollës, përfshirë edhe atë në nivel të aktiveve profesionale, si dhe mbledhjet me prindër në nivel të klasave/paraleleve. Mbi 30 % e kryetarëve të AP u përgjigjën se nuk kanë përgatitur asnjë material informues për mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe të tjerët, lidhur me kurrikulën/programet e reja mësimore. Mbi 50 % e kryetarëve të AP u përgjigjën se kanë përdorur dokumentet kurrikulare dhe materialet tjera të siguruar nga MASHT dhe DKA për t'i informuar aktorët e shkollës lidhur me kurrikulën/programet e reja mësimore. Më pak se 20 % e kryetarëve të AP kanë pohuar se kanë përgatitur letra informative për prindërit, posterë për informim, kanë shpërndarë buletine informative, broshura të informimit për kurrikulën e re etj. Edhe pjesa më e madhe e drejtorëve të shkollave

vërtetojnë se shkollat pak ose fare pak kanë përgatitur materiale informuese për mësimdhënës, nxënës, prindër dhe të tjerët, lidhur me risitë, pritjet dhe ndryshimet nga kurrikula/programet e reja mësimore.

Kështu e përshkruan një mësimdhënës informimin nga shkolla të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve në vitin e parë të fillimit të zbatimit të kurrikulës së re:

Në shkollën tonë informata për zbatimin e kurrikulës janë ndarë vetëm për mësimdhënësit, ndërsa për nxënës dhe prindër as edhe një aktivitet tjetër përveç një informimi verbal nga kujdestarët e klasave se do fillojë në zbatim kurrikula e re. Informatat për ne kanë qenë të mangëta, janë plotësuar deri diku.

Bazuar në pohimet e kryetarëve të AP dhe drejtuesve të shkollave, mund të konkludojmë se në nivel shkolle nuk ekziston një praktikë mirë e konsoliduar e informimit të komunitetit të shkollës për kurrikulën e re/programet e reja mësimore, pritjet dhe ndryshimet, si dhe rolin e tyre për të mbështetur zbatimin e saj.

Përkrahja profesionale që kanë marrë shkollat për zbatimin e kurrikulës së re

Përgjigjet e kryetarëve të AP në pyetjet lidhur me përkrahjen profesionale që kanë marrë për zbatimin e kurrikulës së re janë shumë të shpërndara, nga ato që u referohen vetëm trajnimeve që kanë marrë për zbatimin e kurrikulës, drejt atyre që u referohen edhe dokumenteve kurrikulare të siguruara si mbështetje profesionale dhe mbështetjes në nivel shkolle nga kolegët, koordinatorët e cilësisë, trajnerët dhe drejtuesit e shkollës. Mbi 20 % e kryetarëve të AP janë shprehur se nuk kanë marrë asnjë mbështetje në përpjekjet e tyre për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës. Eshë një numër relativisht i vogël i kryetarëve të AP, të cilët i referohen mbështetjes që kanë marrë nga një trajnim specifik për rolin e AP, të ofruar me mbështetje nga programi i GIZ-it.

Në anën tjetër, edhe drejtuesit e shkollave kanë reflektuar për mbështetjen e tyre profesionale që kanë marrë për të udhëhequr zbatimin e kurrikulës së re, nga punëtoritë e trajnimet e organizuara nga MASHT-i, IPK-ja dhe partnerët mbështetës: GIZ, KulturKontakt Austria, UNICEF, USAID. Mbi 20 % e drejtorëve të shkollave të përfshirë në studim shprehen se nuk kanë marrë asnjë mbështetje profesionale lidhur me udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle. Pjesa tjetër e drejtorëve të shkollave pohuan se kanë marrë mbështetje profesionale nga trajnimet, trajnerët e shkollës së tyre, koordinatorët e cilësisë, nga kolegët e tyre etj. Mirëpo, mbi 50 % e drejtorëve që kanë marrë mbështetje pohojnë se mbështetja e tyre profesionale për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës nuk ka qenë e mjaftueshme.

Si nga udhëheqësit e AP, ashtu edhe nga drejtuesit e shkollave, raportohet së mbështetja profesionale për zbatimin e kurrikulës ka qenë e pamjaftueshme, shpesh jocilësore, nuk ka vazhduar që ajo të bëhet edhe pasi që kanë filluar ta zbatojnë kurrikulën, kur janë ballafaquar me sfida dhe probleme gjatë zbatimit.

Trajnimet për kurrikulë dhe format e tjera të mbështetjes kanë qenë të pamjaftueshme.

Nuk mund të zbatohet një kurrikulë e re pa mbështetje të vazhdueshme.

Trajnerët shpesh na kanë krijuar pasiguri me informacionet që na i kanë ofruar.

Unë jam përpjekur që mbështetjen ta organizoj edhe në nivel shkolle, mirëpo nuk e di a e kemi bërë mirë apo jo. Nuk kemi mbikëqyrje nga askush..., vazhdojmë të punojmë pa e ditur çfarë jemi duke bërë.

Në anën tjetër, drejtorët e shkollave dhe kryetarët e aktiveve profesionale mbështesin iniciativat e disa DKA-ve për formimin e ekipit profesional në nivel të DKA-së për mbështetje dhe këshillim në angazhimet e mësimdhënësve për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re. Iniciativa e filluar nga DKA e Prishtinës është vlerësuar si nga drejtorët e shkollave

dhe kryetarët e AP e KC në Prishtinë, ashtu edhe nga drejtorët e shkollave dhe kryetarët e AP e KC të komunave të tjera, të cilët kanë bashkpunim me shkollat e Prishtinës në kuader të partneritetit me shkollat kampione që përkrahen nga programi i GIZ-it.



Angazhimi dhe ndryshimet e bëra në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re

Zbatimi i kurrikulës së re kërkon angazhim të udhëheqjes së shkollës dhe gjithë stafit të saj, kërkon ndryshime në qasjen organizative, të komunikimit dhe bashkëpunimit, kërkon qasje ndryshe në mësimdhënie. Këto segmente

janë diskutuar me udhëheqësit e AP dhe drejtuesit e shkollave, për të marrë informacion shtesë lidhur me praktikën e shkollave për të përmbushur rolin e tyre në zbatimin e kurrikulës. Përgjigjet në këto kërkesa janë të shpërndara, nga orientimi se kemi bërë shumë angazhime dhe ndryshime organizative në shkollë, deri të informacioni se ne kemi bërë angazhime sipas planit të shkollës dhe nuk kemi bërë disa ndryshime, pa u thelluar në përmbajtjen e tyre.

Udhëheqësit e AP, përmes përgjigjeve të tyre (rreth 75%) , tregojnë se ata kanë qenë vetëm pjesë e planifikimeve mësimore për zbatim të kurrikulës (planeve vjetore, planeve për periudha mësimore dhe planeve të tjera), nuk ofrojnë asnjë të dhënë tjetër për përfshirje në planifikimin në nivel shkolle për informimin e komunitetit të shkollës për ndryshimet që sjell kurrikula e re, planet për zhvillimin e shkollës, projekte të veçanta për zbatimin e kurrikulës, planifikimin e kurrikulës me zgjedhje, planifikimin për zhvillim profesional me bazë në shkollë për zbatim të kurrikulës, planifikimin për vlerësimin e nxënësve për shkallë kurrikulare etj. Pjesa tjetër e udhëheqësve të AP-së japin indikacione për përfshirje dhe angazhim edhe në planifikime tjera në nivel shkollë për zbatimin e kurrikulës së re, mirëpo ato janë të shpërndara. Rreth 9 % e kryetarëve të AP-së kanë thënë se nuk kemi qenë të përfshirë në asnjë planifikim në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re.

Në anën tjetër, drejtorët e shkollave, me përgjigjet e tyre, shprehen se vazhdimisht kanë qenë të angazhuar në këtë proces, kanë iniciuar ndryshime në nivel shkolle, mirëpo kur flasin për ndryshimet më shumë u referohen aspekteve që lidhen me angazhimin në planifikimin zhvillimor në nivel shkolle dhe ndryshimeve në planifikim në raport me pesë fushat e cilësisë së shkollës, takimeve të rregullta, ndryshimeve në rolin udhëheqës për zbatimin e kurrikulës. Vetëm rreth 30 % e drejtorëve u referohen këtyre aspekteve kur flasin për ndryshimet në nivel shkolle dhe rolin udhëheqës të drejtorëve në këtë proces. Disa nga pohimet e drejtuesve të shkollave:

Organizimi i mësimit kabinetik, aktivitete ekstrakurrikulare, ndryshime në qasje;

Mobilizim dhe qasje ndryshe në planifikim;

Kemi ndërmarrë disa masa rreth riorganizimit të punës në shkollë.

Janë riorganizuar aktivet profesionale, të cilat gjithashtu janë trajnuar për menaxhimin e punës brenda aktivitetit profesional, si dhe për mbajtjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Është mbajtur punëtori me bazë në shkollë për lehtësimin e përpilimit të instrumenteve, formën e vlerësimit sipas UA-së. Bëhen takime të vazhdueshme me shkollat bashkëpunuese.

Referuar përgjigjeve të udhëheqësve të AP dhe drejtuesve të shkollave, lidhur me ndryshimet e nevojshme për të përmbushur rolin e tyre në zbatimin e kurrikulës së re, mësojmë se pjesa më e madhe e ndryshimeve të prezantuara prej tyre më shumë janë ndryshime rutinë, që bëhen në nivel shkolle, sesa ndryshime përmbajtjesore, organizative e sistimore, brenda shkollës; ndryshime të qasjes së punës në nivel të organeve të shkollës, qasjes në mësimdhënie, qasjes së punës me prindër, nxënës dhe komunitet etj.

Një diskutim i veçantë me udhëheqësit e AP është zhvilluar rreth praktikës së punës që aplikohet në aktivet profesionale në nivel shkolle lidhur me planifikimin mësimor për zbatimin e kurrikulës/programeve mësimore. Përgjigjet e kryetarëve të AP në këtë pyetje janë shumë të shpërndara, nga ato që i referohen punës së konsoliduar të AP për planifikim mësimor të organizuar mirë në nivel të aktivitetit profesional dhe mundësive të mësimdhënësve për bashkëpunim dhe ndërlidhje ndërmjet fushave kurrikulare, drejt atyre që reflektojnë një praktike individuale të planifikimit mësimor, sidomos në shkollat që kanë numër të vogël të mësimdhënësve për lëndë të caktuara mësimore, apo për klasë. Nga pohimet e kryetarëve të AP, dominojnë ato që lidhen me takimet e rregullta për planifikim në fillim të vitit dhe planifikimet për periudha mësimore, përkatësisht takimet për planet mësimore dhe takimet tjera. Në pohimet e kryetarëve të AP pak reflektohet praktika e punës në kuadër të aktivitetit profesional, praktika se si shqyrtohen dhe analizohen programet mësimore në raport me rezultatet e të nxënësve dhe arritjet e nxënësve, si identifikohen sfidat dhe problemet, si tejkalohen ato, si merren konsensus dhe vendime në kuadër të aktivitetit përkatës lidhur me zbatimin e kurrikulës, si i qasen zhvillimit të kompetencave të nxënësve, qasjes së integruar, si mbështeten nxënësit, trajtimit të temave të përbashkëta, trajtimit të çështjeve ndërkurrikulare etj.

Pothuajse e njëjta gjë reflektohet edhe në pohimet e drejtorëve, por me elemente më shumë administrative. Ata shprehën se AP të mësimdhënësve në nivel shkolle janë të themeluara, kanë kryetarët e tyre, kanë planin e punës së tyre etj. Drejtuesit e shkollave fare pak japin argumente dhe reflektime për punën e AP dhe arrijtjet në zbatimin e kurrikulës së re.

Nisur nga kjo, mund të konkludojmë se AP në shkolla janë pjesë e zbatimit të kurrikulës, por në praktikën e punës së tyre dominon aspekti administrativ dhe formal, jo shumë përmbajtjesor në raport me analizat dhe veprimet që çojnë në zbatim të suksesshëm të kurrikulës së re. Në anën tjetër, puna e tyre nuk monitorohet mjaftueshëm, ashtu siç nuk u ofrohet mbështetje e nevojshme nga drejtuesit e shkollës.

Monitorimi i zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle dhe mentorimi i mësimdhënësve

Monitorimi i zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle lidhet me punën e drejtuesve të shkollave, punën e udhëheqësve të AP. Mbi 40 % e kryetarëve të AP përmes përgjigjeve të tyre konfirmuan se në shkollat e tyre askush nuk bën monitorimin dhe mentorimin e jashtëm të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës/programeve të reja mësimore, edhe monitorimet dhe mentorimet e brendshme janë shumë të pakta. Rreth 40 % iu referohen monitorimeve zyrtare që bëhen nga drejtuesit e shkollave, por kjo përqindje nuk pohon ndonjë praktikë të mentorimit të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Rreth 20 % kryetarëve të AP pohojnë se në shkollat e tyre organizohen monitorime dhe mentorime për mësimdhënien, me qëllim përkrahjen e tyre për zbatimin e kurrikulës, dhe ky grup i kryetarëve të AP vijjnë më shumë nga shkollat që kanë trajnerë në nivel shkolle, shkollat që kanë konsoliduar mekanizimin për siguri të cilësisë në shkollë (koordinatorin e cilësisë). Në anën tjetër, pak kryetarë të AP flasin për rolin e tyre në këtë proces. Më shumë iu referohen konsultimeve dhe diskutimeve që zhvillohen në kuadër të aktivitetit profesional dhe konsultimeve shtesë rreth planifikimeve mësimore.

Edhe pjesa më e madhe e drejtuesve të shkollave vërtetojnë se në shkollat e tyre nuk ka monitorim të jashtëm për zbatimin e kurrikulës. Diku-diku

përmendin se kanë kaluar vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, vlerësimin e disa mësimdhënësve, por akoma nuk kanë informata kthyesë që do t'i përdornin për monitorime shtesë për zbatimin e kurrikulës. Drejtuesit e shkollave më shumë i referohen punës së tyre në monitorimin e rregullt të mësimdhënësve, por nuk japin shumë detaje se si e ndërlidhin këtë me zbatimin e kurrikulës dhe mentorimin e mësimdhënësve. Në disa pohime të drejtorëve përmenden edhe monitorimet që bëhen nga pedagogët e shkollave në ato shkolla ku kanë pedagogë, koordinatorët e cilësisë, si dhe në 4-5 raste pohohet përfshirja e kryetarëve të AP në monitorimin dhe mentorimin e mësimdhënësve. Në disa raste, hetohet se kjo përgjegjësi u është lënë në duar koordinatorëve të cilësisë.

Nisur nga kjo, mund të konkludojmë se në shkolla ka mungesë të monitorimit dhe mentorimit të jashtëm të mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave për zbatimin e kurrikulës. Monitorimet dhe mentorimet e brendshme janë të pakta dhe të pamjaftueshme, si dhe pa një sistem për të siguruar evidence për zbatimin e kurrikulës, nevojat për mbështetje dhe ofrimin e mbështetjes së duhur.

Pranimi apo besimi i mësimdhënësve për kurrikulën e re

Nisur nga fakti që ekziston perceptimi se kurrikula e re nuk mund të zbatohet në shkolla nëse mësimdhënësit nuk e kanë të qartë ndryshimin kryesor që sjell ajo dhe nuk e pranojnë atë si pjesë të punës së tyre, apo nuk kanë besim në të, është nxitur diskutimi edhe me udhëheqësit e AP dhe drejtuesit e shkollave lidhur me pranimin/refuzimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca nga ana e mësimdhënësve.

Përgjigjet e udhëheqësve të AP lidhur me pranimin apo besimin e mësimdhënësve për kurrikulën e re janë shumë të shpërndara, nga ato që flasin për pranim dhe zbatim të suksesshëm nga perspektiva e tyre, drejt atyre që e kanë pranuar pozitivisht, por kanë probleme të theksuara në zbatim, pastaj atyre që e kanë pranuar pjesërisht dhe me vështirësi, kanë pasur shumë hezitim, por janë duke u adaptuar gradualisht, dhe atyre që e konsiderojnë së është një projekt i dështuar, që nuk mund të zbatohet. Nga pohimet e tyre është vështirë të kuantifikohen përgjigjet, sepse brenda

përgjigjeve flasin për vështirësitë, mungesën e informimit dhe, në anën tjetër, zbatimin sipas programit/kurrikulës. Ekziston një përputhje në pohimet e kryetarëve të aktiveve profesionale, në ndikimin që ka pasur pranimi apo besimi për kurrikulën e re, në zbatimin e saj në praktikë. Ata që shprehen se e kanë pranuar pozitivisht, pohojnë se ka pasur ndikim pozitiv në zbatim, në anën tjetër ata që i kanë prekur elementet e dyshimit në pranim i pohojnë më shumë edhe problemet në zbatim.

Fillimisht pranimi për të ndryshuar ka qenë i vështirë, por pas trajnimeve dhe lehtësimeve që u është ofruar mësimdhënësve nga DKA-ja, drejtori, koordinatori i cilësisë, shkollat bashkëpunuese etj., mësimdhënësit kanë ndier përkrahjen dhe janë familjarizuar me KK-në.

Është numër më i madh i mësimdhënësve që mundohen ta zbatojnë kurrikulën, por është edhe një numër i tyre që janë pesimistë. Unë jam për! Këtë mundohem ta përçoj edhe tek kolegët.

Në fillim ka qenë shumë shqetësuese, sidomos problematike ndarja e fondit të orëve. Ka reagime të ndryshme, mësimdhënësit më në moshë janë më rezistues, të tjerët kanë filluar të bëhen pjesë e punës.

Fillimisht mendoj se mësimdhënësit kanë hezituuar që të punojnë me kurrikulën e re, por besoj se ka gjetur zbatim dhe tani janë adaptuar me të.

Besimi i mësimdhënësve është humbur dhe ndihen vështirësi në zbatimin e kurrikulës.

Pranimi i mësimdhënësve ka qenë i vogël, mosbesues, sidomos në vitin e parë, por vitin e dytë është vërejtur pak përmirësim.

Shumë më mirë ka qenë me programe dhe tekste të vjetra. Nuk është kjo reformë, si të pranohet kjo kurrikulë kur nuk ka tekste, nuk ka mbështetje nga askush.

Pothuajse e njëjta gjë reflektohet edhe në pohimet e drejtuesve të shkollave. Ata i grupojnë mësimdhënësit që e kanë pranuar me kohë kurrikulën dhe punojnë me përkushtim të madh, mësimdhënësit që e kanë pranuar, por kanë vështirësi në zbatim, mësimdhënësit që kanë drojë dhe frikë, mësimdhënësit që vazhdimisht shprehin skepticizëm dhe refuzim. Disa nga pohimet e drejtuesve të shkollave:

Në përgjithësi përkrahet, disa janë skeptikë, e shohin si eksperiment, dështim të radhës.

Pavarësisht që shkolla jonë ishte në pilotim, ka një pjesë të mësimmshënësve që thonë se ka dështuar, humbje kohe, administratë... Pranim me drojë, frikë, rezistencë.

Nisur nga kjo, mund të konkludojmë se në shkolla vazhdon të këtë dilema rreth kurrikulës, pranimit të saj, besimit në te. Sipas udhëheqësve të AP dhe drejtuesve të shkollave, reflektohet edhe në zbatimin e saj.

Arritjet në zbatimin e kurrikulës së re, sfidat dhe problemet

Mbi 90 % e udhëheqësve të AP zbatimin e suksesshëm të kurrikulës në shkollën e tyre e ndërlihin me trajnimin e tyre, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimmshënësve të shkollës dhe me shkollat tjera, autonominë që kanë në planifikim dhe në zbatimin e kurrikulës. Këto aspekte konfirmohen si suksese edhe nga ana e drejtuesve të shkollave.

Pohimet e lidhura me suksesin e punës me nxënës janë të pakta, ato që janë evidentuar kryesisht iu referohen angazhimit më të madh të nxënësve, përfshirjes së nxënësve në aktivitete të shumta, përdorimit të praktikave ndryshe të mësimmshënies dhe vlerësimit formativ.

Në anën tjetër, raportohen disa probleme, me të cilat janë përballur mësimmshënësit dhe drejtuesit e shkollave në zbatimin e suksesshëm të kurrikulës së re. Problemet e ngriturat u referohen në radhë të parë nivelit të kuptuarit të pritjeve dhe ndryshimeve që sjell kurrikula e re, pastaj mungesës së teksteve dhe mjeteve mësimore, zbatimin e qasjes së integruar në planifikim dhe në zbatim në klasë, vlerësimit të nxënësve – veçanërisht vlerësimit për shkallë kurrikulare. Problemet e ngritura iu referohen edhe mungesës së kabineteve dhe mjeteve përkatëse për të zhvilluar kompetencat e nxënësve që zhvillohen përmes lëndëve shkencore, jetës dhe punës, por edhe përmes lëndëve të tjera. Drejtorët e shkollave, por edhe një pjesë relativisht e madhe e kryetarëve të AK, i shohin si problem format e planifikimit mësimor dhe ditarët e vlerësimit, i shohin si administratë të ngarkuar.

Si konkluzion i përgjigjeve të kryetarëve të AP dhe drejtuesve të shkollave, mund të pohohet se ka një progres të vogël në zbatimin e kurrikulës dhe njëkohësisht ka probleme të mëdha, të cilat në masë të madhe janë duke e vështirësuar zbatimin e suksesshëm të kurrikulës. Një pjesë e madhe e problemeve lidhen me organizimin e brendshëm të punës së shkollës, qasjen e shkollës ndaj kurrikulës. Gjithsesi, një pjesë tjetër lidhet me faktorët e jashtëm, të cilët nuk kanë arritur të përmbushin rolin e tyre në përgatitjen, mbështetjen dhe ofrimin e kushteve për shkolla dhe mësimdhënës për ta zbatuar kurrikulën e re.

Parashikimi për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle

Pjesa më e madhe e udhëheqësve të AP dhe drejtuesve të shkollave kur flasin për parashikimin për përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën e tyre dhe për mënyrën se si do të punojnë ata me kolegët e tyre për ta bërë këtë proces të suksesshëm, nuk ofrojnë një referim në vetën e parë dhe në atë së çka do të bëjnë me kolegë në nivel shkolle, por më shumë u referohen kërkesave nga jashtë, që lidhen me sigurimin e teksteve shkollore, ofrimin e trajnimeve, pajisjen me mjete dhe materiale mësimore, përmirësimin e kushteve në shkollë, zvogëlimin e numrit të nxënësve (shkollat në qytet), mbështetjen nga MASHT-i, DKA-ja dhe donatorët, zvogëlimin e “administratës” etj. Nga pohimet e raportuara nuk duket në horizont një qasje vetëreflektimi për rolin dhe mundësitë që kanë shkollat në zbatimin e kurrikulës, nuk duket një orientim i qartë për të planifikuar aktivitete e projekte në nivel shkolle për ta bërë zbatimin e kurrikulës të suksesshëm për shkollën dhe përgjithësisht për vendin.

Jam shumë skeptik se kurrikula mund të zbatohet kështu si ka filluar, jemi në rrugë për të dështuar...! Qofsha i gabuar!

Mësimdhënësit krijuan komoditetin me certifikim, të gjithë po certifikohen, ndërsa puna në klasa po mbetet njëjtë. Kjo qasje duhet ndryshuar, nevojiten trajnime më praktike, të vazhdueshme, dhe njëkohësisht mbikëqyrje e procesit të zbatimit.

Krejt varet se si do të plotësohen kushtet e punës në shkollë dhe të kur t'i kemi tekstet e reja mësimore.

Duhet të nxiten mësimdhënësit që kurrikula kërkon bashkëpunim, planifikim të përbashkët, kreativitet, e jo imitim- kopje planesh. Duhet të rritet kreativiteti që të jemi më hulumtues, fakt që kërkon kohë, mund më tepër, por kur shohin që ecën ky trend në shumicën e shkollave dhe askush s'po ndëshkohet apo favorizohet, stimulohet, atëherë edhe më duket që bie motivi te shumë kolegë.

Thjeshtësimin e përpilimit të planeve, reduktimin e rezultateve për fushë-lëndë, si dhe zgjerimin e rrjetit në gjithë shkollën, për të mundësuar mësimin duke aplikuar teknologjinë.

Mënyra se si e parashohin mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollës përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën e tyre, del të jetë një mekanizëm mbrojtës ndaj kërkesave, të cilat nuk janë plotësuar nga sistemi për të zbatuar një kurrikulë të re në nivel shkolle, rezultat i ndikimit të traditës së sistemit të centralizuar, punës së mësimdhënësve vetëm me tekste shkollore, pa iu referuar programeve mësimore, si dhe mungesës së mekanizmave për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përgatitjeve dhe planifikimit të shkollës për zbatimin e kurrikulës së re.

Mbështetja e kërkuar për të shtyrë përpara zbatimin e suksesshëm të kurrikulës së re

Si nga ana e kryetarëve të AP, ashtu edhe nga ana e drejtuesve të shkollave, raportohen disa kërkesa për mbështetje për të shtyrë përpara zbatimin e suksesshëm të kurrikulës. Kërkesat kryesore lidhen me sigurimin e teksteve shkollore, trajnime të vazhdueshëm për zbatimin e kurrikulës, mbështetje të drejtpërdrejtë në nivel shkolle, monitorim dhe mentorim nga zhvillues të kurrikulave, ekspertë të arsimit dhe inspektorë arsimorë, literaturë profesionale, udhëzues shtesë për lëndë mësimore në ndërlidhje me fushat kurrikulare përkatëse, pajisje me mjete mësimore, mjete të konkretizimit, kabinete, harmonizimin e periudhave mësimore, për të siguruar një vlerësim të balancuar.

Udhëheqësit e AP kërkojnë plotësimin e kushteve të nevojshme për të përmbushur rolin e tyre dhe për të qenë më të suksesshëm, kërkojnë trajnime specifike për kryetarë të AP që lidhet me proceset e zbatimit të kurrikulës, mbështetje financiare, lirim nga disa orë mësimore për të qenë më aktivë në rolin e tyre, funksionalizim të AP në nivel komune etj.

Duhet afruar mundësi për t'i zhvilluar aftësitë menaxhuese, por edhe kryetarët e AP duhet ta fuqizojnë vetveten duke punuar, duke gjetur forma bashkëpunimi brenda aktivit, duke ndarë detyrat dhe pritshmëritë në aktiv profesional. Ndoshta të gjejnë forma brenda shkollës që të lirohen me orë mësimi nëse ka hapësirë që atë kohë ta konvertojnë në punë brenda aktivit, sepse një AP në fusha me numër më të madh mësimdhënësish kërkon angazhim për të funksionuar aktivi kënaqshëm.

Në anën tjetër, drejtuesit e shkollave kërkojnë rritje të autonomisë së shkollës në menaxhimin e buxhetit të shkollës, këshillim nga njohësit e kurrikulës në vendin e punës, trajnime të avancuara dhe udhëzime shtesë për zbatimin e kurrikulës dhe rolin e drejtuesve të shkollës në proces, përkrahje dhe trajnime për mësimdhënës etj.

Si konkluzion i përgjigjeve të kryetarëve të AP dhe drejtuesve të shkollave, mund të pohohet se mbështetja e ofruar deri më tani nuk ka qenë e mjaftueshme dhe e organizuar mirë. Njëkohësisht mund të pohohet se është bërë një traditë në kërkesat për trajnime dhe forma të tjera të mbështetjes të bëhen pa një analizë të thelluar të nevojave dhe pa një specifikim të temave konkrete, për të cilat duhet të ofrohet mbështetja.

Vëzhgimet e bëra në shkollat pjesëmarrëse në studim

Për të plotësuar kuadrin e mënyrës së punës së shkollës në zbatimin e kurrikulës, gjatë vizitave në shkolla për plotësimin e pyetësorëve dhe intervistave gjysmë të strukturuar, u realizuan edhe vëzhgime në sallat e mësimdhënësve, korridoret e shkollës – këndet e informimit, mësonjëtoresh/klasa mësimi dhe kabinete të ndryshme.

Gjatë vëzhgimit të shkollave, hulumtuesit u lejuan që të shikonin organizimin e sallave të mësimdhënësve, materialet e informimit të vendosura në këto salla, disa ditarë pune për klasë dhe pamje të tjera të ekspozuara nga salla të mësimdhënësve, si dhe biseda joformale me mësimdhënësit që në kohën e vizitës kishin pauza dhe qëndronin në sallën e mësimdhënësve. Përgjithësisht sallat e mësimdhënësve reflektojnë punën rutinore të mësimdhënësve, reflektojnë pamje tradicionale të organizimit të tavolinave, vendosjen e ditarëve të punës, dhe tabelat e informimit për

çështje të ndryshme. Në shumicën e shkollave, informacionet në tabelat e informimit në salla të mësimdhënësve përmbanin të dhëna për fillimin e vitit shkollor, kalendarin e vitit shkollor, udhëzimin administrativ për vlerësimin e nxënësve, orarin mësimor dhe të dhëna të tjera informative për mësimdhënësit. Sipas raporteve të hulumtuesve, vetëm në pesë shkolla ishte vendosur informimi për hulumtimin për zbatimin e kurrikulës (një gjë e tillë nuk ishte kërkuar).



Në bisedat joformale, të shkurtra, me mësimdhënësit e takuar, kanë dominuar diskutimet që reflektojnë ankesat për kushtet e punës, mungesën e teksteve shkollore, mungesën e mjeteve mësimore, ngarkesën “administrative” në planifikime, trajnime të pamjaftueshme për kurrikulë, cilësinë e trajnerëve, mungesën e përkrahjes jashtë shkollës, mungesën e monitorimit të punës së tyre. Në shumë raste kurrikula e re është trajtuar si një projekt i radhës i MASHT-it i dështuar, që në letër është shumë mirë, por që në praktikë nuk zbatohet. Vëreheshin edhe polarizimet ndërmjet mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave lidhur me kurrikulën e re. Ndërkohë drejtuesit e shkollave dhe mësimdhënësit e përcaktuar për mostër në plotësimin e pyetësorëve dhe intervistave gjysmë të strukturuar, në përgjithësi ishin korrektë në përgjigje të kërkesave për të qenë pjesë e hulumtimit.

Kështu përshkruhen disa biseda joformale me mësime dhënësit e takuar në sallën e mësime dhënëseve gjatë vizitave hulumtuese në disa shkolla të përfshira në hulumtim:

Pas takimit me drejtorin e shkollës, takuam disa mësime dhënëse në sallën e mësime dhënëseve. Edhe mësime dhënësit theksojnë faktin e mungesës së teksteve të përshtatshme, sigurimi i materialeve mësimore dhe administrata e ngarkuar për hartimin e planit ditor. Vërejtjet e tyre lidhen edhe me trajnimet. Gjatë përzgjedhjes së trajnerëve duhet pasur kujdes. Të zgjidhen trajnerë që së pari vetë e njohin mirë kurrikulën e pastaj të na trajnojnë neve.


Nuk ka tekste adekuate që përputhen me planet dhe programet. Disa tema duhet t'i marrim nga tekstet e klasave tjera. Kjo paraqet problem si për ne mësime dhënësit po ashtu edhe për nxënësit, sepse kështu ato janë të shpërndara dhe nuk janë lehtë të kuptueshme nëse është fjala për tema që merren nga tekstet e klasave të 8 apo 9. Edhe me vlerësimin në fillim kemi pasur pak probleme, kurse tani po mendojmë se jemi pak më mirë.

Disa mësime dhënëse që kishim rastin të bisedojmë në biseda rasti u shprehën se zbatimi i kurrikulës nuk ishte edhe proces i lehtë, ishin ballafaquar me sfida gjatë implementimit, me mungesë të mjeteve të nevojshme, letër, tekste e materiale tjera të domosdoshme, pastaj sfida për ta ishte edhe udhëheqja e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, sidomos u theksua ndërrimi i koordinatorit të kurrikulës, i cili kishte ndodhur në kohën kur ata kishin filluar zbatimin e kurrikulës.

Korridoret/hapësirat e shkollave të përfshira në studim përmbanin materiale të ndryshme informative, materiale të ndryshme që reflektonin punën e mësime dhënëseve dhe nxënësve. Mjediset e korridoreve në disa shkolla tregonin pedanteri të punës, materiale e punime të shumta dhe të përditësuara. Në disa shkolla materialet e ekspozuara ishin kryesisht punime të nxënësve të viteve më herët, foto të gjeneratave të ndryshme, por pa përditësime me punime të reja dhe informata të nevojshme për nxënëse. Kishte shkolla që fare nuk kishin tabelë të informimit për nxënëse dhe palët tjera të interesit.

Në korridore dhe klasa kishte mjaft punime të nxënësve. Në korridor, në sallën e mësimdhënësve dhe në zyrën e drejtoreshës, kishte të vendosura tabela informuese. Vetëm në zyrën e drejtoreshës ishte i vendosur udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. Në asnjë ambient tjetër nuk kishte asnjë informim, udhëzim apo detaj tjetër lidhur me kurrikulën.

Në korridore të shkollës ishin ekspozuar punime të shumta të nxënësve që lidheshin me zbatimin e kurrikulës së re. Shtyllat e hollit kryesor të shkollës ishin mbuluar me vizatime të punuara nga nxënësit, të cilat përfaqësonin fushat kurrikulare.



Në të gjitha shkollat e përfshira në studim është vizituar së paku një mësonjëtorë/klasë mësimi apo kabinet i punës (nëse shkollat kanë pasur). Raportet e hulumtuesve tregojnë se në disa klasa (vlejnë për t'u veçuar klasat e nivelit fillor) ka organizime të mira të klasave, reflektohet ndryshim në punën e mësimdhënësve dhe nxënësve, ka produkte të punuara me nxënës, të përditësuara, shkrime me vlera të veçanta, dollapë për çanta dhe libra të nxënësve, mjete mësimore etj. Gjithashtu, raportet tregojnë se në shumë klasa reflektohet qasja tradicionale e punës me nxënës, pak dëshmi të

kreativitetit të punës me nxënës, mungesë e mjeteve mësimore, diku edhe mungesë e bankave të nevojshme në raport me numrin e nxënësve. Pothuajse situatë e njëjtë ishte edhe në kabinetet e vëzhguara, nga ato që janë të kompletuara dhe përdoren gjatë punës me nxënës, deri tek ato që vetëm emrin e mbajnë kabinet mësimi, pa instrumente dhe mjete përkatëse të punës.

Shkolla që vizitua posedon dy kabine, kabinetin e biologjisë dhe kabinetin e informatikës. Kabineti i biologjisë ishte i pajisur me plot materiale konkretizimi. Materialet ishin sistemuar mirë, por nuk kishte ndonjë indikacion që sot aty ishte mbajtur orë mësimi, edhe pse mësimdhënësi u shpreh se aty mbahet mësim...

Të gjitha klasat/dhomat e mësimi të shkollës që e vizitua në kuadër të hulumtimit janë të pajisura me projektorë, në mure kishte të ekspozuara punime të nxënësve dhe të mësimdhënësve, të cilat i përdornin edhe si materiale konkretizimi. Shkolla ka bibliotekën, e cila ishte bukur mirë e pajisur me lektura mësimore për nxënësit e arsimit fillor.

Vizitua dy klasa ku po mbahej mësim. Në të dy klasat që i vizitua, në mungesë të teksteve, nxënësit po merrnin shënime (një nxënës shënonte në tabelë, ndërsa të tjerët të njëjtën përmbajtje e shënonin në fletore).

Gjatë vizitave dhe vëzhgimeve në shkollat e përfshira në hulumtim, në disa raste (jo shumë) hulumtuesit kanë arritur të kenë edhe biseda joformale me nxënës, biseda të shkurtra, të cilat kanë dominuar rreth praktikave të mësimdhënies në klasë, teksteve shkollore, si dhe vlerësimit të nxënësve. Në përgjithësi raportohet se nxënësit kanë qenë të rezervuar të flasin hapur për praktikën e mësimdhënies në klasë, më shumë kanë folur për mungesën e mjeteve mësimore (N. N. kl. 6, *Në klasën tonë përdoret vetëm tabela dhe shkurtesha*), problemet me tekstet shkollore (N.N. kl.7. Tani, *njësitë mësimore janë të shpërndara në dy-tri tekste*), mungesë të kompjuterëve dhe projektorëve në klasa (N.N. kl. 7: *Në shkollë nuk ka kompjuterë dhe projektorë në klasa dhe nuk kemi as kabinet të informatikës*), mungesë të bankave shkollore në disa shkolla dhe klasa (N.N. kl. 7: *Çdo ditë në orën e parë shkojmë i marrim bankat në klasën tjetër, sepse në ndërrimin e pasdites*

klasa tjetër ka më shumë nxënës dhe i marrin nga klasa jonë), vlerësimin e nxënësve (N.N. kl. 7: Në klasën tonë mbahen shumë teste brenda ditës, që është ngarkesë për ne).

Kështu përshkruhen disa biseda joformale me nxënës, gjatë vizitave në shkollë:

Gjatë vizitës në klasën e 7-të morëm disa opinione nga nxënësit, si: Shpeshherë mbahen shumë teste brenda ditës, që është ngarkesë për ne, dhe kjo na bën të kemi shumë stres. Ankesa kishte edhe për metodologji të mësimdhënies, sepse sipas nxënësve mësimdhënësit rrinë e na duhet të lexojmë, të komentojmë e nuk po kuptojmë. Arsimitarët përdorin telefona, kurse na nuk guxojmë, etj. Ndërsa, përkundër tri grupeve të nxënësve, të cilët nuk pëlqenin kurrikulën e re, një grup i nxënësve dha opinione pozitive e që sipas tyre nxënësit, të cilët ankohen, përtojnë të mësojnë, sepse me kurrikulë të re notat vendosen në ditarin personal, e pastaj mblidhen – pjesëtohen dhe vendosen në ditar klase. Kjo na jep mundësi të përmirësohemi.

Gjatë kohës sa qëndruam në shkollë (shkollë që ka qenë e përfshirë në pilotim) (10:30-13:30h) kemi vizituar klasën e shtatë me ç'rast shfrytëzuam rastin që t'iu bëjmë disa pyetje nxënësve, nga të cilët morëm këto përgjigje: me kurrikulën e re është më mirë, sepse kemi tri perioda të vlerësimit dhe kemi mundësi për t'i përmirësuar notat; kemi më shumë aktivitete dhe është më lehtë për të mësuar, mundemi me u shpreh lirshëm, etj. Po ashtu, kishte edhe mendime negative, kryesisht rreth teksteve, fjalorit në tekste dhe vlerësimit.

Në korridorin e shkollës që e vizituam, pasi u takuam me mësimdhënësit që ishin planifikuar për hulumtim, takuam një grup të nxënësve të klasës së shtatë, të cilat ishin në pauzë, për shkak se mungonte një mësimdhënësi. Bëmë një bisedë rreth 10 minuta. Kështu përshkruhet nga nxënësit puna në klasë: Prej të gjithë mësimdhënësve, vetëm 3-4 janë më të angazhuar, praktikojnë metoda pune që na nxisin të mësojmë më shumë, të tjerët më shumë ankohen për problemet që lidhen me kurrikulën dhe tekstet që i përdorim. Shpesh marrim shënime nga mësimdhënësit, sepse ata

po thonë se këto materiale nuk gjinden në tekstet e klasës. Mbajmë vetëm mësim të rregullt, nuk ka aktivitete të lira, nuk ka orë shtesë në lëndët që kemi vështirësi, sidomos në matematikë dhe shkenca të natyrës. Mësimdhënësit na vlerësojnë më së shumti me teste, në periudhe dytë janë mbajtur shumë teste brenda një dite të mësimi etj.

Si konkluzion i analizës së raporteve informative nga vizitat hulumtuese në shkollat e përfshira në hulumtim, ekzistojnë dallime të dukshme sa u përket qasjes dhe organizimit të punës së shkollave në zbatimin e kurrikulës së re. Dallimet reflektojnë kulturën dhe traditën e punës së shkollave, seriozitetin/mosseriozitetin e punës së udhëheqësve të shkollave dhe të mësimdhënësve, lirinë/ jo lirinë e shprehjes së mendimit nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve, angazhimin / jo angazhimin e mësimdhënësve, përkrahjen /jo përkrahjen nga partnerët mbështetës, nga MASHT-i, DKA-të etj. Këto dallime reflektohen edhe në punën me nxënësit, të cilët në disa shkolla vazhdojnë të mos e marrin përkrahjen e nevojshme në funksion të zhvillimit të kompetencave.

4.2.1.3. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e koordinatorëve të cilësisë në DKA

Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e koordinatorëve të cilësisë në DKA, lidhur me zbatimin e kurrikulës në shkolla, janë produkt i analizës së pyetësorit dhe intervistave gjysmë të strukturuar, të organizuara me koordinatorë të cilësisë në komuna, të cilët në kohën e realizimit të studimit, kanë pasur rol në punën me shkollat lidhur me zbatimin e kurrikulës së re. Qëllimi ishte të hulumtohen ndryshimet kryesore që ka sjellë kurrikula e re në punën dhe organizimin e brendshëm të DKA-së, përvojat nga informimi dhe konsultimet gjatë fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore, praktikat e koordinimit të aktiviteteve për zhvillim profesional të mësimdhënësve në nivel të komunës, përvojat gjatë zbatimit, arritjet, sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve dhe shkollave nga perspektiva e Drejtorive Komunale të Arsimit. Rezultatet janë mbledhur nga 11 koordinatorë të cilësisë në DKA. Përgjigjet e koordinatorëve të cilësisë në DKA janë

përmbledhur në nëntema të lidhura me rolin e DKA-ve dhe me pyetjet e diskutuara me KC, siç prezantohet në pjesën më poshtë.

Ndryshimet kryesore që ka sjellë kurrikula e re në punën dhe organizimin e brendshëm të DKA-së

Varësisht nga specifikat e organizimit të DKA-ve, përshkruhet roli aktual i DKA-ve në zbatimin e kurrikulës së re. KC i referohen koordinimit me shkollat dhe MASHT-in në përgatitjet për zbatimin e kurrikulës, përgatitjet për trajnimin e mësimeve, sigurimin e kushteve teknike për mbarrëvajtjen e trajnimeve për kurrikulë. Kështu e përshkruan rolin një nga KC:

Roli aktual i DKA-së në zbatimin e kurrikulës së re është rol "koordinues" në zinxhirin MASHT-DKA-shkollë. DKA-të aktualisht organizon trajnimin e të gjithë mësimeve të gjitha niveleve shkollore për zbatimin e kurrikulës së re, për çdo vit shkollor. Ndonjëherë shfrytëzohet rrjeti i trajnerëve komunalë të kurrikulës për ndonjë mbështetje të këtij procesi, por që nuk është ndonjë mbështetje e vazhdueshme dhe e zyrtarizuar si mekanizëm mbështetës.

Tre nga njëmbëdhjetë KC pohojnë se DKA-të kanë rol edhe në identifikimin e sfidave për përmbushjen e zbatimit sa më të mirë të kurrikulës dhe krijimin optimal të kushteve për zbatimin e saj, monitorimin e zbatimit të kurrikulës së re dhe përgatitjen e raporteve për MASHT-in.

Për pjesën e dytë të pyetjes, që lidhet me ndryshimet kryesore që ka sjellë kurrikula e re në punën dhe organizimin e brendshëm të DKA-së, nuk raportohet për ndryshime të theksuara, përveç vendosjes së koordinatorëve të cilësisë në DKA dhe përpjekjeve të zyrtarëve arsimorë në DKA për të punuar me shkollat në zbatimin e kurrikulës. Sipas pohimeve të KC, ekzistojnë dallime në qasje dhe në organizim të punës së DKA-ve. Kështu përshkruhen dallimet nga disa KC në DKA:

Padyshim që kurrikula e re ka prodhuar kërkesa të reja, për të gjitha hallkat e funksionimit dhe organizimit. Ne si DKA nuk kemi

arritur që të krijojmë mekanizma mbështetës (mentorues dhe monitorues) për zbatim efikas të kurrikulës. Ne e kemi angazhuar një zyrtar që ta ushtrojë edhe funksionin e koordinatorit komunal për kurrikulë, që t'i koordinojë aktivitetet për zbatim të kurrikulës me shkollat.

DKA-ja në nivelin aktual të organizimit nuk ka kapacitetet e duhura për zbatim të Kurrikulës të Kosovës, për arsye të mospërfshirjes së zyrtareve në trajnime dhe mungesës së zyrtarit përkatës në DKA për kurrikulën e re.

Përqendrimi ynë në punën rreth kurrikulës së re është se ne po punojmë rreth marrjes së përgjegjësi të reja në DKA në lidhje me realizimin e kurrikulës në fjalë. Nuk kemi bërë ndonjë ndryshim.

Përshkrimet që ofrojnë KC tregojnë se pjesa më e madhe e DKA-ve nuk e kanë zërthyer në veprime konkrete rolin e tyre në zbatimin e kurrikulës së re dhe se akoma nuk kanë arritur të krijojnë mekanizma mbështetës për zbatim të suksesshëm të kurrikulës.

Udhërrëfyesi për zbatim të kurrikulës së re 2016-2021 është dokument i hartuar nga MASHT-i, me mbështetje nga Projekti i Binjakëzimit. Në këtë dokument janë vendosur edhe synimet dhe aktivitetet për DKA-të, që duhet t'i përmbushin lidhur me zbatimin e kurrikulës së re. Vetëm njëri nga 11 KV, pohon se nuk është në dijeni për Udhërrëfyesin për zbatim të kurrikulës së re 2016-2021 dhe rrjedhimisht shprehet se nuk e kemi pikë referimi në punën tonë. Të tjerët pohojnë se janë në dijeni për Udhërrëfyesin për zbatim të kurrikulës së re 2016-2021, atë e kanë dërguar në shkolla. Në disa DKA patëm rastin të shohim dokumentin në zyre të punës dhe po ashtu edhe në një numër të konsiderueshëm të shkollave që kanë qenë pjesë e Projektit të Binjakëzimit. Njëri nga KC shprehet kështu:

Përpjekjet tona për përmbushjen e rolit tonë janë "modeste" për të punuar në bazë të udhërrëfyesit. Shkollat këtë udhërrëfyes shumë pak e kanë si pikë referimi dhe atë kryesisht shkollat që kanë qenë në pilotim të kurrikulës, që i kanë pasur të formuara ekipet shkollore për zbatim të kurrikulës.

Në bazë të udhërrëfyesit për zbatim të kurrikulës së re, 2016-2021, DKA-të informojnë të gjitha palët e interesit për ndryshimet dhe risitë që sjellë kurrikula e re, ndihmojnë shkollat në përgatitjet e tyre për zbatimin e kurrikulës, udhëheqin procesin e zbatimit të kurrikulës në nivel të komunës, planifikojnë personelin mësimdhënës dhe mbështetës në shkolla, planifikojnë dhe organizojnë trajnimet për zbatimin e kurrikulës, ndihmojnë shkollat në vendosjen e kurrikulës me zgjedhje, në bazë të autonomisë së shkollës etj. Sipas KC, DKA-të po përpiqen që të përmbushin këto detyra, por mungesa e kapaciteteve dhe pengesat tjera burokratike i kanë sfiduar DKA-të në përmbushjen e rolit të tyre. Madje, sipas KC, zbatimi i kurrikulës në nivel shkolle dhe sipas planifikimit në udhërrëfyes është sfiduar në masë të madhe për mungesë të kapaciteteve të drejtuesve të shkollave dhe për mungesë të kapaciteteve në DKA për të ofruar mbështetjen e duhur.

Në bazë të përgjigjeve të KC, konstatohet se komunat dhe shkollat janë pajisur me udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës 2016-2021, mirëpo përmbushja e synimeve dhe aktiviteteve të vendosura në këtë dokument nuk është në linjë me pritjet dhe nuk vërehet një mobilizim për të dinamizuar punën, arritjen e tyre.

Informimi dhe konsultimet gjatë fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore

Përgjigjet e KC në pyetjet lidhur me informimin dhe konsultimet gjatë fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore janë shumë të shpërndara. Disa KC (rreth 40 %) flasin për informim dhe konsultime deri diku të mjaftueshme. Ndërsa, pjesa tjetër e KC pohojnë se në përgjithësi kanë munguar informimi dhe konsultimet e fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore për secilën gjeneratë. Kështu shprehet një nga KC:

Konsultime me zyrtarët e arsimit ka pasur shumë pak, ndërsa me shkolla dhe mësimdhënës pak më shumë, por besojmë se nuk kanë qenë të mjaftueshme. Në fazën pilotuese ka pasur një "anashkalim të DKA-ve", kryesisht orientimi ka qenë në punën me SIA (sektorët rajonalë të inspektoratit të arsimit) dhe shkollat. Ndërsa, në fazën

e shtrirjes së zbatimit në të gjitha shkollat janë organizuar shumë pak konsultime me DKA-të.

Sa i përket prezantimit të programeve të reja mësimore nga MASHT-i, KC pohojnë se nuk është bërë si duhet. Programet e reja mësimore nuk janë shpërndarë kopje fizike në komuna dhe shkolla, ato janë ndarë vetëm në formë elektronike. Të gjithë mësimdhënësit e klasave në të cilat punohet me programe të reja mësimore kanë qenë të obliguar që t'i shkarkojnë nga ueb-faqja e MASHT-it, me qëllim që më pas t'i përgatitin planifikimet e tyre për zbatimin e kurrikulës. Sipas KC kanë munguar edhe takimet informative dhe diskutimet për zbatimin e kurrikulës së re dhe e gjithë kjo është synuar të plotësohet përmes trajnimeve 6-ditore. Kështu shprehet një nga KC:

Mendojmë se nuk janë prezantuar mjaftueshëm as në komuna dhe as në shkolla dhe si rrjedhojë e saj vlerësojmë se edhe shkollat nuk e kanë informacionin e duhur për programet e reja mësimore.

Pothuajse të gjitha përgjigjet e KC tregojnë se informimi dhe konsultimet në fazën e përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore për secilën gjeneratë kanë qenë të pakta, në anën tjetër edhe mënyra e prezantimit të programeve të reja mësimore nga MASHT-i nuk ka qenë e duhur për KC.

Të gjithë KC pohojnë së rreth kurrikulës së re DKA-ja nuk ka përgatitur materiale specifike (pako informative, udhëzues etj.). Të vetmen gjë që ka bërë është shpërndarja e materialeve (dokumenteve kurrikulare, udhëzuesve e doracakëve) të përgatitura nga MASHT-i, IPK-ja, Projekti i Binjakëzimit dhe partnerët e tjerë që kanë mbështetur MASHT-in dhe komunat në këtë proces. Ndërsa, sa i përket dërgimit të tyre në shkolla, KC shprehen se e kanë bërë këtë gjë, mirëpo, sipas tyre, ndërrimet në strukturat udhëheqëse në shkolla shpesh kanë bërë që materialet e tilla të mos jenë në dispozicion të shkollës, sepse ato janë shpërndarë për individë dhe nuk janë ruajtur ekzemplarë të veçantë për shkollën.

Koordinimi i aktiviteteve të zhvillimit profesional

Sipas KC, aktivitetet koordinohen përmes koordinatorit komunal me udhëheqësit e shkollës, koordinatorët e cilësisë në nivel shkolle dhe me aktivet profesionale. Sa i përket cilësisë së trajnimeve, është vlerësim i përgjithshëm se "ka munguar cilësia" në trajnimet e organizuara. Një numër (jo i vogël) i trajnerëve të përzgjedhur nuk kanë pasur kompetencat e duhura (këtë e vërteton edhe testi i mbajtur nga MASHT-i për këtë trajnerë, pasi një numër i konsiderueshëm i trajnerëve nuk kanë arritur ta kalojnë testin). Përzgjedhja e trajnerëve është bërë drejtpërdrejt nga MASHT-i, pa i konsultuar DKA-të dhe shkollat. Koordinimi i trajnimeve është bërë nga Inspektorët e arsimit në rajone. Sipas KC, vitet e fundit, DKA-të, përmes koordinatorit komunal, i organizojnë trajnimet për të gjithë mësimdhënësit, në bashkëpunim me MASHT-in. MASHT-i siguron vetëm udhëzuesit dhe pagesën e trajnerëve, ndërsa DKA-të të gjitha materialet tjera të nevojshme, organizimin e trajnimit, monitorimin e realizimit të trajnimit, dhe vlerësimin e portofoliove të mësimdhënësve të trajnuar, në bashkëpunim me trajnerët. Sipas rekomandimeve nga DKA-të, MASHT-i tash përzgjedhjen e trajnerëve ua ka kaluar si kompetencë komunave dhe ne i shpallim ofertat dhe e bëjmë përzgjedhjen e trajnerëve. Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve tash është shumë më e mirë. Cilësia e trajnimeve, ndoshta edhe për shkak të përvojës së krijuar dhe shtrirjes së kurrikulës, mund të vlerësohet se në vitin e fundit është më e mirë.

Procesi i mbikëqyrjes së trajnimeve dhe formave tjera të përkrahjes profesionale, sipas KC, dallon nga komuna në komunë. Ka komuna që tashmë kanë ngritur ekipe profesionale, në përbërje të së cilave janë përfshirë trajnerë të kurrikulës dhe qëndrojnë më mirë në procesin e mbikëqyrjes, mirëpo pjesa më e madhe e komunave raportojnë se në mungesë të kapaciteteve dhe resurseve njerëzore në DKA nuk kanë arritur të mbikëqyrin sa duhet trajnimet dhe t'i koordinojnë të gjitha aktivitetet e mbështetjes profesionale që ofrohen nga MASHT-i dhe partnerët mbështetës. Disa KC shprehen se ky proces shpesh sfidohet për shkak të moskoordinimit të mirë edhe të vet MASHT-it me komunat dhe me partnerët mbështetës.

Si konkluzion i përgjigjeve të KC në DKA, mund të pohohet se në vitet e fundit ka pasur një progres të vogël në koordinimin nga DKA të aktiviteteve të mbështetjes profesionale për zbatimin e kurrikulës/programeve të reja mësimore që ofron MASHT-i dhe partnerët mbështetës. Cilësia e mbështetjes profesionale dhe cilësia e trajnimeve, si dhe adresimi i problemeve të evidentuara, mbeten sfidë në vete si për DKA-të, ashtu edhe për shkollat.

Monitorimi i zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore

Përgjigjet e KC lidhur me pyetjet për monitorimin nga DKA të zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore, janë të shpërndara. Disa KC shprehen se procesi i zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore, monitorohet vazhdimisht nga DKA, mirëpo nuk ofrojnë dëshmi të monitorimit nga një proces i vazhdueshëm, më shumë flasin për vizita rutinore në shkolla dhe për raportet që i marrin nga drejtorët e shkollave, KC në shkolla dhe trajnerët e kurrikulës. Disa DKA kanë filluar ngritjen e ekipeve komunale për mbështetjen e mësimdhënësve dhe monitorimin e zbatimit të kurrikulës, mirëpo ato janë sfiduar për shkak të kufizimeve ligjore për rritjen e stafit në DKA dhe mungesës së buxhetit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Në anën tjetër, mbi 50 % e KC shprehen se DKA-të nuk kanë ndërtuar mekanizma në nivel komunal për monitorimin e procesit të zbatimit të kurrikulës së re. KC janë duke bërë përpjekje që ta mbulojnë këtë, por e kanë të vështirë për shkak se mbulojnë shumë referate të punës dhe janë të angazhuar në shumë procese që zhvillohen në komuna dhe shkolla. Kështu shprehen disa nga KC lidhur me procesin e zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore:

Nuk kemi krijuar ndonjë mekanizëm komunal mentorues dhe monitorues. Procesin e zbatimit të kurrikulës e monitorojmë kryesisht përmes raportimeve zyrtare të drejtorëve të shkollave dhe vizitave të përgjithshme monitoruese që i bëjmë në shkolla. Në

fazën pilotuese, koordinatorët e shkollave për kurrikulë kanë raportuar përmes raporteve të rregullta. Këto raporte janë analizuar nga koordinatori komunal dhe kryesisht mund të konkludohet se mësimdhënia ka filluar të ndryshojë si rezultat i kurrikulës së re.

DKA nuk ka ndonjë ekip apo mekanizëm të veçantë për monitorimin e zbatimit të kurrikulës së re, përpos raporteve të drejtorëve të shkollave, raporteve të vlerësimit të brendshëm të shkollave dhe raporteve të vlerësimit të jashtëm të shkollave të cilat zhvillohen nga SIA. Raportet flasin/dëshmojnë për zbatim jo të plotë të disa aspekteve të kurrikulës, në veçanti përzgjedhjes së materialit mësimor, mungesës së teksteve shkollore dhe të përfshirjes së nxënësve në procesin e të nxënës dhe vendimmarrjes së përbashkët.

Nisur nga kjo, mund të konkludojmë se DKA-të akoma nuk kanë ndërtuar struktura të qëndrueshme për monitorimin e procesit të zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja, analizën e raportimeve që vijnë nga shkollat dhe SIA lidhur me zbatimin e kurrikulës, si dhe për adresimin e kërkesave dhe nevojave të shkollave që dalin nga praktika e zbatimit të kurrikulës.

Zbatimi i autonomisë së shkollës

Rezultatet tregojnë përputhshmëri në mendime të KC lidhur me shkallën e zbatimit të autonomisë së shkollës sipas përcaktimeve me kurrikulën e re dhe sfidat kryesore, me të cilat ballafaqohen shkollat. Ekziston mendimi se në përgjithësi autonomia e shkollës zbatohet pak, bëjnë përjashtim kërkesat e përgjithshme që burojnë për procedurat nga MASHT-i, të cilat i mbikëqyr Inspektorati i Arsimit dhe kërkesat që burojnë nga procedurat e DKA-së për përfshirje në listën e pagave.

Sipas KC, referuar raporteve që vijnë nga trajnerët, Inspektorati i Arsimit dhe diskutimet me drejtorë dhe mësimdhënës, shkollat dhe mësimdhënësit ballafaqohen me disa sfida që lidhen me zbatimin e autonomisë së shkollës, si mungesa e një sistemi për të planifikuar dhe organizuar aktivitete dhe orë

mësimore përtej orarit zyrtar, mungesa e hapësirave të veçanta (në shkollat e qytetit), mungesa e buxhetit dhe procedurat e menaxhimit të tij nga shkolla. Probleme raportohen edhe sa i përket hartimit të programeve për kurrikulë me zgjedhje, si pjesë e autonomisë së shkollës.

KC e cilësisë janë të mendimit se një pjesë e sfidave lidhen me vetë punën e shkollës dhe mungesën e gatishmërisë së saj për të zbatuar autonominë që ka sipas kurrikulës së re. Njëri nga KC shprehet kështu:

Për tejkalimin e këtyre sfidave, që lidhen me zbatimin e autonomisë së shkollës, drejtorët duhet të jenë më proaktivë në menaxhimin dhe udhëheqjen e shkollave të tyre. Shkollat duhet të pajisen me mjetet e nevojshme didaktike dhe të konkretizimit, të pajisen me kabinete, duke përfshirë edhe atë të TIK-ut, si dhe të kenë qasja në internet. Bashkëpunimi i mësimdhënësve dhe funksionalizimi i aktiveve profesionale e bën më të lehtë tejkalimin e çdo sfide. Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit të gjejnë forma nxitëse që prindërit të jenë më bashkëpunues, kontribuues dhe mbështetës të projekteve që shkolla i planifikon dhe i realizon. Të gjitha këto krijojnë mundësitë që nxënësit të jenë më të angazhuar dhe më të motivuar në arritjen e rezultateve më të mira në arritjen e kompetencave të parapara në kurrikulën e re.

Si konkluzion i përgjigjeve të KC në DKA, mund të pohohet se zbatimi i autonomisë së shkollës, të paraparë me kurrikulën e re, përbën një sfidë më vete, për të cilën DKA duhet të angazhohet në tejkalimin e saj dhe në fuqizimin e rolit të shkollës në zbatimin e kurrikulës së re.

Arritjet, sfidat e problemet kryesore, nevojat për mbështetje

Arritjet për zbatimin e kurrikulës së re në shkollat e komunave përkatëse KC i ndërlidhin me shtrirjen e zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat, sipas dinamikës së planifikuar, me përfshirjen e mësimdhënësve në trajnime për kurrikulë, përkatësisht ofrimin e trajnimeve bazike për zbatim të kurrikulës për të gjithë mësimdhënësit, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve, rritjen e bashkëpunimit të DKA-së me shkollat dhe

mësimdhënësit, fillimin e fuqizimit të shkollave, AP, koordinatorëve të cilësisë në shkolla etj.

Në anën tjetër, KC listojnë një varg sfidash dhe problemesh, me të cilat janë ballafaquar dhe vazhdojnë të ballafaqohen në procesin e zbatimit të kurrikulës së re dhe që në masë të madhe kanë ndikuar në humbjen e besimit në këtë reformë. Ato lidhen me:

- mungesën e kapaciteteve për t'i udhëhequr ndryshimet, siç kërkohet me kurrikulën e re;
- mospërfshirjen e të gjithë zyrtarëve të DKA-ve në aktivitete dhe trajnimet që lidhen me njohjen e filozofisë së kurrikulës së re;
- mungesën e trajnimeve specifike në këtë fushë për pedagogë dhe psikologë të shkollave;
- pamundësitë për krijimin e ekipit komunal mbështetës për zbatim të KK-së;
- funksionalizimin e mekanizmave mbështetës në nivel shkolle;
- zyrtarizmin e lirimit të KC nga orët mësimore, siç përcaktohet me UA;
- mungesën e teksteve shkollore të harmonizuara me kurrikulën e re;
- trajnimet afatshkurta dhe mungesën e një praktike të organizuar në nivel të DKA-ve dhe shkollave për të ofruar forma të tjera të mbështetjes;
- mungesën e mjeteve të nevojshme të konkretizimit dhe pajisjeve të TIK-ut për të përdorur burime të tjera mësimore;
- mospërfshirjen e një numri të madh të mësimdhënësve në disa nga trajnimet bazike që konsiderohen që e ndihmojnë kurrikulën e re, siç janë: MKLSH, Vlerësimi Formativ, Përdorimi i TIK-ut etj.

Nisur nga këndvështrimi i KC në DKA, ka një progres të vogël në zbatimin e kurrikulës dhe njëkohësisht ka disa sfida dhe probleme të mëdha, të cilat në masë të madhe janë duke vështirësuar shtrirjen dhe zbatimin e suksesshëm të kurrikulës. Një pjesë e sfidave dhe problemeve lidhen me

punën e shkollave, një pjesë me punën e DKA-ve dhe një pjesë tjetër u faturohen MASHT-it dhe mekanizmave të MASHT-it.

Disa KC shprehen se çelësi për evitimin e sfidave dhe problemeve lidhur me zbatimin e kurrikulës është në duar të nivelit qendror. Sipas tyre, nga MASHT-i kërkohet angazhim dhe mbështetje për DKA dhe shkollat, kërkohet rritje e buxhetit për pajisjen e shkollave me të gjitha kabinetet e nevojshme, pajisjen me mjetet didaktike dhe të konkretizimit, kërkohet përmirësimi i cilësisë së trajnimeve, pajisja e nxënësve me tekste shkollore të harmonizuara me programet e reja mësimore, monitorimin e vazhdueshëm të shkollave, si dhe ofrimin e mbështetjes përtej trajnimeve afatshkurtra.

Pjesa tjetër e KC reflektojnë më shumë në punën dhe angazhimin e DKA-së, nevojën për të qenë më afër shkollës, punën më aktive me drejtorë të shkollave dhe mësimdhënës, pasi që DKA është punëdhënës, ofrimin e trajnimeve më efektive dhe afatgjata, sigurimin e materialeve të nevojshme shpenzuese për shkollat etj. Në linjë me këtë, kështu shprehen dy KC:

Mendoj se DKA-të duhet "të mobilizohen" dhe t'i marrin me përgjegjësi të shtuar obligimet e tyre, në raport me sigurimin e zbatimit të suksesshëm të kurrikulës, duke krijuar mekanizma komunalë mbështetës dhe monitorues.

Ndarja e qartë e përgjegjësi MASHT-DKA-shkolla. Vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së shkollave - vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave. Organizimi i trajnimeve me bazë në shkollë. Veprimet duhet të jenë të koordinuara, MASHT-DKA.

Nisur nga pohimet e shumicës së KC, mund të konkludojmë se DKA-të kanë filluar të kuptojnë më shumë rolin e tyre për mbështetje të shkollave në zbatimin e kurrikulës së re. Disa DKA tashmë kanë hartuar edhe plane zhvillimore për arsimin në nivel komune dhe kanë përcaktuar fushë të veçantë zbatimin e kurrikulës së re. Mirëpo, veprimet aktuale të DKA-ve, sipas vetë KC, nuk janë në linjë të plotë me këto planifikime.

KC kërkojnë qartazi që mbështetja për shkollat dhe komunat të jetë e qëndrueshme, sepse në këto vite ajo është ofruar me një qasje jo shumë efektive dhe e shpëputur, në varësi të partnerëve mbështetës. Sipas KC, komunat dhe shkollat kanë nevojë për mbështetje konkrete/praktike në terren, përmes mekanizmave të ndryshëm mbështetës.

Jemi në përpyetje të krijimit të një mekanizmi mbështetës komunal, përmes të cilit do të realizonim mbështetje të vazhdueshme në të gjitha shkollat për t'i tejkaluar të gjitha vështirësitë në zbatimin e suksesshëm të kurrikulës. Krijimi i mekanizmit të tillë kërkon përkrahje nga MASHT-i.

Gjithashtu, KC tregojnë përputhshmëri në mendime sa u përket mbështetjes për tejkalimin e sfidave dhe problemeve që tashmë janë evidentuar dhe janë raportuar edhe në këtë pjesë të analizës, si në nevojën për krijimin dhe funksionalizimin e mekanizmave profesionalë në nivel qendror për mbështetje, monitorim të vazhdueshëm të shkollave, dhe vlerësim të zbatimit të kurrikulës.

Ndryshimet që priten si rrjedhojë e zbatimit të kurrikulës së re, në shkallë vendi

Edhe në pyetjet lidhur me ndryshimet që priten si rrjedhojë e zbatimit të kurrikulës së re, në shkallë vendi, përgjigjet e KC janë shumë të shpërndara. Disa KC, duke iu referuar mënyrës së si janë duke u udhëhequr ndryshimet në arsim dhe veçanërisht se si është udhëhequr reforma kurrikulare në këto 10 vitet e fundit, pohojnë se nuk presin ndryshime pozitive, përkundrazi shfaqin shqetësimet e tyre se disa gjëra do të jetë vështirë të ndryshohen.

Nuk pres ndryshime serioze. Ato janë duke u penguar nga niveli qendror deri te shkolla.

Sistemi arsimor është politizuar shumë, shumë probleme janë thelluar dhe askush nuk është duke u marrë me to. Që sa vjet shkollat që kanë filluar pilotimin punojnë pa tekste, pa programe që dikush i ka miratuar...

Në anën tjetër, disa koordinatorë shprehen të jenë më racionalë dhe kanë pritje të ndryshme që duhet të ndodhin në sistemin arsimor, si rrjedhojë e zbatimit të kurrikulës së re.

Nëse zbatohet në tërësi kurrikula e re, në bazë të kërkesave të saj, mendoj se do të ketë ngritje të cilësisë në arsim, por kuptohet nëse depolitizohet arsimi nga niveli qendror deri në atë lokal. Në DKA duhet të ketë riorganizim të brendshëm, gjithnjë në fokus të mbështetjes profesionale të shkollave.

Presim që sistemi arsimor të fillojë të konsolidohet në të gjitha nivelet dhe me të gjithë aktorët. Të fuqizohen dhe të funksionalizohen të gjitha shërbimet që i kontribuojnë këtij procesi, edhe në nivel shkolle, edhe në nivel të DKA-së. Mendojmë se duhet të krijohen mekanizma mbështetës në të gjitha nivelet dhe të rritet prezenca direkte në shkollë - aty ku ndodh ndryshimi, ngase nuk "guxojmë" të sillemi me pasivitet në raport me këto ndryshime.

Me zbatimin e kurrikulës së re presim ndryshime veçmas në punën e arsimtarëve të rinj, të cilët kanë njohuri më të mira dhe kanë përkushtim më të madh për zbatimin e kurrikulave. Roli i DKA-së duhet të jetë mbështetës.

Përmirësim në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, drejt ngritjes së nivelit të arritjes së nxënësve. Përmirësim të një kulture të re organizative, zhvillimore dhe pedagogjike të shkollës, pasi shkolla me zbatimin e kurrikulës së re ka autonomi dhe fleksibilitet më të shtuar.

Në dritën e kësaj, mund të arrihet në përfundimin se shumica e KC kanë pritje për ndryshimet që duhet të ndodhin në sistemin arsimor si rrjedhojë e zbatimit të kurrikulës së re, mirëpo ato përshkruhen me një rezervë, si rezultatet e një kulture joaktive për të çuar përpara ndryshimet e filluara.

4.2.1.4. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e zyrtarëve arsimorë në MASHT

Në diskutimin gjysmë të strukturuar, fokus-grup, të organizuar me zyrtarë arsimorë të MASHT-it, në përbërje nga Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve, Inspektorati i Arsimit, Divizioni i arsimit të hershëm dhe parashkollor dhe Divizioni i arsimit gjithëpërfshirës, është arritur të nxirren rezultate të rëndësishme lidhur me udhëheqjen e reformës së kurrikulës, prezantimin e programeve të reja mësimore në komuna dhe shkolla, ofrimin e materialeve mbështetëse dhe trajnimet për zbatimin e kurrikulës, monitorimin e procesit të zbatimit, arritjet, sfidat e problemet kryesore, nevojat për mbështetje të vazhdueshme. Po ashtu edhe rekomandimet për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Rezultatet që prezantohen në këtë pjesë janë produkt i analizës tematike të diskutimit me fokus-grup dhe të dokumentimit për disa aspekte të kërkuara gjatë diskutimit. Ato janë përmbledhur në nëntema të veçanta, siç prezantohen në pjesën më poshtë.

Udhëheqja e reformës kurrikulare

Diskutimi gjysmë i strukturuar me zyrtarët arsimorë të MASHT-it, të përfshirë në këtë hulumtim, është filluar me pyetjet që lidhen me udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, bazuar në Udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. Lidhur me pyetjet: *Sa dhe si është duke u udhëhequr zbatimi i kurrikulës së re në bazë të Udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021? Si reflektohet udhërrëfyesi (2016 – 2021) në planet e divizioneve/sectorëve tuaj? Sa jeni në dijeni që komunat dhe shkollat kanë pikë referimi këtë udhërrëfyes për të udhëhequr zbatimin e kurrikulës në nivel komune dhe shkolle?*, kemi marrë përgjigje të ndryshme, nga ato që udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës e shohin si një dokument, i cili është bërë sa për të thënë, drejt atyre që mbështeten në këtë dokument, i referohen gjatë planifikimit të punës së tyre dhe bashkëpunimit me komunat.

- *Udhërrëfyesi për zbatim 2016-2021 është bërë pasi që ka filluar procesi. Një dokument i tillë duhet të bëhet para fillimit të procesit. Ky dokument është bërë me kërkesë e zyrës sonë dhe dihet se si është bërë, për faqe të zezë. Kështu që ky proces ka filluar mbrapsht dhe është*

shumë vështirë me pasë sukses, sepse nuk ka pasur përgjegjës kryesor, herë e ka marrë një, herë tjetri, herë është përfshirë politika. Pra, nuk i kemi mekanizmat për të ditur si është gjendja.

- *Sipas planeve të Divizionit tonë për vitin 2018 dhe 2019, asnjë aktivitetet nuk kemi bërë lidhur me kurrikulën. Divizioni i Kurrikulave i ka zhvilluar programet dhe dokumentet kurrikulare, Zyra e trajnimit ka organizuar trajnime me mësimdhënës.*
- *Sa unë kam informata, nuk besoj se ka individë përgjegjës të caktuar në Inspektoratin e Arsimit për të koordinuar punën me Divizionin e kurrikulave për aktivitetet që lidhen me Udhërrëfyesin për zbatim të kurrikulës 2016-2021. Por, si detyrë e njëres pjesë të punës së inspektorëve të arsimit, sipas Ligjit të ri të Inspektoratit të Arsimit, konkretisht të inspektorëve pedagogjikë, kanë edhe detyrë dhe përgjegjësi sa i përket zbatimit ose zbatueshmërisë së kurrikulës përmes raportit mësimdhënës – nxënës. Këto gjera pak a shumë preken, varen se ku gjinden shkolla, mësuesi dhe rrethanat se ku zhvillohet procesi mësimor etj.*
- *Sa i përket Udhërrëfyesit 2016-2021, ne si divizion jemi bazuar në të, planin individual të arsimit e kemi përshtatur me kurrikulën e re, kemi hartuar dhe botuar një udhërrëfyes për gjithëpërfshirje, i cili ndërlidhet edhe me PIA, kemi adaptuar dokumentacionin pedagogjik, kemi organizuar trajnime me mësimdhënës, të cilat janë fokusuar më shumë në fushën e mësimdhënies së individualizuar, zbatimin e planit individual të arsimit dhe menaxhimin e klasave gjithëpërfshirëse, përfshirë klasat në shkollat të rregullta, në të cilat gjenden fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe kemi bashkëpunuar me komunat në këtë fushë.*
- *Në raport me zbatimin e Udhërrëfyesit për kurrikulën në komuna, ne kemi kontakte me komunat përmes e-mailit, kemi pasur një takim/punëtori në komunën e Prishtinës, na i kanë ofruar disa komuna planet e tyre, por, sipas tyre, del se mësimdhënësit në shkolla po punojnë duke u bazuar në udhëzuesit për fusha kurrikulare, saktë nuk e dimë për aspektet tjera të punës së komunave referuar Udhërrëfyesit*

për zbatimin e kurrikulës, sepse nuk kemi qasje në mënyrë direkte, ngase është e pamundur të bëhet një gjë e tillë.

Nisur nga kjo, mund të pohohet/konkludohet se MASHT-i nuk ka vendosur mekanizma, përkatësisht nuk ka strukturë udhëheqëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave e aktiviteteve të përcaktuara në Udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. Këtë rol nuk e ka luajtur as Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, me arsyetimin se përshkrimi i detyrave të punës për Divizionin e kurrikulave dhe mbështetje të mësuesve nuk lidhet me udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, ka të bëjë vetëm me zhvillimin e kurrikulave²¹. Në mungesë të një trupe udhëheqëse dhe koordineuse, nuk është që nuk janë realizuar një numër i aktiviteteve nga sektorë të ndryshëm në MASHT, të lidhur me këtë dokument, por ato nuk janë ndërsektoriale, janë të pakoordinuara mirë dhe nuk sigurojnë informata kthyesë për përmbushjen e roleve dhe përgjegjësi të të gjitha palëve të parapara me Udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës.

Prezantimi i kurrikulave lëndore/programeve të reja mësimore

Pas përfundimit të fazës së pilotimit të dokumenteve të reja kurrikulare, në vitin 2016, kurrikulat lëndore/programet mësimore për klasë dhe lëndë përkatëse hartohen nga grupet punuese për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore, nën udhëheqjen dhe përkujdesjen e Divizionit për Kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT. *Si janë prezantuar programet e reja mësimore në komuna dhe shkolla (zyrtarë arsimorë, drejtorë të shkollave, mësimdhënës etj.)? Sa vlerësohet se komunat dhe shkollat kanë informacionin e duhur për programet e reja mësimore?,* ishin pyetjet e radhës që u diskutuan në fokus-grup me zyrtarët e MASHT-it.

Përgjigjet e pjesëmarrësve në diskutim janë të përafërta sa përket mënyrës së prezantimit të kurrikulave/programeve të reja në komuna dhe shkolla, si

²¹ Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësimdhënësve propozon, harton, zhvillon dhe monitoron zbatimin e kurrikulave për arsimin parashkollor (5-6 vjeç, përfshirë moshën parashkollore), arsimin fillor (klasat 1-5), ciklin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dhe ciklin e mesëm të lartë (klasat 10-12/13). Më gjerësisht, shih Rregulloren (QRK) - nr. 14/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17922>

dhe nivelit të informimit lidhur me to. Për pjesën e parë, përfaqësuesit nga Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve theksojnë se programet mësimore me udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës shkojnë paketë. Me gjeneratën e parë të mësimdhënësve që kanë filluar të punojnë me programe të reja mësimore, në vitin shkollor 2016/2017, janë mbajtur takime të veçanta para fillimit të trajnimit. Ndërsa, me gjeneratat tjera të mësimdhënësve prezantimi i programeve të reja mësimore është bërë në kuadër/gjatë të trajnimit të organizuar në secilën komunë. Pra, nuk janë mbajtur takime të veçanta më zyrtarët arsimorë, drejtuesit e shkollave dhe mësimdhënës në të gjitha komunat.

- *Zyra për momentin është e fokusuar vetëm në zhvillimin e programeve lëndore. Zyra ka një buxhet shumë të vogël, rreth 180 mijë euro, i cili mbulon vetëm shpenzimet e ekspertëve që i hartojnë programet. P.sh., ne kur kemi filluar pilotimin për 10 shkolla, kemi pasur buxhetin rreth 300 mijë euro, ndërsa kur ka filluar zbatimi në shkallë vendi është zvogëluar minimalisht. Zyra jonë i ka kërkuar 5 milionë euro për të siguruar zbatimin në shkallë vendi. Edhe në takimet që i bëjmë me ekspertë u duket qesharake shuma e buxhetit që është ndarë për këtë proces.*

Raportohen raste kur me iniciativë dhe kërkesë të ndonjë komune janë mbajtur takime me zyrtarë arsimorë, mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, por ato janë të pakta. Gjithashtu, nuk konfirmohet se komunat dhe shkollat janë pajisur zyrtarisht me programet e reja nga MASHT-i, ato janë vendosur në ueb-faqe zyrtare të MASHT-it dhe kopje elektronike u janë dërguar komunave.

- *Unë mendoj se shpërndarja e programeve të reja, udhëzuesve, informimi dhe trajnimi për zbatimin e kurrikulës, është dashur të shkojë paketë, së bashku, sepse mësimdhënësit nuk mund të ndjekin trajnimin nëse nuk i kanë programet dhe udhëzuesit në të njëjtën kohë.*

Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve çdo vit nga shkollat prijëse provon që të marrë informata kthyesë lidhur me zbatimin e programeve të reja mësimore, si dhe adresimin e ndonjë mangësie të identifikuar nga mësimdhënësit gjatë zbatimit të kurrikulës. Nuk raportohen

forma të tjera të analizës së zbatimit të programeve nga shkollat prijëse, që zbatojnë kurrikulën e re.

- *I kemi pyetësorët nga shkollat, i kemi informatat e koordinatorëve të fushave. Ata shprehen se për asnjë lëndë mësimore nuk ka diçka konkrete që do të mund të veçonim, si informatë kthyesë, që mund ta marrim si bazë për të rishikuar ndonjë program, janë shumë të përgjithshme, PO, JO. Programi i plotëson të gjitha kërkesat. Asnjë grup punues nuk ka mundur të nxjerrë diçka të qëndrueshme prej pyetësorëve që i kanë plotësuar mësimdhënësit.*

Nuk ka mendim të unifikuar sa i përket informimit të të gjitha komunave dhe shkollave lidhur me kurrikulat e reja lëndore/programet mësimore. Përgjithësisht, përgjigjet e zyrtarëve arsimorë në MASHT janë të shpërndara. Disa pohojnë se ka pasur informim në faza të caktuara, disa thonë se fare nuk ka pasur informim dhe se “pikërisht mungesa e informimit dhe përgatitjes së mirëfilltë ka bërë që të dëmtohet seriozisht procesi i zbatimit”.

Gjithashtu, lidhur me nivelin e informimit të zyrtarëve arsimorë në komuna, drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve, për programet e reja mësimore, raportohet se nuk mund të ndajmë një mendim, pasi që nuk kanë bërë ndonjë analizë të veçantë, por ekziston mendimi se diçka nuk është duke funksionuar, edhe pse, sipas informacioneve të komunave, shumica e mësimdhënësve janë të trajnuar për zbatimin e kurrikulës së re.

- *Në pyetjen që ju e shtruat: Sa vlerësoni se komunat dhe shkollat e kanë informacionin e duhur për programet e reja mësimore? Duhet të dihet qartë se nuk mund të ketë rezultat asnjë proces që nuk ka mekanizma të përcaktuar paraprakisht. Nuk i ka interesuar askujt dhe asnjëherë, përkundër zërit që ne kemi ngritur për vendosjen e mekanizmave mbështetës, duhet një strukturë organizative, kujt me iu drejtuar në Ministri, sa mekanizma duhet me i pasë. Pra, nuk i kemi mekanizmat për të ditur si është gjendja, nuk mundemi ne tre njerëz të zyrës me ditë a ka shkuar programi në shkollë apo nuk ka shkuar, në një fshat të thellë, a e kanë informacionin e duhur apo jo.*

- *Që tre vjet në MASHT nuk kemi planifikim sektorial lidhur me zbatimin e kurrikulës së re. Zyra nuk ka marrë iniciativa për planifikime të tilla.*
- *Zyra ka marrë iniciativa, por nuk kemi pasur përkrahje nga hierarkia në MASHT!*

Pohimet e fundit tregojnë për dallime brenda Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, lidhur me marrjen e rolit iniciues dhe koordinues në planifikimin ndërsektorial për zbatimin e kurrikulës së re, përmes së cilës do të dihej më shumë rreth përgjegjësive, bartësve të informimit të komunave dhe shkollave për programet e reja mësimore, por edhe për nevojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen shkollat.

Mbështetja profesionale për zbatimin e kurrikulës

Diskutimi me pjesëmarrësit në fokus-grup, lidhur me mbështetjen profesionale, u fokusua në ofrimin e udhëzuesve dhe doracakëve për mësimdhënës dhe në trajnimet për zbatimin e kurrikulës. Përfaqësuesit e Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, me diskutimet e tyre treguan se udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës janë rishikuar në bazë të kurrikulave lëndore/programeve mësimore të hartuara në vitin 2016. Pjesë e udhëzuesve për zbatimin e kurrikulës janë shtatë udhëzuesit për fusha kurrikulare, udhëzuesi për nivelin fillor dhe udhëzuesi për kurrikulën me zgjedhje. Udhëzuesit për disa fusha kurrikulare janë plotësuar/rishikuar gjatë procesit të zbatimit edhe në vitet vijuese. Në procesin e rishikimit të udhëzuesve në tri vitet e fundit, raportohet se Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, nuk ka pasur rol prijës, por koordinatorët e fushave që vijnë nga divizione të ndryshme në MASHT dhe jashtë MASHT-it, janë përfshirë nën udhëheqjen e zyrës së trajnimeve.

Në anën tjetër, raportohet se zyrtarë të Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT dhe të divizioneve të tjera, me mbështetjen e partnerëve të tjerë, kanë zhvilluar materiale tjera mbështetëse për shkollat dhe mësimdhënësit, që lidhen me zbatimin e kurrikulës së re.

- *Materialet tjera, që i kemi zhvilluar, janë materiale ndihmese për zbatimin e kurrikulës, një doracak për edukimin seksual, që ndërlidh tri fusha kurrikulare. Jemi në përfundim e sipër të dy doracakëve për çështje ndërkurrikulare, një për nivelin fillor dhe një për arsimin e mesëm të ulët, që lidhen me një çështje ndërkurrikulare – edukimi për paqe, por që ndihmojnë edhe çështjet tjera ndërkurrikulare. Në përgatitjen e këtyre doracakëve janë involvuar një numër i organizatave.*
- *Kemi bërë marrëveshje me UNICEF-in, për përkrahjen e shkollave në zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare dhe zhvillimin e kompetencave të ndërmarrësisë. Ekipi është formuar. Kemi punuar me Universitetin e Cyrihut, Fakultetin e Edukimit – në Kosovë dhe në Shqipëri. Materialet janë në proces – shkëmbimi i përvojave, dhe si rezultat do të dalë një publikim me përvoja.*

Zhvillimi i materialeve mbështetëse për shkollat me marrëveshje dhe udhëheqje nga partnerët që mbështesin MASHT-in duket të jetë një mundësi më e lehtë sesa procesi i brendshëm në MASHT për koordinimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re.

Mbështetja profesionale e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re apo procesi i trajnimeve është udhëhequr nga Zyra për trajnime/zhvillim profesional të mësimdhënësve, e cila me organizimin e ri në MASHT është integruar në Divizionin për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve.

Bazuar në diskutimet në fokus-grup, vihet në dukje se riorganizimi në MASHT, përkatësisht integrimi i Divizionit për ZHPM, në Divizionin për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve, akoma nuk tregon integrim të plotë në planifikim, organizim dhe raportim. Me dallime përshkruhet ky aspekt nga udhëheqja dhe zyrtarët e këtij divizioni.

- *Unë nuk u jap detyra. Ky divizion është lënë anash. Kemi bërë kërkesë në kabinet për përkrahje. Ata janë duke e bërë trajnimin. Nuk jam e sigurt. Nuk kam raporte. Bashkëpunimi është mirë. Kemi diskutuar lidhur me trajnerët, sepse disa trajnerë kanë shkaktuar huti. Ata janë në një situatë jo të mirë, ne nuk kemi marrë përgjegjësitë e tyre, sipas*

organogramit të ri. Nuk mund t'i marr përsipër statistikën për mësimdhënës, licencim.

- *Zyra për ZHPM ka rol në organizimin e trajnimit të mësimdhënësve në shkallë vendi. Ne jemi përkrahur nga Divizioni i kurrikulave lidhur me pjesën e përmbajtjes së agjendës së trajnimeve. Përkrahje tjetër kemi pasur nga komunat, ku është caktuar një koordinator për kurrikulë, i cili ka organizuar në nivel komunal, ka monitoruar dhe raportuar, pastaj në MASHT, lidhur me procesin e mbarëvajtjes.*

Sipas raportimit të Zyrës për ZHPM, numri i mësimdhënësve të trajnuar për zbatimin e kurrikulës së re është si në vijim:

Tabela 14. Numri i mësimdhënësve të trajnuar për zbatimin e kurrikulës sipas viteve

Vitet	Numri i mësimdhënësve të trajnuar për zbatimin e kurrikulës sipas viteve
2017	9300
2018	5020
2019	2500
Gjithsej	16820

Diskutimet në fokus-grup kanë ngritur probleme të shumta lidhur me cilësisë e trajnimit, me fokus të veçantë cilësinë e trajnerëve.

- *Raportet për trajnime flasin se në disa fusha trajnimet kanë qenë jociësore;*
- *Duhet një mekanizëm për ngritjen e cilësisë së trajnimeve, në mënyrë që të arrihet kurrikula;*
- *Disa shkolla kanë bërë kërkesë me shkrim për ndërrimin e trajnerëve, mirëpo nuk ka reaguar askush;*
- *Trajnimet për kurrikulë për drejtorët janë bërë ad-hok. Trajnerët janë zgjedhur pa meritë;*
- *Si MASHT kemi kërkuar të ndërtohet sistem për zhvillim profesional. Ka mungesë të debateve të brendshme;*

- *Ka probleme shumë me trajnerët, disa prej tyre kanë rënë nga testet. Mënyra e testimit nuk ka qenë e mirë.*
- *Ne konsiderojmë se trajnimet janë në nivelin e kënaqshëm, por ende mbetet përkrahje e ulët nga niveli lokal dhe qendror. Sfidë ende mbetet formimi i ekipeve profesionale në shumicën e komunave që do t'u ndihmonte mësimdhënësve për t'u takuar dhe për të tejkaluar sfidat e zbatimit të kurrikulës në praktikë.*

Si përmbledhje e të gjitha diskutimeve për mbështetjen profesionale, mund të konkludohet se zhvillimi profesional për zbatimin e kurrikulës është i përshkruar me sfida të shumta në raport me cilësinë e trajnerëve, me një masivizim të përfshirjes në trajnime në vitin 2017 dhe me mungesë të mekanizmave për të mbikëqyrur procesin e trajnimeve dhe për të ofruar mbështetje të vazhdueshme në ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve, në mënyrë që përmes tyre të përcillen informacionet relevante dhe të nevojshme për mësimdhënës.

Monitorimi i procesit të zbatimit të kurrikulës

Monitorimi i procesit të zbatimit të kurrikulës ishte temë tjetër e trajtimit në diskutimin me zyrtarët e divizioneve në MASHT, të lidhura me këtë proces. Pyetjet referuese për diskutim ishin si në vijim: Si monitorohet procesi i zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore? Cilat janë aspektet kryesore përmbajtjesore që monitorohen? Kush e bën? Çfarë raportesh vijnë në sektorin tuaj? Kush i analizon ato dhe si adresohen kërkesat/nevojat e raportuara? Si raportohet në sektorët tjerë në MASHT?

Edhe për këtë pjesë, zyrtarët e MASHT-it, përfshirë edhe përfaqësuesit e Inspektoratit të Arsimit, konkluduan se MASHT-i nuk ka ndërtuar një mekanizëm dhe instrument të qartë për monitorimin e zbatimit të kurrikulës. Informacionet sigurohen varësisht prej nevojave të sektorëve, ndërsa raportimet janë interne, vetëm për qëllime të brendshme. Në tri vitet e fundit nuk janë bërë raporte përmbledhëse me të arriturat, progresin e zbatimit të kurrikulës, sfidat dhe problemet. Kjo situatë përshkruhet si në vijim:

- *Struktura e Inspektoratit të Arsimit nuk ka divizione të ndara për monitorime, rrjedhimisht nuk ka një strukturë të veçantë për monitorimin e zbatimit të kurrikulës. Por, në kuadër të vlerësimit të performancës së shkollës dhe vlerësimit të performancës së mësimeve janë nxjerrë raporte personale ose ekipore, vendime, por nuk e di se kush i analizon dhe përpunon. Është një grup koordinues, me sa di unë, ata merren me shumë me statistika. Në DKA dhe shkollë raportojnë përmes raportit përmbledhës për individë, vendime. Nuk bëhen raporte përmbledhëse në nivel komune apo shkolle. Sepse nuk na lejon aspekti kohor dhe teknik. Përgatiten vetëm raporte individuale. Aty mbaron.*
- *Nuk ka komunikim, koordinim sa i përket monitorimit. Kjo nuk udhëhiqet nga Sekretari, nuk ka monitorim, nuk ka bashkëpunim...*
- *Monitorim copa-copa, nga organizata joqeveritare, projekte...*
- *Divizioni për arsim me nevoja të veçanta, organizon 4 takime në vit, me zyrtarët për arsim me nevoja të veçanta, diskuton për realizimin e planeve të punës, zbatimin e PIA dhe aspekteve të tjera që lidhen me mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta.*

Edhe sa i përket vlerësimit të nxënësve, diskutimet me fokus-grupe tregojnë se nga terreni vijnë informacione jozyrtare se procesi i vlerësimit të nxënësve nuk është duke ecur mirë, nuk janë lexuar mjaftueshëm dokumentet që e rregullojnë sistemin e vlerësimit të nxënësve, nuk ka vendimmarrje në interes të nxënësve, nga procesi i vlerësimit etj. Për mënyrën se si koordinohen aktivitetet e monitorimit dhe raportimit për procesin e vlerësimit të nxënësve, kështu shprehet njëri nga zyrtarët e Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve:

- *Nuk ka raporte, nuk ka bashkëpunim me Divizionin për vlerësim. Me këtë divizion/zyrë nuk kemi bashkëpunim institucional në të shumtën e rasteve. Nuk raportojnë në Divizionin për kurrikulë, lidhur me rezultatet e nxënësve, për të bërë analiza rreth kurrikulës, teksteve...*

Lidhur me monitorimin e zbatimit të kurrikulës, janë kontaktuar edhe inspektorët e arsimit që punojnë në sektorët e inspektimit të arsimit në rajone. Katër inspektorë të kontaktuar konfirmojnë faktin se nuk ka sistem të

veçantë dhe të organizuar për monitorimin e zbatimit të kurrikulës. Gjithsesi se me kapacitetet ekzistuese të inspektorëve në SIA bëhen monitorime në shkolla, të përgjithshme dhe të veçanta. Në dy-tri vitet e fundit, fokusi është vlerësimin e performancës së shkollës dhe tani në vlerësimin individual të performancës së mësimitdhënësve. Sipas vlerësimeve të inspektorëve, në aspektin formal, kurrikula e re është duke u zbatuar sipas dinamikës së paraparë nga MASHT-i, mësimitdhënësit kanë ndjekur trajnimet për zbatimin e kurrikulës së re, bëhen planifikime sipas kurrikulës së re, ka diskutime interaktive në mes të mësimitdhënësve.

Kështu përshkruhen përvojat e disa inspektorëve nga monitorimet që janë bërë për vlerësimin e performancës së shkollës apo për vlerësimin individual të performancës së mësimitdhënësve:

- *Nga 15 mësimitdhënësit që kam vlerësuar në dy fazat e para të procesit të VPM, duke marrë parasysh intervistën me mësimitdhënësit, përgatitjen e planeve të punës, si dhe monitorimin e orës mësimore, mund të them se sa u përket aspekteve strukturore të përgatitjes së planeve të punës duket se mësimitdhënësit e kanë të qartë hierarkinë, rrjedhën e rezultateve, pavarësisht se mund të ketë këtu dhe kopjime të planeve, ose planifikim në nivel të aktiveve, ku dikush mund të kontribuojë më pak, ose të mos ketë informacione të plota për kurrikulën.*
- *Sa i përket qasjes së përgjithshme, që ka të bëjë me filozofinë e KK dhe me planifikimin në përgjithësi, duket se ka një ndryshim të dukshëm. Në një mënyrë mësimitdhënësit janë koncentruar të mendojnë dhe të planifikojnë edhe përtej lëndëve të tyre. Ndoshta jo në kuptimin e mirëfilltë të diskutimit, por, megjithatë, ata po diskutojnë për rezultatet ndër-lëndore dhe ndër-fushore dhe po i marrin ato në konsideratë gjatë planifikimit, që po mundëson një qasje më të hapur të mësimitdhënies dhe që po rrit përgjegjësitë e tyre ndaj procesit mësimor.*
- *Në klasat ku zbatohet kurrikula, nxënësit janë shumë aktivë dhe kreativë.*
- *Sa u përket aspekteve metodologjike të punës së mësimitdhënësve, nuk mund të them se vërehen ndryshime të mëdha. Ose mund të themi se*

ato kanë ndodhur para zbatimit të KK, si rezultat i trajnimeve të ndryshme për metodologjitë e mësimdhënies.

- Me fillimin e zbatimit të kurrikulës së re, është rritur niveli i bashkëpunimit të mësimdhënësve, si në nivel të shkollës, ashtu edhe jashtë saj. Në disa komuna janë formuar shoqata të mësimdhënësve të lëndëve përkatëse dhe kemi shtim të përdorimit të rrjeteve sociale dhe komunikimit për fushën e kurrikulës, por ky bashkëpunim ende është i pamjaftueshëm.

Inspektorët e arsimit, referuar përvojës së tyre në monitorimin e shkollës dhe të mësimdhënësve, për proceset e vlerësimit të shkollës dhe vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, kanë evidentuar sfida dhe probleme të shumta, si:

- Një numër jo i vogël i shkollave përballen me mungesë të mjeteve të konkretizimit, mungesë të kapaciteteve të mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut, jofunksionalitet të organeve qeverisëse e profesionale, probleme me udhëheqjen e proceseve në nivel shkolle, mangësi të shumta në zbatimin e formës së re të vlerësimit të nxënësve etj.
- Problemet dhe sfidat në zbatimin e KKK, sipas mësimdhënësve, janë: “trajnerët kanë qenë jo të qartë në të kuptuarit e kërkesave të rezultatit sipas thellësisë së përmbajtjes”.
- Brengosës është edhe fakti se një numër jo i vogël i mësimdhënësve flasin për kotësinë e kurrikulës, pa ofruar as edhe një argument të vetëm, por si një retorikë e thatë vetëmbrojtëse për papunësinë e tyre. Mjaft mësimdhënës kanë fare pak njohuri për dokumentet e KK dhe fare pak janë shkëputur nga mënyra tradicionale (në kuptimin e joefektshmërisë).
- Mësimdhënësit ende janë dukshëm të orientuar me tekstin shkollor dhe mungesën e tyre e shohin si pengesë të pakapërcyeshme për zhvillimin e procesit mësimor, qoftë edhe për periudhë të shkurtër. Pra, ende nuk janë të lidhur mjaftueshëm me rezultatet e KK. Nuk duket se udhëhiqen nga filozofia dhe parimet e përgjithshme të KK-së.

- *Duke pasur parasysh mungesën e teksteve të bazuara në rezultatet e kurrikulës së re, në shkollat ku është pilotuar zbatimi i saj për shumë vite dhe për dy vite në të gjitha klasat që është implementuar zbatimi i kurrikulës së re (në klasat e treta, të teta dhe të dymbëdhjeta, edhe këtë vit shkollor) mendoj se nuk mund të shpresojmë shumë për ngritje të rezultateve në mësim. Cilësia e mësimdhënies fare pak ka avancuar, nuk ka qasje hulumtuese në mësim dhe metoda të punës që rrisin kreativitetin e mësimdhënies.*
- *Nuk mundemi të përcaktojmë me një përqindje se sa zbatohet, por ka lëshime të konsiderueshme, sidomos në zbatimin e kurrikulës me zgjedhje. Në shumicën e shkollave nuk zbatohen procedurat për përzgjedhjen e kurrikulës me zgjedhje. Përzgjedhja e lëndëve zgjedhore bëhet duke pasur si qëllim plotësimin e normave të mësimdhënësve dhe jo interesin e nxënësve.*

Evidencat e monitorimeve të inspektorëve në SIA raportohen në varësi të qëllimeve të inspektimeve në shkolla. Për vlerësim të performancës së shkollës, si dhe për vlerësim të performancës individuale të mësimdhënësve, informohen shkollat, mësimdhënësit dhe komunitat, sipas përcaktimeve ligjore. Raporte të përgjithshme dërgohen edhe në Departamentin e Inspektimit në MASHT. Mirëpo, në mungesë të një mekanizimi udhëheqës dhe koordinues për zbatimin e kurrikulës, raportet nuk shkojnë tutje, nuk analizohen dhe përpunohen, dhe nuk merren masa mbështetëse për mësimdhënësit dhe shkolla për të siguruar zbatim të suksesshëm. Natyrisht, kjo, sipas inspektorëve të arsimit, ka përjashtime kur kërkohen zyrtarisht raportet nga divizionet përkatëse në MASHT, ose kur ka devijime në raport me përcaktimet ligjore, për të cilat ngrihen procedurat e verifikimit dhe të marrjes së masave në varësi të rasteve, kontekstit të problemeve.

Arritjet, sfidat dhe problemet kryesore

Arritjet për zbatimin e kurrikulës së re zyrtarët e divizioneve përfaqësuese në takim i ndërlidhin me shtrirjen e zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat, sipas dinamikës së planifikuar, realizimin e planeve dinamike brenda secilit sektor – sipas përgjegjësive që kanë me përshkrim të detyrave

të punës, me përfshirjen e mësimeve në trajnimet e organizuara nga MASHT-i për zbatimin e kurrikulës, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimeve etj.

- *Ne vlerësojmë arritje të lartë faktin që për këto vite kemi arritur t'i zhvillojmë programet për të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha klasat që janë pjesë e zbatimit të kurrikulës së re.*

Në anën tjetër, zyrtarët e divizioneve përfaqësuese në takim, bazuar në përvojën e tyre gjatë këtyre viteve, kontakteve që kanë me hartues të programeve, drejtues të shkollave dhe mësimeve, listojnë disa probleme të natyrave të ndryshme, me të cilat vazhdojnë të sfidohen reforma kurrikulare dhe zbatimi i saj në punën me nxënës. Janë ballafaquar dhe vazhdojnë të ballafaqohen me procesin e zbatimit të kurrikulës së re, të cilat, në masë të madhe, kanë ndikuar në humbjen e besimit në këtë reformë. Ato lidhen me:

- mungesën e përkushtimit të MASHT-it, politikës udhëheqëse, për të marrë udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, për të siguruar buxhet të mjaftueshëm për gjithë procesin e zbatimit të reformës kurrikulare, si dhe ngritje të kapaciteteve të brendshme për të udhëhequr këtë reformë;
- mungesën e bashkëpunimit ndërsektorial për zbatim të kurrikulës, mungesën e mekanizmave mbështetës, monitorues dhe të raportimit për arritjet, sfidat dhe nevojat për shkolla dhe mësimeve;
- mungesën e përfshirjes në hartimin e disa politikave arsimore, të lidhura me kurrikulën e re, si UA për aktivet profesionale, UA për koordinatore të cilësisë etj.
- zhvillimin e programeve të komuniteteve nga vetë komunitetet, pa një mbikëqyrje të MASHT-it, kjo pastaj do të reflektohet në vlerësimin e nxënësve të komuniteteve, me dallime në rezultate të të nxënësve, përmbajtje etj.
- zbatimin e sistemit të vlerësimit sipas kërkesave të kurrikulës së re;
- mungesën e kapaciteteve në nivel komune dhe shkolle për t'i udhëhequr ndryshimet, siç kërkohet me kurrikulën e re;

- mungesën e kapaciteteve të inspektorëve të arsimit për të mbikëqyrur zbatimin e kurrikulës në të gjitha shkollat;
- mungesën e teksteve shkollore të harmonizuara me kurrikulën e re;
- mungesën e një praktike të organizuar në nivel të DKA-ve dhe shkollave për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për mësimdhënës;
- mungesën e mjeteve të nevojshme të konkretizimit dhe pajisjeve të TIK-ut për të përdorur burime të tjera mësimore etj.

Nisur nga këndvështrimi i zyrtarëve arsimorë në MASHT, pjesa më e madhe e sfidave dhe problemeve që lidhen me zbatimin e kurrikulës i referohen sistemit organizativ dhe udhëheqës në nivel të mekanizmave të MASHT-it, por edhe të niveleve tjera arsimore që lidhen me zbatimin e reformës kurrikulare.

Parashikimi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj

Zyrtarët arsimorë në MASHT, të divizioneve përfaqësuese në diskutimin e organizuar, janë të ndarë sa u përket pritjeve dhe parashikimeve të tyre për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj. Një pjesë e tyre janë optimistë se gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur.

- *Hapja e komunikimit në mes të mësimdhënësve ka qenë pozitive. Presim që kjo të vazhdojë edhe në vitet në vijim;*
- *Të paktën mendojmë se është rritur bashkëpunimi dhe do të vazhdojë të rritet;*
- *Shtrirja e zbatimit të kurrikulës është bërë sipas planit, presim që kjo të vazhdojë njëjtë edhe në klasat tjera.*

Ndërsa, në mesin e zyrtarëve të Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve reflektohet një masë pesimizmi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj dhe një masë e vetëkritikës që nuk kanë reaguar më herët që të ndalet procesi i reformës kurrikulare.

- *Nuk mund të këtë sukses kur i gjithë sistemi është hallakamë, nuk funksion asnjë sektor, ka mbetur në dorë të Zotit, ndonjë*

mësimdhënësi, ndonjë drejtori që punon me zemër. Nuk kemi sistem të organizuar për të pasur parashikime pozitive.

- *Është dashur ta ndalim në fillim këtë proces.*

Vendosja e një strukture përgjegjëse në MASHT, krijimi i strukturave në nivel komunal, për mbikëqyrje, monitorim dhe mbështetje të mësimdhënësve, si dhe themelimi i Agjencisë për kurrikula, shihen si masa kryesore për të vënë në binarë të duhur procesin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë.

4.2.1.5. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare për zbatimin e kurrikulës

Qëllimi i përfshirjes së njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare në këtë studim ishte të pasurohet hulumtimi edhe nga perspektiva e jashtme, nga subjektet që në faza të caktuara kanë qenë pjesë e procesit në zhvillimin e kurrikulës dhe të udhëzuesve për zbatimin e kurrikulës, apo që kanë qenë pjesë e monitorimit. Rezultatet mbi mendimet/pikëpamjet e njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare, lidhur me udhëheqjen e reformës kurrikulare, rolin e bartësve, zbatimin e kurrikulës, zhvillimin profesional dhe parashikimin për të ardhmen, janë produkt i analizës së pyetësorit dhe intervistave gjysmë të strukturuar, të realizuara me gjashtë njohës të arsimit dhe të reformës kurrikulare. Përgjigjet e tyre janë përmbledhur në nëntema të veçanta, të ndërlidhura pyetjet e diskutuara me këtë grup të respondentëve, siç prezantohet në pjesën më poshtë.

Udhëheqja e reformës kurrikulare - zbatimit të kurrikulës

Të gjithë njohësit e arsimit të përfshirë në këtë hulumtim raportuan se kanë pasur rol në faza të ndryshme të reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar në Kosovë, përkatësisht hartimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca. Rolet kanë qenë të ndryshme, si pjesë e ekipit teknik për hartimin e Kornizës Kurrikulare, konsulentë të jashtëm të angazhuar nga projekti EU SWAP për të përkrahur grupin e ekspertëve të MASHT-it,

bashkëpunëtorë të jashtëm të angazhuar nga MASHT-i, pjesë e ekipeve në monitorim në zbatim të reformës, anëtarë të grupeve punuese etj.

Respondentët që ishin pjesë e hulumtimit kanë pasur role dhe angazhime të ndryshme, me ndërprerje dhe kohëzgjatje të ndryshme, në varësi të angazhimeve nga MASHT-i dhe partnerët mbështetës.

Lidhur me diskutimet në pyetjen *si e vlerësoni kurrikulën e re në krahasim me kurrikulën paraprake, të bazuar në përmbajtje dhe objektiva mësimore?*, kemi marrë përgjigje me nuanca të ndryshme të dallimeve. Dominojnë mendimet se kurrikula e re është shumë më e avancuar, është në harmoni me trendin e zhvillimit të arsimit/edukimit në vendet evropiane. Parimet kryesore të kurrikulës së re, në veçanti kompetencat dhe mësimi i integruar, vlerësohen të jenë baza të mira për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit dhe për zhvillimin e duhur të fëmijëve për nevojat e shekullit të ri.

Qasja e bazuar në kompetenca është tendencë e kohës dhe në përputhje me rekomandimin e BE-së për zhvillimin e kompetencave për mësim gjatë gjithë jetës. Zgjidhjet e propozuara me Kornizën Kurrikulare sigurojnë ngritjen e cilësisë në arsim, duke adresuar sfidat kryesore të sistemit arsimor në Kosovë.

Kalimi nga mësimdhënia e bazuar në përmbajtje dhe objektiva në mësimdhënie, e drejtuar me në qendër nxënësin, për të ofruar mundësi dhe mbështetje në zhvillim të kompetencave dhe arritje të rezultateve të të nxënit – është ndryshimi kryesor dhe thelbësor i kurrikulës së re. Kurrikula e bazuar në kompetenca, kurrikula e re, promovon të mësuarit për të bërë dhe për të zgjidhur problemet me mençuri – për dallim nga të mësuarit për të mbajtur në mend dhe përsëritur njohuritë e fituara.

Në mesin e respondentëve ka edhe mospajtueshmëri të argumentuar lidhur me trajtimin që shpesh i bëhet dokumentit të kurrikulës së vjetër.

Nuk pajtohem plotësisht se dokumenti i kurrikulës së vjetër ka pasur synim mësimdhënien e orientuar në përmbajtje dhe objektiva, pasi që në atë dokument janë po ashtu edhe rezultatet e pritura. Ideja e mësimdhënies së bazuar në rezultate mësimore ka

rrjedhur nga kurrikula e vjetër. Ajo që e veçon kurrikulën e re është orientimi në zhvillim të kompetencave...

Gjithashtu, në mesin e respondentëve, ka edhe mendime që reflektojnë avancimin e kurrikulës së re dhe njëkohësisht japin mendimin se edhe kurrikula e re ka mangësi përmbajtjesore.

Avancim kundrejt së kaluarës, mirëpo me mangësi përmbajtjesore po ashtu.

Në anën tjetër, rezultatet tregojnë përputhshmëri në mendime në mes të njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare, lidhur me mënyrën se si është udhëhequr reforma kurrikulare në Kosovë. Ekziston mendimi i argumentuar se ka munguar përkushtimi i MASHT-it për përgatitjen e sistemit dhe sforcimin e mekanizmave për reformën kurrikulare, reforma kurrikulare nuk është udhëhequr dhe nuk është duke u udhëhequr nga bartësit kryesorë dhe personat përgjegjës në MASHT.

Është udhëhequr me një mendësi centralizmi. Ndryshimi i praktikës paraprihet nga evoluimi i mendësisë për aktivitetin e caktuar. Në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur.

Udhëheqja e reformës kurrikulare në Kosovë lë për të dëshiruar. Mendoj se një proces kaq i rëndësishëm për arsimin e Kosovës nuk ka qenë prioritet për Qeverinë dhe për udhëheqësit e procesit...

Reformën kurrikulare e kanë udhëhequr në masë të madhe njerëz që as vetë nuk e kanë njohur qasjen e bazuar në kompetenca. Domethënë, ne kemi mësuar për qasjen e bazuar në kompetenca paralelisht me zbatimin e saj në shkollë...

Në tërësi proces i përfunduar në improvizim, keq, dhe mosmenaxhim nga MASHT-i dhe hisedarët e tjerë.

Komunikimi me shkollat/mësimdhënësit është bërë “përmes dokumenteve” dhe jo përmes takimeve e bisedave praktike në komuna/shkolla, nën udhëheqje të bartësve nga MASHT-i, koordinatorët e fushave kurrikulare, trajnerët dhe zyrtarët e DKA-ve. Pra, nga çfarë po dëgjoj në takimet me DKA dhe shkolla,

*mësimdhënësit janë vetëm dhe shpesh të hutuar se si të veprohet
më tutje kur procesi nuk ka drejtim të duhur.*

Argumentet e njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare, për dështime në udhëheqjen e procesit të reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj në praktikë, ilustrohen si në vijim:

- ka filluar hartimi i kurrikulës (në vitin 2009) pa e vlerësuar mirë gjendjen me kurrikulën e atëhershme;
- janë bërë plane ambicioze për hartimin e kornizës dhe të kurrikulës re pa e pasur ekspertizën dhe kapacitetet e duhura (përfshirë ato institucionale);
- është vonuar fillimi i zbatimit, pastaj procesi me pilotim të stërzgatur;
- Fakultetet e Edukimit, që përgatisin mësimdhënës, kanë filluar t'u përshtaten, apo u janë përshtatur kurrikulave me rreth pesë vjet vonesë - në vend se t'u paraprijnë atyre;
- ndryshimet infrastrukturore janë një fushë tjetër e vendimeve të gabuara politike.
- asnjë ndryshim nuk është bërë në furnizimin e shkollave me mjete materiale për të përcjellë natyrën e ndryshimeve të kurrikulës së re;
- asnjë ndryshim nuk është bërë në infrastrukturën e brendshme për të përcjellë infrastrukturën e re (kur dihet se kurrikula e re për shembull ngërthen shumë më shumë bashkëpunim në mes të mësimdhënësve);
- mospërgatitja e teksteve shkollore në harmoni me kërkesat e kurrikulës së re, kur të gjithë e dimë se teksti shkollor është për nxënës, por në traditën e punës së mësimdhënësve ka qenë dokumenti bazë i orientimit për punën në klasë;
- mosfunksionalizimi i mekanizmave mbështetës, problemet në vendosjen e koordinatorëve të cilësisë etj.;
- gabim tjetër strategjik është struktura e trajnerëve të kurrikulës. Ata nuk janë trajnuar mirë dhe e kanë përcjellë një mesazh dhe diskurs të gabuar për kurrikulën e re të mësimdhënësit dhe të shkollat.

Nisur nga argumentet e lartcekura, kjo mund të pohohet se zbatimi i reformës kurrikulare në Kosovë është sfiduar në masë të madhe nga mënyra e udhëheqjes dhe nga fakti se pothuajse shkollat kanë mbetur të vetme në

udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, pa mbështetje profesionale të konsoliduar dhe të vazhdueshme.

Informimi dhe konsultimet

Informimi dhe konsultimet e ofruara nga MASHT-i për DKA-të, drejtorët e shkollave dhe mësime të mësimdhënësve, gjatë fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore në shkallë vendi, ishte një temë tjetër e diskutuar me njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare. Përgjigjet e tyre janë të shpërndara. Disa pohojnë se ka pasur informim në fazë të caktuar, disa thonë se fare nuk ka pasur informim dhe se pikërisht mungesa e informimit dhe përgatitjes së mirëfilltë ka bërë që të dëmtohet seriozisht procesi i zbatimit. Kështu përshkruhet procesi i informimit dhe konsultimeve për përgatitjet dhe fillimin e zbatimit të programeve të reja mësimore në shkallë vendi:

Ka pasur në fazë të caktuar. Për mendimin tim dhe nga çfarë më kanë thënë në DKA, drejtorë e mësime të mësimdhënësve, vetëm fazë a parë me 10 shkollë, e deri diku edhe fazë e shtrirjen në 70+ shkollë tjera, ka pasur konsultime e mbështetje të mirëfilltë. Pastaj çdo gjë (informimi, komunikimi e mbështetja) është fuzionuar në një 'trajnim 5-6 ditë' – gjë që as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat/nevojat e mësime të mësimdhënësve dhe shkollave.

Informim mendoj se ka pasur, por informimi dhe konsultimet kanë qenë joadekuate (improvizuese) dhe të painformuara mirë.

Ka pasur konsultime informative, mirëpo ato nuk janë të mjaftueshme. Edhe sot pas sa vjetësh, mendoj se DKA dhe shumica e drejtorëve të shkollave nuk e kanë të qartë procesin. Trajnimet e para është dashur të mbahen për zyrtarët e DKA-së dhe për drejtorët e shkollave, pastaj me mësime të mësimdhënësve. Si mund të menaxhohet apo udhëhiqet një proces kaq i rëndësishëm nëse nuk kuptohet mirë.

Procesi i informimit dhe konsultimit ka çaluar në cilësinë e tyre. Informimi, konsultimi, përcjellja, jo rrallë janë zhvilluar nga

individë që kanë pasur pasaktësi dhe paqartësi në vetvete për kurrikulën e re dhe programet e reja.

Aspak, janë pikërisht mungesa e informimit dhe përgatitja jo e mirëfilltë që kanë shpirë në dështim në zbatim.

Si konkluzion i këtyre përgjigjeve, mund të pohohet se informimi dhe konsultimet kanë qenë të pakta dhe shpesh jopërmbajtjesore.

Pranimi apo refuzimi i kurrikulës së re

Ekziston mendimi se kurrikula e re nuk mund të zbatohet në shkolla nëse mësimdhënësit nuk e kanë të qartë ndryshimin kryesor që sjell ajo dhe nëse nuk i kuptojnë dhe pranojnë parimet kryesore të definuara me kornizën kurrikulare. Prandaj, është nxitur diskutimi lidhur me pranimin/refuzimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca nga ana e mësimdhënësve. Përgjithësisht të njohësit e arsimit të përfshirë në këtë hulumtim ekziston mendimi se ka mësimdhënës që e kanë pranuar shumë mirë kurrikulën e re dhe punojnë me përkushtim për ta zbatuar atë. Mirëpo, një pjesë relativisht e madhe e mësimdhënësve, sipas tyre, nuk e kanë pritur mirë kurrikulën e re, nuk e shohin si të tyre, në forma direkte dhe indirekte e refuzojnë, për shkak të komunikimit dhe qasjes së gabuar në udhëheqjen e procesit të zbatimit.

Njëri nga njohësit e arsimit dhe reformës kurrikulare, duke iu referuar kontakteve dhe diskutimeve me mësimdhënës, si dhe duke përcjellë zhvillimet rreth zbatimit të kurrikulës, shprehet se elementet kryesore të zbatimit: informimi, komunikimi dhe trajnimet e ofruara, kanë siguruar dezinformim dhe frikësim të mësimdhënësve. Kjo ka gjetur ‘truall’ të përshtatshëm në mendësinë improvizuese në shkollat tona dhe – unë besoj – kjo ka çuar te dështimi në masë të madhe i kurrikulës së re (me pasoja për shumë gjenerata). Ilustrim i miteve/shablloneve të krijuara si rezultat i zbatimit të gabuar:

1. “Planifikimi i tepërt dhe i panevojshëm”: Kohët e fundit është shpërndarë një mit te mësimdhënësit se kurrikula e re kërkon sasi

të madhe e të panevojshme të planifikimit!!! Po të flasësh me mësimmhënësit – shumica e thonë këtë. Kjo ndodh sepse më së lehti sjell një situatë kur mësimmhënësit të refuzojnë këtë segment thelbësor të kurrikulës së re. Kjo ndodh sepse mësimmhënësve nuk u janë shpjeguar përparësitë e planifikimit të mirëfilltë dhe bashkëpunues.

2. “Kurrikulat e reja janë të ndërlikuara”: mësimmhënësit ankohen se kurrikula e re është e komplikuar dhe se është vështirë të punohet duke u bazuar vetëm në kompetenca dhe në rezultate. Gjithsesi, ajo është e komplikuar, sepse as trajnerët nuk i kuptojnë udhëzuesin përkatës dhe kurrikulat bërthamë.

3. “Administrata e tepërt” me dokumentacion pedagogjik. Ankesat bazohen në faktin se duhet tepër angazhim për të evidentuar punën me nxënës. Njësoj thuhet edhe për vlerësimin tepër strikt dhe që e shkel pavarësinë e mësimmhënësve “pasi që nuk lejon mundësi për fleksibilitet.

Mendime të përafërta shfaqin edhe njohësit tjerë të arsimit:

Mendoj se ka mësimmhënës që e kanë pranuar shumë mirë dhe me entuziazëm procesin e zbatimit të KKK-së, por, sipas asaj që shihet çdo ditë, ata dalëngadalë do të humbin ambicien, vullnetin dhe durimin, sepse rrethohen me shumicën e mësimmhënësve që e refuzojnë procesin. Ata që e refuzojnë procesin kanë prirje edhe t'i injorojnë ata që punojnë me përkushtim dhe t'i anashkalojnë. Në këtë mënyrë ata zbehin punën e "punëtorëve".

Është shumë e ndjeshme, një frustrim nga ana e mësimmhënësve për zbatimin e kurrikulës. Dyshimet personale të tyre në të kuptuarit e koncepteve të kurrikulës, qëndrimet e ndryshme të aktorëve të ndryshëm për të njëjtat çështje të kurrikulës, në mjaft raste cilësia e trajnimeve të ofruara, mungesa e materialeve shoqëruese dhe së fundi edhe vlerësimi i performancës ka bërë që mësimmhënësit të ndihen të pasigurt në punën e tyre. Periudhën e fundit, praktikat e tyre të punës po ndikojnë që mësimmhënësit më

shumë të shqetësohen për ‘dosjet’ e tyre dhe plotësimin e punës administrative sesa për nxënësit.

Në situatën kur shkollat/mësimdhënësit janë lënë vetëm të përballen me procesin vetëm me atë çfarë e kanë të shkruar në plane dhe programe, çfarë u thuhet shkurt dhe shpejt në 5-6 ditë trajnim, pa tekste adekuate e materiale mësimore përkatëse, pa komunikim të rregullt me bartësit e procesit – pranimi/refuzimi është gjithsesi i pranishëm.

Një tjetër njohës i arsimit dhe i reformës kurrikulare, duke iu referuar përvojës në disa procese të monitorimit në shkolla, shprehet se:

Reagimi i komunitetit të mësimdhënësve do të duhej të ishte më i madh kundrejt mospërkrahjes në zbatim. Kurrikula është pranuar si e mirëqenë, mirëpo është vetëm pas fillimit të zbatimit të saj, që mësimdhënësit i kanë kuptuar vështirësitë.

Si konkluzion i këtyre përgjigjeve, mund të pohohet se në komunitetin e mësimdhënësve ekziston luhatje në pranimin e kurrikulës së re, refuzimi nga brenda është shfaqur te një pjesë e madhe e mësimdhënësve. Kjo në masë të madhe ndikon në praktikën e punës me nxënës dhe pengon zbatimin e suksesshëm të kurrikulës.

Roli i bartësve kryesorë në zbatimin e kurrikulës së re

Rezultatet tregojnë përputhshmëri në mendime të respondentëve, në këtë pjesë të hulumtimit, se roli i MASHT-it është i qartë – ata janë bartësit. Nuk ka çfarë të ndryshohet për të qartësuar më shumë rolin e tyre. Problemi qëndron në konsolidimin e strukturave brenda MASHT-it, në harmonizimin dhe bashkërendimin e të gjitha veprimeve në funksion të reformës kurrikulare, në definimin e përgjegjësive të ndërlidhura me sektorët tjerë lidhur me këtë proces të ndjeshëm dhe kompleks. Kjo përbën thelbin e problemit. Problemi i dytë lidhet me kapacitetet në MASHT për të përmbushur rolin që ka në udhëheqjen e proceseve që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

MASHT-i duhet ta kuptojë së pari kurrikulën në thelb dhe pastaj të organizojë një qasje sistematike për zbatimin e saj. Reforma kurrikulare dhe zbatimi i saj duhet të kuptohen si zemra e angazhimit të MASHT-it. Zbatimi i KKK-së nuk është vetëm çështje e sektorit të kurrikulës. Kjo qasje sistematike ka munguar në vazhdimësi...

Mendime të përafërta pasqyrohen edhe lidhur me rolin e Inspektoratit të Arsimit dhe DKA-ve lidhur me zbatimin e kurrikulës së re. Roli i tyre dhe detyrat deri diku janë të përshkruara në legjislacion dhe në akte nënligjore, mirëpo në raport me procesin e zbatimit të reformës kurrikulare ato nuk janë definuar qartë. Edhe për pjesën e roleve që dihen problemi qëndron te mosmarrja e rolit, qoftë mbikëqyrës, mbështetës apo udhëheqës.

Pjesa më e madhe e DKA-ve nuk e ushtrojnë rolin e tyre mbështetës dhe udhëheqës në disa segmente që lidhen me zbatimin e kurrikulës. Megjithatë, ka shembuj të mirë nga disa komuna në Kosovë.

DKA-të më shumë merren me mbledhjen e mungesave, me shpalljen e konkurseve për punësim dhe me blerje të shkurtesave dhe aspektet e tjera logjistike..

Unë nuk shoh rol të Inspektoratit në sigurim të cilësisë, as në zbatim të kurrikulës – madje as në monitorimin e punës së mësimdhënësve.

Pa një definim të qartë të rolit dhe përgjegjësi, si dhe pa një sistem të llogaridhënies, nuk mund të pritët zbatim i suksesshëm i reformës kurrikulare, apo, siç shprehet njëri nga njohësit e arsimit, “mungesa e llogaridhënies krijon terren për produkt jocilësor të punës”.

Në anën tjetër, në nënpyetjen se *çfarë mund/duhet të bëjnë bartësit e kurrikulës më ndryshe për të siguruar zbatim të suksesshëm të reformës kurrikulare*, kemi orientime dhe propozime gjithëpërfshirëse nga të gjithë respondentët. Ekziston mendim i përgjithshëm se duhet të konsolidohen strukturat brenda MASHT-it, Inspektoratit të Arsimit dhe DKA-ve.

MASHT-i fillimisht duhet t'i konsolidojë strukturat brenda (duke kompletuar kuadrin e nevojshëm për mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e nevojshme në zbatimin e kurrikulës, me theks të veçantë në divizionin e kurrikulës dhe teksteve shkollore), si dhe t'i harmonizojë dhe bashkërendojë të gjitha veprimet në funksion të reformës kurrikulare.

MASHT-i duhet të krijojë mekanizmat përkatës për të jetësuar rolin e tyre dhe për të udhëhequr procesin përmes ekipeve profesionale..., komunikimit të rregullt mujor me shkollat e komunat; ekipeve në nivel DKA (të themeluar bashkë me MASHT-in, duke përfshirë drejtorë e mësimdhënës); konferencave vjetore për të gjithë mësimdhënësit në formën e “praktikat më të mira për zbatim të kurrikulës së re”.

DKA-ja duhet të reformohet tërësisht dhe duhet rishikuar rolin dhe kapacitetet e tyre nga fillimi... DKA-ja duhet të ndërtojë më shumë kapacitete dhe të marrë përgjegjësi në drejtim të sigurimit të cilësisë.

Inspektorët duhet siguruar që gjatë zbatimit të procesit për VPM – të ofrojnë dëshmi dhe të dhëna nga përvojat e mësimdhënësve, të cilët i nënshtrohen procesit të VPM, për përvojat, rezultatet, sfidat gjatë procesit të zbatimit të kurrikulës së re. Konkretisht, formulari “Planifikimi dhe përgatitja me shkrim”, të cilin inspektorët e kërkojnë nga mësimdhënësit duhet të shërbejë si dokument bazë për të ofruar dëshmi për përvojat e mësimdhënësve gjatë punës së klasës. Gjetjet dhe analizat e këtyre formularëve Inspektorati duhet t'i ndajë me MASHT-in, DKA-në dhe shkolla në mënyrë që procesi i zbatimit të kurrikulës të përmirësohet në vazhdimësi.

Edhe sa i përket rolit të drejtorëve të shkollave dhe udhëheqësve të aktiveve profesionale (AP) në zbatimin e kurrikulës së re, ekziston mendimi se kuadri ligjor dhe udhëzimet janë shkruar dhe plotësuar në vazhdimësi. Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle është detyrë kryesore e drejtorëve të shkollave dhe udhëheqësve të AP. Mirëpo, si gjatë përgatitjeve për fillimin e zbatimit të kurrikulës, ashtu edhe gjatë zbatimit të saj në këto

dy vitet e shtrirjes në të gjitha shkollat e Kosovës, raportohet se ka munguar mbikëqyrja e drejtorëve, menaxhmentit të mesëm, por edhe e mësimdhënësve, lidhur me shkallën e zbatimit të detyrave që ata kanë – zbatimin e kurrikulës (planeve dhe programeve).

Njëri nga njohësit e arsimit nuk pajtohet se është qartësuar mirë roli i drejtorëve të shkollave në zbatimin e kurrikulës:

Nuk besoj që është i qartë roli i tyre tash, në rend të parë, sepse përshkrimi i detyrave të tyre është shumë “gjithëpërfshirës” (gjithçka dhe asgjë) dhe se rutinat e krijuara shkojnë kah një rol marginal i drejtorit i tipit të një koordinatori, e jo të një menaxheri akademik e administrativ. Pozita e drejtorit është thelbësore, por as për së afërmi nuk i ka autorizimet, përgjegjësitë, përkrahjen, e as përgatitjet për një funksion të tillë.

Pjesa më e madhe e njohësve të arsimit, pjesëmarrës në këtë hulumtim, shprehin mendimin se drejtorët dhe kryetarët e AP, jo të gjithë, janë të trajnuar për zbatim të kurrikulës dhe për udhëheqje të këtij procesi. Kjo tregon, siç shprehet njëri nga njohësit e arsimit, se:

me zbritjen nga hierarkia këto role veniten dhe reflektohen fuqishëm, sidomos tek mësimdhënësit, të cilët duhet të zbatojnë diçka që ende nuk e kanë procesuar, kuptuar dhe bërë pjesë të filozofisë së tyre të mësimdhënies. Nxënësit janë kthyer në ‘shërbëtorë’ të mësimdhënësve, modeleve, formateve, kërkesave.

Edhe sa i përket nënpyetjes se *çfarë mund/duhet të bëjnë më ndryshe drejtorët e shkollave dhe kryetarët e AP për të siguruar zbatim të suksesshëm të reformës kurrikulare*, kemi orientime dhe propozime që kryesisht i referohen definimit të qartë – shumë specifik, të rolit të tyre për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, monitorimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të mësimdhënësve etj. Gjithashtu, përveç ngritjes së kapaciteteve të drejtorëve dhe kryetarëve të AP, aktivizimi i AP në nivel shkolle dhe komune shihet si mundësia më e mirë për të mbështetur zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle/klase.

Bazuar në mendimet e njohësve të proceseve arsimore, lidhur me rolin e bartësve kryesorë në zbatimin e kurrikulës së re, mund të konkludohet (MASHT, Inspektorati i Arsimit, DKA dhe shkolla) se moskompletimi i kuadrit të nevojshëm për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, mbikëqyrjen e procesit dhe mosdefinimi i qartë i roleve të hisedarëve në këtë proces, ka sfiduar dhe vazhdon të sfidojë zbatimin me sukses të kurrikulës. Prandaj, është i domosdoshëm konsolidimi dhe qartësimi i roleve, detyrave dhe përgjegjësiave për të gjithë hisedarët, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re. Pa e bërë këtë improvizimi do të dominojë mbi procesin e suksesshëm të reformës.

Zhvillimi profesional

Për sa i përket përgatitjes akademike dhe zhvillimit profesional që kanë bartësit e procesit të zhvillimit të kurrikulës dhe udhëheqësit arsimorë në nivel qendror, komunal, dhe në nivel shkolle, për të udhëhequr, mbikëqyrë dhe përkrahur shkollat dhe mësimdhënësit në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, përgjigjet e njohësve të arsimit janë të shpërndara. Nga ata që mendojnë që deri diku ekziston përgatitje bazike akademike dhe profesionale e bartësve të këtij procesi për të udhëhequr, mbikëqyrur dhe përkrahur shkollat dhe mësimdhënësit në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe të grupit tjetër që pohojnë JO, bartësit e këtij procesi nuk e kanë përgatitjen e duhur akademike dhe profesionale. Përgjigjet e grupit të dytë më shumë u referohen personave politikë.

Në anën tjetër, ekziston përputhje e plotë e mendimeve se nevojitet konsolidim i strukturave përkatëse dhe ngritje e mëtejme e kapacitetit të bartësve të procesit të zbatimit të kurrikulës.

Sa u përket drejtuesve të shkollave dhe mësimdhënësve, njohësit e arsimit pohojnë se këta do të duhej të kenë përgatitjen e duhur akademike dhe profesionale për ta udhëhequr dhe zbatuar kurrikulën në nivel shkolle/klasë. Mirëpo, praktika, sipas tyre, po tregon se ka mungesë të kapaciteteve, përkundër ofrimit të trajnimeve nga shumë partnerë që mbështesin arsimin, por edhe nga vetë MASHT-i dhe DKA-të.

Sipas njohësve të arsimit, mënyra e zgjedhjes së drejtorëve dhe cilësia e trajnimeve të zhvilluara (vetëm disa prej tyre me proces monitorimi dhe vlerësimi, takime përcjellëse) kanë ndikuar që kapacitetet e drejtorëve të shkollave për zbatimin e kurrikulës të jenë të limituara dhe shpesh kanë ndikuar që shumë procese në shkolla të zbehen apo dështojnë. Sa i përket përgatitjes së mësimeve për zbatimin e kurrikulës, ka një mendim të unifikuar se është krijuar një kapacitet solid, përkundër shumë problemeve të lidhura me kualifikimin e mësimeve, dhe se mungon përkrahja materiale, financiare, infrastrukturore dhe një sistem i llogaridhënies, për zbatim me sukses të kurrikulës. Referuar trajnimeve për kurrikulë, njëri nga njohësit e arsimit shprehet kështu:

Mendoj se mësimeve e kanë pasur përgatitjen e duhur derisa programi i trajnimit ka qenë 10+ ditë. Kanë pasur përgatitje, mbështetje dhe kohë të mjaftueshme për të përkrahur mësimeve në shkolla. Nuk mendoj se e kanë tani, sepse në ekipe të trajnerëve të sotëm ka mësimeve që nuk janë duke zbatuar kurrikulën në klasat/shkollat e tyre.

Njohësit e arsimit sugjerojnë që zhvillimi profesional për zbatimin e kurrikulës duhet të ndryshojë, sepse trajnimet disaditore nuk e garantojnë suksesin e zbatimit të kurrikulës. Sipas njërit nga njohësit e arsimit:

Udhëheqja dhe planifikimi për zbatim të kurrikulës së re janë temat kryesore që duhet trajnuar në programe trajnimi. Planifikimi për zbatim, program më specifik e praktik për mësimeve, duhet të përfshijë: të kuptuarit e konceptit dhe filozofisë së re, dallimi nga ajo ekzistuese, format e mënyrat e planifikimit dhe zbatimit, përgatitja dhe shfrytëzimi i teksteve dhe materialeve mësimore, format dhe teknikat e ndryshme të vlerësimit, reflektimi individual dhe plani për përmirësim.

Edhe njohësit e tjerë mbështesin përfshirjen e këtyre temave në programet e zhvillimit profesional për zbatimin e kurrikulës. Një nga njohësit e arsimit shprehet se zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i nevojshëm dhe kjo duhet të bëhet me bazë në shkollë.

Si përmbledhje e të gjitha përgjigjeve, mund të themi se zhvillimi profesional për zbatimin e kurrikulës duhet të ndryshojë, nevojitet mbështetje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme për mësimdhënës dhe bartësit e tjerë të këtij procesi, në mënyrë që të sigurohet zbatim i suksesshëm i kurrikulës.

Zbatimi i autonomisë së shkollës

Zbatimi i autonomisë së shkollës, i paraparë me kurrikulën e re, ishte një temë tjetër e diskutuar me njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare. Rezultatet tregojnë përputhshmëri në mendime se kurrikula e re, në masë të madhe, përcakton autonominë e shkollës, e cila me zhvillimin e programeve specifike për lëndë mësimore ka humbur një pjesë të madhe të idesë fillestare me kurrikulën e re. Pavarësisht ndryshimeve, sipas njërës nga njohësit e arsimit, *shkolla ka mundësi për të riorganizuar dhe mobilizuar ekipet në nivel shkolle, për të planifikuar dhe përshtatur format dhe modelet e zbatimit të kurrikulës bazuar në nevojat e nxënësve dhe mundësitë/kapacitetet e mësimdhënësve, si dhe ka mundësi të zhvillojë vetë kurrikulat me zgjedhje për secilën klasë.*

Gjithashtu, rezultatet tregojnë përputhshmëri në mendime edhe sa i përket shfrytëzimit/zbatimit të autonomisë që ka shkolla me kurrikulën e re. Pothuajse të gjithë pajtohen se autonomia e shkollës nuk zbatohet sa dhe si duhet. Sipas tyre, qëndrojnë dy shpjegime se pse nuk është duke u zbatuar sa dhe si duhet autonomia e shkollës. E para, ka të bëjë me vetë shkollën, një numër i shkollave nuk kanë gatishmëri dhe vullnet për t'iu qasur ndryshimeve dhe shfrytëzimit të autonomisë që kanë:

Nuk shfrytëzohet autonomia e shkollës, pasi që mendoj u nxjerrë më shumë telashe mësimdhënësve, sepse kërkohet punë dhe përkushtim për planifikim të shfrytëzimit të autonomisë. Është për të ardhur keq, por më lehtë i duam gjërat e prera se të mendojmë e të planifikojmë vetë për to.

E dyta, ka të bëjë me mungesën e mbështetjes nga DKA-ja. Këtë të fundit kështu e përshkruan njëri nga njohësit e arsimit: *Askush nuk merret me ta.*

DKA-ja merret me shkolla vetëm kur ka ndonjë problem. Mekanizmat e llogaridhënies nuk zbatohen aspak. Nuk ka ndonjë përkrahje serioze. Ka një pakt të heshtur për mosbërje në të dyja anët: shkollat dhe autoritetet.

Po sipas njohësve të arsimit, shkollat kanë “rënë në provim” sa i përket autonomisë së shkollës edhe për shkak të menaxhimit jo të mirë të kurrikulës me zgjedhje. *Si duket, autonomia e shkollës më tepër ‘(keq)përdoret’ për plotësimin e fondit të orëve të mësimdhënësve të caktuar.*

Gjithashtu, sipas njohësve të arsimit, moszbatimi e autonomisë së shkollës lidhet me sistemin, përkatësisht me mungesën e zbatimit të decentralizimit. Sipas njërit nga njohësit e arsimit: *Mungesa e zbatimit të decentralizimit në mënyrë të mirëfilltë ka krijuar një situatë në të cilën shkollat perceptohen që kanë autonomi, mirëpo në realitet janë të varura nga hierarkia, përfshirë në veçanti DKA-të. Ne besojmë në autonomi të shkollave vetëm atëherë kur kemi rekrutime meritokratike të udhëheqësve të shkollës dhe personelit, pra, shkollë të udhëhequr nga individët kompetentë.*

Sipas njohësve të arsimit, njoftimi i drejtorëve të shkollave për funksionin e autonomisë së shkollës dhe përgatitja e tyre për shfrytëzim adekuat të saj është i domosdoshëm. Megjithatë, sipas njërit nga njohësit e arsimit, *përderisa shkollat nuk mbahen përgjegjëse për performancën e tyre (respektivisht të nxënësve), vështirë mund të sigurohet që autonomia e shkollës të shfrytëzohet në dobi të nxënësve dhe proceseve mësimore në shkollë.*

Bazuar në mendimet dhe qëndrimet e shprehura nga njohësit e arsimit, të përfshirë në hulumtim, autonomia e shkollës nuk shfrytëzohet sa dhe si duhet dhe kjo situatë nuk mund të ndryshojë pa mbikëqyrje, mbështetje dhe zbatim të mekanizmave të llogaridhënies.

Ndryshimi i qasjes në mësimdhënie

Segmente të tjera, të diskutuara me njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare, ishin ndryshimet në qasjen ndaj mësimdhënies, si rezultat/kërkesë e kurrikulës së re. Përgjigjet/mendimet për këtë komponentë

janë të shpërndara/ndryshme, varësisht nga përvoja e punës me shkolla dhe mësimdhënës. Disa u referohen përvojave të drejtpërdrejta, disa bisedave me mësimdhënës dhe aktorë të tjerë të lidhur me shkollën dhe një pjesë u referohen raporteve dhe analizave të publikuara në vitet e fundit për zbatimin e kurrikulës. E përgjithshmeja reflektohet se ka praktika dhe shembuj shumë të mirë, por ato janë të pakta, siç shprehet njëri nga njohësit e arsimit: *Janë të individualizuara rastet kur punohet me përkushtim dhe shihen produktet e kurrikulës, si rezultat i ndryshimit të mësimdhënies dhe nxënies. Përafërsisht njëjtë përshkruhet edhe nga njohësi tjetër i arsimit: Çfarëdo ndryshimi në praktika në klasë është i lidhur me vullnetin dhe përkushtimin e mësimdhënësve individualisht, gjë që veç ka qenë prezent edhe para kurrikulës së re. Kjo do të mund të korrigjohej me një llogaridhënie më të madhe në proces.*

Përgjithësisht pohohet se vërehen ndryshime në plane, por nuk ka ndonjë dallim substancial në raport me qasjen në mësimdhënie dhe nxënie. Edhe sa i përket planifikimeve, ekziston perceptimi se ato janë shabllonizuar, nuk janë kreative për të siguruar një ndryshim në mësimdhënie dhe nxënie.

Megjithatë, njëri nga njohësit e arsimit shprehet se *kurrikula e re i ka trazuar ujërat gjithandej – megjithëse jo gjithkund në mënyrë pozitive. Ndërsa, njohësi tjetër i arsimit shprehës: Ajo çfarë më së shumti kam dëgjuar në biseda, takime me mësimdhënës, drejtorë të shkollave dhe DKA, është ngarkesa e madhe administrative me plane në letër. Sidomos vështirësitë për të personalizuar (individualizuar) planet dymujore – të cilat, sipas disa mësimdhënësve që i kam takuar – duhet të jenë të njëjta për klasë të njëjta, kudo qofshin ato në një komunë të caktuar.*

Nga këto përgjigje mund të konkludohet se ndryshimi në qasje të mësimdhënies dhe nxënies nuk mund të vjen vetvetiu, duhet mbikëqyrur punën e mësimdhënësve, duhet ofruar mbështetje të nevojshme dhe duhet ngritur llogaridhënien, në mënyrë që çdo veprim i mësimdhënësve të jetë në përputhje me parimet e kurrikulës dhe në funksion të zotërimit të kompetencave kryesore.

Parashikimi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj

Të gjithë respondentët kanë dhënë përgjigje dhe orientime të qarta për ndryshimet që duhet të ndodhin në nivel qendror dhe lokal për të zbatuar në mënyrë efektive kurrikulën e re - në fazat tjera të zbatimit dhe rishikimit të kurrikulës. Analiza e përgjigjeve të tyre përmban një set të ndryshimeve domethënëse që duhet të ndodhin në këtë proces:

- Vlerësim i gjendjes aktuale dhe përcaktimi i aktiviteteve të tjera pas rezultateve të dalta;
- Rishikimi i zbatimit dhe zhvillimi i planit të veprimit për korrigjim nga MASHT-i;
- Ridefinim i përgjegjësiave;
- Zhvillim i mekanizmave të qëndrueshëm nga niveli qendror (MASHT) në atë lokal (DKA dhe shkollë) për përkrahje në zbatim në nivel shkolle;
- Ndryshimi i strukturës, misionit dhe funksionit të DKA-së;
- Forcimi i shkollës: përkrahje materiale, infrastrukurore, njerëzore, financiare;
- Forcimi i mekanizmit të koordinatorit të cilësisë dhe i aktiveve profesionale;
- Forcimi i përgjegjësisë dhe rolit të drejtorit (profil i ri).
- Sigurimi i teksteve cilësore dhe respektimi i autonomisë së shkollave për përzgjedhjen e teksteve të miratuara nga MASHT-i;
- Ofrimi i mbështetjes së nevojshme për konsolidimin dhe funksionimin e ZHPM me bazë në shkollë (përfshirë zbërthimin e kompetencave të përgjithshme të mësimdhënësve në pritshmëri konkrete përmes treguesve përkatës);
- Harmonizim i kuadrit rregullativ dhe bashkërendim i të gjitha masave që ndërlidhen me reformën kurrikulare;
- Qasja në zhvillimin e mësimdhënësve dhe në ngritjen e kapaciteteve të bartësve të procesit.

Njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare kanë trajtuar edhe kërkesat drejtuar organizimit të brendshëm të shkollës për të udhëhequr me sukses zbatimin e kurrikulës së re. Sipas tyre, shkolla, organet e saj qeverisëse dhe profesionale, duhet ta ushtrojnë rolin e tyre për të gjitha proceset që zhvillohen në shkollë. Në mënyrë të veçantë i referohen zbatimit të kurrikulës, i cili vlerësohet të jetë procesi më i rëndësishëm për shkollën dhe gjithë sistemin e arsimit parauniversitar. Në linjë me këtë, kërkohet që secila shkollë të bëjë analizën e punës së saj dhe mbi bazën e kontekstit, nevojave dhe mundësive reale, të riorganizimit të brendshëm, duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e gjithë mekanizmave në shkollë për zbatimin e kurrikulës. Në mënyrë të veçantë kërkohet që të bëhet: *Aktivizimi i aktiveve profesionale, ashtu siç e kërkon UA për AP, fuqizimi i rolit të koordinatorit të cilësisë në shkollë, mbikëqyrja dhe mbështetja nga drejtori*. Gjithashtu, kërkohet që të fuqizohet roli i drejtorit, të ketë përkrahjen në marrjen e vendimeve për proceset e shkollës. *Kjo nuk do t'i linte punët për t'u dëshiruar në shkollë, por punët janë detyrim që të gjithë duhet t'u përgjigjemi dhe t'i kryejmë mirë.*

Parashikimi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj lidhet edhe me ndryshimet që duhet të ndodhin në Fakultetet e Edukimit dhe njësitet tjera akademike që ofrojnë programe kualifikimi për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave. Të gjithë respondentët e vlerësojnë nevojën për përfshirje më aktive të universiteteve në procesin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar dhe nevojën për të ndryshuar diskursin e MASHT-it në mënyrën se si punon me universitetet në reformat arsimore, përkatësisht në reformën kurrikulare. Sipas njërit prej tyre: *MASHT-i duhet të dalë me kërkesa të qarta për Fakultetin/et e Edukimit dhe njësitet akademike që përgatisin mësimdhënës.*

Krahas kërkesës për të ndryshuar MASHT-i qasjen ndaj universiteteve/fakulteteve dhe njësive akademike që përgatisin mësimdhënës, kërkohet që universitetet të reformohen nga brenda, sepse, sipas disa njohësve të arsimit, disa fakultete të edukimit/njësi akademike vetë kanë probleme me të kuptuarit e filozofisë së kurrikulës së re, akoma vazhdojnë të punojnë sipas sistemit të kurrikulës me përmbajtje: *Ato (disa fakultete të edukimit/ njësi akademike që përgatisin mësimdhënës), dhjetë vjet pas fillimit të reformës*

kurrikulare, akoma janë larg konceptit të mësimi të integruar dhe të mësimi të bazuar në kompetenca.

Analiza e të gjitha përgjigjeve përmban orientime të rëndësishme lidhur me atë se çfarë duhet të ndryshojnë Fakultetet e Edukimit dhe njësitë tjera akademike që ofrojnë programe kualifikimi për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave, për të siguruar përgatitjen e duhur akademike e profesionale për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca:

- Rishikimi i programeve të studimit dhe cilësia në studime, në veçanti, rishikim i angazhimit të personelit arsimor;
- FE dhe njësitë akademike duhet siguruar se filozofia e kurrikulës së re është integruar në programet/kurset e tyre për përgatitje të mësimdhënësve. Nuk mjafton qasja e tanishme – ofrimi i një kursi për kurrikulën e re. Në fakt kjo po e dëmton procesin e përgatitjes së mësimdhënësve të rinj, sepse kurrikula e re (e ofruar me këto kurse të veçanta) po mësohet jashtë kontekstit lëndor apo profesional. Pra, po ofrohet jo e integruar në kurse tjera (p.sh. planifikimi në arsim, Matematika 1..., Gjuha 1...), por e veçantë, dhe kjo po shkakton më shumë paqartësi dhe keqinformim për zbatim;
- Parimet, konceptet bazë, kompetencat dhe kërkesat kurrikulare, duhet integruar në shumicën (nëse jo në të gjitha), kurset e ofruara në FE dhe njësitë akademike. Vetëm në këtë mënyrë kurrikula është integruar (embedded) në programet për përgatitje të mësimdhënësve;
- Kurrikulat e njërive akademike që përgatisin mësimdhënës dhe drejtues të shkollave duhet të sigurojnë zotërimin e kompetencave përkatëse të përcaktuara me Kornizën për Zhvillim të Mësimdhënësve, respektivisht përgatitjen e drejtorëve për udhëheqje arsimore konform pritshmërive të reja;
- Trajnimin e stafit akademik që kanë mangësi në prapavijën e tyre pedagogjike - e obligueshme;
- Lehtësimi nga modulet me përmbajtje të tepruar shkencore.

Pritjet e njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare, për atë se *si do të reflektohet kurrikula e re në cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë,*

janë të artikuluar në gjuhën e dilemave dhe të shpresës. Sipas tyre, zhvillimet e gjertanishme nuk kanë ofruar një fotografi të qartë të zbatimit të kurrikulës së re dhe ndikimit të saj në cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë. Kështu shprehet njëri prej tyre: *Nuk e kam shumë të qartë ... do të reflektohet ashtu siç po mbështetet zbatimi i saj në praktikë. Suksesi i nxënësve duhet të pritët pas vitit 2024 (të paktën 8 vjet pas zbatimit në nivel vendi). Megjithatë – mbështetja që i ofrohet procesit do të kontribuojë në suksesin e saj. Duhet të presim sukses dhe cilësi në arsimin parauniversitar aq sa po e mbështesim mësuesin/shkollën dhe komunën.*

Gjykim përafërsisht i njëjtë reflektohet edhe tek njohësi tjetër i arsimit: *Nuk e di si do të reflektohet...Kam ndjesinë që na ka ikur nga duart...e nuk kemi më kontroll mbi të! Ndiej një përgjegjësi të madhe çka po ofrojmë për brezat sot....dhe llogarinë që duhet t'u japim kur ta kërkojnë nesër.*

Njohësit e arsimit shprehen se kemi rrugën përpara, prandaj duhet të rriten në maksimum veprimet për të arritur cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë. Zbatimi i kurrikulës së re, në bazë të kërkesave të saj, shihet si një instrument, i cili do të rrisë cilësisë e arsimit parauniversitar në Kosovë. Mirëpo, siç është përshkruar më lart, përvoja e tanishme me bartësit e procesit të reformës kurrikulare, pjesën më të madhe të respondentëve, i bën të shpresojnë se kjo do të zbatohet siç është projektuar. Kështu shprehet njëri nga njohësit e arsimit: *Shpresoj ta kuptojnë njëherë e përgjithmonë udhëheqja e MASHT-it (ministri, sekretari, drejtori i DAP, Divizionet për Kurrikula, trajnime dhe vlerësim) se ata/ato janë bartësit dhe përgjegjësit kryesorë për (mos) suksesin e zbatimit të kurrikulës së re. Shpresoj që ata/ato do ta kuptojnë se nuk ka proces më të rëndësishëm në gjithë sistemin e arsimit në Kosovë (parauniversitar dhe atë të lartë) sesa zbatimi me sukses i kurrikulës së re. Shpresoj, por nuk besoj shumë!*

Lidhur me parashikimin për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj, mund të konkludohet se, sipas njohësve të arsimit dhe të reformës kurrikulës, është i domosdoshëm zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshëm për përkrahje në zbatim të kurrikulës në nivel shkolle, përfshirë edhe ridefinimin e roleve dhe përgjegjësi. Po ashtu, edhe fuqizimi i shkollës, mbikëqyrja e vazhdueshme dhe funksionalizmi i mekanizmave të

llogaridhënies, nëse synohet të vazhdohet reforma kurrikulare dhe të zbatohen ndryshimet e saj në nivel shkolle/klase.

4.2.2.Rezultatet nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore dhe dokumentimit të shkollave për zbatimin e kurrikulës

4.2.2.1. Gjetjet nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore

Struktura e programeve lëndore është e përafërt për të gjitha lëndët mësimore, pavarësisht klasës. Ato përfshijnë aspektet në vijim: Hyrja, qëllimi, temat dhe rezultatet e të nxënit, udhëzimet metodologjike, udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, udhëzimet për vlerësim, dhe udhëzimet për materialet dhe burimet mësimore.

Referuar gjetjeve nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore për klasën përgatitore, klasën 2 dhe 7, konkludohet se:

- Struktura – përmbajtja e kurrikulave lëndore në klasën përgatitore, klasat 2 dhe 7 të analizuara, është e njëjtë për të gjitha kurrikulat lëndore;
- Numri i temave dhe rezultateve të nxënit – me dallime të theksuara;
- Shkrimi i rezultateve të nxënit për tema mësimore ka dallime në strukturë, organizim, përdorim të foljes aktive;
- Lidhja rezultateve të nxënit të lëndës (RNL) me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) nuk është bërë nga të gjitha lëndët mësimore të klasave përkatëse;
- Përmbajtja dhe gjuha e udhëzimeve metodologjike dhe udhëzimeve të tjera me dallime të theksuara, me përsëritje në programe të klasave të ndryshme dhe me përgjithësime që nuk orientojnë mjaftueshëm punën e mësimdhënësve në procesin e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës në klasën përkatëse;
- Udhëzime dhe orientime minimale për qasjen ndaj zhvillimit të kompetencave dhe dokumentit referues për rezultatet e kompetencave

kryesore në shkallën përkatëse kurrikulare;

- Dallimet në përmbajtje për çështje të njëjta tregojnë se dokumentet për kurrikulat lëndore/programet mësimore nuk duket se kanë kaluar në një proces të udhëheqjes së dokumentit apo të redaktimit profesional për të unifikuar disa nga çështjet themelore që u duhen mësimdhënësve gjatë zbatimit.

Përshkrimet brenda secilës pjesë të strukturës së kurrikulave lëndore dallojnë shumë nga lënda në lëndë, si në gjuhë të formulimit dhe shtrirje të udhëzimeve, ashtu edhe në numrin e faqeve. Në këtë drejtim, dallimet më të mëdha janë në programet e lëndëve të fushës Gjuhët dhe komunikimi. Në kurrikulat lëndore të gjuhëve të huaja (gjuhë angleze, gjuhë gjermane dhe gjuhë frënge -klasa 7) kurrikulat janë prezantuar të tëra në gjuhë të huaj, mikse apo të tëra në gjuhën shqipe, pavarësisht se kurrikula është për gjuhën e dytë të huaj.

Në disa kurrikula lëndore, qëllimi i përshkruar i lëndës, kalon përtej klasës – është i njëjtë si në klasat tjera, por nuk jepet informacioni pse, si kur duhet arrihet qëllimi apo qëllimet e kurrikulës lëndore për klasën përkatëse. Për shembull, kështu përshkruhen qëllimet e të mësuarit të lëndës Njeriu dhe natyra në klasën përgatitore dhe klasën e dytë:

Klasa përgatitore	Klasa 2
Qëllimet e të mësuarit të lëndës Njeriu dhe natyra janë: ▪ Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes hulumtimit të proceseve biologjike, fizike dhe kimike në mjedis. ▪ Zhvillimi i qasjes shkencore që ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues. ▪	Qëllimi i të mësuarit të lëndës Njeriu dhe natyra është: ▪ Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes hulumtimit të proceseve biologjike, fizike, kimike dhe gjeografike në mjedis. ▪ Zhvillimi i qasjes shkencore që ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues. ▪

Në programet e lëndëve Edukatë/ Art muzikor, Matematikë, Shkencat e natyrës (Natyra dhe njeriu, Biologji, Kimi), Shoqëria dhe mjedisi (Histori, Gjeografi, Edukatë qytetare), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, si dhe Jeta dhe puna (Shkathtësitë për jetë /Teknologji me TIK), rezultatet e të nxënit për tema të lëndës mësimore përkatëse (RNL), janë të ndërlidhura me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare përkatëse (RNF). Ndërsa kjo nuk reflektohet në programet e lëndore të klasës së 7 –të: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Gjuhë frënge, Edukatë figurative, Art figurativ dhe Fizikë, si dhe në programet e Gjuhës shqipe dhe Gjuhës angleze për klasën e dytë. RNF e vendosura në kurrikulën lëndore të matematikës – klasat 2 dhe 7, nuk përputhen me RNF e Kurrikulave Bërthamë (I dhe II), për fushën e matematikës në shkallën e parë dhe shkallën e tretë kurrikulare.

Një dallim tjetër i dukshëm në programet e lëndëve mësimore është numri i temave mësimore dhe numri i rezultateve për tema mësimore. Referuar analizës së programeve mësimore për lëndë mësimore, numri i rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) në klasën përgatitore arrin në 297, në klasën e dytë 465 rezultate të nxënit, ndërsa në klasën e shtatë 815 rezultate të të nxënit.

Dallimet më të mëdha janë ndërmjet lëndës së Gjuhës shqipe. Shembull në klasën përgatitore janë përcaktuar 16 rezultatet të nxënësit në lëndën e Gjuhës shqipe, ndërsa 99 rezultate të nxënit në Gjuhën angleze, në klasën e dytë janë përcaktuar 51 rezultate të të nxënit në lëndën e Gjuhës shqipe me 6 orë mësimi në javë, ndërsa 160 rezultate të të nxënit në gjuhën angleze me 1 orë mësimore në javë, kurse në programin e Gjuhës shqipe për klasën e shtatë janë përcaktuar 42 rezultate të të nxënit (5 orë mësimore në javë) dhe lëndës së 212 rezultate të të nxënit në lëndën e Gjuhës angleze (2 orë mësimore në javë). Tabela nr. 15 prezanton këto dallime.

Tabela 15. Numri i orëve mësimore javore, temave mësimore dhe rezultateve të të nxëniet të lëndës (RNL) – Klasa përgatitore dhe klasa 2

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Klasa përgatitore			Klasa e dytë		
		Numri i orëve mësimore javore	Numri i temave të programit të lëndës	Numri i rezultateve të të nxëniet të lëndës (RNL)	Numri i orëve mësimore javore	Numri i temave të programit të lëndës	Numri i rezultateve të të nxëniet të lëndës (RNL)
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	Nxënësit gjatë një jave i zhvillojnë përbajtjet nga të gjitha fushat	10	16	6	20	51
	Gjuhë angleze		18	99	1	18	160
Artet	Edukatë figurative		8	16	1	14	48
	Edukatë muzikore		11	19	1	9	20
Matematikë	Matematikë		9	42	5	12	75
Shkencat natyrore	Njeriu dhe natyra		4	30	1	7	32
Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi		7	25	1	7	26
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti		10	35	2	7	27
Jeta dhe puna	Shkathësi për jetë		5	15	1	6	26
Pjesa zgjedhore					1		
Totali – Orë javore		18	82	297	21	100	465

Burimi /MASHT (2018): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasën përgatitore dhe klasën 2.

Tabela 16. Numri i orëve mësimore javore, temave mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) – Klasa 7

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Numri i orëve mësimore javore	Numri i temave të programit të lëndës	Numri i rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL)
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	5	38	52
	Gjuhë e huaj/ gjuhë angleze	2	8	212
	Gjuhë e dytë e huaj / gjuhë gjermane	1	12	32
Artet	Art muzikor	1	12	22
	Art figurativ	1	22	42
Matematikë	Matematikë	4	12	57
Shkencat natyrore	Fizikë	2	8	72
	Kimi	2	5	56
	Biologji	2	5	45
Shoqëria dhe mjedisi	Histori	2	14	44
	Gjeografi	2	15	66
	Edukatë qytetare	1	6	27
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	2	7	24
Jeta dhe puna	Teknologji me TIK	2	8	64
Pjesa zgjedhore	Pjesa zgjedhore	1	/	/
Gjithsej		30	172	815

Burimi/MASHT (2018): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasën 7.

Përveç numrit në rezultatet e të nxënit, në raport me numrin javor të orëve mësimore, edhe në raport me formulimin e rezultateve të të nxënit për tema mësimore të lëndës, ka dallime në strukturë, organizim, përdorim të foljes

aktive, përdorim të shumësit apo njëjësit në rezultate etj. Këto dallime mund të shihen si në vijim:

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shembuj të rezultateve të të nxënësit (Klasa përgatitore)	Shembuj të rezultateve të të nxënësit (Klasa e dytë)
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	Përqendrohen në të dëgjuar e të folur për të kuptuar informatën, këshillën, ngjarjen, tregimin, përrallën, përrallëzën etj.	Përcakton tiparet themelore të përrallës, përrallëzës, tregimit, poezisë.
	Gjuhë angleze	Listens and repeats the target language for basic greetings (hello, goodbye, hi);	Listens to short dialogues in which characters talk about school objects and subjects, their favourite sports and musical instruments
Artet	Edukatë figurative	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat edhe tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre individual...	Të përdorë lloje të ndryshme të vijave për të krijuar figura e objekte
	Edukatë muzikore	Këndon këngë të thjeshta (në grup) sipas imitimit. (<i>Këngët trajtojnë tema të ndryshme, të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.)</i>)	Këndon këngë e melodi të thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. (<i>Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.)</i>)
Matematikë	Matematikë	Lexon të dhëna të thjeshta nga përditshmëria (p.sh. moti gjatë javës, lëvizja e veturave, etj.)	Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe i paraqet në tabelë.
Shkencat natyrore	Njeriu dhe natyra	Dallon lodrat dhe objektet e rrethinës së vet, sipas ngjyrës, formës, madhësisë, peshës, fortësisë dhe temperaturës.	Identifikon lëndën nga druri, plastika, xhami etj në klasë, shkollë shtëpi.
Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Identifikon shërbimet që i ofrohen në familje, lagje/ kopsht/shkollë, mjedisin rrethues (kujdesin prindëror, shërbimet mjekësore dhe rekreative, etj).	Dallon disa procese e fenomene natyrore dobiprurëse për njeriun si p.sh. shiu, bora, erërat, etj., veçon disa fenomene natyrore të rrezikshme si stuhitë, vërshimet, zjarret, ortejë, tërmetet, vullkanet dhe përshkruan disa sjellje/veprime të njeriut në raste të tilla.
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Njeh dhe dallon rreziqet në shkollë/kopsht, shtëpi dhe mjedisin ku jeton.	Diskuton për sigurinë dhe rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedise tjera.
Jeta dhe puna	Shkathësi për jetë	Përdor mjetet elektronike për punime të ndryshme	Demonstron me vegla të ndryshme që lidhen me profesione të caktuara.

Lëndët mësimore	Shembuj të rezultateve të të nxënësit – klasa 7
Gjuhë amtare	Dallon temën, kompozicionin, subjektin e personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.
Gjuhë e huaj/ gjuhë angleze	Speaks clearly and with confidence in group and class discussions, listens attentively to others in discussions, allows others their turn to express things happened in the past and shows respect for those events (social, religious, history, etc.);
Gjuhë e dytë e huaj / gjuhë gjermane	Lexon dhe kupton fjalë dhe shprehje të thjeshta në një tekst.
Gjuhë e dytë e huaj / gjuhë frënge	Kupton biseda rreth vetes, familjes, shkollës, aktiviteteve të përditshme dhe gjërave konkrete, nëse njerëzit flasin ngadalë dhe rrjedhshëm.
Art muzikor	Nxënësit këndojnë këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar teknikën e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).
Art figurativ	Analizojnë ritmin në punime të ndryshme të artistëve të njohur dhe aplikojnë lloje të ndryshme të ritmit në punët e tyre.
Matematikë	Zgjedh njësitë standarde për matje të gjatësisë, sipërfaqes dhe vëllimit, si dhe shpjegon marrëdhëniet ndërmjet njësive të ndryshme të matjeve gjatë zgjidhjes së problemeve.
Fizikë	Shpjegon fizikën si shkencë të natyrës që studion vetitë, strukturën dhe shndërrimet e materies dhe i formulon në formë të rregullave dhe ligjeve.
Kimi	Përcakton masën molekulare relative duke shfrytëzuar të dhënat e masave atomike relative nga tabela e sistemit periodik të elementeve.
Biologji	Identifikon përgjegjësitë e prindësisë së hershme, rritjes së fëmijëve, planifikimit familjar, planifikimi në karrierë, kontracepsionin, vendimmarrjen dhe kujdesin në rast të shtatzënisë
Histori	Analizon rolin e kishës në shoqërinë mesjetare, identifikon disa nga urdhërat kryesore fetare dhe përshkruan inkuizicionin si mënyrë e luftimit të oponencës ndaj saj.
Gjeografi	Dallon në hartë sistemet malore, fushat, rrafshnaltat dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse rreth Mesdheut ka tërmete dhe vullkane (Etna, Vezuvi etj.).
Edukatë qytetare	Krahason traditat, zakonet dhe adetet e pashkruara që praktikohen ose janë praktikuar dikur në familje ose komunitet, si: besa, mikpritja, fejesa dhe martesat, lojërat tradicionale, festat popullore etj., me rregullat, normat dhe ligjet e shkruara që praktikohen në shoqëri dhe institucione publike, si: shkollë, teatër, spital, polici, organe të pushtetit, organizata shoqërore etj.
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll.
Teknologji me TIK	Informohet nga burime, forma e mënyra të ndryshme për rolin edukimit me kohë për karrierën e tij të ardhshme.

Në anën tjetër, në raport me udhëzimet metodologjike, në të gjitha programet lëndore ka pak orientime dhe udhëzime se si mësimdhënësit t'i qasen planifikimit për zbatim të kurrikulës, cilin model duhet të ndjekin me shtrirjen apo shpërndarjen e temave mësimore brenda periudhave mësimore, në raport me specifikat e nivelit/ klasës përkatëse dhe thellësinë dhe gjerësinë e përmbajtjes së temave përkatëse (modeli linear ku një temë mësimore vendoset dhe përfundohet brenda një periudhe mësimore, modeli spiral ku temat mësimore shtrihen në periudha të ndryshme për shkak të thellësisë dhe gjerësisë së përmbajtjes, me qëllim që disa aspekte të përsëriten në procesin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe modeli i kombinuar (linear dhe spiral). Gjatë shpërndarjes së temave, sugjerohet të përdoren modele të ndryshme, si, Udhëzimet kryesisht janë të përgjithshme dhe i referohen metodologjisë së mësimdhënies.

Të gjitha kurrikulat lëndore/programet mësimore përmbajnë udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, ndërsa udhëzimet për zhvillimin e kompetencave, lidhjen e rezultateve të kompetencave me programet e lëndëve mësimore janë të pakta, me dallime të vogla ndërmjet programeve të lëndëve mësimore. Nisur nga fakti se mësimdhënësit kryesisht i referohen programit të lëndës mësimore, jo sa duhet dhe si duhet kurrikulës bërthamë për nivelin përkatës, është vështirë të sigurohet se formati aktual i programeve lëndore të zhvilluara siguron zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Në vendosjen e temave mësimore dhe në udhëzimet metodologjike të programeve lëndore për klasën përgatitore, nuk respektohen orientimet e vendosura në hyrje të programit për këtë klasë, sipas të cilave: *Edukatorja/ri mësimdhënien duhet ta realizojë të integruar, nëpërmjet aktiviteteve në formë të lojës, duke e ndërlidhur me punën dhe jetën e përditshme të fëmijëve në mënyrë që të kuptojnë drejt marrëdhënien e tyre me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu. Të gjitha fushat kurrikulare/lëndët mësimore duhet të mësohen të integruara në mënyrë që të shmanget fragmentarizimi i mësimdhënies në orë të veçanta lëndore, si Matematikë, Gjuhë shqipe apo lëndë të tjera. Ato së bashku duhet të kontribuojnë që te fëmijët t'i zhvillojnë kompetencat që janë përcaktuar në shkallën e parë të kurrikulës*²². Përkundrazi mënyra se si janë vendosur

²² Më gjerësisht shih: Kurrikulat lëndore/programet mësimore - Klasa përgatitore (2018).

temat mësimore për lëndë dhe rezultatet e të nxëniet për lëndë mësimore për këtë klasë, ka bërë që planifikimi dhe puna e edukatorëve të jetë e ndarë sipas lëndëve mësimore, jo me qasje të integruar, siç përcaktohet me Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulën Bërthamë për nivelin e parë të arsimit, në mënyrë specifike për klasën përgatitore.

Kjo situatë kërkon vëmendje nga MASHT-i për të nisur procesin për rishikimin e kurrikulës për klasën përgatitore. Procesi i rishikimit duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar të kurrikulës për klasën përgatitore, qartësi se veprimtaria edukative në këtë klasë duhet të organizohet përmes lojës dhe aktiviteteve ndërvepruese, paraprakisht të planifikuara nga edukatorët.

Zhvillimi i kurrikulave lëndore/programeve mësimore për klasat vijuese të të tri niveleve të arsimit është duke vazhduar. Në kohën e fillimit të shkrimit të këtij raporti të studimit janë publikuar në faqe të MASHT-it edhe kurrikulat për klasat 3, 8 dhe 12, të cilat një vit shkollor më parë (2018/2019) janë zbatuar nga shkollat prijëse në zbatimin e kurrikulës së re, përkatësisht shkollat që ishin pjesë e pilotimit të kurrikulës së re. Duhet rikujtuar se në fazën e pilotimit të kurrikulës nga shkollat pilotuese është kërkuar që planifikimi i programit mësimor të bëhet në nivel shkalle. Mirëpo, një gjë e tillë nuk është duke ndodhur me programet mësimore që janë duke u zhvilluar nga grupet punuese të udhëhequra nga MASHT-i, zhvillimi i programeve është duke u zhvilluar nga klasa në klasë në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, kjo përbën një rrezik për ikje nga parimet e kurrikulës që reflektojnë zhvillimin e kompetencave dhe promovimin e të nxëniet holistik përmes mësimdhënies dhe nxënies së integruar. Gjithashtu, kjo përbën një rrezik që të mos sigurohet mbulimi i të gjitha rezultateve të kompetencave kryesore të shkallës përkatëse nga mësimdhënësit që punojnë me nxënës në këto klasa, nëse ato nuk merren parasysh nga zhvilluesit e kurrikulave.

Nga mësimdhënës dhe trajnerë të fushave të ndryshme kurrikulare sugjerohet të ketë modifikim të temave, të kurrikulave lëndore. Kjo arsyetohet me faktin se programet e lëndëve të një fushe të caktuar duhet të kenë përafrim dhe qasje të integruar, si dhe mundësi të fleksibilitetit të ndonjë teme të caktuar, që patjetër duhet të jenë të veçanta sipas lëndëve,

por jo me dallime kaq të mëdha në raport me temat dhe rezultatet e të nxënit. Gjithashtu, sugjerohet që të ketë më shumë shembuj të ndërlidhjes së planifikimit mësimor me metodologjitë e mësimdhënies dhe të vlerësimit.

Në dy vitet e fundit, kurrikulat lëndore/programet mësimore dërgohen në shkolla në formë elektronike, nuk botohen si programe të veçanta. Kjo përbën sfidë për shkollat dhe mësimdhënësit që nuk kanë internet të qëndrueshëm, pajisje të TIK-ut, mundësi printimi dhe shumëzimi për të gjithë mësimdhënësit. Gjithashtu, kjo përbën një rrezik që mësimdhënësi/ja të merret vetëm me programin e lëndës së tij/saj si në planifikim, e po ashtu edhe në procesin e zbatimit.

4.2.2.2 Analiza e gjetjeve nga dokumentimi i shkollave për zbatim të kurrikulës

Gjetjet nga analiza mbi dokumentimin e shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës

Në kapitullin e parë të këtij studimi janë përshkruar elementet kryesore të lidhura me përgatitjet e shkollës për zbatimin e kurrikulës, duke filluar nga analiza e kontekstit të shkollës dhe krijimi i kushteve bazë për zbatimin e kurrikulës; informimi komunitetit të shkollës me qëllimet, mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re; trajnimi i mësimdhënësve dhe stafit e shkollës që mbështet zbatimin e kurrikulës së re; përgatitja e materialeve përkatëse mësimore; riorganizimi i strukturave në nivel shkolle dhe menaxhimi efikas i procesit të zbatimit të kurrikulës; monitorimi i vazhdueshëm i realizimit të procesit mësimor dhe mentorimi i mësimdhënësve gjatë zbatimit të kurrikulës së re; dhe bashkëpunimi me prindërit dhe partnerët e tjerë që mbështesin zbatimin e kurrikulës. Kjo pjesë ka shërbyer për të përgatitur dhe aplikuar instrumentin e listë-kontrollit për analizë të dokumentimit të shkollave të përfshira në studim për përgatitjen e tyre dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës.

Instrumenti për analizë të dokumentimit të shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës për çështje praktike është organizuar në gjashtë pjesë, me gjithsej 34 tregues/kërkesa për dëshmi të dokumentimit të punës së shkollës.

Tabela 17. *Fushat e dokumentimit të shkollave dhe kërkesat/ treguesit e dëshmimeve për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës*

I. Informimi për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re
1.1. Institucioni arsimor/shkolla ka përgatitur materiale informuese për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re
1.2. Materialet informuese kanë përshkrim të qartë dhe i kontribuojnë mjaftueshëm informimit për kurrikulën e re
1.3. Shkolla ka dëshmi të përdorimit të materialeve informuese për kurrikulën e re të përgatitura nga MASHT, DKA ose partnerët tjerë mbështetës
1.4. Dëshmi të tjera lidhur me informimin e komunitetit të shkollës për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re
II. Plani Zhvillimor i Shkollës
2.1. Shkolla ka plan zhvillimor, i cili përfshin edhe periudhën e vitit shkollor 2018/2019
2.2. Analiza e planit zhvillimor përshkruan qartë gjendjen e shkollës në raport me fushat e cilësisë së performancës së shkollës.
2.3. Plani Zhvillimor i Shkollës ka së paku një objektiv zhvillimor që lidhet me zbatimin e kurrikulës së re
2.4. Plani Zhvillimor i Shkollës përfshin masa dhe aktivitetet konkrete për përgatitjen e shkollës dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re
III. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019
3.1. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 është i ndërlidhur me Planin Zhvillimor të Shkollës
3.2. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 ka pasqyrim të qartë të aktiviteteve kryesore, përgjegjësve për aktivitete dhe periudhën e realizimit të tyre
3.3. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 ka masat dhe aktivitetet konkrete për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re
3.4. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 ka ndërlidhje të mirë me punën e organeve profesionale dhe qeverisëse të shkollës

IV. Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës
4.1.Shkolla ka raportin e VPSH sipas strukturës së raportit përmbledhës
4.2.Raporti i VPSH, përveç tjerash, përmban edhe konstatimet përmbledhëse për gjendjen e shkollës në raport me kriteret dhe fusha të cilësisë së shkollës
4.3.Në raportin e VPSH janë identifikuar përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë
4.4.Në raportin e VPSH janë dhënë rekomandime të qarta për masat që duhet ndërmarrë nga shkolla për të mënjeluar dobësitë e identifikuara
4.5.Në raportin e VPSH-së janë dhënë rekomandime të qarta për masat që duhet ndërmarrë nga shkolla për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re
V. Dëshmi (plane të veprimit dhe raporte pune të drejtuesve të shkollës dhe organeve qeverisëse) që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle
5.1.Plani vjetor i punës së drejtorit /zv.drejtorit të shkollës përmban aktivitete lidhur me monitorimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës
5.2.Plani vjetor i punës së drejtorit /zv.drejtorit të shkollës përmban aktivitete me prindër dhe nxënës lidhur me zbatimin e kurrikulës
5.3.Raporti i drejtorit/ zv.drejtorit të shkollës për monitorimin e zbatimit të kurrikulës pasqyron gjendjen dhe masat për zbatim të suksesshëm
5.4.Planet e organeve qeverisëse të shkollës (KDSH, KP, KN) përmbajnë aktivitete që i kontribuojnë zbatimit të kurrikulës së re
5.5.Raportet e punës së organeve qeverisëse të shkollës pasqyrojnë aktivitete, vendime, propozime, etj. në funksion të zbatimit të kurrikulës
5.6.Plani për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve – me fokus zhvillimin profesional me bazë në shkollë, përmban aktivitete lidhur me zbatimin e kurrikulës së re
5.7.Raporti i shkollës për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve pasqyron aktivitetet vjetore të shkollës të realizuara me mësimitdhënës në fushën e zbatimit të kurrikulës së re

VI. Dëshmi (plane vjetore dhe raporte pune) të organeve profesionale të shkollës që pasqyrojnë punën në planifikimin për zbatim të kurrikulës (nga KC, AP, pedagogut/psikologut të shkollës)
6.1.Plani i punës së koordinatorit të cilësisë përmban aktivitete lidhur me përkrahjen e udhëheqjes së shkollës dhe AP për zbatimin e kurrikulës
6.2.Raporti i koordinatorit të cilësisë pasqyron aktivitetet mbështetëse të realizuara, gjendjen në zbatimin e kurrikulës dhe masat për zbatim të suksesshëm
6.3.Planet e punës së AP përmbajnë aktivitete lidhur me planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës, si dhe përkrahjen e mësimdhënësve të aktivitetit profesional
6.4.Planet e punës së aktiveve profesionale përmbajnë aktivitete lidhur me aktivitetet e lira me nxënës, aktivitetet ekstrakurrikulare dhe mësim plotësues/shtues
6.5.Raportet e AP pasqyrojnë aktivitetet e realizuara për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re, gjendjen në zbatimin e kurrikulës dhe masat për zbatim të suksesshëm
6.6.Raportet e AP pasqyrojnë analiza të lidhura me vlerësimin e nxënësve dhe përparimin e nxënësve në klasat që punojnë me programe të reja mësimore
6.7.Raportet e AP pasqyrojnë dëshmi të realizimit të aktivitetit të lira me nxënës, aktivitetet ekstrakurrikulare dhe mësim plotësues/shtues
6.8.Plani vjetor i punës së pedagogut/psikologut të shkollës përmban aktivitete lidhur me zbatimin e kurrikulës, përfshirë aktivitetet me mësimdhënës, nxënës dhe prindër
6.9.Raporti i pedagogut/psikologut të shkollës pasqyron aktivitetet e realizuara që lidhen me zbatimin e kurrikulës së re, gjendjen dhe masat për zbatim të suksesshëm
6.10.Raporti i pedagogut/psikologut pasqyron analiza të lidhura me vlerësimin e nxënësve dhe përparimin e nxënësve në klasat që punojnë me programe të reja mësimore

Dëshmitë e lidhura me treguesit/kërkesat e vendosura janë vlerësuar në tri nivele: (i) nivel i lartë i dëshmime (3 pikë); (ii) nivel mesatar i dëshmime (2 pikë); dhe (iii) nivel minimal i dëshmime (1 pikë). Për treguesit që nuk ka pasur dëshmi është evidentuar si mungesë e dëshmime (0 pikë).

Nga analiza cilësore e dokumentimit të 34 shkollave të përfshira në studim, del se disa shkollat nuk i kanë kushtuar kujdes dokumentimit të punës në fusha të ndryshme, apo nuk kanë dëshmi për të dokumentuar punën e tyre në këtë fushë. Kështu, sipas përmbledhjes së analizës së dokumentimit të të gjitha shkollave, 8 shkolla nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për materialet informuese të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re; 3 shkolla nuk kanë ofruar planet zhvillimore për analizë, 2 shkolla nuk kanë ofruar planet vjetore për analizë dhe shqyrtim; 10 shkolla nuk kanë ofruar raporte të vetëvlerësimit të performancës së shkollës, 3 shkolla nuk kanë ofruar asnjë plan dhe raport pune që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, si dhe 4 nuk kanë ofruar asnjë plan dhe raport të punës së organeve profesionale të shkollës.

Analiza tregon se ekziston një traditë e shkollave në përgatitjen dhe ruajtjen e planeve zhvillimore dhe planeve vjetore të punës. Këtë e dëshmon dokumentimi i planeve të 23 përkatësisht 24 shkollave të përfshira në studim. Në anën tjetër, analiza tregon se 19 shkolla, përkatësisht 16, kanë dëshmi minimale në tri fusha mjaft sensitive që lidhen me përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës:

- Materiale informuese, të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re – 19 shkolla kanë dëshmi minimale;
- Plane vjetore dhe raporte pune që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle - 19 shkolla kanë dëshmi minimale;
- Plane vjetore dhe raporte pune të organeve profesionale të shkollës – 16 shkolla kanë dëshmi minimale.

Tabela në vijim paraqet fushat e analizuara të dokumentimit për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës nga shkollat dhe përqindjen (%) e shkollave sipas nivelit të dëshmime të ofruara.

Tabela 18. Të dhëna përshkruese për nivelet e dëshmime, për dokumentimin e punës së shkollës, për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës

Fushat e dokumentimit të shkollës për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës	Mungesë e dëshmime	Nivel minimal i dëshmime (deri në 49 % të dëshmime)	Nivel mesatar i dëshmime (50 – 79 % e dëshmime)	Nivel i lartë i dëshmime (mbi 80% e dëshmime)
1. Materialet informuese të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re	23,5 %	55,9 %	11,8 %	8,8 %
2. Plani Zhvillimor i Shkollës	8,8 %	20,6 %	44,1 %	26,5 %
3. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019	5,9 %	26,5 %	47,1 %	20,6 %
4. Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës	23,5 %	26,5 %	23,5 %	26,5 %
5. Dëshmi (plane të veprimit dhe raporte pune) që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle	8,8 %	55,9 %	20,6 %	14,7 %
6. Dëshmi (plane të veprimit dhe raporte pune) të organeve profesionale të shkollës që pasqyrojnë punën në planifikimin për zbatim të kurrikulës	11,8 %	47,1 %	23,5 %	17,6 %

Me gjithë punën e mirë që bëjnë shkollat në planifikim, analiza tregon se planifikimi mësimor nuk është i harmonizuar, mungon qasja për zhvillim të integruar të shkollës, përmes së cilës do të sigurohej më mirë udhëheqja e zbatimit të kurrikulës. Në mënyrë të veçantë vërehet shpërpushje ndërmjet planeve të organeve qeverisëse e profesionale me PZHSH dhe Planin vjetor/planin e veprimit të integruar në PZHSH. Në anën tjetër, ka mungesë të raporteve për përmbushjen e planeve të punës, përkatësisht kundrejt dëshmimeve për analizë, diskutim, shqyrtim për arritjet realizimin e planit, sfidat dhe problemet e shkollave me të cilat janë ballafaquar në dy vitet e para të zbatimit të kurrikulës, masat shtesë që janë ndërmarrë etj. Kjo tregon se në mungesë të mekanizmave për monitorimin e shkollës dhe të kërkesave për raportim cilësor në këtë fushë, shkollat nuk mobilizohen në përgatitjen e raporteve dhe dëshmimeve në këtë fushë dhe në fushat e tjera që lidhen me zhvillimin e shkollës.

Kuantifikimi tjetër i analizës së përgjithshme për dokumentimin e shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës është bërë në raport me pikët maksimale për secilën fushë të dokumentimit, duke nxjerrë mesataren e pikëve dhe përqindjet për të gjitha shkollat pjesëmarrëse në studim. Edhe kjo analizë tregon se në raport me pikët maksimale, mesatarja e pikëve për të gjitha shkollat tregon se shkollat kanë më shumë dokumentim të planit zhvillimor dhe planit vjetor të punës së shkollës. Këtë e dëshmojnë pikët mesatare dhe përqindjet në këto dy fusha, ku shkollat i kanë plotësuar dëshmitë rreth 67% nga të gjitha kërkesat për to. Fushat tjera plotësojnë mesatarisht kërkesat bazike, me përjashtim të kërkesave për materiale informuese të përgatitura nga shkolla për mësimdhënësit, prindërit, nxënësit, lidhur me kurrikulën e re, si dhe kërkesat për planet vjetore e raportet e punës që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle.

Tabela 19. Fushat e dokumentimit të shkollës për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, shprehur në mesatare dhe në përqindje

Fushat e dokumentimit të shkollës për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës	Pikët maksimale	Pikët mesatare të të gjitha shkollave	%
1. Materiale informuese të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re	9 pikë	3	33%
2. Plani Zhvillimor i Shkollës	12 pikë	8	67%
3. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019	12 pikë	8	67%
4. Raporti i vlerësimit të brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës	15 pikë	8	53%
5. Dëshmi (plane vjetore dhe raporte pune) që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle	21 pikë	9	43%
6. Dëshmi (plane vjetore dhe raporte pune) të organeve profesionale të shkollës që pasqyrojnë punën në planifikimin për zbatim të kurrikulës	21 pikë	11	52%
Gjithsej	90 pikë	47	52%

Gjetjet nga analiza mbi dokumentimin e planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës

Në kapitullin e parë të këtij raporti të studimit, kemi përshkruar elementet kryesore të lidhura me planifikimin mësimor referuar orientimeve dhe udhëzimeve në dokumentet kurrikulare dhe në udhëzuesit e përgatitur për mësimdhënës për zbatimin e kurrikulës së re. Kjo pjesë ka shërbyer për të përgatitur dhe aplikuar instrumentin e listë-kontrollit për analizë të dokumentimit të shkollave dhe mësimdhënësve për planifikimin mësimor për zbatim të kurrikulës.

Dokumentimi i planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës është mbledhur gjatë vizitave hulumtuese në shkollat e përfshira në studim. Prej 34 shkollave pjesëmarrëse në studim, vetëm shtatë shkolla i kanë dërguar planet mësimore me elektronikë, megjithëse kemi kërkuar që shkollat të mos bëjnë shpenzime në kopjimin e planeve dhe të mos ngarkohen me këtë proces. Një pjesë e planeve mësimore që shkollat i kanë siguruar për këtë proces kanë qenë dosje/portfolio e mësimdhënësve, të përgatitura për certifikim, pasi që kanë ndjekur trajnimin për zbatimin e kurrikulës.

Analiza e planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës është bërë nga bashkëpunëtorët profesionalë për fusha kurrikulare/lëndë mësimore, të angazhuar nga IPK-ja, në bashkëpunim me Divizionin për Kurrikula në MASHT. Instrumenti për analizë të dokumentimit të planifikimit mësimor për fusha kurrikulare/lëndë mësimore është organizuar në tri pjesë (i) *Plani vjetor për fusha kurrikulare/lëndë mësimore*; (ii) *Planet për periudha mësimore/planet dymujore*; dhe (iii) *Planifikimet për orë mësimore*. Instrumenti për analizë ka përfshirë gjithsej 27 tregues/kërkesa për dëshmi të planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës.

Tabela 20. *Kërkesat/treguesit për dokumentimin e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës së re*

1. Plani vjetor për fusha kurrikulare/lëndë mësimore
1.1. Plani vjetor mbulon të gjitha temat mësimore të programit të lëndës mësimore dhe ka të përcaktuar numrin e orëve mësimore për tema mësimore
1.2. Plani vjetor është harmonizuar me planet vjetore të lëndëve të fushës kurrikulare
1.3. Numri i orëve mësimore për tema mësimore është në harmoni me numrin e përgjithshëm të orëve mësimore vjetore të lëndës mësimore për klasën përkatëse.
1.4. Shtrirja e temave përgjatë periudhave të vitit mësimor siguron lidhjen logjike dhe përmbajtjesore të mbarështimit të programit të lëndës mësimore
1.5. Rezultatet për kompetenca që synohen të arrihen përmes kontributit të temave që zhvillohen për gjatë gjithë vitit mësimor janë të ndërlidhura me rezultatet e të nxënit për tema mësimore

2. Planet për periudha mësimore / planet dymujore
2.1. Struktura e planit dymujor/plani për periudha mësimore përmban elementet kryesore të planifikimit për periudha mësimore (si: kontributin në RNK dhe RNF, temat mësimore, rezultatet e të nxënit për tema mësimore, njësitë mësimore, metodologjia e mësimdhënies, metodologjia e vlerësimit, ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me situata jetësore, si dhe burimet e materialet e nevojshme).
2.2. Planet për periudha mësimore mbulojnë temat mësimore sipas shtrirjes në planin vjetor dhe në përputhje me programin e lëndës mësimore.
2.3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve në periudha mësimore kanë ndërlidhje me rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore për tema të periudhës përkatëse.
2.4. Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve në periudha mësimore kanë ndërlidhje me rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore për tema të periudhës përkatëse.
2.5. Rezultatet e të nxënit për tema mësimore, të vendosura në planet e periudhave mësimore, janë në harmoni me temat përkatëse të programit të lëndës mësimore
2.6. Njësitë mësimore, të vendosura në planet e periudhave mësimore, lidhen, përkatësisht janë zbërthyer në bazë të rezultateve të të nxënit të lëndës mësimore për temë (RNL)
2.7. Njësitë mësimore të vendosura në planet e periudhave mësimore janë të mjaftueshme dhe sigurojnë arritjen e rezultateve të lëndës mësimore për temë (RNL)
2.8. Numri i orëve mësimore të përcaktuara për periudha mësimore është në harmoni me rezultatet e lëndës mësimore për temë dhe njësitë mësimore të planifikuara për t'u realizuar përgjatë periudhave mësimore
2.9. Metodologjia e mësimdhënies, pasqyruar në planet e periudhave mësimore, përmban qasje metodologjike, metodat dhe teknikat të mësimdhënies interaktive, që janë relevante për temën/at, rezultatet e të nxënit, njësitë mësimore dhe ndihmojnë nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënit të planifikuara në kuadër të periudhave mësimore
2.10. Metodologjia e vlerësimit, e pasqyruar në planet e periudhave mësimore, përmban metodat, teknikat dhe instrumentet relevante të vlerësimit që mund të përdoren për të vërtetuar nivelin e arritjeve të nxënësve dhe për të orientuar mbështetjen e të nxënit të nxënësve.

2.11.	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore, është bërë në mënyrë të drejtë dhe në harmoni me temën/at, përkatësisht njësitë mësimore të planifikuara për t'u zhvilluar brenda periudhës mësimore përkatëse
2.12.	Planifikimi i burimeve dhe materialeve të nevojshme që mësimdhënësi dhe nxënësit do t'i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të nxënimit në periudhat përkatëse, bërë në mënyrë të drejtë dhe në harmoni me temën/at, përkatësisht njësitë mësimore të planifikuara për t'u zhvilluar brenda periudhës mësimore përkatëse
3. Planifikimet për orë mësimore	
3.1.	Modelet e planifikimit për orë mësimore përmbajnë kërkesat themelore për planifikimin e orës mësimore dhe pasqyrojnë kreativitetin e mësimdhënësit në planifikimin e orës mësimore.
3.2.	Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore janë formuluar drejt dhe kanë ndërlidhje me temën dhe rezultatin e temës
3.3.	Kriteret e suksesit janë formular drejt dhe në harmoni me rezultatet e të nxënimit të orës mësimore
3.4.	Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore është bërë në harmoni me njësinë mësimore, përkatësisht rezultatet e orës mësimore që synohen të arrihen
3.5.	Burimet dhe mjetet e konkretizimit që mësimdhënësi dhe nxënësit do t'i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të nxënimit për orë mësimore janë në harmoni me përmbajtjen e njësisë mësimore, rezultatin/et e njësisë mësimore/orës mësimore.
3.6.	Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore tregon qartë atë që do të zhvillohet brenda orës mësimore dhe është në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënimit të orës mësimore
3.7.	Përshkrimi i metodologjisë, vlerësimit, për arritjen e rezultateve të të nxënimit të orës mësimore tregon qartë se çka dhe si do të vlerësohet dhe siguron informatë kthyesë për arritjet e nxënësve brenda orës mësimore
3.8.	Udhëzimet për detyra dhe punë të pavarur janë të qarta dhe të mjaftueshme për nxënës
3.9.	Reflektimet për rrjedhën e orës mësimore janë objektive dhe ofrojnë orientime për vetëpërmirësim të mësimdhënësit
3.10.	Modelet e planifikimit të orës mësimore pasqyrojnë kreativitetin e mësimdhënësit në punën me nxënës.

Analiza dhe vlerësimi për secilën kërkesë/tregues është bërë në tri nivele: (i) nivel i lartë; (ii) nivel mesatar dhe (iii) nivel minimal. Për treguesit që nuk ka pasur dëshmi është evidentuar si mungesë e dëshmive. Bazuar në vlerësimin e secilës kërkesë/tregues, është nxjerrë vlerësimi i përgjithshëm për planet vjetore, planet për periudha mësimore dhe planifikimet për orë mësimore.

Nga analiza planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës, përkatësisht nga dokumentimi i marrë prej 34 shkollave, del se të gjitha shkollat i kanë të dokumentuara planet vjetore për fusha kurrikulare/lëndë mësimore, kundrejt planeve për periudha mësimore/planeve dymujore. Në raport me planet për periudha mësimore, mbi 90 e shkollave kanë ofruar dëshmi të planeve mësimore për periudhën e parë (shtator – dhjetor), ndërsa rreth 80% e shkollave kanë ofruar dëshmi të planeve mësimore për periudhën e dytë (janar – mars), përkundër faktit se vizitat hulumtuese në shkolla janë realizuar në periudhën mars – maj.

Analiza tregon se format e planifikimit mësimor janë pothuajse të njëjta në të gjitha shkollat, ashtu siç janë udhëzuar përmes udhëzuesve dhe trajnimeve për kurrikulë. Në mesin e formave të planifikimit mësimor janë raportuar edhe modelet e fazës së pilotimit, si në shkollat që kanë qenë pjesë e pilotimit, ashtu edhe në ato që nuk kanë qenë të përfshira në pilotim. Kjo tregon se në disa shkolla ekziston tendenca që planet mësimore të dorëzohen në organet e shkollës sa për të plotësuar anën formale, pa një punë, analizë dhe shqyrtim, me kontekstin e shkollës, klasës dhe fushës kurrikulare, si dhe pa iu referuar programit zyrtar të miratuara nga MASHT-i. Gjithashtu, kjo tregon se në një numër të shkollave mbledhen planet nga organet përkatëse të shkollës, mirëpo vetëm si formë teknike, pa një shqyrtim dhe analizë të përmbajtjes së tyre.

Analizë e gjetjeve mbi planifikimin mësimor për klasën përgatitore

Nga analiza e planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës në klasën përgatitore (në kopshte dhe shkolla), vërehen dallime në plotësimin e kërkesave bazike për planifikim vjetor, planifikim për periudha mësimore, si dhe planifikim për aktivitete mësimore apo orë mësimore.

Në raport me kërkesat/treguesit për planifikimin mësimor për zbatim të kurrikulës, në përgjithësi planifikimet mësimore nuk ofrojnë qasje të integruar dhe të harmonizuar në planifikim, ndërmjet fushave kurrikulare. Në anën tjetër, edhe shtrirja e temave përgjatë periudhave të vitit mësimor nuk siguron qasjen e integruar dhe lidhjen logjike e përmbajtjesore të mbarështrimit të programit mësimor në këtë klasë.

Në planifikimet mësimore (Matematikë dhe Gjuhë amtare/gjuhë shqipe) për klasën përgatitore ka pak metodologji të të nxënit përmes lojës. Edhe nëse është e pranishme në planet për periudha mësimore/planet dymujore, nuk është hasur në planifikim të ndonjë loje në planet të orës mësimore të analizuara. Duke marrë parasysh që edukimi parafillor duhet të realizohet përmes lojës, këtu paraqitet nevoja kryesore për ndërhyrje.

Në planifikimet për lëndën e Matematikës, në disa raste, janë planifikuar njësi mësimore shumë më të ngarkuara sesa që kërkohet në RNL për lëndë, si: thyesa $\frac{1}{4}$, e $\frac{1}{2}$, shenjat $>$, $<$, $-$, $+$, $=$, si dhe numrat çift dhe tek etj. Në anën tjetër, burimet e evidentuara janë shumë të mangëta në të gjitha planet, e në disa raste janë shumë formale, libra, internet, jo cila libër cila uebfaqe, etj. Në disa plane gjejmë vlerësime të fëmijëve me test, me notë. Kurse sa u përket reflektimeve për orë mësimore, ato lënë për të dëshiruar, më shumë janë formalitete sesa reflektime për mësimet dhe reflektime për vetëpërmirësim.

Edhe planifikimet që lidhen me lëndën e Gjuhës amtare tregojnë së në planifikimet për periudha mësimore dhe për orë mësimore ka pak metodologji të të nxënit përmes lojës. Në disa plane është planifikuar mësimi i shkronjave të alfabetit, me radhë nga A deri në ZH. Kjo formë e planifikimit lë për të kuptuar se shkollarizmi i edukimit në klasën përgatitore është pjesë e përditshmërisë së punës me fëmijë, është pjesë e praktikës së mësimdhënies dhe nxënies në këtë klasë.

Kërkesat/ treguesit e planifikimit për periudha mësimore dhe aktiviteteve/ orë mësimore janë plotësuar në shkallë më të lartë, kundrejt kërkesave për planifikim mësimor vjetor. Tabela në vijim pasqyron një përmbledhje të mesatares së përmbushjes së të gjitha kërkesave/ treguesve për dëshmi të

planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës në klasën përgatitore – në kopshte dhe në shkolla.

Tabela 21. *Të dhënat përshkruese për plotësimin e kërkesave për planifikim mësimor në arsimin parashkollor, shprehur në përqindje, për fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi dhe Matematikë*

Fushat kurrikulare	Mesatarja e plotësimit të kërkesave					
	Planet vjetore		Planet për periudha mësimore / planet dymujore		Planifikimet e orës mësimore / aktivitete mësimore	
	Parashko llore në kopshte	Klasa përgatitore në shkolla	Parashkollorë në kopshte	Klasa përgatitore në shkolla	Parashko llore në kopshte	Klasa përgatitore në shkolla
Gjuhët dhe komunikimi	50 %	51 %	79 %	74 %	79 %	75 %
Matematikë	49%	53%	77%	75%	78 %	76%

Referuar gjetjeve nga analiza e planifikimeve mësimore për zbatimin e kurrikulës në klasën përgatitore, cilësia e planifikimeve mësimore për këtë klasë është sfiduar në masë të madhe nga:

- Mënyra e konceptimit dhe përmbajtjes së kurrikulave lëndore për këtë klasë;
- Mungesa e udhëzimeve të qarta për aplikimin e qasjes së integruar në planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës dhe mënyrën e shtrirjes së temave mësimore në planifikim;
- Mungesa e një udhëzuesi të veçantë për klasën përgatitore, duke pasur parasysh specifikat e kësaj klase, pavarësisht faktit që nga ana zyrtare është pjesë e shkallës së parë të kurrikulës;
- Trajtimi i planifikimit mësimor, si administratë, kundrejt faktit që planifikimi mësimor është një aktivitet parapërgatitor i organizimit të procesit mësimor, i cili parashikon kushtet e domosdoshme dhe veprimtaritë mësimore për një nxënie të suksesshme të nxënësve.

- Fokusimi më i madh në plotësimin e kërkesave teknike për zbatimin e kurrikulës, në të kuptuarit konceptit dhe filozofisë së kurrikulës së re, mundësive dhe qasjeve që duhet aplikuar.

Analizë e gjetjeve mbi planifikimin mësimor për klasën e dytë

Rezultatet e analizës tregojnë se planifikimet për këtë klasë u referohen formave të planifikimit të vendosura nga MASHT-i në udhëzuesin për mësimdhënës në klasën përgatitore dhe nivelin fillor, ato përmbajnë elementet kryesore për secilin nivel të planifikimit mësimor (vjetor, për periudhë mësimore, aktivitet/ orë mësimore). Planifikimet mësimore të analizuara për lëndët Gjuhë shqipe, Matematikë, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, kanë mbështetje në programet mësimore, por vërehet varësi e madhe ndaj teksteve mësimore për këto lëndë. Kjo është e dukshme, sidomos në zbërthimin e rezultateve të të nxënësve në njësi mësimore, ky njësitë mësimore kryesisht janë marrë nga teksti dhe në shumë raste nuk lidhen me temën/at e përcaktuar dhe nuk sigurojnë arritjen e rezultateve për tema mësimore.

Në planifikimet vjetore në lëndën e Gjuhës shqipe, shpërndarjen e temave mësimore, vërehet një tendencë e planifikimit sipas renditjes së temave në programin mësimor, p.sh. të gjitha temat e planifikuara për periudhën shtator – dhjetor janë tema që lidhen me konceptin ‘tekste letrare dhe jo letrare’, në anën tjetër asnjë temë që lidhte me konceptin ‘sistemi gjuhësor’, temat e të cilit janë në pjesën e fundit të programit mësimor – programit zyrtar për lëndën e gjuhës shqipe, klasa e dytë.

Ka planifikime vjetore në të cilat “*Vlerësimi i njohurive të nxënësve*” (sic) është temë mësimore e shpërndarë në secilën periudhë mësimore. Kjo lë të kuptohet se nga një numër i mësuesve të klasës së dytë nuk është kuptuar në esencë qasja metodologjike e planifikimit vjetor, përkatësisht e shtrirjes së temave mësimore të programit të lëndës përkatëse përgjatë një viti mësimor, varësisht nga nevoja për shtrirje dhe thellësia e trajtimit të përmbajtjes së saj në ndërlidhje me rezultatet e të nxënësve.

Në shumicën e planeve për periudha mësimore, njësitë mësimore janë marrë nga tekstet shkollore (nuk janë zbërthyer në bazë të rezultateve të të nxënit të lëndës mësimore). Po ashtu ka edhe mangësi në zbërthimin e njësive mësimore. Njësitë mësimore dalin krejt jashtë temave mësimore. Ato janë marrë nga teksti dhe nuk janë në harmoni me temat mësimore dhe nuk e sigurojnë arritjen e rezultateve mësimore.

Përshkrimi i metodologjisë së punës dhe vlerësimit është shumë i përgjithshëm, në shumë plane për periudha mësimore vetëm është kopjuar nga programi lëndor. Tek lidhja ndërlëndore shënohen vetëm lëndët mësimore (njëjtë në të gjitha periudhat), duke mos qartësuar lidhjen me temat përkatëse, lidhjen me situata nga jeta, etj. Ndërsa, te përshkrimi i burimeve dhe materialeve mësimore shënohen vetëm lëndët mësimore dhe materiale tjera, duke mos i specifikuar burimet apo materialet tjera.

Në planifikimet për orë mësimore, në një numër relativisht të madh ka mangësi në formulimin e rezultateve të nxënit për orë mësimore dhe formulimin e kriterëve të suksesit dhe në të shumtën e rasteve janë të njëjta. Përshkrimi i ecurisë së aktiviteteve në shumë raste nuk i kontribuon arritjes së rezultateve të të nxënit dhe hapave për arritjen e kriterëve të suksesit të orës mësimore. Vërehet përshkrim i mangët i lidhjes ndërlëndore dhe situatave nga jeta praktike.

Ashtu si në dëshmitë e planifikimit mësimor për klasën përgatitore, edhe në dëshmitë e planifikimit mësimor për klasën e dytë, kërkesat/ treguesit e planifikimit për periudha mësimore dhe orë mësimore, janë plotësuar në shkallë më të lartë, kundrejt kërkesave për planifikim mësimor vjetor. Tabela në vijim pasqyron një përmbledhje të mesatares së përmbushjes së të gjitha kërkesave/ treguesve për dëshmi të planifikimit mësimor vjetor, planifikimit për periudha mësimore dhe planifikimit për orë mësimore, në lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë, Njeriu dhe natyra dhe Shoqëria dhe mjedisi.

Tabela 22. Të dhëna përshkruese për plotësimin e kërkesave për planifikim mësor në klasën e dytë, shprehur në përqindje për fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Shkencat natyrore dhe Shoqëria dhe mjedisi

Fushat kurrikulare	Mesatarja e plotësimit të kërkesave		
	Planet vjetore - Klasa dytë	Planet për periudha mësimore / planet dymujore - Klasa dytë	Planifikimet e orës mësimore / aktivitete mësimore - Klasa dytë
Gjuhët dhe komunikimi	43 %	70 %	73 %
Matematikë	43 %	72 %	74 %
Shkencat natyrore	40 %	52 %	46 %
Shoqëria dhe mjedisi	38 %	48 %	44 %

Planifikime të orës mësimore për lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë për klasën e dytë janë siguruar nga shumica e shkollave, ndërsa për lëndët mësimore Njeriu dhe natyra, si dhe Shoqëria dhe mjedisi vetëm $\frac{1}{4}$ e shkollave kanë dorëzuar plane të orës mësimore. Kjo është një e dhënë që mësuesit e nivelit fillor planifikim të orës mësimore kryesisht e bëjnë për lëndët mësimore Gjuhë shqipe dhe Matematikë.

Referuar gjetjeve nga analiza e planifikimeve mësimore për zbatimin e kurrikulës në klasën e dytë, cilësia e planifikimeve mësimore edhe për këtë klasë është sfiduar nga elementet e njëjta të përshkruara për klasën përgatitore. Për dallim, në këtë klasë planifikimet mësimore për periudha mësimore/planet dymujore, kryesisht janë të orientuara në tekstet shkollore, të cilat nuk janë në përputhje me kurrikulën e re. Kjo përbën një sfidë më vete dhe vazhdon të pengojë të kuptuarit e konceptit dhe filozofisë së kurrikulës së re, mundësive dhe qasjeve që duhen aplikuar.

Analizë e gjetjeve mbi planifikimin mësor për klasën e shtatë

Dëshmitë e planifikimit mësor për zbatim të kurrikulës në klasën e shtatë tregojnë se planifikimet e mësimeve për këtë klasë iu referohen

formave të planifikimit të vendosura nga MASHT-i në udhëzuesit për mësimdhënës në fushat përkatëse të kurrikulës. Në përgjithësi, planifikimet mësimore për këtë klasë tregojnë se janë të mbështetura në kurrikula lëndore zyrtare, mirëpo në shumicën e planifikimeve mësimore sipas lëndëve mësimore, vërehet varësi e madhe në planifikim mësimor në raport me tekstet shkollore, kryesisht të klasës së shtatë. Referuar një numri relativisht të madh të planifikimeve për periudha mësimore/planifikimeve dymujore, vërehet se një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve, njësitë mësimore i përcaktojnë në bazë të teksteve shkollore dhe jo sipas rezultateve të të nxënit për tema mësimore (RNL) të përcaktuara me kurrikula lëndore për klasën dhe lëndën mësimore përkatëse. Në anën tjetër, në shumë raste njësitë mësimore nuk lidhen mirë me temën/at e përcaktuar brenda periudhës mësimore dhe nuk sigurojnë arritjen e rezultateve për tema mësimore.

Bashkëpunëtorët e angazhuar për analizë të dëshmimeve të planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës në klasën e shtatë kanë bërë analizë dhe vlerësim të planifikimit për secilën shkollë, për secilën lëndë, përfshirë edhe përshkrimin e situatës në raport me planifikimet e analizuara. Kështu përshkruhen situatat e planifikimit mësimor:

- *Kjo dosje konsideroj se është në përputhje me KB dhe Programin lëndor. Planifikimet shihet se janë bërë duke i shikuar dokumentet. Ajo çfarë ndoshta kushtimisht i mungon është kreativiteti në përshkrimin e metodologjisë, që është nevojë e shumë mësimdhënësve;*
- *Kjo shkollë e ka planin vjetor të vitit shkollor 2017/18, është plan i huazuar nga SHFMU, „N.N’’, nga një komunë tjetër, emri i shkollës prej nga vjen plani është fshirë dhe është shënuar emri i shkollës „N/N’’. Planifikimi mban në sfond logon e shkollës, që si duket mësimdhënësi nuk ka arritur ta fshijë. Në anën tjetër, planet për periudha mësimore janë të kombinuara nga dy shkolla të komunave të ndryshme.*
- *Siç po shihet nga këto planifikime, janë përdorur mirë programi lëndor dhe KB për të hartuar planet. Njësitë mësimore në planin dymujor janë hartuar kujdesshëm, duke i harmonizuar me rezultatet e lëndës/ temës dhe kohën, p.sh. mësimdhënësi ka planifikuar një njësi*

mësimore, por i ka dhënë hapësirë dy orë mësimore, që do të thotë se në harmoni me rezultatet e lëndës/temës ndonjëherë mjafton një njësi mësimore, por vështirë është e realizueshme. Gjithashtu, vlerësoj se edhe RNK janë përzgjedhur me kujdes dhe përgjegjësi.

- Shtrirja e temave nga programi lëndor nuk korrespondon me kronologjinë e lëndës ose me trajtimin tematik, qasje të cilat kanë lidhje logjike. Siç shihet në planin vjetor, temat janë të ndara sipas kohës do të thotë, kalendarit shkollor. Ndërkaq, në planin dymujor RNL nuk janë marrë nga programi lëndor, mirëpo janë hartuar nga mësimdhënësi, p.sh. tema (plani vjetor): Organizimi i jetës shoqërore në Mesjetë; Rezultati i temës/lëndës (nga programi lëndor): Ilustron aspektet e jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare; Në planin dymujor RNL figuron të jetë): “kuptoni dhe mësoni për qytetet mesjetare”??? Ky RNL fare nuk figuron në kurrikulën lëndore zyrtare.
- Plani vjetor është hartuar duke u bazuar në KB, sikur mos të ekzistonte fare programi lëndor. Po ashtu, edhe plani dymujor dhe ai i orës mësimore. Vërehet një seriozitet në planifikime, por shkollës i nevojitet që të pajiset me programin lëndor dhe të ndjekë trendët e ndryshimit dhe udhëzimet tjera të dhëna nga MASHT-i.
- Te plani vjetor janë përfshirë temat nga teksti mësimor, nuk është konsultuar fare programi lëndor e RNK janë shënuar paushallë. Te planet dymujore vërehet joseriozitet në planifikim dhe mospërfshirje e programit lëndor. Te planet e orëve vërehet një mënyrë e njëjtë e punës dhe një përfillje jo e mjaftueshme të RNK-ve dhe RNL-ve. Këta mësimdhënës kanë nevojë për ndjekje të trajnimit për zbatim të KKK-së.
- Planifikimi mësimor vjetor i kësaj shkolle, në këtë lëndë mësimore, është jashtë strukturës së planifikimit vjetor, me elemente të pakërkuara, dhe jashtë filozofisë dhe konceptit të KKK-së. Plani për periudha mësimore/dymujor ka strukturë sipas kurrikulës, por në vend të numrit të orëve mësimore shënohet tipi i orës mësimore; zhvillim, ushtrim, përsëritje. Planet ditore mbajnë strukturën e duhur, por

plotësimi me shkrim dore dhe i fotokopjuar nuk jep mundësi leximi dhe as analize.

- *Nga shkolla “B.B” është dorëzuar një planifikim vjetor, i fotokopjuar, i madhësisë fotografisë, i viteve kur është pilotuar kurrikula në 10 shkollat pilot, dhe vetëm është shlyer viti shkollor i atëhershëm dhe është shënuar viti shkollor 2018/2019, me laps të thjeshtë.*
- *Nga shkolla “D.D.” nuk kemi siguruar planin vjetor. Shkolla ka dorëzuar vetëm planifikimet dymujore. Planifikimi dymujor (shtator – tetor) është i viteve të kaluara, që nuk përputhet me strukturën e planit. Planifikimi tjetër dymujor (nëntor – dhjetor) ka strukturën e re, por jo i kompletuar, nuk mban tema, njësitë mësimore - nuk paraqesin njësi mësimore, si p.sh Kumtim dhe analizë e rezultateve të testit të parë (I). Përafërsisht i njëjtë është edhe planifikimi për janar – shkurt, mars-prill, ndërsa nuk është dorëzuar planifikimi për muajt maj – qershor.*

Pas analizës dhe vlerësimit individual të planifikimeve sipas shkollave, bashkëpunëtorët e angazhuar për analizë të dëshmimeve të planifikimit mësimor, për zbatimin e kurrikulës në klasën e shtatë, kanë identifikuar anët pozitive të përgjithshme dhe disa lëshime, të cilat në pjesën në vijim pasqyrohen në formë përmbledhëse.

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës në **lëndën e Gjuhës shqipe**, evidentohet se ekzistojnë disa modele të mira të planifikimeve mësimore në shkolla të caktuara, që janë të lidhura në mënyrë kronologjike dhe të sistemuara si duhet nga planet vjetore, planet për periudha mësimore /planet dymujore dhe planet për orë mësimore. Nuk ka dëshmi të mjaftueshme se plani vjetor është i harmonizuar me planet vjetore të lëndëve të fushës kurrikulare. Mirëpo, shpërndarja e temave mësimore në planet vjetore tregon për dallime të dukshme ndërmjet disa shkollave dhe se nuk ka një kriter të vendosjes së rezultateve për kompetenca që synohen të arrihen gjatë periudhave mësimore, në raport me rezultatet e të nxënit për tema mësimore.

Metodologjia e mësimdhënies, pasqyruar në planet e periudhave mësimore, nuk përmban gjithnjë metoda dhe teknika të mësimdhënies interaktive, që

janë relevante të ndihmojnë nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënit. Kurse, metodologjia e vlerësimit, e pasqyruar në planet e periudhave mësimore, nuk ka dëshmi të mjaftueshme për metodat, teknikat dhe instrumentet relevante të vlerësimit, që vërtetojnë nivelin e arritjeve dhe mbështetjen e të nxënit të nxënësve.

Shembujt e disa orëve mësimore nuk ofrojnë kahe për reflektim përmirësues të mësimdhënësit në raport me nxënës si në ngritjen e kreativitetit, udhëzimeve për detyra, qartësisë së detyrave, nxitjes së mendimit kritik, e pavarësisë në punën me nxënës. Thjesht janë rutina konsistente të përshkrimit nga programi lëndor dhe udhëzuesi.

Në dëshmitë e planifikimit vjetor për **lëndën e Gjuhës angleze** planifikimet në përgjithësi janë hartuar sipas tabelave nga udhëzuesi – MASHT. Në shumicën e planifikimeve, temat ,në planet për periudha mësimore/ planet dymujore janë në harmoni me planet vjetore, si dhe ndërlidhja e temave me rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore për shkallë është bërë saktë. Është evidentuar qasje e drejtë e metodologjive të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe ndërlidhjes me lëndët tjera.

Në anën tjetër, në dëshmitë e planifikimit shihet se planet vjetore për gjuhën angleze nuk janë hartuar në harmoni me lëndët tjera të fushës kurrikulare. Te shumica e planeve vjetore nuk është respektuar programi zyrtar i klasës përkatëse. Planifikimi i temave është bërë në bazë të librit ekzistues. Mësimdhënësit nuk kanë pasur qasje në ndërlidhjen e temave mësimore me rezultatet e temave, si dhe zbërthimin e njësive mësimore nga rezultatet e temave. Në një numër të madh të planeve dymujore është vërejtur se temat mësimore janë marrë nga libri ekzistues, rezultatet e temave nga programi lëndor dhe njësitë mësimore nga libri ekzistues dhe këtu nuk ka pasur ndërlidhje të temave me rezultatet. Metodologjitë e vlerësimit në shumicën e planeve nuk janë shkruar saktë, si dhe ndërlidhja me çështjet ndërkurrikulare te shumica e planeve nuk është vendosur fare. Në plane, si burime dhe materiale mësimore është shkruar “interneti”, duke mos konkretizuar linkun.

Mësimdhënësit kanë pasur vështirësi në hartimin e rezultateve të të nxënit për njësinë mësimore dhe vendosjen e kriterëve të suksesit, pasi në

shumicën e rasteve kanë qenë të njëjta. Vlerësimi nuk është bazuar në kriteret e suksesit, nuk ka qenë e qartë çka dhe si po vlerësohet, si dhe nuk është ofruar informata kthyesë. Mësimdhënësit nuk kanë qenë objektivë në reflektimin e orës mësimore.

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës në **lëndën e Gjuhës gjermane**, raportohet se rezultatet e lëndës përgjithësisht janë të mira. Temat që ofrohen mjaft mirë bazohen në kërkesat e Kurrikulës së Re të Kosovës dhe janë në bazë të Kornizës së Përbashkët Evropiane për Gjuhët. Përcaktim plotësisht i drejtë dhe sipas standardeve të literaturës për gjuhë gjermane në të gjitha shkollat (temat i plotësojnë standardet sa u takon moshës, nivelit, rezultateve, kompetencave). Numri i orëve është në proporcion me rezultatet e kërkuara. Përcaktim tërësisht i drejtë dhe sipas standardeve më të mira evropiane të niveleve gjuhësore, rezultateve, kompetencave që mund të arrihen brenda orës mësimore, brenda dymujorit, brenda periudhës, brenda vitit, brenda komplet viteve.

Në anën tjetër, lidhur me mangësitë/ anët e dobëta të evidentuara në planifikimet mësimore të analizuara/vlerësuara, raportohen: (i) Mungesa e planeve vjetore, ndërlidhjet brenda fushës. Temat dhe njësitet mësimore të ngatërruara. Rezultatet për lëndën, temat, apo njësitet mësimore nganjëherë nuk përshtaten. Disa programe përmbajnë pothuajse vetëm gramatikë. (Librat nuk e ofrojnë këtë, besoj kjo ka të bëjë vetëm me mosnjohuritë teknike, e jo përmbajtjesore); (ii) Mungesa e vlerësimit të katër shkathtësive gjuhësore. Mungesa e konsultimit me librat për mësimdhënësin për nivelin, rezultatet, temat, njësitet mësimore, kohëzgjatjen. Mungesa e konsultimit me Kurrikulën Bërthamë dhe dokumentet tjera përcjellëse për planet dhe rezultatet e reja; (iii) Shumë raste ‘copy paste’ e tabelave bashkë me përmbajtjen. Mungesë e trajnimeve për kurrikulë, apo dhe marrja e njohurive të gabuara, ose ndoshta interpretimi jo i drejtë i përmbajtjes së kompetencave.

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës në **lëndën e Artit muzikor**, vlerësohen pozitivisht të jenë: qasja ndaj planifikimit, shtrirja e temave në periudha mësimore, vendosja e rezultateve të kompetencave, kreativiteti i mësimdhënësve në përgatitjen e orës

mësimore, si dhe mjetet e konkretizimit të përshkuara për përdorim nga mësimdhënësit në arritjen e rezultateve. Nuk vërehet bashkëpunim në planifikim mësimor në raport me fushat tjera, nuk është e qartë në planet vjetore periudha kohore për përpunimin e përmbajtjeve të temave mësimore, si dhe në planifikimet nuk ka ndërlidhje të duhur të temave mësimore me lëndët e fushës përkatëse.

Në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës **në lëndën e Matematikës** raportohet se shumica e shkollave planifikimet mësimore i kanë punuar me përkushtim, shpërndarja e temave ishte bërë në harmoni me kalendarin vjetor mësimor dhe me numrin e përgjithshëm të orëve mësimore vjetore të lëndës së Matematikës për klasën e shtatë. Gjithashtu, raportohet se ka disa raste që gjatë planifikimeve RNK-të ishin shënuar si numra, pa u menduar fort se si do të zhvillohen dhe të maten. Në planifikimet mësimore vërehet varësi e madhe ndaj tekstit mësimor.

Duhet ndërmarrë masa që t'i evitojmë shabllonet, të bëhet thjeshtëzimi i formularëve për planifikimet për periudha/dymujore dhe planit të orës mësimore. RNF-të nuk është e nevojshme të shënohen, pasi janë hartuar programet lëndore (pasi ato janë të ndërlidhura me përmbajtjet mësimore dhe mendoj se këto rezultate janë të përfshira-zbërthyera te RNL-të, megjithëse këtë duhet ta kishin bërë hartuesit e programeve lëndore). Është mirë që shkollave t'u propozohet që planet vjetore dhe ato për periudha të hartohen në punëtori të përbashkëta, të organizuara nga shkollat apo DKA-të, në mënyrë që të mos ketë shumë laramani ndërmjet shkollave, edhe pse kjo nuk u vërejt në fushën/lëndën e Matematikës.

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës **në lëndën e Historisë**, raportohet se situata në terren dhe praktikë ka filluar të ndryshojë, për shkak se shkollat dhe mësimdhënësit po bëjnë përpjekje për t'u aftësuar t'i përdorin dokumentet e nevojshme gjatë hartimit të planifikimeve mësimore, e jo t'i përdorin tekstet shkollore. Përparësi tjetër raportohet të jetë përgatitja e planifikimeve mësimore të shkruara në formën softuerike dhe ky është një tregues i mirë, për shkak se mësimdhënësit dhe shkollat përdorin kompjuterët dhe kanë dëshmi të shkruara, duke mos i gjykuar përmbajtjet në këtë pikë. Temat që diskutohen nëpër shkolla nga

mësimdhënësit, vitet e fundit, kanë ndryshuar. Mësimdhënësit vërehet se janë duke diskutuar për ndryshimet që i ka sjellë reforma në arsimin parauniversitar. Ky ndryshim mund të duket jo i madh, mirëpo kjo qasje e mësimdhënësve, të cilët flasin dhe diskutojnë për ndryshimet, ngrit nivelin e diskutimeve të hapura dhe konstruktive, që si rezultat mendoj se mund të jetë rritja e shkallës së bashkëpunimit, i cili konsiderohet si çelës i tejkalimit të sfidave.

Në anën tjetër, si mangësi raportohet se nuk po kuptohet mjaftueshëm “filozofia” e KKK-së, e cila sjell dy ndryshimet e mëdha, si: mësimdhënie të bazuar në kompetenca, pra mësimdhënia duhet të planifikohet dhe të realizohet në mësimin praktik e jo përmbajtjesor, dhe të jetë e integruar, e cila kërkon bashkëpunim profesional – konstruktiv dhe planifikime të përbashkëta. Në bazë të analizës dhe vlerësimit të dosjeve, vërehet se rezultatet e kompetencave kryesore nuk analizohen, kuptohen dhe përdoren mjaftueshëm për të organizuar dhe planifikuar orën dhe aktivitetet në klasë. Nëse ato do ishin lexuar dhe kuptuar drejt nga mësimdhënësit, ata nuk do të duhej të kishin ndonjë vështirësi në planifikimin e aktiviteteve në klasë ose jashtë saj. RNK-të e përzgjedhura janë orientim për ta hartuar një plan të orës mësimore me aktivitete, në harmoni me “filozofinë” e KKK-së. Në këto dosje asnjë plan i orës mësimore nuk ishte në harmoni me kërkesat e kurrikulave. Mangësi tjera konsideroj se janë përgjegjësia dhe llogaridhënia gjatë përzgjedhjes së RNK-ve. Mësimdhënësit janë të lirë t’i zgjedhin vetë RNK-të dhe kur vendosin t’i shënojnë ato në planifikimet mësimore, ata duhet të marrin përgjegjësi se përmbajtjet e tyre mësimore do të jenë në harmoni dhe në shërbim të atyre rezultateve.

Si mangësi tjetër raportohet edhe tendenca e “kopjimit” ose bartjes së planifikimeve mësimore nga një shkollë në tjetrën, rrjedhimisht nga një mësimdhënës te tjetri, pa ndonjë tentim individual dhe profesional të secilit mësimdhënës se si do t’i arsyetojnë ose argumentojnë planifikimet e veta para koordinatorit/ës së cilësisë, ose kujtdo në shkollë që pranon ose mbledh planifikimet mësimore. Si pasojë e kësaj qasjeje, ka efekte tjera te mësimdhënësit, për shkak se po ushqehet jollogaridhënia, duke u “mbytur” kreativiteti i mësimdhënësve dhe duke u krijuar disa “shabllone”, të cilat nuk

janë në dobi as të vetë mësimdhënësve, shkollave, nxënësve, prindërve dhe krejt shoqërisë.

Raporti i analizës së dëshmimeve të planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës lëndore të **Edukatës qytetare** tregon se pjesa më e madhe e mësimdhënësve të kësaj lënde mësimore i kanë përgatitur dhe raportuar planifikimet në bazë të formatit të planifikimit të specifikuar në udhëzuesin për mësimdhënësit e fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi. Raportohet se ka modele të mira të planifikimit, vlejnë për t'u veçuar disa planifikime vjetore dhe disa modele të orës mësimore. Gjithashtu, raportohen disa mangësi të evidentuara, të cilat u referohen ngarkesës së mësimdhënësve dhe mungesës së plotë të njohurive për planifikim mësimor të bazuar në filozofinë e kurrikulës së bazuar në kompetenca.

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës **në lëndën e Kimisë**, raportohet se shumica e planifikimeve i përmbajnë elementet e kërkuara sipas kurrikulës së re. Rezultatet e të nxënësve për kompetencë janë përcaktuar me kujdes në shumicën e planeve vjetore. Në anën tjetër, raportohet se nga modelet e planifikimit të paraqitura vërehet se një pjesë e madhe e mësimdhënësve nuk e kuptojnë mirë funksionin e secilit element të paraqitur në këto plane. Ndërlidhja mes planeve vjetore-dymujore dhe planifikimeve të orës mësimore në shumicën e rasteve nuk është bërë si duhet, pra nuk kanë rrjedhur me logjikën që plani dymujor të zbërthehet nga plani vjetor dhe ai i orës mësimore nga plani dymujor. Në disa shkolla për planifikime nuk janë përdorur programet lëndore, të cilat janë esenciale për planifikime. Kriteret e suksesit vërehet të të gjitha planet që nuk janë kuptuar si duhet dhe si të tilla sjellin probleme në vlerësim dhe arritje të rezultateve. Burimet e dhëna në plane janë të mangëta dhe të paspecifikuara në të gjitha planet. Sa i përket ndërlidhjes me lëndët tjera, vetëm është paraqitur emri i lëndëve, pa u përfshirë edhe fusha e ndërlidhjes. Ndërlidhja me situata jetësore nuk është evidentuar në asnjë planifikim. Vërehet se bashkëpunimi mungon në planifikime (ose nuk ka bashkëpunim, ose nuk është përfshirë në dokumente).

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës **në lëndën e Biologjisë**, si përparësi është evidentuar se në të gjitha planifikimet

ishte respektuar struktura sipas modeleve të hartuara nga MASHT-i, si dhe ka përpjekje për punë sipas koncepteve kurrikulare. Ndërsa, janë raportuar si mangësi disa evidenca, si: (i) Planifikimet janë realizuar më shumë për shkak të kërkesës zyrtare, e jo si dokument që të ndihmojë apo të përcjellë punën e mësimeve; (ii) Rezultatet e kompetencave nuk analizohen, por vendosen pa ndonjë kriter; (iii) Lidhur me metodologjitë, më shumë shpjegohet se si punohet me teknikë sesa si po punohet në drejtim të rezultatit të nxënies; (v) Vlerësimi nuk është duke u përdorur për qëllimin e duhur, në raste të duhura; (vi) Kriteret e suksesit nuk janë kuptuar, ose së paku mungon aftësia e formulimit të tyre.

Raporti i analizës së dëshmive të planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës lëndore të **Fizikës** tregon se në përgjithësi planifikimet e mësimeve të lëndës së fizikës janë me formatin teknik të udhëzuar sipas udhëzuesit për mësimeve të fushës kurrikulare Shkencat e natyrës, mirëpo përmbajtja e planifikimeve të mësimeve tregon për sfida dhe probleme të shumta që kanë mësimeve në planifikimin mësimor për zbatim të programit të fizikës. Raportohet se të gjitha rezultatet e kompetencave të synuara, që evidentohen në planin vjetor, përsëriten në të gjitha planifikimet për periudha mësimore, që lë të kuptohet se rezultatet për kompetenca nuk analizohen, nuk kuptohet në thellësi qasja e planifikimit në funksion të arritjes së kompetencave, specifikat që kanë temat e aktuara dhe rezultatet e nxënies të temave të lëndës mësimore për arritjen e disa rezultateve specifike të kompetencave.

Gjithashtu, raportohet se ka shprehur ndërmjet planifikimit vjetor dhe planifikimeve për periudha mësimore, mungon harmonizimi me lëndët e fushës (Kimi dhe Biologji), njësitet mësimore nuk dalin nga RNL, ato kryesisht janë përshkruar sipas librit. Po ashtu, raportohet se metodologjia e mësimeve dhe vlerësimit, ndërlidhja me lëndët tjera mësimore, planifikimi i burimeve dhe materialeve të nevojshme, shënohen dhe përsëriten në të gjitha planifikimet për periudha mësimore, pa u zbrëthyer.

Problemet tjera që raportohen lidhen me planifikimet për orë mësimore, vlejnjë të veçohen rezultatet e nxënies dhe kriteret e suksesit, të cilat, në të shumtën e rasteve, nuk janë në harmoni me RNL. Sipas raportit të analizës

së planifikimit mësimor për lëndën e Fizikës (klasa shtatë), një numër i madh i modeleve të planifikimit të orës mësimore nuk pasqyrojnë kreativitetin e mësimdhënësve, në shumë raste ato punohen vetëm sa për ta pasur planin dhe për ta prezantuar atë zyrtarisht para organeve të shkollës.

Bazuar në dëshmitë e planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës në fushën kurrikulare **Jeta dhe puna/** Teknologji me TIK/, evidentohet se ekzistojnë disa modele të mira të planifikimeve mësimore në shkolla të caktuara, që janë të lidhura, të sistemuara sipas kërkesave të strukturës së planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës. Mirëpo, në një numër relativisht të madh të planifikimeve, nuk është përfillur fare programi i kurrikulës lëndore dhe fryma e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Në këto planifikime kryesisht janë përdorur librat si bazë e planifikimit mësimor vjetor dhe gjithashtu rezultatet e lëndës në planifikimet për periudha mësimore janë hartuar nga vetë mësimdhënësit, jo sipas kurrikulës lëndore.

Edhe dëshmitë e analizuara për planifikimin mësimor për zbatimin e kurrikulës në fushën kurrikulare **Edukata fizike, sportet dhe shëndeti** tregojnë anët pozitive dhe mangësitë e evidentuara. Nga analiza e dëshmimeve të planifikimit raportohet se shumica e mësimdhënësve i përdorin modelet e planifikimit mësimor sipas udhëzuesit për mësimdhënës në këtë fushë kurrikulare, si dhe vërehet përpjekje e mësimdhënësve për t'i plotësuar kërkesat bazike në planifikim. Në anën tjetër, raportohet se ka mangësi evidente si në shtrirjen e temave mësimore në planin vjetor, ashtu edhe në zbërthimin e rezultateve të të nxëniet në njësi mësimore, ndërlidhjen me metodologji të mësimdhënies dhe me vlerësimin. Gjithashtu, raportohet se në disa planifikime janë modele të vjetra të fazës së pilotimit dhe se shumica e planifikimeve nuk janë hartuar mbi bazën e kurrikulës lëndore, por në bazë të teksteve shkollore.

Raporti i analizës së dëshmimeve të planifikimit mësimor për zbatimin e **kurrikulës me zgjedhje** tregon se shumica e shkollave të përfshira në këtë studim kanë prezantuar planet vjetore me përmbajtje të temave mësimore, numrin e orëve për tema mësimore dhe shtrirjen e temave përgjatë periudhave të vitit mësimor. Planet për periudha mësimore/planet dymujore të analizuara përmbajnë rezultatet për kompetenca që synohen të arrihen, në

ndërlidhje me temat mësimore përmbajnë metodologjinë e mësimdhënies, metodologjinë e vlerësimit, ndërlidhjen me lëndët tjera mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore.

Sipas raportit të analizës së dëshmimeve të planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje, raportohet se një numër i madh i shkollave emërtojnë lëndën e kurrikulës me zgjedhje me emërtim të njëjtë si lëndët mësimore bazike, p.sh. Matematika, Gjuha angleze, pa ndonjë specifike që tregon se është zgjedhur një domen/fushë specifike e lëndëve bazike për ta integruar në kurrikulën me zgjedhje. Gjithashtu, raporti i analizës tregon për disa shkëputje ndërmjet planifikimit vjetor dhe planifikimeve për periudha mësimore/planeve dymujore, për këtë të fundit janë ofruar pak dëshmi për planet e periudhës së dytë mësimore (janar – mars) dhe periudhës së tretë (prill – qershor). Në disa raste, planet për periudha mësimore në pjesën hyrëse para tabelës janë krejtësisht identike me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare dhe për kompetencat kryesore të shkallës së të nxënit që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave. Po ashtu metodologjia e mësimdhënies dhe ajo e vlerësimit përshkruhen në shkallë mesatare dhe janë identike në shumë plane të prezantuara. Shumë shkolla nuk kanë dorëzuar asnjë plan për orë mësimore, vetëm disa nga to kanë dorëzuar vetëm nga një plan për orë mësimore, ku pjesa më e madhe e tyre kriteret e kërkuara i kanë arritur në nivel minimal.

Përmbledhje e analizës së planifikimeve mësimore për të gjitha fushat kurrikulare/ lëndët mësimore – klasa 7

Tabela në vijim pasqyron një përmbledhje të mesatares së përmbushjes së të gjitha kërkesave/ treguesve të analizuar dhe vlerësuar për planifikimet mësimore, përkatësisht planet vjetore, planet për periudha mësimore / planet dymujore dhe planifikimit për orë mësimore. Rezultatet i referohen planifikimeve mësimore për klasën e 7-të, me përjashtim të lëndës së Gjuhës frënge dhe Artit figurativ, për të cilat nuk është arritur të bëhet analiza e tyre.

Tabela 23. Të dhëna përshkruese për plotësimin e kërkesave për planifikim mësimor në klasën e shtatë, shprehur në përqindje

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore / klasa 7	Mesatarja e plotësimit të kërkesave		
		Planet vjetore	Planet për periudha mësimore / planet dymujore	Planifikimet e orës mësimore
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë amtare	66 %	69 %	71 %
	Gjuhë e huaj/ gjuhë angleze	47 %	55 %	57 %
	Gjuhë e dytë e huaj / gjuhë gjermane	58 %	61 %	61 %
	Gjuhë e dytë e huaj / gjuhë frënge	Nuk janë analizuar		
Artet	Art muzikor	61 %	75 %	74 %
	Art figurativ	Nuk janë analizuar		
Matematikë	Matematikë	71 %	66 %	58 %
Shkencat natyrore	Fizikë	55 %	56 %	41 %
	Kimi	68 %	63 %	42 %
	Biologji	49 %	63 %	40 %
Shoqëria dhe mjedisi	Histori	50 %	60 %	55 %
	Gjeografi	42 %	59 %	43 %
	Edukatë qytetare	49 %	47 %	51 %
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	41 %	50 %	35 %
Jeta dhe puna	Teknologji me TIK	65%	60 %	45 %
Pjesa zgjedhore	Pjesa zgjedhore	63 %	68%	33 %
Në nivel klase		56 %	61%	50 %

Përveç analizës specifike për fusha kurrikulare / lëndë mësimore, është bërë një përmbledhje e përgjithshme e të gjitha planifikimeve të analizuara, për të përcaktuar nivelin e plotësimit të kërkesave të planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës. Edhe në këtë analizë nuk janë përfshirë shkollat prej së cilave kanë munguar dëshmitë e planifikimit. Përcaktimi i shkallës së nivelit është bërë në bazë të kriterëve, në tri nivele, niveli minimal, niveli mesatar dhe niveli i lartë i plotësimit të kërkesave për planifikim mësimor. Për të përcaktuar këto nivele, janë përdorur raportet e vlerësimit për mbi 180 planifikime vjetore, mbi 210 planifikime për periudha mësimore/planifikime dymujore dhe mbi 160 planifikime për orë mësimore.

Tabela në vijim pasqyron tri lloje të planifikimit mësimor për zbatimin e kurrikulës dhe nivelet e plotësimit të kërkesave për secilin lloj të planifikimit.

Tabela 24. *Të dhënat përshkruese për nivelin e përgjithshëm të plotësimit të kërkesave të planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës*

Planifikimi mësimor	Niveli i plotësimit të kërkesave të planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës		
	Nivel minimal i plotësimit të kërkesave (deri në 49 %)	Nivel mesatar i plotësimit të kërkesave (50 – 80 %)	Nivel i lartë i plotësimit të kërkesave (mbi 80%)
Planifikimi vjetor	38.3 %	42.1 %	19.7 %
Planifikimi për periudha mësimore / planifikimi dymujor	33.7 %	43.7 %	22.6 %
Planifikimi për orë mësimore	45.8 %	40.6 %	13.5 %

Analizë e gjetjeve mbi dokumentimin e PIA-s

Pjesë e analizës së dokumentimit për planifikim mësimor për zbatim të kurrikulës ishin edhe PIA. Nga të gjitha shkollat e përfshira në studim, janë mbledhur 17 PIA, 14 plane për nxënësit me aftësi të kufizuara, ndërsa 3 plane për nxënësit me talente të jashtëzakonshme.

Analiza e PIA-s është bërë në 6 fusha: (i) Pjesa administrative; (ii) Pjesa pedagogjike; (iii) Pjesa rehabilituese; (iv) Planifikimi i tranzicionit; (v) Raporti i përgjithshëm vjetor i vlerësimit të arritjes së rezultateve të të nxënës; dhe (vi) Rishikimi i parë dhe rishikimi i dytë.

Sipas formës së përmbajtjes, planet individuale të shqyrtuara rezultojnë të jenë: 11 plane (64,70%) sipas formës së dokumentit të rishikuar të PIA-s (Forma e Planit Individual të Arsimit, 2017) e përshtatur sipas kurrikulës së re, 3 plane (17,64%) sipas formës së mëparshme (PIA konfidenciale), 2 plane (11,70%) - forma të PIA-ve që nuk përmbajnë të gjitha kriteret e dokumentit të PIA-s zyrtare (nuk janë të kompletuara apo janë të përziera)

dhe 1 plan individual (5.88%) sipas modelit të ATOMI-t (në çdo faqe të dokumentit figuron mbishkrimi ATOMI).

Nga këto plane, 41.1% janë hartuar për një lëndë të individualizuar, 41.1% janë hartuar për dy lëndë, 11.7% për tri lëndë, ndërsa 5.8% është plan i përgjithësuar - pa specifikuar lëndën apo fushën.

Pjesa administrative – sipas gjetjeve në 23.5% të PIA është e plotësuar me informata të nivelit të lartë, por në pjesën tjetër të PIA-ve janë dhënë informata të mangëta, të pjesshme apo edhe mungojnë fare këto informata, p.sh.: tek disa PIA mungojnë informata për historikun e shkollimit paraprak; tek disa gjendja shëndetësore paraprake dhe aktuale: si p.sh. rekomandimet mjekësore, intervenimet, rehabilitimi, terapitë apo shërbimet tjera, të cilat i përfiton nxënësi në faza të caktuara dhe përgjegjësit e shkollës; tek disa PIA nuk ka informata për institucionin arsimor në të cilin nxënësi vijon mësimin-orarin e plotë apo të pjesshëm; shërbimet brenda dhe jashtë institucioneve edukativo – arsimore etj.

Pjesa Pedagogjike e PIA - në këtë pjesë ka dallime sa i përket nivelit të përshkrimit të informatave, në kritere të ndryshme, p.sh.:

- *Niveli i gjendjes aktuale në pesë fushat e zhvillimit* është përshkruar në shumicën e PIA, por në mënyrë kryesisht sipërfaqësore, ndërsa mungojnë informatat nëse vlerësimi i referohet ekipit vlerësues komunal apo ndonjë aktori tjetër dhe rekomandimet (vetëm në 5.8% të planeve individuale është përshkruar në detaje niveli i fushave të zhvillimit dhe rekomandimet duke iu referuar ekipit vlerësues komunal). Po ashtu, mungon edhe data e vlerësimit në shumicën nga PIA.
- *Qëllimi* - Në 23,5% të rasteve qëllimi është përshkruar në formë korrekte, në 29.4% nuk është plotësuar fare kjo rubrikë, ndërsa te pjesa tjetër përshkrimi i qëllimit të procesit mësimor është në vija të përgjithshme apo jo i qartë.

Lëndët e individualizuara - pavarësisht nga forma e PIA-ve, të gjitha PIA e shqyrtuara (100%) përmbajnë planin për lëndët e përcaktuara. Varësisht nga përcaktimi – në një, dy apo tri lëndë të

individualizuara, janë dhënë informata për *aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësit për lëndë dhe nevojat arsimore, metodat dhe materialet didaktike.*

- Rezultatet e të nxënësit nuk janë shënuar në 17.6% të rasteve, ndërsa në 29.4% të planeve janë në formën e objektivave mësimore. Po ashtu, *rezultatet e të nxënësit* - objektivat mësimore në rreth 23.5% të rasteve janë të përgjithshme – jo specifike. *Numri i orëve mësimore* në disa raste është shënuar, por që nuk dallon nga numri i orëve i përcaktuar me kurrikulë të rregullt. Ndërsa në shumicën e rasteve nuk janë dhënë informata të detajuara për *mbështetjen*, nëse merr nxënësi nga resurset brenda dhe jashtë institucionit.
- *Metodat e vlerësimit të nxënësit* janë shënuar në rreth 88.7% të rasteve, ndërsa rreth 17.6% të PIA kanë të bashkëngjitur edhe instrumente të vlerësimit - testin e vlerësimit.
- *Përshkrimi i nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënësit* në shumicën e rasteve është në formë të përgjithshme, ndërsa në rreth 23.5% të PIA mungojnë këto informata.

Pjesa rehabilituese - Në PIA të analizuar vetëm 17.6% janë dhënë disa informata për shërbimet rehabilituese, si, p.sh. emri i OJQ apo edhe është cekur ndonjë shërbim, i cili i ofrohet nxënësit, por nuk ka informata apo raport të bashkëngjitur, të cilit i referohet apo bashkëpunon ekipi hartues i PIA, ndërsa pjesa tjetër e PIA-ve nuk kanë dhënë ndonjë informatë nëse nxënësit kanë apo nuk kanë nevojë apo mundësi ofrimi të trajtimeve rehabilituese.

Planifikimi i tranzicionit – vetëm në një PIA janë dhënë informata për përgatitje dhe planifikim në mbështetje të nxënësit për fazën e tranzicionit. Ndërsa, në rastet tjera nuk është plotësuar kjo fletë e formës së PIA-s dhe nuk ka informata nëse ka pasuar apo jo nevojë për këtë pjesë të planifikimit.

Raporti i përgjithshëm i vlerësimit të arritjes së rezultateve të të nxënësit – në tri raste të PIA –ve kanë plotësuar në mënyrë sipërfaqësore raportin e arritjes së rezultateve të nxënësit për gjysmëvjetorin e parë (pasi që mbledhja

e të dhënave është realizuar para përfundimit të vitit), ndërsa për pjesën tjetër nuk ka të dhëna.

Hartimi dhe rishikimi i PIA - Marrja e përgjegjësive për planifikim zbatim dhe rishikim të PIA dëshmohej nga nënshkruesit e dokumentit. Sipas gjetjeve, 11.7% të PIA-ve janë të plotësuar sipas kriterëve të PIA-s, në të cilët figurojnë nënshkrimet e anëtarëve të ekipit, si dhe datat e hartimit dhe rishikimit të PIA-s, ndërsa, të tjerat kanë shumë mangësi, si, p.sh.: mungojnë nënshkrimet e ekipit hartues, mungon nënshkrimi i prindit, data e rishikimit mungon ose është e njëjta me datën e hartimit, mungon raporti i rishikimit. Nënshkrimi i drejtorit dhe vula e institucionit për miratimin e dokumentit figurojnë në 23.5% të rasteve, ndërsa te pjesa tjetër mungon vula apo mungon fare edhe nënshkrimi nga ana e drejtorit.

Nga të gjitha PIA-t e analizuara, tri prej tyre janë shoqëruar me dosjet e nxënësve, të cilat janë dëshmi e përshtatjes së materialit mësimor dhe punës së individualizuar. Gjithashtu, vlerësohet pozitivisht marrja e përgjegjësive nga ana e shkollës – iniciativat e mësimdhënësve dhe vetëdijesimi i prindërve për hartimin e PIA-s për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, përdorimi i formës zyrtare të PIA-s dhe udhëzuesi për hartimin e PIA-s, si dhe niveli i plotësimit të pjesëve të ndryshme në disa PIA.

Në anën tjetër, analiza dhe vlerësimi i dokumentimit të PIA-ve, të siguruara nga shkollat e përfshira në këtë studim, evidentojnë edhe **disa mangësi/ anë të dobëta lidhur me cilësinë e tyre**, si:

- Planet individuale të shqyrtuara nuk kanë ndonjë shenjë identifikimi për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe ata me talente;
- Forma ekzistuese e PIA nuk është e përshtatshme edhe për nxënësit me talente;
- Asnjë PIA nuk është hartuar plotësisht sipas kriterëve të udhëzuesit për hartimin e PIA, edhe pse disa PIA janë në nivel më të lartë (Vetëm 38.8% të planeve individuale kanë arritur numrin e pikëve mbi 50% të vlerës maksimale të përcaktuar);

- Mungojnë faktet e bashkëpunimit me ekipet vlerësuese komunale apo ekspertë të ndryshëm jashtë institucionit (dyshohet se në shumicën e rasteve PIA hartohet vetëm nga mësimmshënësi;
- Pjesët e PIA, në të cilat kërkohet të shprehurit me shkrim dhe informata të detajuara, kryesisht janë të cekëta, të mangëta, të përgjithshme apo mungojnë fare,(krahasuar me pjesët në të cilat kërkohet të piketohen opsionet e mundshme - të cilat kryesisht janë plotësuar);
- Nga shumica e PIA-ve nuk mund të identifkohet plotësisht gjendja e nxënësit;
- Në disa PIA, sipas përshkrimit të gjendjes së nxënësve, numri i lëndëve të individualizuara nuk i plotëson nevojat e nxënësve.
- Më disa PIA mungon data e hartimit, rishikimit, apo janë datat e njëjta të hartimit dhe rishikimit.
- Në shumicën e PIA-ve, mungojnë raportet e përgjithshme për të nxënëit e nxënësve, ose nuk kanë informata të hollësishme.

KAPITULLI I PESTË: DISKUTIM I REZULTATEVE

Ky kapitull paraqet diskutimet, interpretimet dhe vlerësimet lidhur me rezultatet e studimit për: (i) *Udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës*; (ii) *Informimin dhe konsultimet për kurrikulën e re /programet e reja mësimore*; (iii) *Zhvillimin profesional – trajnimet për zbatimin e kurrikulës*; (iv) *Ndryshimet në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re*; (v) *Ndryshimin e qasjes në mësimdhënie*; (vi) *Pranimin apo besimin e mësimdhënësve për kurrikulën e re*; (vii) *Monitorimin e zbatimit të kurrikulës*; (viii) *Dokumentimin nga shkollat për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës dhe planifikimin mësimor për zbatim të kurrikulës*; (ix) *Arritjet në zbatimin e kurrikulës së re, sfidat dhe problemet (një përmbledhje e pikëpamjeve të respondentëve)*; dhe (x) *Parashikimin sipas respondentëve të studimit për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle*.

5.1. Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës

Zbatimi me sukses i reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar kërkon angazhim të të gjitha strukturave arsimore që lidhen me këtë nivel të arsimit, nga niveli qendror deri në nivel shkolle, kërkon udhëheqje të procesit, objektiva të qarta dhe drejtim të duhur. Parimet e Kornizës Kurrikulare²³ janë pikë referimi për zhvillimin e kurrikulave lëndore dhe të dokumenteve përcjellëse për zbatimin e tyre, organizimin e strukturave menaxhuese, udhëheqjen e shkollës, planifikimin, praktikën e mësimdhënies dhe nxënies etj.

Udhëheqja e zbatimit të kurrikulës duket se përballet me sfida të njëjta, që gjenden në të gjitha projektet e zhvillimit shkollor (Fullan, 2007; Huusko, Pietarinen, Pyhältö & Soini 2007; Lewin & Fullan 2008; Manninen 2008; Manninen & Luukannel 2008; Atjonen, Manninen, Mäkinen & Vanhalakka -Ruoho vitin 2011). Çdo proces i madh i përtëritjes është i vështirë për t'u zbatuar në praktikë, sepse gjithmonë ka rezistencë ndaj ndryshimeve. Në anën tjetër, ndërtimi i qëndrueshmërisë së proceseve në gjithë sistemin është

²³ (i) Gjithëpërfshirja; (ii) Zhvillimi i kompetencave; (iii) Mësimdhënia dhe nxënia e integruar; (iv) Autonomia dhe fleksibiliteti; dhe (v) Përgjegjësia dhe llogaridhënia.

i vështirë dhe thelbësor për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shkollave në shkallë vendi (Eugene Schaffer, 2017, f. 3).

Udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021, i hartuar nga MASHT-i me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit, ishte dokumenti kryesor orientues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, me objektiva dhe aktivitete të përcaktuara për secilin vit, si dhe për bartësit e tyre, si: MASHT-in, Inspektoratin e Arsimit, DKA-të, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit, i pashfrytëzuar mjaftueshëm dhe i neglizhuar nga niveli qendror, MASHT-i.

Nga rezultatet e studimit, konfirmohet se disa nga aktivitetet për zbatim të kurrikulës janë zhvilluar duke u bazuar në udhërrëfyes (2016-2021), por jo në përmbajtjen e tij dhe në kalendarin kohor të planifikuar. Kjo u konfirmua nga vetë zyrtarët e arsimit në MASHT, sipas të cilëve ata nuk i janë përmbajtur këtij dokumenti, me arsyetimin *se dokumenti i udhërrëfyesit është bërë pasi që ka filluar procesi, një dokument i tillë duhet të bëhet para fillimit të procesit. Ky dokument është bërë me kërkesë e zyrës sonë dhe dihet se si është bërë, për faqe të zezë.*

Nga analiza e diskutimeve me fokus-grup të zyrtarëve arsimorë në MASHT, konstatohet se MASHT-i nuk ka një komision/këshillë apo grup punues që ka udhëhequr procesin e zbatimit të kurrikulës. Rolin udhëheqës për zbatimin e kurrikulës nuk e ka luajtur as Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, me arsyetimin se përshkrimi i detyrave të punës për Divizionin e kurrikulave dhe mbështetje të mësuesve nuk lidhet me udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, ka të bëjë vetëm me zhvillimin e kurrikulave lëndore. Kështu, Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT konfirmon se tani për tani janë të fokusuar vetëm në zhvillimin e programeve lëndore, edhe atë me mungesë të resurseve dhe përkrahjes së nevojshme. Këtë rol nuk e ka kryer as Këshilli i ekspertëve për programe dhe tekste shkollore, i cili në emërtim ka mbajtur edhe punën me programe mësimore, por në përmbajtje të vendimit, në përmbajtje të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe të rregullores së punës, e gjithë puna e

këtij këshilli është lidhur vetëm me tekste shkollore²⁴. Pjesë e Këshillit janë edhe dy përfaqësues të Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT.

Në mungesë të një trupe udhëheqëse dhe koordinuese, nuk është që nuk janë realizuar një numër i aktiviteteve nga sektorë të ndryshëm në MASHT, veçanërisht nga Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, por ato në raport me procesin e zbatimit të kurrikulës janë të fragmentuara, nuk janë sektoriale dhe ndërsektoriale (Departamenti i Arsimit Parauniversitar, Inspektorati i Arsimit dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës), nuk janë të koordinuara mirë, dhe nuk sigurojnë informata kthyesë për përmbushjen e roleve dhe përgjegjësi të të gjitha palëve të parapara me udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës.

Ekziston mendimi i argumentuar, si nga zyrtarët e arsimit në MASHT, ashtu edhe nga njohësit e kurrikulës të intervistuar, se ka munguar përkushtimi i MASHT-it për përgatitjen e sistemit për reformën kurrikulare, reforma kurrikulare nuk është udhëhequr dhe nuk është duke u udhëhequr nga bartësit kryesorë dhe personat përgjegjës në MASHT. Nuk ka një mekanizëm që diskuton në mënyrë të vazhdueshme me palë të interesit, në mënyrë që të krijohet të kuptuarit e përbashkët për konceptin, përmbajtjen dhe procesin e zbatimit të kurrikulës.

Sipas njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare, janë bërë disa hapa të gabuar në udhëheqjen e procesit të reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj në praktikë, si: (i) ka filluar hartimi i kurrikulës pa e vlerësuar mirë gjendjen me kurrikulën paraprake dhe kontekstin dhe mundësitë për ta zbatuar kurrikulën e re; (ii) janë bërë plane ambicioze për reformën kurrikulare pa ekspertizën dhe kapacitetet e duhura (përfshirë ato institucionale); (iii) ka filluar pa përgatitje të duhura në ndërtimin e strukturave udhëheqëse, mekanizmave mbështetës, etj.; (iv) kanë filluar pilotimi dhe shtrirja e zbatimit të kurrikulës pa përgatitje të teksteve shkollore dhe infrastrukturës përcjellëse, për të zbatuar kurrikulën e re etj.

²⁴ Vendimi nr 251 për emërimin e Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/04/vendim-refnr-251-01b-dt-090218-per-emerimin-e-keptsh-251.pdf>) ,

Koordinatorët e cilësisë (KC) në komuna konfirmojnë se DKA-të në nivelin aktual të organizimit nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të udhëhequr zbatim e kurrikulës në nivel komune, për arsye të mungesës së strukturave profesionale për të mbuluar çështjet që lidhen me kurrikulën dhe për mungesë të përgatitjes së duhur profesionale të zyrtarëve arsimorë. Pjesa më e madhe e tyre nuk janë përfshirë në programe trajnimi, për të kuptuar me bazë filozofinë dhe kërkesat e kurrikulës, si dhe rolin e tyre në proceset që lidhen me zbatimin e kurrikulës në nivel komune.

Në anën tjetër, udhëheqësit e shkollave, koordinatorët e cilësisë në shkolla, kryetarët e aktiveve profesionale, udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës e shohin nga një perspektivë dhe përgjegjësi e jashtme, e cila nuk ka funksionuar dhe nuk i ka përkrahur ata në përgatitjet për zbatimin e kurrikulës dhe në tejkalimin e sfidave dhe problemeve, me të cilat janë ballafaquar gjatë zbatimit. Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle duket se theksohet më shumë në aspektin e bashkëpunimit të mësimdhënësve për planifikime mësimore sesa në aspektin e udhëheqjes së ndryshimeve në nivel shkolle. Bashkëpunimi në mes të mësimdhënësve, i cili në nivel shkolle veçohet si rezultat i udhëheqjes, duket më shumë si një plotësim i një kërkesë dhe nevojë të lidhur me qasjen ndaj planifikimit të kurrikulës, sesa një kulturë e bashkëpunimit kolegial brenda një procesi të ndryshimeve.

Nga analiza e planeve strategjike dhe raporteve të lidhura me zbatimin e kurrikulës, si dhe përpunimi i rezultateve të studimit me të gjithë aktorët pjesëmarrës në studim, shihet se procesin e udhëheqjes së zbatimit të reformës kurrikulare në Kosovë e karakterizon një qasje e fragmentuar. Kjo për faktin se nuk janë konsoliduar mekanizmat e nevojshëm për udhëheqje të procesit, monitorim dhe mbështetje të shkollave dhe mësimdhënësve, si dhe nuk ka bashkërendim institucional dhe ndërsektorial për të mbuluar të gjitha aspektet e rëndësishme të intervenimit të nevojshëm, si në nivel qendror, në atë lokal, dhe në nivel shkolle. Për më tepër, agjenda e zbatimit të kurrikulës në masë të madhe udhëhiqet nga prioritetet e donatorëve (Boshtrakaj, L., 2018, f. 30). Kjo shpesh është reflektuar për shkak të qasjes në udhëheqje dhe vonesave në realizimin e planifikimeve nga MASHT-i.

5.2. Informimi dhe konsultimet për kurrikulën e re /programet e reja mësimore

Nga rezultatet e studimit me zyrtarë arsimorë në MASHT, KC në DKA, drejtorë të shkollave dhe udhëheqësit e AP, njohës të arsimit dhe reformës kurrikulare, konfirmohet se procesi i informimit dhe konsultimet për kurrikulën e re /programet e reja mësimore është i lidhur me udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, proces i cili është përcjellë me mangësi, mungesë informimi dhe shpesh me informata të gabuara ose me paqartësi, të cilat kanë shkaktuar dilema për shkollat. Kështu raportohet në pyetësorët dhe intervistat me drejtorë të shkollave, udhëheqës të AK dhe KC në shkolla.

Procesi i informimit dhe konsultimeve me shkollat është përshkruar me dallime në raport me fazat e zbatimit të kurrikulës, në raport me rolin që kanë pasur gjatë këtyre viteve, por edhe në raport me cilësisë e trajnerëve (përfaqësuesit nga shkollat). Materialet e zhvilluara, si kurrikulat lëndore, udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës, si dhe udhëzues të tjerë, vlerësohen si resurse të informimit, të cilat janë shpërndarë gjatë trajnimeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit me shkollat, por që nuk kanë zëvendësuar format tjera standarde të informimit dhe të konsultimeve për procese të ndryshimeve të mëdha, siç është procesi i ndryshimit të kurrikulës. Edhe kur janë organizuar aktivitete të informimit dhe të konsultimeve me shkollat, sipas materialeve të analizuara, përqendrimi ishte më shumë në nivelin e zbatimit të kurrikulës sesa vendosjen e debatit në një nivel më konceptual të vlerave dhe aspiratave që u shërben kurrikula e re (Saqipi, B., 2019, f. 44).

Për aspektet e informimit dhe konsultimeve që zhvillohen në nivel shkolle për zbatimin e kurrikulës së re, drejtuesve të shkollave u është kërkuar informacion lidhur me praktikën shkollore për informimin e komunitetit shkollor, përgatitjen e materialeve informative për prindër, nxënës dhe mësimdhënës. Rezulton se në nivel shkolle fare pak zhvillohen materiale informimi për këtë proces, kryesisht janë përdorur dokumentet zyrtare të kurrikulës, udhëzuesit për mësimdhënës, si dhe informacionet nga trajnimet që i kanë përdorur për të informuar komunitetin shkollor (nxënësit, prindërit, mësimdhënësit etj.). Madje konfirmohet se shpesh kanë kërkesa për informacione shtesë dhe nuk adresë të qartë për të marrë përgjigje, kanë probleme në sigurimin e dokumenteve dhe informacioneve shtesë në faqen

zyrtare të MASHT-it, e cila përshkruhet me mungesë të informacioneve për kurrikulë, me mungesë të organizimit të dokumenteve të kurrikulës në një link të faqes zyrtare, të cilat në situatën aktuale janë të shpërndara, vështirë të gjinden nga përdoruesit jashtë MASHT-it (DKA-të, shkollat/udhëheqësit, mësime dhënësit, prindërit, përfaqësuesit e komunitetit etj.) dhe shkarkohen për përdorim praktik, sipas nevojës. Kjo e fundit konfirmohet edhe nga vetë zyrtarët e Divizionit për kurrikula në MASHT, të cilët shprehen se kanë insistuar shumë herë që të pasurohet faqja me informacione rreth procesit të zbatimit të kurrikulës dhe me përcjellje të dokumenteve përkatëse, por nuk kanë gjetur mbështetje.

Sa u përket konsultimeve lidhur me kurrikulën e re/programet e reja mësimore, konfirmohet se procesi i konsultimeve të brendshme është konsoliduar dhe është në ngritje. Përpunimi i rezultateve nga pyetësi me mësime dhënësit tregoi se rreth 78% e personelit të shkollës pohojnë se kanë përfituar nga konsultimet dhe u është ofruar mbështetje profesionale brenda shkollës, ndërsa mbi 22 % e personelit të shkollës pohojnë se gjatë zbatimit të kurrikulës asnjëherë nuk u është ofruar mbështetje profesionale brenda shkollës. Përtej trajnimeve që kanë ndjekur, mbi 53 % e personelit të shkollës konfirmojnë se kanë përfituar edhe nga konsultimet dhe mbështetja profesionale jashtë shkollës (kryesisht i referohen konsultimeve me trajnerët për përgatitjen e portfoliove për certifikim), ndërsa rreth 47 % e personelit të shkollës asnjëherë nuk kanë pasur konsultime e as mbështetje profesionale jashtë shkollës. Ndërsa ia i përket përkrahjes së mekanizmave jashtë shkollës, u konfirmua edhe nga zyrtarët e MASHT-it që gjatë tri viteve të fundit, përkatësisht që nga fillimi i shtrirjes së zbatimit të kurrikulës, nuk ka pasur një formë të organizimit të konsultimeve dhe mbështetjes shtesë për mësime dhënësit dhe shkolla.

5.3. Zhvillimi profesional – trajnimet dhe mbështetja profesionale për zbatimin e kurrikulës

Sipas Chan (2010), zhvillimi profesional është thelbësor për zbatimin e reformës kurrikulare (sipas Saqipi, B., 2019, f. 45). Zbatimi i kurrikulës bëhet i suksesshëm atëherë kur mësime dhënësit fitojnë përvojat e duhura, njohuritë, shkathtësitë, idetë dhe qëndrimet e drejta për kurrikulën apo

programin mësimor që do ta zbatojnë në praktikë (Marash 2009, f. 93). Mbështetja profesionale apo procesi i trajnimeve për zbatimin e kurrikulës së re, nga viti 2016, përkatësisht nga fillimi i zbatimit të kurrikulave të reja lëndore/ programeve mësimore të hartuara pas përfundimit të fazës së pilotimit të kurrikulës, është udhëhequr nga Zyra për trajnime/zhvillim profesional të mësimdhënësve, e cila me organizimin e ri në MASHT është integruar në Divizionin për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve. Koordinimi i aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës është bërë nga KC në komuna, nga të cilët konfirmohet kjo e dhënë.

Nga rezultatet e studimit me të gjithë aktorët pjesëmarrës në studim, konfirmohet se trajnimet për zbatimin e kurrikulës kanë qenë pika më e diskutuar, si për kohëzgjatjen e trajnimeve, ashtu edhe për cilësinë e trajnimeve dhe të trajnerëve. Megjithatë, konsiderohet si një nga fushat kryesore të sistemit, e cila ka ndërlidhur punën e MASHT-it, DKA-ve dhe shkollave në kuadër të angazhimeve për zbatimin e kurrikulës në shkallë vendi.

Në nivel shkolle, në përgjithësi, ekziston një qëndrim pozitiv për trajnimet lidhur me zbatimin e kurrikulës, por ka dallime ekstreme nga një përqindje relativisht e vogël, që nuk duhet nënçmuar (rreth 6 %), pasi, sipas tyre, trajnimet kanë qenë humbje kohe, të mërzitshme dhe të gabuara në formën e organizimit. Ndërsa, mbi 18% e mësimdhënësve janë shprehur se trajnimet nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe nuk kanë qenë nxitëse, përkatësisht rreth 23 % e mësimdhënësve janë shprehur se trajnimet nuk kanë qenë praktike dhe nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme. Në anën tjetër, për aspektet e njëjta rreth 32% e mësimdhënësve janë me dilema ose pajtohen se trajnimet kanë qenë të mjaftueshme, me rezultate të kënaqshme, nxitëse dhe praktike. Ndërsa, pjesa tjetër 45 - 54% e mësimdhënësve kanë vlerësim pozitiv për kërkesat e mësipërme.

Për cilësinë e mbështetjes profesionale, trajnimeve, shprehin mendim ndryshe udhëheqësit e AP, KC dhe drejtuesit e shkollave, kundrejt një pjese të mësimdhënësve. Sipas tyre, mbështetja profesionale për zbatimin e kurrikulës nuk ka qenë e mjaftueshme, shpesh jocilësore, nuk ka vazhduar që ajo të bëhet edhe pasi që kanë filluar ta zbatojnë kurrikulën, kur janë

ballafaquar me sfida dhe probleme gjatë zbatimit. Lidhur me aspektin e nxitjes apo stimulimit për pjesëmarrje në trajnim, del të jetë se kjo është e lidhur me nevojën për certifikim, pasi që pjesa më e madhe e mësimeve nuk janë përfshirë në programet e trajnimit për t'i plotësuar kërkesat e certifikimit. Duket se certifikimi ka qenë një motivim i brendshëm, por nuk është përcjellë me ndryshime në klasë. Kështu shprehet njëri nga drejtuesit e shkollës:

Mësimeve krijuan komoditetin me certifikim, të gjithë po certifikohen, ndërsa puna në klasa po mbetet e njëjtë. Kjo qasje duhet ndryshuar, prandaj nevojiten trajnime më praktike, të vazhdueshme, dhe njëkohësisht mbikëqyrje e procesit të zbatimit.

Procesi i mbikëqyrjes së trajnimeve dhe formave tjera të përkrahjes profesionale, sipas KC dallon nga komuna në komunë. Ka komuna që tashmë kanë ngritur ekipe profesionale, në përbërje të së cilave janë përfshirë trajnerë të kurrikulës, dhe qëndrojnë më mirë në procesin e mbikëqyrjes. Mirëpo, pjesa më e madhe e komunave raportojnë se, në mungesë të kapaciteteve dhe resurseve njerëzore në DKA, nuk kanë arritur të mbikëqyrin trajnimet dhe t'i koordinojnë të gjitha aktivitetet e mbështetjes profesionale që ofrohen nga MASHT-i dhe partnerët mbështetës. Sa i përket cilësisë së trajnimeve, është vlerësim i përgjithshëm i KC në DKA se ka munguar cilësia në trajnimet e organizuara.

Edhe fillimi i formimit të ekipeve profesionale në nivel komune dhe shkolle për mbështetjen e zbatimit të kurrikulës është përcjellë me pengesa konceptuale, ligjore, organizative, dhe financiare, në mungesë të platformës dhe vendimmarrjes nga MASHT-i për ndërtimin e mekanizmave në përkrahje të procesit të zbatimit të kurrikulës, për përkrahje të vazhdueshme të mësimeve dhe të fuqizimit të zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Komunitetet e mësimeve dhe ekipet për zhvillim profesional me bazë në shkollë kërkojnë më shumë vëmendje dhe mbështetje nga shkollat, drejtuesit komunalë të arsimit, por edhe nga drejtuesit e arsimit në nivel qendror, (Buleshkaj, O., 2017, f. 694). Kjo argumentohet edhe nga Hargreaves dhe Fullan (2012, 2013). Sipas tyre, kur bëhet fjalë për ekipet e bazuara në shkollë, ata artikulojnë "rëndësinë për punën profesionale,

aftësinë profesionale dhe efektivitetin profesional" në përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies (cituar nga Buleshkaj, O., 2017).

Edhe nga zyrtarët arsimorë në MASHT trajnimet për zbatimin e kurrikulës janë përshkruar me sfida të shumta në raport me cilësinë e trajnerëve, me një masivizim të përfshirjes së mësimdhënësve në trajnime në vitin 2017 dhe me mungesë të mekanizmave për të mbikëqyrur procesin e trajnimeve dhe për të ofruar mbështetje të vazhdueshme në ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve dhe shpesh me qasje ad-hok në organizimin e trajnimeve, pa një platformë të qartë. Pavarësisht ngarkesat, sfidat dhe problemet në organizimin e trajnimeve, zyra për ZHPM në MASHT është angazhuar maksimalisht, së bashku me zyrtarët arsimorë në komuna, që t'u përgjigjet kërkesave të shkollave për trajnimin e të gjithë mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës dhe 16820 mësimdhënës në tri vitet e fundit e kanë përfunduar trajnimin për zbatimin e kurrikulës. Kjo statistikë më së miri tregon ngarkesën e zyrës së ZHPM për t'iu përgjigjur kërkesave të trajnimeve në këtë fushë dhe njëkohësisht lënie anash të zhvillimit të politikave arsimore, të cilat janë përgjegjësi e MASHT-it.

Ndërrimet e shpeshta në pozitat koordinuese, në nivel qendror, në nivel komunal dhe në nivel shkolle, si koordinatorë për zhvillim profesional, koordinatorë për kurrikulë, koordinatorë për sigurim të cilësisë (edhe pse për secilën pozitë janë përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë), kanë ndikuar që të mos udhëhiqet dhe koordinohet si duhet procesi i zhvillimit profesional për zbatimin e kurrikulës. Mungesa e një platforme të qartë për këtë proces ka bërë që zhvillimi profesional për zbatimin e kurrikulës të jetë në këtë pikë të diskutimit.

Në anën tjetër, referuar analizës së rezultateve nga pyetësorët dhe intervistat me njohës të arsimit dhe të reformës kurrikulare, mund të konkludohet se ekziston mendimi i argumentuar se qasja e ndjekur nga MASHT-i në udhëheqjen e gjithë procesit të reformës kurrikulare ka ndikuar edhe në cilësinë e trajnimeve. Trajnimet janë përshkruar më të organizuara në fazën e pilotimit të kurrikulës, kundrejt tri viteve të fundit. Njohësit e arsimit sugjerojnë që zhvillimi profesional për zbatimin e kurrikulës të ndryshojë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga forma e trajnimit. Trajnimet disaditore nuk garantojnë suksesin e zbatimit të kurrikulës. Nevojitet

mbështetje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme për mësimdhënës dhe bartësit tjerë të këtij procesi, në mënyrë që të sigurohet zbatim i suksesshëm i kurrikulës. Mësuesit ka të ngjarë të pranojnë aktivitete të zhvillimit profesional që adresojnë problemet që ata vetë i kanë identifikuar (Diana Fox Wilson, 2004, f. 126). Duhet të pranohet se në transformime kaq të mëdha kurrikulare, që synojnë nivelin konceptual të rolit të shkollimit, komuniteti shkollor ka nevojë për më shumë kohë dhe aktivitete në nivelin e shkollës për të brendësuar dhe bërë interpretimet e tyre për atë që bëhet fjalë për kurrikulën e re. Kjo kërkon kohë dhe kontribut të mjaftueshëm për të brendësuar qëllimet e reformës dhe mënyra më e mirë për ta siguruar këtë është përfshirja e shkollave në zhvillimin e diskursit të tyre koordinues (Saqipi, B., 2019, f. 45).

5.4. Ndryshimet në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re

Tashmë është e njohur se risitë e kurrikulës së re janë qasja në kompetenca dhe rezultate të të nxënit, riorganizimi i fushave kurrikulare dhe shkallëve kryesore të kurrikulës, përqendrimi në nxënësin, qasja e integruar, zbatimi i gjuhës angleze nga shkalla e parë e kurrikulës, vlerësimi i arritjes së nxënësve, riorganizimi i kurrikulës me zgjedhje në funksion të zhvillimit të kompetencave, si dhe aspektet e tjera të organizimit në nivel shkolle, DKA-je dhe MASHT-i.

Shkollat tona, edhe pse kanë marrë një orientim për udhëheqjen e ndryshimeve në shkollë, në kuadër të udhëzuesit për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë²⁵, në përgjithësi, nuk kanë arritur të bëjnë ndryshime thelbësore në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re, të menaxhojnë ndryshimet që sjell kurrikula e re, në raport me aspektet organizative të mekanizmave të brendshëm, ndryshime në punën me prindër, por edhe ndryshime në klasë. Në një listë prej 18 kërkesave që lidhen me ndryshimet në shkollë, në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re:

²⁵ Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2016). Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, Prishtinë, <https://ipkmasht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2017/03/Udhwzuesi-pwr-zbatim-tw-kurrikulws1.pdf>,

- mbi 20% e mësimeve dhe drejtuesve të shkollave konfirmojnë se kanë bërë ndryshime thelbësore në përgjigje të kërkesave të kurrikulës;
- rreth 39% e mësimeve dhe drejtuesve të shkollave konfirmojnë se kanë bërë ndryshime të moderuara;
- mbi 27% mësimeve dhe drejtuesve të shkollave konfirmojnë se kanë bërë ndryshime të vogla;
- mbi 14 % mësimeve dhe drejtuesve të shkollave konfirmojnë se nuk kanë bërë ndryshime apo nuk i kanë konsideruar të nevojshme ndryshimet.

Për kërkesat e ndryshimeve në shkollë, si: (i) riorganizimi i brendshëm i shkollës, (ii) ndryshimi në monitorimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës dhe (iii) ndryshimi në qasjen e përdorimit të teksteve dhe burimeve tjera mësimore; si kërkesa bazike të ndryshimeve në shkollë në raport me pritshmëritë e shkollës për zbatimin e kurrikulës së re rezultojnë të jenë bërë ndryshime të vogla në këto tri vitet e fundit, apo nuk janë bërë fare ndryshime në këto kërkesa/ përkatësisht nuk i kanë konsideruar të nevojshme ndryshimet. Kjo tregon se pritshmëritë për ndryshime nga shkolla nuk ndodhin pa një proces mbikëqyrës dhe pa mekanizma mbështetës.

Lidhur me qasjen ndaj planifikimit mësimor, konfirmohet se janë bërë ndryshime të moderuara dhe thelbësore sa u përket planifikimeve (planeve vjetore, planeve për periudha mësimore, planeve të orës mësimore dhe planeve të tjera për procesin mësimor). Megjithatë, ekziston perceptimi se ato janë shabllonizuar, nuk janë kreative për të siguruar një ndryshim cilësor në mësimdhënie dhe në procesin e të nxënës.

Sa u përket dallimeve ndërmjet shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulave lëndore të reja në vitin shkollor 2016/2017 dhe shkollave që kanë filluar një vit më vonë, në vitin 2017/2018, duke iu referuar rezultateve të përpunuara me respondentët nga shkollat, evidentohen dallime të vogla në raport me ndryshimet në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re. Referuar përgjigjeve të subjekteve nga shkollat, shkollat që kanë filluar zbatimin e kurrikulave lëndore në vitin shkollor 2016/2017, për 4 % kanë

bërë më shumë ndryshime sesa shkollat që kanë filluar një vit më vonë (2017/2018). Edhe referuar analizës së dokumentimit të shkollave për përgatitje dhe udhëheqje të zbatimit të kurrikulës, shkollat që kanë filluar punën me kurrikulat e reja lëndore në vitin shkollor 2016/2017 kanë dëshmi dhe evidenca më shumë për ndryshimet e bëra në nivel shkolle, kundrejt shkollave që kanë filluar një vit më vonë. Dallimet nuk janë të mëdha dhe si në grupin e parë të shkollave, ashtu edhe në grupin e dytë ka shkolla që raportojnë ndryshime përmbajtjesore, sikurse ka shkolla që kanë raportuar fare pak ndryshime të bëra gjatë këtyre tri viteve.

Ndryshime në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re pritej të bëhen edhe në nivelin lokal. Në pyetjen që lidhet me ndryshimet kryesore që ka sjellë kurrikula e re në punën dhe organizimin e brendshëm të DKA-së, nuk raportohet për ndryshime të theksuara, përveç vendosjes së koordinatorëve të cilësisë në DKA dhe përpjekjeve të zyrtarëve arsimorë në DKA për të punuar me shkollat në zbatimin e kurrikulës dhe për të koordinuar organizimin e trajnimeve në këtë fushë. Sipas pohimeve të KC, ekzistojnë dallime në qasje dhe në organizim të punës së DKA-ve.

Pa dyshim që kurrikula e re ka prodhuar kërkesa të reja, për të gjitha hallkat e funksionimit dhe organizimit. Ne si DKA nuk kemi arritur që të krijojmë mekanizma mbështetës (mentorues dhe monitorues) për zbatim efikas të kurrikulës. Ne e kemi angazhuar një zyrtar që ta ushtrojë edhe funksionin e koordinatorit komunal për kurrikulë, që t'i koordinojë aktivitetet për zbatim të kurrikulës me shkollat.

Gjithashtu, ndryshime në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re pritej të bëhen edhe në nivelin qendror. Në nivelin qendror/ MASHT, siç u përshkrua më lart, nuk janë konfirmuar ndryshime organizative dhe ndryshime në ndërtimin të mekanizmave mbështetës për të promovuar, mbështetur, përkrahur dhe monitoruar zbatimin e kurrikulës së re. Madje, referuar diskutimeve me zyrtarët arsimorë në MASHT, edhe disa ndryshime organizative të filluara dhe struktura të themeluara gjatë pilotimit të kurrikulës, janë ndërpresë, nuk janë funksionalizuar, si planifikimi sektorial për procesin e zbatimit të kurrikulës, skema e koordinatorëve të kurrikulës për nivele (funksionon vetëm skema e koordinatorëve për zhvillimin e

kurrikulave lëndore), skema e koordinatorëve të kurrikulës në nivel shkolle etj. Në aspektin e legjislacionit është miratuar Ligji për Inspektoratin e Arsimit, i cili parasheh funksionimin e inspektoratit në dy shtylla: Inspektoratin Administrativ dhe Inspektoratin Pedagogjik, si dhe janë miratuar disa UA që ndërlidhen me zbatimin e kurrikulës, si: UA për Aktivitet Profesional²⁶; UA për Sigurimin e cilësisë²⁷; UA për vlerësim të performancës së shkollës²⁸, Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës²⁹ etj.

Një ndryshim tjetër, në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re, është zbatimi i autonomisë së shkollës. Duke krahasuar rezultatet e fituara, si nga respondentët në nivel shkolle, ashtu edhe nga respondentët e zyrtarëve arsimor (komunal dhe qendror), inspektorëve të arsimit, por edhe njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare, rezulton se ka diferencë midis pikëpamjeve të tyre. Përfaqësuesit nga shkollat shprehen se kanë mungesë të autonomisë, në anën tjetër aspektet e ndryshimeve që lidhen me autonominë e shkollës, si planifikimi shkollor, funksionalizimi i organeve qeverisëse dhe profesionale, planifikimi mësimor, zbatimi i kurrikulës me zgjedhje, janë identifikuar si procese dhe aktivitete që nuk janë bërë me kohë dhe në mënyrën e duhur, në një numër të konsiderueshëm të shkollave (shih analizën e dokumentimit të punës së shkollave). Sa u përket menaxhimit të personelit, resurseve financiare dhe vendimmarrjes në disa fusha, vërtet shkollat kanë pak autonomi të kufizuar, që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e zbatimit të kurrikulës së re.

²⁶ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016) Udhëzimi Administrativ për aktivitet profesional (departamentet), të shkollave, Prishtinë, <https://masht.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016>,

²⁷ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016c). *Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>

²⁸ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (04/2017). *Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>

²⁹ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë*. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>

Çështje të njëjta lidhur me autonominë e shkollës u ngritën edhe zyrtarët arsimorë në MASHT dhe nga zyrtarët arsimorë/koordinatorët e cilësisë në komuna. Sipas tyre, shkollat dhe mësimdhënësit ballafaqohen me disa sfida që lidhen me zbatimin e autonomisë së shkollës, si mungesa e një sistemi brenda shkollës për të planifikuar dhe organizuar aktivitete mësimore mbështetëse dhe orë mësimore përtej orarit zyrtar (orientime dhe kërkesa të kurrikulës për të siguruar që të gjithë nxënësit marrin mbështetjen e nevojshme për zhvillim maksimal të kapaciteteve të tyre), mungesa e buxhetit dhe procedurat e menaxhimit të tij nga shkolla. Probleme raportohen edhe sa i përket hartimit të programeve për kurrikulë me zgjedhje, si pjesë e autonomisë së shkollës.

Edhe njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare shprehen se nga shkollat nuk shfrytëzohet sa dhe si duhet autonomia e saj, e përcaktuar me dokumentet kurrikulare. Ata, gjithashtu, shprehen se kjo situatë nuk mund të ndryshojë pa mbikëqyrje, mbështetje dhe zbatim të mekanizmave të llogaridhënies. Nga ky grup i respondentëve theksohet fakti se kurrikula e re në masë të madhe përcakton autonominë e shkollës, e cila me zhvillimin e kurrikulave lëndore/programeve mësimore ka humbur një pjesë të madhe të idesë fillestare me kurrikulën e re. Autonomia e shkollës dhe niveli i iniciativave dhe aktiviteteve të zhvillimit në shkollë janë elemente thelbësore për të siguruar nivelin e diskutimit komunikues dhe koordinues, që ndodhin në zbatimin e reformës së kurrikulës (Saqipi, B., 2019, f. 46). Gjithashtu, autonomia e shkollave në hartimin e planeve dhe programeve mësimore dhe fleksibiliteti në identifikimin dhe aplikimin e zgjidhjeve të ndryshme pedagogjike në nivel të shkollës mund të shfrytëzohet në favor të zhvillimit të kompetencave vetëm nëse ato përfshihen në mënyrë adekuate në sistemet e vlerësimit (Boshtrakaj, L., 2018, f. 31).

5.5. Ndryshimi i qasjes në mësimdhënie

Ndryshimi në qasje të mësimdhënies dhe nxënies nuk mund të vijë vetvetiu, nuk është proces i automatizuar, përkundrazi është proces që merr kohë dhe kërkon mbështetje të vazhdueshme. Për të arritur këtë, duhet mbikëqyrur punën e mësimdhënësve, duhet ofruar mbështetje të nevojshme dhe duhet ngritur llogaridhënien, në mënyrë që çdo veprim i mësimdhënësve të jetë në

përputhje me parimet e kurrikulës dhe në funksion të përkrahjes së nxënësve për zhvillimin e kompetencave.

Ndryshimi i qasjes në mësimdhënie, përkatësisht ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës së re, janë eksploruar përmes 20 kërkesave në pyetësonin për mësimdhënës, lidhur me aspektet e praktikës së mësimdhënies me bazë kompetencat, përkatësisht aspektet që janë të dukshme (evidente) në praktikë, në punën me nxënës. Rezultatet e përpunuara tregojnë se:

- Mbi 11 % e mësimdhënësve shprehen se nuk është evidente praktika e ndryshimeve në mësimdhënien e tyre, nuk konsiderojnë se duhen bërë ndryshime në praktikën e mësimdhënies; apo është evidente në ndonjë rast dhe nuk e konsiderojnë të rëndësishëm ndryshimin;
- Rreth 42 % e mësimdhënësve shprehen se është evidente praktika e ndryshimeve të tyre në mësimdhënie dhe është e rëndësishme që shpesh të bëjnë ndryshime në funksion të përkrahjes së nxënësve në zhvillimin e kompetencave;
- Rreth 47 % e mësimdhënësve shprehen se për ta janë shumë të qarta ndryshimet që duhen bërë, ato janë evidente në praktikën e tyre dhe kanë rëndësi në punën e tyre;

Rezultatet e përpunuara konfirmojnë një masë relativisht të lartë të mësimdhënësve, të cilët janë në dijeni për ndryshimet që duhen bërë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe ndryshimet për ta janë të rëndësishme në punën e tyre. Puna me këtë grup të mësimdhënësve vlerësojmë se mund të përmirësojë dhe avancojë praktikën e mësimdhënies së bazuar në kompetenca. Puna me këtë grup të mësimdhënësve kërkon njohje të potencialeve dhe nevojave të mësimdhënësve për mbështetje, kërkon drejtim të duhur të shkollës dhe të organeve të saj, kërkon motivim dhe mbështetje të vazhdueshme.

Në anën tjetër, në pyetjen se sa ka qenë e vështirë të aplikohen aspektet e praktikës së mësimdhënies me bazë kompetencat, rezultatet e përpunuara tregojnë se:

- Rreth 30 % e mësimeve shprehen se e kanë pasur shumë të vështirë, ose të vështirë të aplikojnë praktikën e mësimit me bazë kompetencat;
- Rreth 54 % e mësimeve shprehen se e kanë pasur të lehtë të aplikojnë praktikën e mësimit me bazë kompetencat;
- Ndërsa, rreth 16 % e mësimeve shprehen se e kanë pasur shumë të lehtë të aplikojnë praktikën e mësimit me bazë kompetencat;

Disa nga aspektet e praktikës së mësimit me bazë kompetencat, që konsiderohen shumë të vështira apo të vështira për t'u praktikuar nga mësuesit në punën me nxënës, janë si në vijim:

Tabela 25. Të dhënat përshkuese për vështirësitë e zbatimit të kurrikulës në praktikë, shprehur në përqindje

Sa e shihni të vështirë t'i zbatoni në praktikë?	Shumë e vështirë & e vështirë
▪ Unë i modifikoj praktikën e mësimit me qëllim që nxënësit të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit dhe të shprehurit.	34 %
▪ Nxënësit angazhohen dhe bëjnë gjëra praktike me njohuri në kontekste dhe situata nga jeta.	31 %
▪ Nxënësit nxiten të marrin vendime dhe veprime për të zgjidhur probleme në mënyrë të vetëdijshme për ndikimin dhe pasojat e tyre.	35 %
▪ Unë angazhohem me nxënës për të kultivuar vazhdimisht kërkimin dhe interesimin e tyre për të nxënë.	30 %
▪ Nxënësit përkrahen që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvlerësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore.	37 %
▪ Nxënësit përgatiten që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.	41 %
▪ Unë punoj me prindër dhe komunitet me qëllim përfshirjen e nxënësve në jetën familjare dhe shoqërore.	40 %
▪ Unë praktikoj përfshirjen e nxënësve në vendimet lidhur me format e mësimit dhe masat tjera rreth të nxënësve të tyre.	30 %
▪ Unë praktikoj punën me projekte me qëllim vlerësimin e nxënësve në më shumë se një kompetencë.	30 %

Nëse mësimdhënësit vazhdojnë të kenë vështirësi në praktikën e mësimdhënies për të aplikuar kërkesa të kësaj natyre, të lidhura me qasjen e bazuar në kompetenca, dhe nuk marrin mbështetjen profesionale, përkrahjen e nevojshme, nuk monitorohen dhe mentorohen, ekziston rreziku i humbjes së besimit në kurrikulën e re, refuzimit të saj, kthimit në praktikën tradicionale etj.

Rreth ndryshimit të qasjes në mësimdhënie janë shprehur edhe njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare, që ishin pjesë e studimit. Sipas tyre, duke iu referuar kontakteve, bisedave dhe formave të tjera të bashkëpunimit të tyre me mësimdhënësit që e zbatojnë kurrikulën e re, lidhur me ndryshimet në mësimdhënie, japin argumentet e tyre se ka praktika dhe shembuj shumë të mirë të ndryshimeve në mësimdhënie, por ato janë të pakta:

- *janë të individualizuara rastet kur punohet me përkushtim dhe shihen produktet e kurrikulës, si rezultat i ndryshimit të mësimdhënies dhe nxënies;*
- *çfarëdo ndryshimi në praktika në klasë është i lidhur me vullnetin dhe përkushtimin e mësimdhënësve individualisht, gjë që veç ka qenë prezent edhe para kurrikulës së re;*
- *konteksti i zhvillimit të mësimdhënësve reflektohet edhe në mënyrën se si mësimdhënësit i individualizojnë planifikimin dhe mësimdhënien.*

Të njëjtën gjë e konfirmojnë edhe inspektorët e arsimit, të cilët në këta 2-3 vjet ishin më aktivë në vizitat në orë mësimore në kuadër të proceseve për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës dhe vlerësim individual të performancës së mësimdhënësve. Kështu e përmbledh përgjigjen njëri nga inspektorët e arsimit, në pyetjen *Sa ka ndryshuar qasja në mësimdhënie në shkollat e Kosovës si rezultat i kurrikulës së re të bazuar në kompetenca?:* *Sa u përket aspekteve metodologjike të punës së mësimdhënësve, nuk mund të them se vërehen ndryshime të mëdha. Ose mund të themi se ato kanë ndodhur para zbatimit të KK, si rezultat i përgatitjes paraprake dhe trajnimeve të ndryshme për metodologjitë e mësimdhënies.*

5.6. Pranimi apo besimi i mësimeve për kurrikulën e re

Zbatimi i kurrikulës bëhet i suksesshëm atëherë kur pranohet plotësisht nga mësuesit e një shkolle dhe kur veprimtaritë e lidhura me të kthehen në rutinë, mund të thuhet se kurrikulumi ka arritur fazën e “institucionalizimit” (Marash 2009, f. 93). Në kontekstin e zbatimit të kurrikulës në Kosovë, në këto dy-tri vitet e fundit, ekziston mendimi se ka mësimeve që e kanë pranuar shumë miri kurrikulën e re dhe punojnë me përkushtim për ta zbatuar atë, mirëpo një pjesë relativisht e madhe e mësimeve nuk e kanë pritur mirë kurrikulën e re, nuk e shohin si të tyre, në forma direkte dhe indirekte e refuzojnë atë. Kjo bëhet për shkak të komunikimit dhe qasjes së gabuar në udhëheqjen e procesit të zbatimit, mungesës së informimit dhe debateve profesionale, por edhe për mungesë të mbështetjes së vazhdueshme gjatë procesit të zbatimit. Mësimeve mirëpresin mundësi për të diskutuar problemet me mësuesit tjerë (Diana Fox Wilson, 2004, f. 126).

Përmes 12 pyetjeve të paraqitura në pyetësorin e anketës për mësimeve, kemi marrë mendimin e mësimeve që janë duke zbatuar kurrikulën e re, lidhur me pranimin apo besimin për kurrikulën e re bazuar në kompetenca. Mësimeve kanë shprehur nivele të ndryshme të pajtueshmërisë, pranimi/besimi apo mospranimi/mosbesimi për zbatimin e kurrikulës në kontekstin e tyre të punës.

Në përgjithësi, mësimeve e pranojnë se kurrikula e re kërkon ndryshimin e qasjes së punës nga mësimeve (për këtë shprehin mendimin mbi 80% e mësimeve), është nxitëse për të mësuar (për këtë shprehin mendimin rreth 66% e mësimeve), është më e avancuar se kurrikula e mëparshme (për këtë shprehin mendimin mbi 68% e mësimeve). Këto janë disa argumente shumë të mira për ta drejtuar ndryshimin dhe për t'i përkrahur mësimeve që ta bëjnë ndryshimin e duhur.

Në anën tjetër, ekziston një përqindje relativisht e lartë e mësimeve, që përmes mendimit të tyre shprehin mospranim/mosbesim ndaj kurrikulës së re. Kështu reflektohet mospranimi/mosbesimi i mësimeve për kurrikulën e re, apo kështu shihet nga mësimeve që janë duke zbatuar:

- Rreth 56 % e mësimeve shprehen se kurrikula e re ka pritshmëri tepër të larta;
- Rreth 39 % e mësimeve shprehen se kurrikula e re ka ngarkesa të paarsyeshme;
- Mbi 32 % e mësimeve shprehen se kurrikula e re ka kërkesa të paarritshme;
- Mbi 37 % e mësimeve shprehen se kurrikula e re është tepër sfiduese;
- Mbi 16 % e mësimeve shprehen se kurrikula e re është e vështirë për t'u kuptuar etj.

Lidhur me pranimin apo besimin në kurrikulën së re, është interesant fakti se pajtueshmëri më të lartë kanë shprehur mësuesit që nuk kanë pozita udhëheqëse në shkollë sesa koordinatorët e kurrikulës, kryetarët e aktiveve profesionale dhe koordinatorët e cilësisë në shkollë, të cilët kanë shprehur më shumë dilema rreth pranimin apo besimit ndaj kurrikulës së bazuar në kompetenca. Sipas të dhënave të përpunuara, dilemat e tyre lidhen me pritshmëritë për kurrikulën dhe këtë e shprehin mbi 54 % e koordinatorëve të cilësisë, koordinatorëve të kurrikulës në nivel shkolle dhe kryetarëve aktiveve profesionale.

Pothuajse e njëjta gjë reflektohet edhe në pohimet e drejtuesve të shkollave. Ata grupojnë mësuesit që e kanë pranuar me kohë kurrikulën dhe punojnë me përkushtim të madh, mësuesit që e kanë pranuar, por kanë vështirësi në zbatim, mësuesit që kanë drojë dhe frikë, si dhe mësuesit që vazhdimisht shprehin skepticizëm dhe refuzim, shprehen se është dështim i radhës. Ja se si shprehin disa drejtorë të shkollave lidhur me reagimet e mësimeve ndaj kurrikulës së re:

- *Në përgjithësi përkrahet, disa janë skeptikë, e shohin si eksperiment, dështim të radhës;*
- *Pavarësisht që shkolla jonë ishte në pilotim, një pjesë të mësimeve thonë se ka dështuar, humbje kohe, administratë...';*
- *Pranim me drojë, frikë, rezistencë.*

Shikuar nga perspektiva për nivelin e informacioneve që duhet të kenë stafi i shkollës që kanë role udhëheqëse në shkollë lidhur me reagimet e mësimdhënësve ndaj kurrikulës së re, në ato shkolla që stafi udhëheqës e mbikëqyrin procesin e zbatimit të kurrikulës dhe janë më afër mësimdhënësve, në parim, ata e kanë fotografinë më të qartë për atë se si e kanë pranuar apo sa kanë besim mësimdhënësit e shkollave të tyre në kurrikulën e re. Nëse “fotografia” e shprehur prej tyre, e shprehur më lart, tregon gjendjen e përgjithshme në nivel shkolle, atëherë supozimi mund të jetë se mësimdhënësit në mendimet e tyre janë treguar më subjektivë sa i përket pranimi apo besimit në kurrikulën e re.

Lidhur me pranimin apo besimin e mësimdhënësve në kurrikulën e re, inspektorët e arsimit shprehen se është brengosës fakti *se një numër jo i vogël i mësimdhënësve flasin për kotësinë e kurrikulës, pa ofruar as edhe një argument të vetëm pse kundërshtohet apo nuk pranohet, por si një retorikë e thatë vetëmbrojtëse për papunësinë e tyre!* Kjo tregon se një pjesë e mësimdhënësve pak janë shkëputur nga mënyra tradicionale e punës së tyre, vazhdojnë të qëndrojnë në kutinë e tyre, në zonën e rehatisë (Rukiqi, Sh., 2014). Zbatimi i frymës së re kurrikulare kërkon edhe ndryshim të perceptimit të mësimdhënësve, ashtu që ata të shohin edhe veten si nxënës, respektivisht të kuptojnë nevojën për zhvillim të vazhdueshëm personal e profesional. Zhvillimi profesional i vazhdueshëm në karrierë është i nevojshëm për të gjithë mësimdhënësit, në mënyrë që të mbajnë ritmin e ndryshimit dhe të rishikojnë dhe rinovojnë njohuritë, aftësitë dhe vizionet e tyre për mësimdhënie të mirë (Day, C., 2002, f.2). Nga ana tjetër ata duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin e tyre, si lehtësues të proceseve të të nxënës që përqendrohen në zhvillimin e kapacitetit të nxënësve për të konstruktuar dijen e tyre, si bazë për zhvillim të mëtejshëm (Boshtakaj, L., 2019, f. 31).

Lidhur me pranimin apo besimin në kurrikulën së re janë shprehur edhe njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare, që ishin pjesë e studimit. Sipas tyre, ka mësimdhënës që punojnë me përkushtim për ta zbatuar kurrikulën e re, mirëpo një pjesë relativisht e madhe e mësimdhënësve nuk e kanë pritur mirë kurrikulën e re, nuk e shohin si të tyre, dhe në forma direkte apo indirekte e refuzojnë. Njëri nga njohësit e arsimit dhe reformës kurrikulare, duke iu referuar kontakteve dhe diskutimeve me mësimdhënës, si dhe duke përcjellë zhvillimet rreth zbatimit të kurrikulës, shprehet se *elementet*

kryesore të zbatimit, informimi, komunikimi dhe trajnimet e ofruara, kanë siguruar dezinformim dhe frikësim të mësimdhënësve.

Gjetjet për pranimin apo besimin e mësimdhënësve në kurrikulën e re janë një informatë e rëndësishme për zhvilluesit dhe zbatuesit e politikave arsimore dhe një tregues i qartë për nevojën e intensifikimit të angazhimeve dhe përkushtimit institucional për të orientuar nivelin e informimit shtesë, vendosjen e debatit në nivel më konceptual të vlerave dhe mundësive që sjell kurrikula e re. Njëkohësisht kërkohet të rriten përgjegjësia dhe llogaridhënia institucionale, efikasiteti i punës për shkollën dhe komunitetin e saj në raport me mbështetjen dhe krijimin e të kuptuarit të përbashkët për reformën kurrikulare dhe rolin e shkollës në këtë proces.

5.7. Monitorimi i zbatimit të kurrikulës

Nga analiza e rezultateve me respondentët nga shkollat pjesëmarrëse në këtë studim (mësimdhënësit, udhëheqësit e organeve profesionale të shkollës, drejtuesit e shkollës), mund të arrihet në përfundimin se shkollat po vazhdojnë ta zbatojnë kurrikulën e re pa një sistem të organizuar mirë brenda shkollës, apo me një praktikë të monitorimit që është e pamjaftueshme për një proces ndryshimi, siç është ndryshimi i kurrikulës, si dhe pa një sistem për të siguruar evidencë, raportim për zbatimin e saj, nevojat për ofrimin e mbështetjes së duhur.

Në anën tjetër, as niveli komunal/DKA-të nuk ka ndërtuar mekanizma për monitorimin e procesit të zbatimit të kurrikulës së re. Koordinatorët e cilësisë janë duke bërë përpjekje që ta mbulojnë këtë, por e kanë të vështirë, për shkak se kanë shumë referate të punës dhe janë të angazhuar në shumë procese që zhvillohen në komuna dhe shkolla.

Siç u përshkrua te pjesa e diskutimit për zhvillimin profesional, ndërrimet e shpeshta në pozitat koordinuese në nivel shkolle dhe në nivel komunal, si koordinatore për zhvillim profesional, koordinatore për kurrikulë, koordinatore për sigurim të cilësisë, në masë të madhe kanë ndikuar që të këtë qasje jokonsistente edhe në monitorimin e zbatimit të kurrikulës nga vetë shkolla, por edhe nga mekanizmat tjerë jashtë shkollës.

Në përfundim të njëjtë arrihet edhe nga analiza e rezultateve që lidhen me pyetjet për monitorimin e jashtëm/ nga niveli qendror për zbatimin e

kurrikulës. MASHT-i nuk ka ndërtuar një mekanizëm dhe instrument të qartë për monitorimin e zbatimit të kurrikulës. Informacionet sigurohen varësisht prej nevojave të sektorëve, ndërsa raportimet janë interne, vetëm për qëllime të brendshme. Në tri vitet e fundit nuk janë bërë raporte përmbledhëse me të arriturat, progresin e zbatimit të kurrikulës, sfidat dhe problemet.

Ligji i ri për Inspektoratin e Arsimit (IA) (2018) parasheh që Inspektorati Pedagogjik të jetë një njësi e veçantë brenda IA, që do të merret me procese të përmbajtjes, vlerësimit të performancës, përfshirë edhe monitorimin për zbatim të kurrikulës. Kapacitet ekzistues të IA nuk sigurojnë që kjo njësi do të funksionalizohet shpejt dhe do të fillohet me një proces të organizuar mirë për monitorimin e shkollave në zbatimin e kurrikulës. Megjithatë, inspektorët e arsimit, në kuadër të procesit të VPSH, monitorojnë edhe zbatimin e kurrikulës. Mirëpo, në mungesë të një mekanizimi udhëheqës dhe koordinues për zbatimin e kurrikulës, raportet nga procesi i VPSH-së në nivelin qendror dërgohen vetëm në Departamentin e Inspektimit në MASHT, nuk shkojnë tutje, nuk analizohen dhe përpunohen, dhe nuk merren masa mbështetëse për mësimdhënës dhe shkolla për të siguruar zbatim të suksesshëm. Natyrisht, kjo, sipas inspektorëve të arsimit, ka përjashtime kur kërkohen zyrtarisht raportet nga divizionet përkatëse në MASHT, ose kur ka devijime në raport me përcaktimet ligjore, për të cilat zhvillohen procedurat e verifikimit dhe të marrjes së masave në varësi të rasteve, kontekstit të problemeve.

5.8. Dokumentimi nga ana e shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës

Zbatimi i mundësive të reja, kërkesave të kurrikulës, është i mundur vetëm me kontributin e shkollave, përmes një planifikimi shkollor gjithëpërfshirës për zbatimin e kurrikulës, i cili në nivel shkolle mbështetet në analizën e kontekstit të përgjithshëm të shkollës dhe raportin e vetëvlerësimit të shkollës.

Në mungesë të raporteve nga monitorimi i rregullt i shkollave për procesin e zbatimit të kurrikulës, dokumentimin e punës së shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, është analizuar dhe vlerësuar

nëpërmjet instrumentit të përgatitur për këtë qëllim, me gjithsej 34 tregues/kërkesa për dëshmi të dokumentimit të punës të punës së shkollës në gjashtë fusha:

- *Materialet informuese, të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re;*
- *Plani Zhvillimor i Shkollës;*
- *Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019;*
- *Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës;*
- *Dëshmi (plane të veprimit dhe raporte pune) që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle;*
- *Dëshmi (plane të veprimit dhe raporte pune) të organeve profesionale të shkollës që pasqyrojnë punën në planifikimin për zbatim të kurrikulës.*

Dëshmitë e lidhura me treguesit/kërkesat e vendosura për të dokumentuar punën për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në fushat e shënuara më lart janë vlerësuar në tri nivele: (i) nivel i lartë i dëshmime (3 pikë); (ii) nivel mesatar i dëshmime (2 pikë); dhe (iii) nivel minimal i dëshmime (1 pikë). Për treguesit që nuk ka pasur dëshmi është evidentuar si mungesë e dëshmime (0 pikë). Detajet për këtë janë dhënë në pjesën e raportit ku analizohet dokumentimi i punës së shkollës për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës.

Nga rezultatet e studimit lidhur me dokumentimin e shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, konfirmohet se shkollat kanë nivel mesatar dhe nivel të lartë të dëshmime lidhur me Planin Zhvillimor të Shkollës dhe Planin vjetor të punës së shkollës, kundrejt fushave të tjera. Kurse në fushat tjera të dokumentimit dominojnë dëshmitë minimale ose kanë mungesë të dëshmime. Mirëpo, analiza cilësore e dëshmime të lidhura me planifikimin shkollor tregon se planifikimi shkollor nuk është i harmonizuar, mungon qasja për zhvillim të integruar të shkollës, përmes së cilës do të sigurohej më mirë udhëheqja e zbatimit të kurrikulës. Në mënyrë të veçantë vërehet shpërputhje ndërmjet planeve të organeve qeverisëse e profesionale me PZSHS dhe Planin vjetor/planin e veprimit të integruar në PZSHS. Vlerësimi për shkallë kurrikulare në pjesën më të madhe të

shkollave nuk është integruar në planin vjetor të punës së shkollës dhe nuk në përgjithësi shkollat nuk e kanë planifikuar dhe detajua as si një plan të veçantë, përmes të cilit do të dihej mënyra dhe qasja e shkollë ndaj këtij vlerësimi me rëndësi të veçantë për mbështetjen e nxënësve.

Në anën tjetër, ka mungesë të raporteve për përmbushjen e planeve të punës, dëshmive për analizë, diskutim, shqyrtim për arritjet, realizimin e planit/eve, sfidat dhe problemet e shkollave me të cilat janë ballafaquar në dy vitet e para të zbatimit të kurrikulës, masat shtesë që janë ndërmarrë etj. Kjo tregon se, në mungesë të mekanizmave për monitorimin e shkollës dhe të kërkesave për raportim cilësor, shkollat nuk mobilizohen në përgatitjen e raporteve dhe dëshmive në këtë fushë dhe në fushat tjera që lidhen me zhvillimin e shkollës. Nevojitet rishikimi i kulturës organizative të shkollave në funksion të përmbushjes së rolit të tyre të ri dhe të dokumentimit për proceset që zhvillohen në shkollë.

5.9. Dokumentimi i planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës

Zhvillimi i kompetencave kërkon ndërrim të qasjes në planifikimin mësimor për zbatim të kurrikulës, përkatësisht angazhim kreativ në planifikim dhe realizim të proceseve mësimore (Boshtrakaj, L., 2016, f. 47). Për të arritur këtë kërkohet njohje e mirë e dokumenteve kurrikulare dhe udhëzuesve për zbatim të kurrikulës, përvojë dhe praktikë profesionale në planifikim, njohje të kontekstit të shkollës, klasës, nxënësve dhe mundësive përkras.

Ashtu si dokumentimi për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit në shkollë, edhe dokumentimi i planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës është mbledhur gjatë vizitave hulumtuese në shkollat e përfshira në studim. Dokumentimi për planifikim mësimor është analizuar dhe vlerësuar me ndihmën e bashkëpunëtorëve për kurrikula lëndore, nëpërmjet instrumentit të përgatitur për këtë qëllim, me gjithsej 27 tregues/kërkesa për dëshmi në tri nivele të planifikimit:

- *Planet vjetore*
- *Planet për periudha mësimore / planet dymujore*
- *Planifikimet e orës mësimore / aktivitete mësimore*

Dëshmitë e lidhura me treguesit/kërkesat e vendosura për të dokumentuar planifikimet mësimore janë vlerësuar në tri nivele: (i) nivel i lartë i dëshmimeve (3 pikë); (ii) nivel mesatar i dëshmimeve (2 pikë); dhe (iii) nivel minimal i dëshmimeve (1 pikë). Për treguesit që nuk ka pasur dëshmi është evidentuar si mungesë e dëshmimeve (0 pikë).

Analiza tregon se format e planifikimit mësimor janë pothuajse të njëjta në të gjitha shkollat, ashtu siç janë udhëzuar përmes udhëzuesve dhe trajnimeve për kurrikulë. Në mesin e formave të planifikimit mësimor janë raportuar edhe modelet e fazës së pilotimit, si në shkollat që kanë qenë pjesë e pilotimit, ashtu edhe në shkollat që nuk kanë qenë të përfshira në pilotim, përkundër faktit se ato janë rishikuar pas zhvillimit të kurrikulave lëndore. Kjo tregon se në disa shkolla ekziston tendenca që planet mësimore dorëzohen në organet e shkollës sa për të plotësuar anën formale, pa një analizë dhe shqyrtim me kontekstin e shkollës, klasës dhe fushë kurrikulare, si dhe pa iu referuar programit zyrtar të miratuara nga MASHT-i. Detajet e planifikimit të mësimdhënësve për kurrikulat lëndore janë prezantuar në kapitullin që trajton këtë pjesë. Rreth 20% e planifikimeve i plotësojnë në nivel të lartë kërkesat e planifikimit mësimor, rreth 42 % i plotësojnë mesatarisht, ndërsa mbi 38 % i plotësojnë në nivel minimal kërkesat themelore për planifikim mësimor për zbatimin e kurrikulës.

Cilësia e planeve mësimore, bazuar në kërkesat e kurrikulës, është sfiduar në masë të madhe, për faktin se një numër jo i vogël i mësimdhënësve planifikimin mësimor e identifikojnë me administratë, kundrejt faktit që planifikimi mësimor është një aktivitet parapërgatitor i organizimit të procesit mësimor, i cili parashikon kushtet e domosdoshme dhe veprimtaritë mësimore për një nxënie të suksesshme të nxënësve. Nevojitet ndryshim i kulturës së punës së mësimdhënësve për qasjen ndaj planifikimit mësimor, i cili kërkon njohje të mirë të dokumenteve kurrikulare, interpretime profesionale, kreativitet, përvojë dhe praktikë profesionale, njohje të kontekstit të shkollës, klasës, nxënësve dhe të mundësive përkrahëse etj.

5.10. Përmbledhje e arritjeve në zbatimin e kurrikulës së re, sfidave dhe problemeve

Duke krahasuar rezultatet e të gjithë respondentëve të përfshirë në këtë studim, rezulton se nuk ka diferencë të theksuar midis pikëpamjeve të përfaqësuesve nga shkollat, si bartës kryesorë të procesit të zbatimit të kurrikulës dhe subjekteve tjerë, për arritjet në zbatimin e kurrikulës së re, sfidat dhe problemet, diferencat janë në raport me rolin që kanë, përgjegjësitë dhe nivelin e informimit.

Subjektet nga shkollat shprehin pikëpamjet/mendimet e tyre se në nivel shkolle ka progres në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimeve të shkollës me shkollat tjera, autonominë që kanë në planifikim dhe në zbatimin e kurrikulës, ka progres të vogël në zbatimin e kurrikulës në klasë. Ndërsa, problemet e ngriturat u referohen në radhë të parë nivelit të kuptuarit të pritjeve dhe ndryshimeve që sjell kurrikula e re, mungesës së teksteve dhe mjeteve mësimore, zbatimit të qasjes së integruar në planifikim dhe në zbatim në klasë, vlerësimit të nxënësve – veçanërisht vlerësimit për shkallë kurrikulare, mungesës së kabineteve dhe mjeteve didaktike për të zhvilluar kompetencat e nxënësve që zhvillohen përmes lëndëve shkencore, jetës dhe punës, por edhe përmes lëndëve të tjera.

Gjithashtu, në pikëpamjet e tyre, fare pak pasqyrojnë reflektime për probleme të brendshme në zbatimin e kurrikulës, nuk janë sa duhet autokritikë për atë që nuk e kanë bërë dhe kanë mundur ta bëjnë, Ka një tendencë që për problemet të shikojnë jashtë shkollës. Kjo qasje duhet të ndryshojë, në frymën e parimeve të kurrikulës, fleksibilitetit dhe autonomisë, por edhe të përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Zyrtarët e arsimit/ koordinаторët e cilësisë në DKA arritjet për zbatimin e kurrikulës së re i ndërlidhin me shtrirjen e zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat, sipas dinamikës së planifikuar, me përfshirjen e mësimeve në trajnime për kurrikulë, përkatësisht ofrimin e trajnimeve bazike për zbatim për të gjithë mësuesit, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimeve, rritjen e bashkëpunimit të DKA-së me shkollat dhe mësuesit, fillimin e fuqizimit të shkollave, AP, koordinatorëve të cilësisë në shkollat etj. Sipas ZA/KC në DKA, ka sfida dhe probleme të mëdha në zbatimin e kurrikulës, të cilat në masë të madhe janë duke i vështirësuar shtrirjen dhe zbatimin e suksesshëm të kurrikulës. Një pjesë e

sfidave dhe problemeve lidhen me punën e shkollave, një pjesë me punën e DKA-ve dhe një pjesë tjetër u faturohet MASHT-it dhe mekanizmave të MASHT-it. Për dallim prej subjekteve të shkollave, ZA/KC në DKA janë pak më kritikë ndaj rolit të tyre, por jo shumë në kuptimin angazhimit të tyre, për mënyrën se si nuk kanë arritur që të ofrojnë mbështetjen e duhur për shkollat, projektimin e qartë të procesit në nivel të komunës, por më shumë në raport me resurset që kanë. Gjithashtu, ZA/KC në DKA tregojnë përputhshmëri në mendime sa u përket mbështetjes për tejkalimin e sfidave dhe problemeve që tashmë janë evidentuar dhe janë raportuar edhe në këtë pjesë të analizës, si në nevojën për krijimin dhe funksionalizimin e mekanizmave profesionalë në nivel komunal dhe në nivel qendror, për mbështetje, monitorim të vazhdueshëm të shkollave dhe vlerësim të zbatimit të kurrikulës. Iniciativa për krijimin e mekanizmit mbështetës komunal duhet të mbështetet dhe të bëhet politikë arsimore nga niveli qendror.

Edhe zyrtarët arsimorë në MASHT dhe inspektorët e arsimit, të cilët ishin pjesë e këtij studimi, arrijtjet për zbatimin e kurrikulës së re i ndërlidhin me shtrirjen e zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat, sipas dinamikës së planifikuar, zhvillimin e kurrikulave lëndore, përfshirjen e mësimdhënësve në trajnimet e organizuara nga MASHT-i për zbatimin e kurrikulës, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve etj. Kurse, pjesa më e madhe e sfidave dhe problemeve që lidhen me zbatimin e kurrikulës, sipas këtyre subjekteve, i referohen sistemit organizativ dhe udhëheqës në nivel të mekanizmave të MASHT-it, por edhe të niveleve tjera arsimore që lidhen me zbatimin e reformës kurrikulare, për mungesë përkushtimi, serioziteti dhe përgjegjësie. Ikja nga planifikimi, bashkëpunimi dhe raportimi ndërsektorial për zbatimin e kurrikulës, si dhe fokusimi i Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT, që të merren vetëm me zhvillimin e kurrikulave lëndore, jo edhe me udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, pavarësisht se nuk specifikohet një gjë e tillë, nuk mund të justifikohet, për faktin se ky mekanizëm i MASHT-it ka udhëheqje, ka përfaqësim me dy anëtarë në Këshillin e ekspertëve për programe dhe tekste shkollore. Ashtu siç nuk mund të arsyetohet menaxhmenti i lartë në MASHT, i cili për vite me radhë nuk e ka vendosur prioritet kryesor zbatimin e kurrikulës, nuk ka plotësuar kapacitetet e nevojshme me staf në Divizionin për kurrikula, nuk ka siguruar buxhet të mjaftueshëm për zhvillimin dhe

zbatimin e kurrikulës, si dhe nuk ka siguruar mekanizma mbështetës e monitorues të qëndrueshëm për këtë proces tejet të ndjeshëm dhe kompleks.

Në anën tjetër, njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare njëzëri janë të mendimit se është shënuar një progres i vogël, por jo i pritur dhe i duhur, në kuadër të një ndryshimi, siç është reforma kurrikulare. Sipas tyre, zbatimi i kurrikulës është sfiduar në masë të madhe nga mënyra e udhëheqjes dhe nga fakti se pothuajse shkollat kanë mbetur të vetme në udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, pa mbështetje profesionale të konsoliduar dhe të vazhdueshme. Pa një sistem të llogaridhënies, nuk mund të pritet zbatim i suksesshëm i reformës kurrikulare, pasi, siç shprehet njëri nga njohësit e arsimit, mungesa e llogaridhënies krijon terren për produkt pune jocilësor.

Referuar raportit të vlerësimit për zbatim të kurrikulumit të ri të Kosovës në fazën e pilotimit, të hartuar nga Projekti i Binjakëzimit, dhe situatës aktuale të zbatimit të kurrikulës (2016-2019), të përshkruar në këtë raport të studimit, ka dallime të theksuara në përmbushjen e rolit të institucioneve në zbatimin e kurrikulës, si dhe dallime në udhëheqjen e procesit të zbatimit.

Këto dallime, në formë të një përmbledhjeje, shihen si në vijim:

Niveli	Zbatimi i kurrikulës në fazën e pilotimit (Manninen, J., 2014)	Zbatimi i kurrikulës në vitet 2016 - 2019
Niveli qendror - MASHT	Pilotim aktiv pas një fillimi të ngadaltë	Aktiv në rishikimin e dokumenteve kurrikulare, zhvillimin e kurrikulave lëndore, organizimin e trajnimeve. Në anën tjetër, me përcjellje të tendencës së largimit nga udhëheqja e procesit dhe bashkëpunimi sektorial.
Niveli komunal - DKA	Të neglizhuar dhe me burime të pakta	Angazhim i pamjaftueshëm në procesin e zbatimit të kurrikulës, me rol më të shtuar në koordinimin e trajnimeve, me burime dhe kapacitete të kufizuara.

Niveli shkollor	Rritje e punës në ekupe me burime të pakta	Rritje e punës në aktive profesionale, me pak ndryshime organizative, të fokusuar më shumë në zbatim se në të kuptuarit konceptit, mundësive dhe qasjeve që duhet aplikuar. Shfrytëzim i pamjaftueshëm i autonomisë së shkollës për zbatimin e kurrikulës. Pothuajse të vetëm në procesin e zbatimit, me mbështetje dhe burime të pakta.
-----------------	--	--

5.11. Parashikimi për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle

Është thelbësore që reforma e kurrikulës të mbështetet nga konteksti në të cilin është zbatuar dhe analiza e projekteve të reformës së kurrikulës, si një parakusht që idetë e reformës të kenë sukses (Saqipi, B., 2019, f. 46). Vazhdimi i zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle është proces i pakthyeshem në këtë fazë të zhvillimit, prandaj nevojitet të merret për bazë konteksti i zbatimit në këto dy-tri vitet e para të zbatimit të kurrikulës, si dhe të merren idetë nga të gjithë bartësit e këtij procesi, në mënyrë që vazhdimi i zbatimit të kurrikulës të jetë një mundësi për përmirësime në fushat e identifikuara që nuk kanë funksionuar, apo që kanë sjellë sfida dhe probleme për shkollat dhe mësimdhënësit.

Edhe për parashikimin për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, duke krahasuar rezultatet e të gjithë respondentëve të përfshirë në këtë studim, rezulton se ka diferencë të theksuar midis pikëpamjeve të përfaqësuesve nga shkollat, DKA-të dhe MASHT-i, kundrejt njohësve të arsimit dhe reformës kurrikulare.

Pjesa më e madhe e udhëheqësve të AP-së dhe drejtuesve të shkollave kur flasin për parashikimin, për përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën e tyre, dhe për mënyrën se si do të punojnë ata me kolegët e tyre për ta bërë këtë proces të suksesshëm. Nuk ofrojnë një referim në vetën e parë dhe në atë së çka do të bëjnë me kolegë në nivel shkolle, por më shumë u referohen kërkesave nga jashtë, që lidhen me sigurimin e

teksteve shkollore, ofrimin e trajnimeve, pajisjen me mjete dhe materiale mësimore, përmirësimin e kushteve në shkollë, zvogëlimin e numrit të nxënësve (shkollat në qytet), mbështetjen nga MASHT-i, DKA-të dhe donatorët, zvogëlimin e “administratës” etj. Mënyra se si e parashohin mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollës përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën e tyre del të jetë një mekanizëm mbrojtës ndaj kërkesave, të cilat nuk janë plotësuar nga sistemi për të zbatuar një kurrikulë të re në nivel shkolle, punës së mësimdhënësve vetëm me tekste shkollore, pa iu referuar programeve mësimore, si dhe mungesës së mekanizmave për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përgatitjeve dhe planifikimit të shkollës për zbatimin e kurrikulës së re.

Në pyetjet drejtuar zyrtarëve arsimorë/koordinatorëve të cilësisë në DKA, lidhur me ndryshimet që priten si rrjedhojë e vazhdimin të zbatimit të kurrikulës së re, përgjigjet e KC janë shumë të shpërndara. Disa KC, duke iu referuar mënyrës së si janë duke u udhëhequr ndryshimet në arsim dhe veçanërisht se si është udhëhequr reforma kurrikulare në këto 10 vitet e fundit, pohojnë se nuk presin ndryshime pozitive, përkundrazi shfaqin shqetësimet e tyre se disa gjëra do të jetë vështirë të ndryshohen. Vetëm 4 nga 11 KC të cilësisë, kur flasin për ndryshimet që priten si rrjedhojë e vazhdimin të zbatimit të kurrikulës së re, u referohen ndryshimeve në punën e tyre, me theks të veçantë riorganizimit të brendshëm në DKA, themelimit të një ekipi profesional, me qëllim ofrimin e mbështetjes për shkollat. Pjesa tjetër e KC më shumë u referohen ndryshimeve që priten t’i marrin nga niveli qendror. Sipas mënyrës se si e pasqyrojnë KC në DKA parashikimin e tyre për ndryshimet dhe përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollat e komunës së tyre, tregon se komunat ende nuk e kanë arritur nivelin e përgatitjes për ta përmbushur rolin e tyre në koordinimin e aktiviteteve, në mbështetjen e shkollave dhe në krijimin e kushteve në të gjitha shkollat që ta zbatojnë kurrikulën, sipas kërkesave të saj. Sipas Eva Hoffman (2003), për të pasur një produkt kreativ, duhet të këtë persona kreativë, proces kreativ dhe mjedis kreativ (cituar nga Rukiqi, Sh., 2014, f. 17). Kërkesat e kurrikulës kërkojnë produkte dhe punë kreative nga të gjithë bartësit e procesit të zbatimit të kurrikulës. Ky produkti kreativ nuk mund të fitohet pa

qenë aktivisht pjesë e procesit edhe autoriteti lokal dhe pa i përkrahur shkollat në krijimin e mjediseve kreative për punë me nxënës.

Ashtu si KC e cilësisë në DKA, edhe zyrtarët arsimorë në MASHT janë të ndarë sa u përket pritjeve dhe parashikimeve të tyre për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj. Një pjesë e tyre janë optimistë se gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur dhe shprehen se presin të vazhdojë zbatimi sipas planit dinamik, të bashkëpunojnë me të gjithë aktorët, të mbajnë komunikime me mësimdhënës. Ndërsa të pjesa tjetër reflektohet një masë pesimizmi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj dhe një masë e vetëkritikës që nuk kanë reaguar më herët që të ndalet procesi i reformës kurrikulare, me arsyetimin se nuk kemi sistem të organizuar për të pasur parashikime pozitive. Kjo e fundit duket se ka ndikuar që të rritet shkalla e pesimizmit, të mungojnë iniciativat për ta marrë në duar procesin dhe të vendosen brenda një zone të lidhur vetëm me një segment të ngushtë brenda një procesi shumë të gjerë, siç është udhëheqja dhe koordinimi i procesit të zbatimit të kurrikulës. Si duket, mungesa e plotë e informacionit për zhvillimet në nivel shkolle lidhur me zbatimin e kurrikulës dhe fokusi i angazhimit vetëm brenda një sektori, nuk i lejon subjektet e këtij grupi që të fokusohen për parashikimin për përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, për mënyrën se si të inkurajohen dhe përkrahen shkollat për një qasje inovative në përpilimin e planeve mësimore, përzgjedhjen e përmbajtjeve dhe burimeve mësimore për realizimin e proceseve efektive dhe kuptimplota (Boshtrakaj, L., 2019, f. 31), për qasjen që duhet të ndjekin ndaj vlerësimit të nxënësve etj.

Megjithatë, edhe nga zyrtarët e arsimorë në MASHT vendosja e një strukture përgjegjëse në MASHT, krijimi i strukturave në nivel komunal për mbikëqyrje, monitorim dhe mbështetje të mësimdhënësve, si dhe themelimi i Agjencisë për kurrikula, shihen si masa kryesore për të vënë në binarë të duhur procesin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë. Ideja për themelimin e Agjencisë për kurrikula ka dështuar tash e një dekadë, nuk është pritja që agjencia të themelohet shpejt, edhe vendosja e një strukture përgjegjëse në MASHT në rrethanat e ristrukturimit mund të jetë sfidë. Në rrethanat ekzistuese, nevojitet vëmendje e shtuar nga MASHT-i në përkrahjen dhe autorizimin e Divizionit për kurrikula që ta marrë

përgjegjësinë e udhëheqjes së gjithë procesit për vazhdimin e zbatimit të kurrikulës.

Parashikimi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj sipas njohësve të arsimit dhe të reformës kurrikulare lidhet me ndryshimet që duhet të ndodhin në aspektin organizativ, nga niveli qendror deri në shkolla, me ushtrimin e rolit dhe të përgjegjësive që kanë të gjitha strukturat që lidhen me këtë proces. Ridefinimi i përgjegjësive dhe zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshëm nga niveli qendror (MASHT) në atë lokal (DKA dhe shkollë), për përkrahje në zbatim në nivel shkolle, fuqizimi i shkollës, mbikëqyrja e vazhdueshme dhe funksionalizmi i mekanizmave të llogaridhënies, janë masa të domosdoshme që njohësit e arsimit parashikojnë se duhet të ndërmerren, për të siguruar zbatim të suksesshëm të kurrikulës. Sipas tyre, fokusi duhet të jetë në shkolla. Shkollat duhet ta ushtrojnë rolin e tyre gjatë gjithë procesit të zbatimit të kurrikulës, duhet të bëjnë analizën e punës në këto dy-tri vite, arrijtjet, sfidat dhe problemet me të cilat janë ballafaquar dhe mbi bazën e kontekstit, nevojave dhe mundësive reale, të bëjnë riorganizimin e brendshëm, duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e gjithë mekanizmave në shkollë për zbatimin e kurrikulës.

Parashikimi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj lidhet edhe me ndryshimet që duhet të ndodhin në Fakultetet e Edukimit dhe njësitë tjera akademike që ofrojnë programe kualifikimi për mësimdhënës dhe drejtues të shkollave. Të gjithë respondentët e vlerësojnë nevojën për përfshirje më aktive të universiteteve në procesin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar dhe nevojën për të ndryshuar diskursin e MASHT-it në mënyrën se si punon me universitetet në reformat arsimore, përkatësisht në reformën kurrikulare. Krahas kërkesës për të ndryshuar MASHT-i qasjen ndaj universiteteve / fakulteteve dhe njësive akademike që përgatisin mësimdhënës, kërkohet që universitetet të reformohen nga brenda.

KAPITULLI I GJASHTË: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Studimi i realizuar ka arritur qëllimin, që të evidentojë dhe të vlerësojë progresin e arritur në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, me fokus në nivel shkolle, të identifikojë sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin efektiv të kurrikulës. Përmirësimi dhe avancimi i praktikave të zbatimit të kurrikulës ishte synim kryesor i këtij studimi.

Dokumentimi i punës së shkollave për zbatimin e kurrikulës, perceptimet e mësimdhënësve, drejtuesve të shkollave, zyrtarëve arsimorë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zbatimin e kurrikulës në Kosovë, si dhe të njohësve të arsimit dhe të reformës kurrikulare, të cilët në faza të ndryshme ishin pjesë e procesit të reformës kurrikulare, ishin baza e të dhënave për këtë studim, të cilat u analizuan dhe u trajtuan gjatë tërë studimit.

Nga studimi dolën në pah një numër i konsiderueshëm i gjetjeve, të cilat tregojnë se ka mjaft zhvillime dhe praktika pozitive në zbatimin e kurrikulës që duhet të përforcohen, dhe njëkohësisht ka mjaft sfida dhe probleme, të cilat duhet të adresohen. Prandaj, vlerësojmë se të gjeturat e këtij studimi mund të shërbejnë për vendosjen e hapave dhe masave të mëtejshme që duhet të ndërmarrin MASHT-i, komunat dhe shkollat për zbatim të suksesshëm të kurrikulës.

6.1. Konkluzione

Përmbledhja e konkluzioneve u referohet pyetjeve kërkimore, të cilat e udhëhoqën këtë studim.

- *A është udhëhequr procesi i zbatimit të kurrikulës së re sipas udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës 2016-2021?*
- *Deri në çfarë shkalle i kontribuojnë zbatimit të kurrikulës së re/programeve të reja mësimore trajnimet dhe mbështetja e ofruar për zbatimin e kurrikulës?*

- *Sa janë të dukshme kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca, në proceset që zhvillohen në shkollë, në planifikimin shkollor dhe planifikimin mësimor për zbatimin e kurrikulës?*
- *A ka përputhje ndërmjet perceptimit të mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për zbatimin e kurrikulës, në raport me rolin e tyre në shkollë dhe vitin e fillimit të zbatimit të kurrikulës së re?*

Konkluzion i përgjithshëm është se, nga analiza cilësore dhe sasiore e të dhënave të fituara, është arritur mjaftueshëm që të evidentojmë dhe të vlerësojmë progresin e arritur në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, të identifikojmë sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të shkollave dhe mësimdhënësve për zbatimin efektiv. Gjithashtu, konkluzion i përgjithshëm është se nga mënyra se si është udhëhequr procesi i zbatimit të kurrikulës së re dhe praktika si janë ofruar trajnimet dhe mbështetja në fillimin dhe vazhdimin e zbatimit të saj, zbatimi cilësor i kurrikulës së bazuar në kompetenca është sfiduar në masë të madhe, vazhdimi i ballafaqimit me sfida të njëjta edhe në vitet vijuese, rrezikon të prodhojë efekte të kundërta, pasojat e së cilave do të reflektohen për disa vite me radhë.

Nga analiza dhe krahasimi i të dhënave të fituara dhe të diskutuara, në lidhje me pyetjet kryesore të studimit, janë fituar konkluzionet në vijim:

Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës

Udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re, 2016-2021, është dokumenti kryesor i MASHT-it, i cili orienton udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës nga viti 2016 e këndeje. Gjatë studimit rezulton se ka pak përputhje ndërmjet asaj që është përcaktuar në udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës (2016-2021) dhe asaj që është realizuar në raport me udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, si në përmbajtje ashtu edhe në kalendarin kohor të planifikuar. Nga mënyra, me të cilën përfaqësuesit e institucioneve arsimore përgjegjëse për zbatimin e kurrikulës e raportojnë udhëheqjen e këtij procesi, duket se dokumenti i udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës është i pashfrytëzuar mjaftueshëm dhe i neglizhuar, në mënyrë të veçantë nga niveli qendror,

MASHT. Kjo reflektohet edhe në qasjen e ndjekur në raport me konsolidimin e mekanizmave koordinues dhe mbështetës, zhvillimin e strukturës në nivelin komunal, zhvillimin e dokumenteve përcjellëse dhe teksteve shkollore, monitorimin e procesit të zbatimit, vlerësimin e procesit në fund të çdo viti të përcaktuar, qasjen ndaj trajnimeve, qasjen ndaj TIK-ut etj.

Rezultatet tregojnë se ka munguar përkushtimi i MASHT-it për përgatitjen e sistemit dhe mekanizmave për reformën kurrikulare dhe se reforma kurrikulare nuk është udhëhequr dhe nuk është duke u udhëhequr nga bartësit kryesorë dhe personat përgjegjës në MASHT. Nuk ka një mekanizëm që udhëheq diskutimet dhe konsultimet në mënyrë të vazhdueshme me palë të interesit, në mënyrë që të krijohet/thellohet të kuptuarit e përbashkët për konceptin, përmbajtjen dhe procesin e zbatimit të kurrikulës. Këtë proces aktualisht nuk është duke e udhëhequr nga Këshilli i ekspertëve për programe dhe tekste shkollore i themeluar nga MASHT, si dhe as nga Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT. Në mungesë të një trupe udhëheqëse dhe koordinuese, aktivitetet kryesore që lidhen me reformën kurrikulare vazhdojnë të jenë fragmentuara dhe të pakoordinuara brenda sektorëve dhe nënsektorëve në MASHT, dhe si të tilla reflektohen edhe në punën e DKA-ve dhe shkollave.

Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle duket se përballet me sfida të njëjta, që kalojnë të gjitha projektet e zhvillimit shkollor (Manninen, J., 2014, f. 15). Rezultatet treguan se akoma në shumë shkolla nuk është arritur që të ndryshohet kultura organizative për të zhvilluar dhe zbatuar praktika të reja, që lidhen me rolin dhe pritshmëritë e shkollës për të udhëhequr ndryshimet në nivel të saj, siç janë ndryshimet në reformën kurrikulare. Kjo gjithashtu tregon se pilotimi i kurrikulës, i përfunduar në vitin shkollor 2015/2016, në 1-2 shkolla të secilës komunë, nuk ka ndikuar mjaftueshëm në përgatitjen e shkollave dhe sistemit për ta udhëhequr zbatimin e kurrikulës në shkallë vendi, apo, siç e përshkruan njëri nga njohësit e reformës kurrikulare: Pilotimi i kurrikulës ishte një front i izoluar.

Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle më shumë u referohet kërkesave që vijnë nga MASHT-i dhe DKA-të dhe iniciativave mbështetëse nga partnerët sesa një udhëheqjeje të organizuar mirë në nivel shkolle, për riorganizimin e brendshëm të shkollës dhe udhëheqjen e proceseve për zbatimin e kurrikulës. Udhëheqja e procesit të zbatimit të kurrikulës duket se theksohet më shumë në aspektin e bashkëpunimit të mësimdhënësve për planifikime mësimore sesa në aspektin e udhëheqjes së proceseve mësimore në funksion të mësimin të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore. Bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve, i cili në nivel shkolle veçohet si rezultat i udhëheqjes, duket më shumë si një plotësim i një kërkesë dhe nevojë të lidhur me qasjen ndaj planifikimit të kurrikulës sesa një kulturë e bashkëpunimit kolegial brenda një procesi të ndryshimeve.

Në anën tjetër, vetëvlerësimi i performancës së shkollës, si instrument për përmirësimin dhe avancimin e performancës së shkollës në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës dhe si një mekanizëm periodik i transparencës dhe llogaridhënies, përbën ndryshim në udhëheqjen e proceseve në shkollë, që nuk është vlerësuar dhe konsideruar si duhet në procesin e përgatitjes dhe udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle. Rreth 50 % e shkollave nuk kanë ofruar dëshmi, apo kanë ofruar dëshmi të pakta/mangëta, që kanë kaluar në një proces të vetëvlerësimit të performancës së shkollës, në ndërlidhje me parimet e kurrikulës dhe pritshmëritë e shkollës, të përcaktuara me Kornizën për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës. Problemet e ngritura në funksionalizimin e koordinatorëve të cilësisë në nivel shkolle, komune dhe MASHT-i, kanë ndikuar që shkollat të mos e realizojnë vetëvlerësimin e performancës së shkollës/vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës.

Konkluzion i përgjithshëm për udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës. Zbatimi i kurrikulës së re në shkollë vendi ka nisur pa u konsoliduar mekanizmat e nevojshëm për udhëheqje të procesit, monitorim dhe mbështetje të shkollave dhe mësimdhënësve. Udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re, 2016-2021, është dokumenti kryesor orientues, i cili përcakton fushat që kanë nevojë për vëmendje të veçantë gjatë procesit të zbatimit të kurrikulës, përcakton përgjegjësitë institucionale afatgjata për

procesin e zbatimit të kurrikulës, dhe ofron udhëzime për shkollat dhe mësime të mësimdhënësve se si të fillojnë zhvillimin e shkollës së tyre në mënyrë që procesi i zbatimit të kurrikulës të bëhet i suksesshëm. Përbën një risi në reformën e fundit kurrikulare, që nuk është vlerësuar dhe konsideruar si duhet në procesin e udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës, në radhë të parë nga vetë MASHT-i, pastaj edhe nga DKA-të dhe shkollat. Kjo ka bërë që udhëheqja e zbatimit të kurrikulës të vazhdojë me një qasje të fragmentuar dhe më së shumti ka ndikuar në punën e shkollave.

Trajnimet dhe mbështetja profesionale për zbatimin e kurrikulës së re

Trajnimi dhe mbështetja janë një nga tetë fushat e udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës së re, 2016-2021. Nga rezultatet e studimit, me të gjithë aktorët pjesëmarrës në studim, konfirmohet se trajnimet për zbatimin e kurrikulës kanë qenë pika më e diskutuar, si për kohëzgjatjen e trajnimeve, ashtu edhe për cilësinë e tyre dhe të trajnerëve. Megjithatë, trajnimi për zbatimin e kurrikulës konsiderohet si një nga fushat kryesore të sistemit, e cila së bashku me kurrikulat e reja lëndore të zhvilluara, kanë ndërlidhur punën e MASHT-it, DKA-ve dhe shkollave në kuadër të angazhimeve për zbatimin e kurrikulës në shkallë vendi, pavarësisht faktit se nuk janë ndërtuar mekanizma për të mbikëqyrur procesin e trajnimeve dhe për të ofruar mbështetje të vazhdueshme në ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve.

Nga fillimi i zbatimit të kurrikulave të reja lëndore, në vitin shkollor 2016/2017 e këndej, në nivel të sistemit kryesisht janë ofruar trajnimet 5-6-ditore për zbatimin e saj dhe janë zhvilluar aktivitete përcjellëse për certifikimin e mësime të mësimdhënësve në këtë program. Forma tjera të mbështetjes kanë filluar në disa komuna, përmes ekipeve profesionale mbështetëse, apo organizimit të shkollave në kuadër të komuniteteve, të mësuarit së bashku, mirëpo raportohen sfida në funksionalizimin e tyre për mungesë të rregullave ligjore, resurseve buxhetore, por edhe për mungesë të zhvillimit të kapaciteteve.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se në qendër të vëmendjes gjatë këtyre viteve kanë qenë trajnimet e mësime të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, ndërsa janë lënë anash trajnimet në këtë fushë për zyrtarët arsimorë në DKA

dhe udhëheqjen e shkollave, lidhur me rolin e tyre dhe udhëheqjen e procesit të zbatimit të saj. Gjithashtu, në dokumentimin e punës së shkollave fare pak ka dëshmi për aktivitet të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë (me përjashtim të shkollave që mbështeten nga projekti i EU – projekti Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve dhe GIZ).

Nga Inspektorati i Arsimit raportohet se nuk kanë ndërtuar një sistem të raportimit dhe shkëmbimit të informatave për sektorë dhe nënsektorë brenda MASHT-it, për aspektet e identifikuara gjatë procesit të vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve dhe vlerësimit të performancës së shkollës, lidhur me zbatimin e kurrikulës, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen shkollat. Gjithashtu, nuk ka dëshmi se është ndërtuar ndonjë mekanizëm për të koordinuar bashkëpunimin në mes të DKA-ve, shkollave dhe Fakultetit të Edukimit për mbështetjen profesionale për zbatimin e kurrikulës, siç është përcaktuar në udhërrëfyesin për zbatimin e saj.

Në anën tjetër, në nivel shkolle, në përgjithësi, ekziston një qëndrim pozitiv për trajnimet lidhur me zbatimin e kurrikulës, por me dallime. Mbi 22% e mësimitdhënësve shprehen se trajnimet nuk kanë qenë të mjaftueshme, mbi 18 % e mësimitdhënësve janë shprehur se trajnimet nuk kanë dhënë rezultate dhe nuk kanë qenë nxitëse, si dhe mbi 25 % e mësimitdhënësve shprehen se trajnimet nuk kanë qenë praktike. Në përgjithësi vlerësimi për trajnimet del të jetë me shumë kundërthënie si për kohëzgjatjen e trajnimeve, ashtu edhe për cilësinë e trajnimeve dhe të trajnerëve.

Konkluzion i përgjithshëm për trajnimet dhe mbështetjen profesionale për zbatimin e kurrikulës së re. Nuk është krijuar masa e nevojshme dhe në cilësinë e duhur e kapaciteteve për të udhëhequr dhe për të ofruar trajnimet për zbatimin e kurrikulës së re. Reflektimet e respondentëve në studim, veçanërisht drejtorëve të shkollave dhe mësimitdhënësve, tregojnë se trajnerët kanë përçarur mesazhe të ndryshme, të cilat shpesh kanë krijuar konfuzione te një pjesë e mësimitdhënësve. Trajnimet disaditore nuk e garantojnë suksesin e zbatimit të kurrikulës. Mungesa e mekanizmave për mbikëqyrjen e trajnimeve të mësimitdhënësve ka ndikuar në cilësinë e trajnimeve dhe në zbatimin në praktikë të përvojave të trajnimeve.

Zbatimi i kurrikulës në nivel shkolle - *Sa janë të dukshme kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca, në proceset që zhvillohen në shkollë, në planifikimin shkollor dhe planifikimin mësimor, për zbatimin e kurrikulës?*

Shumica e shkollave që morën pjesë në studim ofruan dëshmi të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle. Kjo u bë e mundshme nga vëzhgimet e mjediseve shkollore gjatë vizitave hulumtuese, nga analiza e planifikimeve shkollore dhe raporteve të punës për proceset që zhvillohen në shkollë, nga analiza e planifikimeve të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, por edhe nga pyetësorët dhe intervistat me mësimdhënës dhe udhëheqës të shkollave.

Përgjithësisht, klasat e shkollave të vëzhguara, sallat e mësimdhënësve dhe mjediset tjera në shkolla, që lidhen me punën me nxënës, japin informacione që tregojnë se ka filluar të ndihet fryma e kurrikulës së re në shkolla, si në organizimin e klasave, ashtu edhe në këndet e informimit për nxënës, prindër dhe mësimdhënës. Megjithatë, ekzistojnë dallime të dukshme sa u përket qasjes dhe organizimit të punës së shkollave në zbatimin e kurrikulës së re. Dallimet reflektojnë kulturën dhe traditën e punës së shkollave, seriozitetin apo mosseriozitetin e punës së udhëheqësve të shkollave dhe të mësimdhënësve, lirinë e shprehjes dhe mendimit apo mungesën e saj nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve, angazhimin apo mosangazhimin e mësimdhënësve, përkrahjen apo mospërkrahjen nga partnerët mbështetës, nga MASHT-i, DKA, etj. Hasem në grupe të nxënësve që tregonin se në shkollat e tyre disa mësimdhënës akoma vazhdojnë të japin shënime për nxënës, në mungesë të teksteve. Mungesa e teksteve shkollore, sipas kurrikulave të reja lëndore, ka qenë shqetësim i ngritur pothuajse nga të gjithë mësimdhënësit, por edhe nga nxënësit, me të cilët janë zhvilluar diskutime joformale.

Planifikimet shkollore dhe raportet e punës për proceset që zhvillohen në shkollë, me fokus zbatimin e kurrikulës, përshkruhen me dallime ndërmjet shkollave dhe me argumente të paketa për zbatimin e kurrikulës. Vetëm 33% e shkollave kanë përgatitur dhe shpërndarë materiale informuese për mësimdhënës, prindër dhe nxënës, lidhur me ndryshimet e kurrikulës së re, rolin dhe përgjegjësitë e shkollës, ndërsa vetëm 43 % e shkollave kanë ofruar

dëshmi, si plane dhe raporte pune, që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkollë. Në anën tjetër, 52 % e shkollave kanë ofruar dëshmi, plane dhe raporte pune, të organeve profesionale të shkollës, që pasqyrojnë punën në planifikim dhe raportim për zbatim të kurrikulës. Një progres më i madh është shënuar në planin zhvillimor dhe planin vjetor të punës së shkollës, mirëpo përmbajtjet e tyre në përgjithësi tregojnë se mungon qasja për zhvillim të integruar të shkollës, përmes së cilës do të sigurohej më mirë zbatimi i kurrikulës së re.

Është rritur bashkëpunimi i mësimeve në fushën e planifikimit mësimor. Përgjithësisht planifikimet mësimore janë hartuar në formatin teknik, të prezantuar në udhëzuesit për mësime që lidhen me zbatimin e kurrikulës, udhëzuesit për fusha kurrikulare. Mirëpo, cilësia e planifikimeve mësimore akoma mbetet një sfidë më vete. Trajtimi i planifikimit mësimor nga një pjesë e madhe e mësimeve, por edhe e drejtuesve të shkollave, si punë administrative; mungesa e qasjes kreative në planifikim; tendenca e planifikimeve shabllone, planifikimi mësimor duke u bazuar në tekste mësimore (edhe pse tekstet janë të viteve të mëhershme, nuk janë hartuar sipas kurrikulës së re në kohën e realizimit të studimit) jo në kurrikula lëndore dhe kurrikula bërthamë, etj., vazhdojnë të ndikojnë në cilësisë e planifikimeve mësimore dhe në përdorimin e tyre për ta udhëhequr mësime dhe punën me nxënës në zbatimin e kurrikulës së re. Duket se planifikimet mësimore për zbatimin e kurrikulës në disa shkolla më shumë janë realizuar për shkak të kërkesës zyrtare, jo si rezultat i reflektimeve që tregojnë se planifikimet e mësimit janë dokumente që ndihmojnë apo përcjellin punën e mësimeve.

Problemet më të mëdha në planifikimin mësimor për zbatimin e kurrikulës së re janë identifikuar në: (i) ndërlidhjen në mes të planifikimit vjetor – planifikimit për periudha mësimore – dhe planifikimit për orë mësimore; (ii) përcaktimin e njësive mësimore apo aktiviteteve mësimore (për klasën përgatitore) sipas rezultateve të të nxënës për tema mësimore; (iii) përcaktimin dhe përshkrimin e metodologjisë së mësimeve dhe vlerësimit në funksion të zhvillimit të kompetencave dhe zbatimit të qasjes së integruar. Në përgjithësi, mungon qasja e planifikimit për proceset mësimore në funksion të mësimit të integruar dhe zhvillimit të

kompetencave kryesore, kërkesa kryesore që duhet plotësuar për zbatim të suksesshëm të kurrikulës së bazuar në kompetenca.

Nuk ka dallime të theksuara në planifikimet e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, në raport me vitet e fillimit të zbatimit të kurrikulës (2016/2017 apo 2017/2018). Në shumë raste planifikimet e shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re, në vitin 2016/2017, janë bartur te shkollat tjera që një vit më vonë (2017/2018) kanë filluar zbatimin e kurrikulës. Kjo ka bërë që në disa plane të evidentohen mospërputhje me kurrikulat lëndore zyrtare, si rezultat se në shkollat e grupit të parë (2016/2017) çdo vit bëhet një lloj pilotimi i kurrikulave lëndore, të cilat në fund të vitit plotësohen me ndonjë detaj të identifikuar dhe miratohen nga MASHT-i për t'u bërë kurrikula lëndore zyrtare në nivel vendi në vitin vijues.

Bazuar në dokumentimin e punës së shkollave, përfshirë edhe dokumentimin për planifikim mësimor, vlerësimi për shkallë kurrikulare, vazhdon të mbetet një mekanizëm apo instrument i pashfrytëzuar në bazë të qëllimit të vendosur për mbështetjen e nxënësve në zotërimin e rezultateve të nxënësve të kompetencave dhe përkrahjen në zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre. Në përgjithësi shkollat nuk kanë ndërtuar bazë të orientimeve, evidencave e dëshmive të vlerësimeve që sigurojnë realizimin e vlerësimit për shkallë kurrikulare bazuar në qëllimin e tij. Gjithashtu, shkollat që kanë bërë vlerësimin e për shkallë kurrikulare, nuk kanë ofruar dëshmi se si janë përdorur rezultatet në planifikimin mësimor në klasën vijuese, si janë përdorur rezultatet për të ofruar mbështetje për nxënësit, si mësim plotësues, mësim shtues, aktivitete ekstrakurrikulare, projekte të veçanta mësimore me nxënësit, etj.

Në anën tjetër, referuar perceptimeve të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave, ka progres në zbatimin e kurrikulës, punohet sipas kurrikulave të reja lëndore, kurrikula ka filluar të pranohet nga mësimdhënësit, janë bërë ndryshime të vogla në praktikat e mësimdhënies në klasë, qasjen ndaj punës me nxënësit, qasjen ndaj vlerësimit të nxënësve, përdorimit të teksteve ekzistuese dhe burimeve tjera mësimore. Mirëpo, kufizimi i mbështetjes vetëm me trajnime disaditore për zbatimin e kurrikulës ka bërë që shkollat dhe mësimdhënësit të kenë sfida të shumta në zbatimin e kurrikulës, udhëheqjen e proceseve mësimore bazuar në parimet e kurrikulës.

Konkluzion i përgjithshëm lidhur me zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle. Pothuajse të gjitha shkollat janë lënë vetëm në procesin e zbatimit të kurrikulës, duke u përballur me mungesë të teksteve shkollore, mungesë të mbështetjes, mungesë të kopjeve fizike të kurrikulave të reja lëndore, mungesë të pajisjeve të TIK-ut dhe mjeteve tjera të nevojshme, si dhe duke u përballur me frikë nga ndryshimi, qëndrimet e refuzimit joformal të disa mësimeve etj. Zbatimi i kurrikulës në nivel shkolle është realizuar aq sa sistemi është përgatitur për të udhëhequr procesin e zbatimit të kurrikulës dhe aq sa ka ofruar mbështetje për shkollat lidhur me zbatimin e saj. Natyrisht, me përjashtime në disa shkolla dhe te disa mësimeve të përkushtuar, të cilët vazhdojnë të punojnë me përkushtim. Mungesa e koordinimit nga niveli qendror dhe mungesa e monitorimit të shkollave dhe mësimeve ka ndikuar në cilësinë e zbatimit të kurrikulës, pavarësisht faktit se zhvillimi i kurrikulave lëndore/programeve mësimore dhe trajnimet e ofruara nga MASHT-i kontribuojnë dhe lehtësojnë deri diku zbatimin e kurrikulës së re.

Në anën tjetër, mungesa e një dokumenti zyrtar, që rregullon procedurat standarde të planifikimit mësimor, shqyrtimit dhe miratimit të tyre në nivel shkolle, ka bërë që dokumentimi i planifikimit mësimor dhe shqyrtimi i tyre të jetë një proces i shpërndarë në shkolla dhe në shumë raste pa adresë të qartë, si dhe të dallojnë planifikimet mësimore për përditshmërinë e punës së mësimeve në raport me planifikimet mësimore për vlerësim të performancës së mësimeve që kërkohen nga Inspektorati i Arsimit. Pavarësisht kësaj, gjatë procesit të hulumtimit, kontakteve që i kishim me drejtues të shkollave, me mësimeve dhe personelin tjetër në shkolla, por edhe të dëshmive që lidhen me zbatimin e kurrikulës, kemi vërejtur një entuziazëm shprehës se shkollat janë shumë të interesuara të marrin përgjegjësinë mbi vete sa i përket reformës kurrikulare, gjegjësisht zbatimit të saj në nivel shkolle. Puna më përmbajtësore me shkollat mund të kthejë këtë entuziazëm me rezultate të prekshme, të cilat reflektohen në arritjet e nxënësve.

Perceptimet e mësimeve dhe udhëheqësve të shkollave për zbatimin e kurrikulës së re, në raport me rolin e tyre në shkollë dhe vitin e fillimit të zbatimit të saj

- Mësimeve e arsimit të mesëm të ulët kanë mendim më pozitiv për mbështetjen e ofruar gjatë trajnimeve sesa mësimeve e arsimit fillor, sipas të cilëve mbështetja e ofruar gjatë trajnimeve nuk ka qenë e mjaftueshme (46.2% pohojnë se nuk ka qenë e mjaftueshme, ndërsa 23.1% janë me dilema). Mbi 18 % e gjithë mësimeve të përfshirë në studim janë shprehur se trajnimet nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe nuk kanë qenë nxitëse, përkatësisht rreth 23 % e mësimeve janë shprehur se nuk kanë qenë praktike dhe nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme.
- Mendimet e mësimeve për konsultimet dhe mbështetjen e ofruar brenda shkollës ishin të shpërndara, si në raport me pozitën e mësimeve në shkollë, ashtu edhe në raport me vitin e fillimit të zbatimit të kurrikulës së re. Përpunimi i rezultateve nga pyetësi i mësimeve tregon se rreth 78% e gjithë mësimeve pohojnë se kanë përfituar nga konsultimet dhe u është ofruar mbështetje profesionale brenda shkollës, ndërsa mbi 22 % e personelit të shkollës pohojnë se gjatë zbatimit të kurrikulës asnjëherë nuk u është ofruar mbështetje profesionale brenda shkollës. Udhëheqësi i shkollës ishin ndër tre mbështetësit kryesorë, të cilët ofruan mbështetje për mësimeve, këtë e shprehin rreth 86 % e mësimeve. Në anën tjetër, në pyetje të hapura mësimeve shprehin dilema për cilësinë e mbështetjes së ofruar nga udhëheqësi i shkollës.
- Mësimeve që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re, në vitin shkollor 2016/2017, më shumë u referohen konsultimeve dhe mbështetjes së ofruar jashtë shkollës sesa mësimeve që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re në vitin shkollor 2017/2018. Përtej trajnimeve që kanë ndjekur, mbi 53 % e mësimeve të përfshirë në studim konfirmojnë se kanë përfituar edhe nga konsultimet dhe mbështetja profesionale jashtë shkollës (kryesisht i referohen konsultimeve me trajnerët për përgatitjen e portfoliove për certifikim), ndërsa rreth 47 %

e personelit të shkollës asnjëherë nuk kanë pasur konsultime e as mbështetje profesionale jashtë shkollës.

- Lidhur me pranimin apo besimin në kurrikulën e re, është interesant fakti se pajtueshmëri më të lartë kanë shprehur mësimdhënësit që nuk kanë pozita udhëheqëse në shkollë sesa koordinatorët e kurrikulës, kryetarët e aktiveve profesionale dhe koordinatorët e cilësisë në shkollë, të cilët kanë shprehur më shumë dilema rreth pranimin apo besimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca. Këta të fundit (mbi 54 % e tyre) shfaqin më shumë dilema rreth kurrikulës së re. Në intervistat e realizuara me KC dhe udhëheqës të AP, ata i referohen më shumë realitetit në shkollat e tyre lidhur me zbatimin e kurrikulës. Në anën tjetër, përballja më e gjatë në vitet e zbatimit të kurrikulës ka tendencë më të mëdha për rritjen e mosbesimit në të dhe kjo reflektohet në përqindje më të lartë të mësuesit e klasës së dytë dhe mësimdhënësit që japin mësim në klasën e shtatë.
- Një çështje që mund të nxirret si konkluzion është fakti se janë parë pak ndryshime në nivel të shkollave, në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re. Rezultatet e studimit tregojnë se nuk ka dallime të theksuara në mendimet e mësimdhënësve që kanë role udhëheqëse në shkollë, mësimdhënësve që nuk kanë role udhëheqëse në shkollë dhe udhëheqësve të shkollave, lidhur me ndryshimet në nivel shkolle, në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re. Mbi 40 % e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave konfirmojnë se kanë bërë ndryshime të vogla apo nuk kanë bërë ndryshime në përgjigje të kërkesave për zbatimin e kurrikulës së re. Ndërsa, rreth 39% kanë bërë ndryshime të moderuara/të kujdesshme dhe mbi 20 % e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave konfirmojnë se kanë bërë ndryshime thelbësore në përgjigje të kërkesave të kurrikulës.
- Lidhur me ndryshimet në shkollë, në përgjigje të kërkesave të kurrikulës ka ndryshime të vogla në raport me vitet kur shkollat kanë filluar të punojnë me kurrikula të reja lëndore, të hartuara sipas dokumenteve kurrikulare të bazuara në kompetenca. Mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re në vitin shkollor 2016/2017, për 6 % më shumë, shprehen se kanë bërë ndryshime të

moderuar dhe ndryshime thelbësore në nivel shkolle, në përgjigje të kërkesave të kurrikulës së re. Kjo evidentohet edhe në dëshmitë e shkollave, planet dhe raportet e punës, lidhur me zbatimin e kurrikulës së re. Në anën tjetër, mësimdhënësit dhe udhëheqësit e shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re në vitin shkollor 2017/2018, në shkallë më të lartë shprehin mendimin se kanë bërë ndryshime të vogla, apo kanë ndërmend që në vitin vijues t'i bëjnë ndryshimet e nevojshme.

- Në anën tjetër, mësimdhënësit e shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re në vitin shkollor 2017/2018, kundrejt mësimdhënësve që kanë filluar në vitin shkollor 2016/2017, shprehin mendimin se ata i kanë më të qarta dhe evidente ndryshimet në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies lidhur me zhvillimin e kompetencave të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës së re. Në parim, mësimdhënësit e shkollave që kanë filluar zbatimin e kurrikulës së re në vitin 2016/2017 do të duhej të avanconin më shumë kundrejt kolegëve të tyre që filluan një vit më vonë me kurrikulën e re, kur kemi parasysh se grupi i parë i shkollave ka qenë për dy vite me radhë pjesë e pilotimit të kurrikulës dhe ka marrë më shumë mbështetje nga MASHT-i dhe donatorët mbështetës të arsimit. Kjo duket se është ndikuar nga sfidat, me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit dhe shkollat për vite me radhë, me mungesë të mekanizmave mbështetës, mungesë të përkrahjes, mungesë të teksteve shkollore dhe mungesë të informatave kthyesë për punën që kanë bërë gjatë këtyre viteve.

Konkluzion i përgjithshëm lidhur me dallimet në perceptimet e mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave për zbatimin e kurrikulës së re, në raport me rolin e tyre në shkollë dhe vitin e fillimit të zbatimit të kurrikulës. Referuar ballafaqimit të rezultateve të përpunuara nga pyetësorët me mësimdhënësit dhe udhëheqës të shkollave, rezultoi se në përgjithësi mendimet ndryshonin, por ato nuk janë shumë të theksuara, me ndonjë përjashtim për ndonjë kërkesë të veçantë. Edhe pse shkollat që kanë filluar të zbatojnë kurrikulën e re në vitin 2016/2017 njëkohësisht kanë qenë pjesë e pilotimit të kurrikulës për dy vite me radhë, kanë përfituar mbështetje më shumë se shkollat tjera, kanë dallime minimale në perceptimin pozitiv të

proceseve lidhur me kurrikulën e re. Kjo duket se është ndikuar nga sfidat, me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit dhe shkollat gjithë këto vite, me mungesë të mekanizmave mbështetës, mungesë të përkrahjes, mungesë të teksteve shkollore dhe mungesë të informatave kthyesë për punën që kanë bërë gjatë këtyre viteve. Mënyra me të cilën i qasen MASHT-i dhe komunat në përmbushjen e përgjegjësiave për zbatimin e kurrikulës ndikon në mënyrën se si udhëheqja e shkollës dhe mësimdhënësit i shohin proceset e zbatimit të saj dhe angazhohen për të përmbushur rolin e tyre.

6.2. Rekomandime

Rezultatet nga ky studim, njohuritë teorike dhe përvoja në fushën e studimit, shtrojnë nevojën që rekomandimet të konceptohen dhe të organizohen duke iu referuar rolit dhe përgjegjësiave të institucioneve arsimore në reformën kurrikulare, me qëllim përmirësimin dhe avancimin e udhëheqjes së procesit dhe praktikave të zbatimit të kurrikulës. Pra, rekomandimet nga ky studim do të shërbejnë si udhërrëfyes për MASHT-in, DKA-në dhe shkollat, për të marrë masat e nevojshme për vazhdimin e reformës kurrikulare, përmirësimin dhe avancimin e udhëheqjes dhe zbatimit të kurrikulës.

Rekomandime për MASHT-in

MASHT-i, në radhë të parë, duhet të rikonfirmojë vullnetin dhe përkushtimin institucional për të vazhduar zbatimin e kurrikulës, duke i dhënë përparësi mbi çdo prioritet tjetër dhe duke siguruar qëndrueshmëri të procesit. Kjo pastaj duhet të reflektohet në masat në vijim. (Kurrikula është kushtetuta e arsimit).

Rishikimi i udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës së re, 2016-2021.

Rezultatet e studimit tregojnë se udhërrëfyesi nuk është vlerësuar dhe konsideruar si duhet në procesin e reformës kurrikulare, nuk janë zbatuar një mori e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara për tetë fushat tematike të zhvillimit të reformës kurrikulare. Vazhdimi i reformës kurrikulare pa një udhërrëfyes të tillë, i cili përcakton fushat që kanë nevojë për vëmendje të veçantë gjatë procesit të zbatimit të kurrikulës, objektivat dhe masat kryesore, përgjegjësitë institucionale për procesin e zbatimit të kurrikulës

dhe udhëzimet për shkollat dhe mësimdhënësit, përbën një rrezik për vazhdimin e qasjes së fragmentuar në zbatimin e kurrikulës. Rishikimi i udhërrëfyesit duhet të mbështetet në gjetjet e këtij studimi dhe në raportet e rekomandimet e studimeve të viteve të fundit për reformën kurrikulare në Kosovë. Udhërrëfyesi duhet të mbështetet me mjete financiare, personel udhëheqës dhe burime tjera të nevojshme. Udhërrëfyesi i rishikuar, duhet të mbulojë fushat tematike të udhërrëfyesit aktual, si dhe rishikimin vazhdueshëm të kurrikulave lëndore, duke filluar me rishikimin e kurrikulave lëndore nga klasa përgatitore. Udhërrëfyesi duhet të mbështetet me mjete financiare, personel udhëheqës/bartës për secilën fushë dhe burime tjera të nevojshme.

Procesi i përgatitjes së teksteve të reja dhe burimeve tjera të nevojshme.

Mungesa e teksteve të reja, të bazuara në kurrikulën e re, konsiderohet si një prej sfidave kryesore, me të cilën janë përballur shkollat dhe mësimdhënësit në këto vitet e fundit. Tekstet e para, të hartuara në bazë të kurrikulës së re, nuk ishin pjesë e këtij studimi, mirëpo shqetësimet e ngritura, mangësitë e identifikuara, si dhe nevojat për tekste të reja shkollore, kërkojnë që të përshpejtohet procesi i përgatitjes së teksteve dhe të vendosen procedura standarde që sigurojnë tekste cilësore dhe në përputhje me kërkesat e kurrikulës së re. Gjithashtu, MASHT-i duhet t'u kushtojë vëmendje dhe përkushtim të veçantë zhvillimit të burimeve shtesë, zhvillimit të platformave online, që ndihmojnë punën e nxënësve dhe mësimdhënësve në përmbushjen e kërkesave të kurrikulës së re.

Konsolidimi i mekanizmave për udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, monitorimin e procesit dhe sigurim të cilësisë. Situata e përshkruar në raportin e këtij studimi dhe situata e përshkruar edhe në raportin e studimit *Sfidat e zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë*, të autores Boshtakaj, L., (2018), tregojnë se procesi i zbatimit të kurrikulës është sfiduar seriozisht shkaku i mungesës së këtyre mekanizmave. Reforma kurrikulare është komplekse dhe e ndjeshme, prandaj nuk mund të vazhdohet procesi pa konsolidim të mekanizmave drejtues, mbështetës dhe mbikëqyrës. Konsolidimi i këtyre mekanizmave do të ndikojë që procesi i zbatimit të kurrikulës të marrë mbështetjen e nevojshme dhe të vihen në jetë parimet e kurrikulës në raport me

përgjegjësitë institucionale të udhëheqjes së proceseve të reformës kurrikulare.

Ndërrimi i qasjes në raport me kurrikulën në edukimin parashkollor, mbështetjen dhe zhvillimin profesional të edukatorëve dhe udhëheqësve të institucioneve. Nevojitet fokusim më i madh në të kuptuarit e konceptit, mundësive dhe qasjeve që duhen aplikuar në këtë nivel të edukimit. Rishikimi i kurrikulës së klasës përgatitore është një nevojë që duhet të adresohet nga MASHT-i. Në këtë proces dhe përgjithësisht në procesin e reformës kurrikulare duhet të angazhohen edhe Fakultetet e Edukimit dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës. Rishikimi duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar, qartësi se veprimtaria edukative në këtë klasë duhet të organizohet përmes lojës dhe aktiviteteve ndërvepruese, paraprakisht të planifikuara. Rishikimi i kurrikulës për klasën përgatitore duhet të përcillet edhe me një udhëzues të veçantë për zbatimin e saj në klasën përgatitore - *material ndihmës për edukatorët/mësuesit e klasës përgatitore*, si dhe me instrumente të veçanta për planifikim mësimesor.

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për zbatimin e kurrikulës. Rezultatet e studimit tregojnë se trajnimet disaditore nuk garantojnë suksesin e zbatimit të kurrikulës. Nevojitet ekspertizë e re, mbështetje profesionale e vazhdueshme dhe e qëndrueshme për mësimdhënës dhe bartësit e procesit, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i suksesshëm. Për këtë nevojitet një platformë e qartë e ofrimit të trajnimeve dhe formave të tjera të mbështetjes profesionale, e cila siguron se rriten thellësia dhe kohëzgjatja e zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Pikë referimi për zhvillimin e mësimdhënësve duhet të jenë kërkesat e kurrikulës, të kuptuarit e konceptit dhe parimeve të saj, mundësive dhe qasjeve që duhen aplikuar, si dhe Korniza për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë (2017). Rregullimi i bazës ligjore për formimin e ekipeve profesionale në nivel komune, për mbështetjen dhe zbatimin e kurrikulës dhe zhvillimin profesional me bazë në shkollë, duhet të kenë vëmendjen e veçantë nga MASHT-i.

Ngritja e debatit institucional për reformën kurrikulare. Të gjitha studimet e viteve të fundit për reformën kurrikulare në Kosovë tregojnë se ka mungesë të debatit kombëtar mbi reformën kurrikulare, përkatësisht ka mungesë të vendosjes së debateve në një nivel më konceptual të vlerave dhe

aspiratave që u shërben kurrikula e re. Kjo vërehet edhe në nivelin e informimit të komunitetit të shkollës dhe të sensibilizimit për zbatimin e kurrikulës në mbështetje të parimeve të saj. Prandaj, është e nevojshme që MASHT-i të fillojë një debat kombëtar mbi reformën kurrikulare dhe cilësinë e sistemit arsimor në përgjithësi, sidomos tani, kur priten edhe rezultatet nga PISA 2018. Përfshirja e mediave të ndryshme, përmes informimit dhe ofrimit të programeve të veçanta për reformën kurrikulare, rrishtë dhe mundësisë e saj, mund t'i shërbejë këtij qëllimi. Ngritjes së debatit duhet t'i kontribuojë MASHT-i edhe me ngritjen e transparencës për këtë proces, me rregullimin e faqes zyrtare për reformën kurrikulare dhe pasurimin e saj me materiale dhe informata të nevojshme për komunitetin arsimor dhe gjithë shoqërinë.

Fuqizimi i autonomisë së shkollës. Studimet tregojnë se autonomia e shkollës, niveli i iniciativave dhe aktivitetëve të zhvillimit në shkollë, janë elemente thelbësore për të ngritur komunikimin, koordinimin dhe nivelin e përgjegjësisë për zbatimin e reformës së kurrikulës. Ky studim tregon se autonomia e shkollës, e përcaktuar me kurrikulën e re, nuk është zbatuar në masë të duhur për faktin se nuk është fuqizuar autonomia e shkollës me ngritje të mjaftueshme të kapaciteteve, sigurimin e mjeteve dhe buxhetit të nevojshëm. Këto janë aspekte që duhet të rregullohen nga MASHT-i, duke vendosur procedura standarde të autonomisë së shkollës për plotësimin e nevojave me mjete të nevojshme dhe për menaxhimin e financave në nivel shkolle.

Rekomandime për DKA-të

Ristrukturimi i DKA-ve në funksion të përmbushjes së rolit të tyre. DKA-të ballafaqohen me sfidën e mungesës së stafit që udhëheq proceset e reformës arsimore në nivel komune dhe për ofrimin e mbështetjes për shkollat, me mungesë të kapaciteteve për të përmbushur rolin e tyre. Komunat dhe MASHT-i duhet të mbështesin DKA-të për të vendosur një strukturë të qartë organizative, në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e arsimit në nivel komune, me fokus të veçantë të proceseve që lidhen me zbatimin e kurrikulës. Ristrukturimi duhet të bëhet me kujdes, duke analizuar bazën ligjore, kontekstin e komunave dhe DKA-ve,

kapacitetet e tyre, kontekstin e rënies së numrit të nxënësve dhe nevojës për menaxhim cilësor të personelit mësimdhënës në nivel komune. Ngjitja e kapaciteteve për të njohur konceptin e kurrikulës, pritshmëritë e saj dhe rolin e DKA-ve në këtë proces, është një nevojë tjetër, të cilën duhet adresuar në vitet vijuese nga DKA-të.

Konsolidimi i mekanizmave mbështetës në nivel komune dhe shkolle.

Komuna/DKA-ja, bazuar në legjislacionin në fuqi, është punëdhënëse e mësimdhënësve dhe ka përgjegjësi të caktuara në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Për të përmbushur rolin e vet, përkrahjen e procesit të zbatimit të kurrikulës dhe ofrimin e mbështetjes për shkollat, DKA-ja duhet të bëjë një analizë të kontekstit të menaxhimit të personelit mësimdhënës në nivel komune, duhet të shfrytëzojë kapacitetet ekzistuese dhe ligjore për të ngritur një ekip profesional të qëndrueshëm, dhe duhet të mbështesë atë në zhvillimin e kapaciteteve, në mënyrë që secila shkollë në nivel komune të marrë mbështetjen e duhur në procesin e zbatimit të kurrikulës. Pjesë e mekanizmave duhet të jenë edhe rishikimi dhe përshkrimi i detyrave të punës, në pajtim me kërkesat e reja të kurrikulës, për angazhim më të madh të mësimdhënësve përtej procesit, kohës minimale të orëve mësimore të përcaktuara me numrin javor për fusha kurrikulare/lëndë mësimore. Mbështetja e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë, krijimi i rrjeteve profesionale, mbështetja e shkollave në zbatimin e kurrikulës dhe kërkesave të saj, pëfshirë edhe realizimin e vlerësimit për shkallë kurrikulare sipas qëllimeve të tij, duhet të jenë prioritete të veçanta për DKA-të.

Rekomandime për shkollat

Ndërrimi i qasjes në udhëheqje të procesit të reformës kurrikulare në nivel shkolle. Roli i shkollës në procesin e zbatimit të kurrikulës është vendimtar, prandaj shkolla duhet të vendosë një agjendë të qartë për udhëheqjen e procesit të reformës kurrikulare në nivel shkolle. Pjesë e kësaj agjende duhet të jetë maksimalizimi i veprimeve për planifikimin dhe udhëheqjen inovative të procesit të zbatimit të kurrikulës, sigurimin e një mjedisi mundësues për zbatimin e kurrikulës, shfrytëzimin e vlerësimit të

nxënësve sipas qëllimeve të tij, përkrahjen e vazhdueshme profesionale të mësimdhënësve për zbatimin e saj, vetëvlerësimin vjetor të performancës së përgjithshme nga perspektiva e ndikimit në përmirësimin e arritshmërisë së nxënësve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në funksion të zbatimit të plotë të kërkesave të kurrikulës. Të gjitha proceset që zhvillohen në nivel shkolle duket të kenë pikë referimi parimet e kurrikulës.

Fuqizimi i koordinatorëve të cilësisë dhe aktiveve profesionale në nivel shkolle. Pa mekanizma profesionalë të fuqishëm, nuk mund të jetësohet me sukses reforma kurrikulare në nivel shkolle. Prandaj, organet udhëheqëse dhe qeverisëse të shkollës, duke marrë për bazë kornizën ligjore dhe mundësitë për fuqizimin e KC dhe AP, duhet të marrin veprime konkrete për fuqizimin e tyre, duke përkrahur qartë rolin dhe përgjegjësitë, duke ofruar kushte dhe mjedis mundësues për punë dhe angazhim me stafin mësimdhënës, me nxënës dhe prindër, si dhe duke krijuar mundësi e lehtësira në ngritjen e kapaciteteve për përmbushjen e rolit të tyre.

Shfrytëzimi efektiv i autonomisë së shkollës për zbatimin e kurrikulës. Autonomia e shkollës, e përcaktuar me kurrikulën e re, duhet shfrytëzuar në frymën e kërkesave dhe parimeve të kurrikulës. Autonomia e shfrytëzuar në mënyrë efektive e bën një shkollë të dallojë në bazë të kontekstit të saj dhe ta veçojë atë për veçantitë që ka në përmbushjen e rolit të saj dhe në ofrimin e mundësive shtesë për nxënës. Por, për të arritur këtë, kërkohet që shkolla të kuptojë rëndësinë e shfrytëzimit të autonomisë, të planifikojë dhe të zbatojë iniciativa dhe aktivitete lidhur me shfrytëzimin efektiv të autonomisë së shkollës. Shfrytëzimi i autonomisë së shkollës për zbatimin e reformës së kurrikulës është proces vijanoz, që kërkon komunikim, koordinim dhe nivel të përgjegjësisë.

Avancimi i planifikimit dhe dokumentimit të punës së shkollës, me qëllim ngritjen e cilësisë së zbatimit të kurrikulës. Studimet tregojnë se planifikimi dhe dokumentimi i punës së një institucioni, udhëheqësi apo edhe mësimdhënësi, janë pasqyra e institucionit dhe individit, janë fondamenti për veprime konkrete, përmirësim dhe avancim të punës. Dokumentimi aktual i punës së shkollave, i punës së mësimdhënësve, nuk siguron mjaftueshëm bazë të integruar të planifikimit, zbatimit, raportimit dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të punës së shkollës dhe procesit të

mësimdhënies dhe nxënies. Kjo kërkon që drejtuesit e shkollës, të organeve të saj, dhe mësimdhënësit në veçanti, të përmirësojnë dhe të avancojnë planifikimin dhe dokumentimin e punës së tyre. Është një nga masat që shpie drejt institucionalizimit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle.

Studime të mëtejme

Studimi i procesit të zbatimit të kurrikulës bazuar në arritjen e kompetencave hodhi dritë mbi përvojat gjatë zbatimit, sfidat me të cilat shkollat janë ballafaquar në këtë proces, mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme. Për të kompletuar gjithanshëm studimin për reformën kurrikulare në Kosovë dhe zbatimin e saj në të gjitha nivelet e arsimit, rekomandohet që të bëhen studime të mëtejme për të parë më thellësisht disa nga aspektet që nuk janë mbuluar mjaftueshëm me këtë studim, si vlerësimin e nxënësve bazuar në kompetenca, cilësinë e teksteve të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim në vitin shkollor 2019/2020, zbatimin e kurrikulës në gjimnaze etj. Gjithashtu, rekomandohet që të zhvillohen edhe studime që lidhen me programet për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit – lidhjes me reformën kurrikulare, si dhe me programet e zhvillimit profesional në shërbim dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca.

Gjithsesi, zhvillimi i një studimi pas një periudhe 2-3-vjeçare, kur përmbyllet cikli i shtrirjes së zbatimit të kurrikulës së re, në të gjitha klasat e tri nivele të arsimit parauniversitar, do të shërbente të nxirren konkluzione lidhur me ndikimin e reformës kurrikulare dhe kahet për të ardhmen në këtë fushë, duke marrë për bazë nxënësin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Në përmbyllje, ky studim ofron informacione për aspekte të ndryshme, që parashikohen të ndikojnë në procesin në vazhdim të reformës kurrikulare, në zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle dhe në dinamizmin e krijimit të mekanizmave mbështetës për zbatimin e kurrikulës, proces për të cilin nevojitet angazhim maksimal i të gjitha institucioneve arsimore që kanë rol dhe përgjegjësi në këtë proces (Mehmeti, S., Boshtrakaj. L., Bytyqi, L., Zylfiu, H., & Potera, I., 2018, f. 158).

Sahlberg (2011) shprehet se ndryshimi i vërtetë arsimor ndodh kur shkolla lulëzon në nivelin e poshtëm, me presion nga anash, dhe drejtohet nga lart

(Saqipi, 2013, f. 20). Konsolidimi i mekanizmave për udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, monitorimin e procesit, sigurimin e cilësisë dhe mbështetjen e vazhdueshme për zbatimin e kurrikulës, do të ndihmojë të jetësojë parimet e kurrikulës në raport me përgjegjësitë institucionale të udhëheqjes së proceseve të reformës kurrikulare, do të ndihmojë që të fillojë të ndodhë ndryshimi i vërtetë arsimor!

BIBLIOGRAFIA

1. Azemi. A., (2017). Refleksione arsimore (Vështrim kritik për zhvillimet në sistemin e arsimit, 2000-2017). 'Zero Print', Prishtinë.
2. Banka Botërore (2014). Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri - Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000-2012. Njësia për Sektorin e Arsimit, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore.
<https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/a-l-pisa-report-al.pdf>
3. Bashkim, A. & Bekim, M., (2013) *Aparatura didaktike në librat e leximit të klasave 1-9*. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë. 2013.
4. Bashkimi Evropian & UNICEF (2017). *Analiza e situatës- Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë*, 24 nëntor, 2017.
5. Boshtrakaj, L., (2016). Sistemi i arsimit parauniversitar në Kosovë nga perspektiva e mësimi gjatë gjithë jetës: një analizë krahasuese me tendencat e shteteve të BE-së. Tema për titullin Master i Pedagogjisë (e papublikuar). Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik. Prishtinë, Kosovë,
6. Boshtrakaj, L. (autore), Rraci, E. & Bajrami, K. (2018). Sfidat e zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. http://keen-ks.net/site/assets/files/1444/sfidat_e_zbatimit_te_reformes_kurrikulare_alb-1.pdf
7. Boshtrakaj, L. (autore), Rraci, E. & Bajrami, K. (2018). Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1466/cilesia_e_teksteve_shkollore_ne_kosove_alb-1.pdf
8. Buleshkaj, O.. (2017). Leading curriculum implementation: The case of Kosovo. Integrated Economy and Society: Diversity, Creativity, and Technology 17–19 May 2017 Lublin, Poland.
<http://www.toknowpress.net/ISBN/978-961-6914-21-5/papers/ML17-165.pdf>
9. Day, C., (2002). *Developing Teachers: The Challenges of Lifelong Learning*, Palmer Press, London.
10. Devetaku-Gojani, H. (2011). Procesi i zhvillimit të Kurrikulit dhe i Planeve e Programeve mësimore në Kosovë 2001-2011. *Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh*, Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.

11. Devetaku, H. (2018). Doracaku për Aktivitet Profesional në shkollat e Kosovës – roli dhe funksioni i tyre (GIZ, 2018);
12. Diana Fox Wilson (2004). Supporting Teachers Supporting Pupils, by RoutledgeFalmer 11 New Fetter Lane, London EC4P 4EE.
13. Education Scotland. (2015). *Community learning and development in curriculum for excellence: 1. Senior phase*. Edinburgh, UK: Education Scotland.
14. European Agency for Development in Special Needs Education (2012) Profile of Inclusive Teachers. Odense, Denmark: European Agency for Development in Special Needs Education, <https://www.european-agency.org/sites/default/files/Profile-of-Inclusive-Teachers.pdf>, shkarkuar më 14.02.2017
15. Fullan, M. (2001). Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim. CDE. Edualba. Tiranë.
16. Gläser, J. & Laudel, G. (2013). Life With and Without Coding: Two Methods for Early-Stage Data Analysis in Qualitative Research Aiming at Causal Explanations. Forum Qualitative Sozialforschung / Forum: Qualitative Social Research, 14(2), Art. 5, <https://ris.utwente.nl/ws/portalfiles/portal/7061681/3529.pdf>
17. Hamza, M. (2011). Kurrikula e arsimit bazë. Nevojat për rishikim, prirjet dhe konceptimi. *Revista pedagogjike*, 2011, (f . 136-164). http://www.izha.edu.al/materiale/Revista_Pedagogjike_2011.pdf
18. Hyseni, H., Mita, N. Salihaj, J. & Pupovci, D. (2003). Qeverisja dhe udhëheqja në arsim – Si të bëheni udhëheqës i suksesshëm. Udhëzues. Qendra për Arsim e Kosovës.
19. Institute of Education, University of London (2005). Planet dhe programet kombëtare në Kosovë – vlerësim i fazave të para, 22 korrik 2005, www.standards.dfes.gov.uk/literacy/publications/framework/63277/
20. Instituti i Studimeve Pedagogjike (2003), “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore”, Tiranë.
21. Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2016), Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, Prishtinë, <https://ipkMASHT.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/Udhezuesi-per-zbatim-te-kurrikules1.pdf>,
22. Instituti Pedagogjik i Kosovës (2016). Udhëzuesi për vetëvlerësim të performancës së shkollës (IPK, 2016); <http://ipkMASHT.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/udhezuesi-per-vetevleresim1.pdf>
23. Janaqi, G. (2014). *Zhvillimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca në Shqipëri: Përgatitjet për një proces të suksesshëm*. Konferenca ndërkombëtare - Qasja e re kurrikulare sfidë e së ardhmes, Kumtesat,

- prezantimet dhe rekomandimet, (fq. 77-92). Prishtinë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
24. Kocani, A. (2008): *Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*. Ufo Press. Tiranë.
 25. Koliqi, D. (2014), Barazia Gjinore në tekstet e gjuhës shqipe dhe të lëndëve shoqërore të shkollës fillore të Kosovës. Prishtinë.
 26. Koren, A. (2014). *Roli i drejtorëve të shkollave në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca*. Konferenca ndërkombëtare - Qasja e re kurrikulare sfidë e së ardhmes, Kumtesat, prezantimet dhe rekomandimet, (fq. 129-140). Prishtinë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
 27. Llambiri, S., Abdurrahmani, T., & Mulla, A., (2011). Analiza krahasuese e kurrikulës aktuale të arsimit bazë me atë të vendeve të tjera. Ministria e Arsimit dhe Shkencës & Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Tiranë, Shqipëri.
 28. Majlinda, Gj. (autore), Rraci, E. & Bajrami, K. (2018). Edukimi Parashkollor në Kosovë. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf
 29. Manninen, J. (2014). Evaluation report: Qualitative stakeholder evaluation of the first year of implementation of nëë Kosovo curriculum. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë.
 30. Marsh, J. Colin. (2009). *Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin*. Botimi i katërt në shqip, Tiranë, Qendra për Arsim Demokratik.
 31. Marzano, R. J. and Brown, L. J. (2009). A handbook for the art and science of teaching, Alexandria, Virginia USA.
 32. Matero, M. (2014). Raport: Analiza e mjedisit mësimor dhe vlerësimi i nevojave për 61 shkolla pilot në Kosovë. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë.
 33. Matthews, B./ Ross, L (2010): *METODAT E HULUMTIMIT*. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Qendra për Arsim Demokratik (CDE). Tiranë.
 34. McNamara, D. (2012). Classroom pedagogy and primary practice, Taylor & Francis e-Library, Canada.
 35. Mehmeti, S. & Buleshkaj, O. (2017). Përdorimi dhe zbatimi i programeve mësimore të hartuara në bazë të kurrikulës së bazuar në kompetenca. *Kërkime Pedagogjike*, 2017 përmbledhje punimesh nr.6, fq 10-50. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.

36. Mehmeti, S., Boshtrakaj, L., Bytyqi, L. Zylfiu, H. & Potera, I. (2018). Përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë. <http://ipkMASHT.rks-gov.net/ep-content/uploads/2015/11/Raporti-Pervojat-e-para-ne-vleresimin-e-performances-se-shkolles.pdf>
37. Mehmeti, S. (2015). Vlerësimet e shkollave pilot për procesin e zbatimit të kurrikulës së re 2014-2015. *Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh*, 2015, (f. 5-22), Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
38. Mehmeti, S. (autor), Rraci, E. & Bajrami, K. (2019). Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve në Kosovë. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1467/zhvillimi_profesional_i_mesimdhenesve_ne_kosove_alb-1.pdf
39. Mexhuani A. (2014). Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore në Libër Leximi (1-5). Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
40. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (2011). Ligji për Arsimin Parauniversitar, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/legjislacioni>
41. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). Udhëzimi Administrativ për përdorimin e planit individual të arsimit, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016>,
42. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & KulturKontakt Austria (2016). Manuali për sigurim të cilësisë në shkollë (KulturKontakt Austria).
43. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Save the Children, (2011). Manual didaktik për parandalimin e dhunës (Save the Children, 2014) <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2018/07/manuali-per-parandalimin-e-dhunes-ne-shkolla.pdf>
44. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). Udhëzimi Administrativ për aktivet profesionale (departamentet) të shkollave, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016>,
45. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). Udhëzimi Administrativ për aktivitetet jashtëshkollore, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016>,
46. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). *Kurrikulat Bërthamë për Arsimin parafillor dhe fillor*, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>
47. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). *Kurrikulat Bërthamë për Arsimin e mesëm të ulët*, Prishtinë. <https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>

48. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021* (https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf)
49. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2016). Udhërrëfytyesi për zbatimin e kurrikulës 2016-2021, Prishtinë <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/02/udherrefyves-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>
50. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2017). *Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e Planit Individual të Arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore*, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijetnxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene>,
51. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2017). *Praktika të mira të gjithëpërfshirjes*, Prishtinë, <https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijetnxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene>,
52. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, (2011). *Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme (0- 6 vjet)*, Prishtinë, https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf,
53. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, (2017). *Mësimdhënia në fusha të aktiviteve, program për mësimdhënës në punë me nxënës me dëmtime të rënda dhe të shumëfishta*, Prishtinë. <https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2018/05/mesimdhenea-sipas-fushave-te-aktiviteve.pdf>,
54. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2012). Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë - Shkolla fillore, mosha 6-10 vjeç, klasat 1 – 5, shkallët 1 dhe 2 të Kurrikulës (MASHT & SĚAP, 2012);
55. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.(2016). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar)*. Prishtinë. <http://MASHT.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
56. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa përgatitore (<https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)
57. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e parë (<https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)
58. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e dytë (<https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

59. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e gjashtë (<https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)
60. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e shtatë (<https://MASHT.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)
61. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, (2017). Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës - Material ndihmës për mësuesit e klasës përgatitore dhe arsimin fillor. MASHT & IPK, 2016.
62. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). Udhëzimi Administrativ nr. 05/2011 Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore (<https://MASHT.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-e-teksteve.pdf>)
63. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. IPK, Prishtinë.
64. Morgan, N. (2014). *Qasja e Skocisë në zbatimin e kurrikulës për përsosmëri: Si të mbështesim më së miri zbatimin në nivel shkolle?* Konferenca ndërkombëtare - Qasja e re kurrikulare sfidë e së ardhmes, Kumtesat, prezantimet dhe rekomandimet, (f. 37-50), Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë.
65. Musai, B. (2014). *Metodologji e mësimdhënies*, bot.2, CDE, Tiranë.
66. Peffers, J., Reid, E., Stylianidou, dr.F., Walsh, dr.P., & Young, prof. Michael (2005). Planet dhe programet kombëtare në Kosovë – Vlerësim i hapave të parë. Instituti i Edukimit, Universiteti i Londrës.
67. Planet, S. dhe WUS Austria (2019). Planifikimi për zbatimin e kurrikulës. EU Kosovo, Projekti Zhvillimi profesional i mësimdhënësve.
68. Potera, I. & Shala, L. (2018) Qëndrimi i mësimdhënësve ndaj kurrikulës së re. *Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh*, 2018, fq. 71-103. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
69. Potera, I. (2012). Kompetenca komunikues efektiv në fund të klasës së parë, *Mësuesi i Kosovës*, nr. 9, tetor 2012.
70. Potera, I. (2013). “Aspektet metodologjike dhe praktikat e planifikimit dhe zbatimit të KK të ri”, *Mësuesi i Kosovës*, nr. 20, nëntor 2013.
71. Potera, I. (2013).Zhvillimi i kompetencës mendimtar kritik”, *Mësuesi i Kosovës*, nr.13, shkurt 2013.

72. Potera, I. (2014). Niveli i informimit të shkollave dhe qëndrimi i tyre për kurrikulën e re. *Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh, 2014, fq. 45-72*. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
73. Potera, I. Mehmeti, S. & Zylfiu, H. (2017). Addressing students ’’Wellbeing in the new Kosovo Curriculum: Challenges and opportunities’’. Cidree Yearbook 2017. Dublin/Ireland.
74. Potera, I.(2017). Rëndësia e qasjeve metodologjike në mësimdhënie dhe të nxënë bazuar në kërkesat e Kurrikulit të ri, *Kërkime Pedagogjike, IPK, Vol.1, (42-68)*.
75. Qendra për arsimin e Kosovës (KEC) (2007). *Barazia gjinore në librat e leximit në arsimin e drejtuar nëntëvjeçar në Kosovë*. Prishtinë.
76. Ramaj, A. (2001), Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor, ‘Libri Shkollor’, Prishtinë.
77. Reçica-Havolli, S. (2017). Specifikat e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara, *Kërkime pedagogjike, vëllimi 1, (f. 125-154)*.
78. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese BIRNI (2013). *Problemet dhe të metat e teksteve shkollore*, (Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët / klasat VI, VII, VIII dhe IX) . Prishtinë,
79. Rukiqi, Sh., (2014). Mësimdhënie kreative.
80. Saqipi, B. (2013). Të ndryshosh shkollat për kohërat në ndryshim: Perspektiva e mësimdhënies në Kosovë. Revista Shqiptare e Studimeve Arsimore, Volumi 1, nr. 2, 2013 , f. 4-21. CDE, Tiranë.
<http://www.cde.edu.al/sites/default/files/biblioteka/Revista%20Shqiptare%20E%20Studimeve%20Arsimore%202.pdf>
81. Saqipi, B. (2019). Understanding the relation of policy discourse and re-conceptualising curriculum: a Kosovo perspective on a new meaning of context CEPS Journal 9 (2019) 2, S. 33-52.
https://www.pedocs.de/volltexte/2019/17441/pdf/cepsj_2019_2_Saqipi_Understanding_the_relation.pdf
82. Schaffer, E., (2017). Implementation of the Kosovo pre-university curriculum: Recommendations. MEST report.
83. Shala, L. (2017) Roli udhëheqës i drejtorit të shkollës në zbatimin e kurrikulit të ri. *Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh, 2017, fq. 68-96*. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
84. Sinnema, C. (2011). Monitoring and Evaluating Curriculum Implementation. Final Evaluation Report on the Implementation of The New Zealand Curriculum 2008–2009. Ministry of Education, New Zealand.

<https://pdfslide.net/documents/monitoring-and-evaluating-curriculum-implementation-monitoring-and-evaluating.html>

http://do2learn.com/disabilities/CharacteristicsAndStrategies/IntellectualDisability_Strategies.html shkarkuar më 22.05.2017

<http://www.projectidealonline.org/v/intellectual-disabilities/>, shkarkuar më 25.01.2019

Shtojcat

Shtojca 1: Pyetësi për mësimdhënës - personelin e shkollës

I/e nderuar,

Ju jeni përzgjedhur për të marrë pjesë në këtë studim. Ju lusim me mirëkuptim që të ndani kohën tuaj të çmueshme për të dhënë përgjigje në pyetjet e këtij pyetësi. **Të gjitha të dhënat që do të mblidhen me këtë pyetësor do të përdoren vetëm për qëllimet e studimit. Cdo informacion i dhënë në këtë pyetësor do të mbetet konfidencial.** Prandaj ju lusim që këtë pyetësor ta plotësoni në mënyrë të pavarur, me sinjeritet dhe ndershmëri, në mënyrë që t'i kontribuoni qëllimit të këtij studimi. Qëllimi i studimit është:

- të përshkruajë dhe të analizojë përvojat e shkollave në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca;
- të identifikojë sfidat dhe problemet me të cilat janë duke u ballafaquar shkollat dhe mësimdhënësit në zbatimin e kurrikulës;
- të identifikojë mundësitë dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve; dhe
- të ofrojë rekomandime të bazuara në evidencë për veprimet e nevojshme që duhen ndërmarrë për të siguruar zbatim efektiv të kurrikulës së re në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës.

Nëse keni ndonjë paqartësi apo dëshironi të dini më shumë rreth studimit, ju lutem mos hezitoni të shkruani në e-mail adresën: selim.mehmeti@yahoo.com Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Dëshirojmë t'ju falënderojmë paraprakisht për pjesëmarrjen tuaj në studimin tonë dhe për kontributin e dhënë.

Pjesa I - TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

1. **Komuna:** _____
2. **Lokacioni i shkollës:** 1) Urban 2) Rural
3. **Gjinia:** 1) Femër 2) Mashkull
4. **Mosha së cilës i përkisni:** 1) 21-30, 2) 31-40, 3) 41-50,
4) Mbi 51 vjeç.
5. **Kualifikimi:** 1) Shkollë e lartë 2) Bachelor 3) Fakulteti 4 vj. 4) Master 5) Doktoratë

6. Vitet e parvojës në mësimdhënie: 1) 1-2 vj. 2) 3 -7 vj. 3) 8 - 12 4) 13-17,
5) Mbi 18+ vj.

7. Çfarë pozite mbani tani në shkollë (varësisht nga pozitat që keni, mund të rrethoni një e më shumë pozita):

- 1) Drejtor shkolle/ zv.drejtor shkolle
- 2) Koordinator i kurrikulës në nivel shkolle
- 3) Koordinator i cilësisë
- 4) Kryetar i aktivitet të klasës përgatitore, klasës 1 apo klasës 2 (shëno klasën):

- 5) Kryetar i aktivitet të fushës kurrikulare (shëno emrin e fushës kurrikulare):

- 6) Mësimdhënës kujdestar i klasës 6 apo klasës 7 (shëno klasën) _____
- 7) Vetëm mësimdhënës, pa ndonjë pozitë tjetër në shkollë

8. Mësimdhënës i klasës/ lëndës (rretho përgjigjen që tregon në cilën klasë/ për cilën lëndë mësimore mbani mësim):

- 1) Edukatore e klasës përgatitore
- 2) Mësues/e - klasa 1
- 3) Mësues/e - klasa 2
- 4) Mësimdhënës i gjuhës angleze klasa përgatitore, klasa 1 dhe 2
- 5) Mësimdhënës lëndor, klasa 6, shëno lëndën/t mësimore që i mban: _____
- 6) Mësimdhënës lëndor, klasa 7, shëno lëndën/t mësimore që i mban: _____
- 7) Mësimdhënës lëndor, klasa 6 dhe 7, shëno lëndën/t mësimore që i mban: _____

9. Në cilin vit shkollor shkolla juaj ka filluar të punojë me plane dhe programe të reja mësimore të hartuara sipas kurrikulës së re, në klasën përgatitore, klasat 1 dhe 6?

- 1) Në vitin shkollor 2016/2017
- 2) Në vitin shkollor 2017/2018
- 3) Nuk jam i sigurt

PJESA II**MBËSHTETJA PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS SË RE/ PROGRAMEVE MËSIMORE**

10. A e keni ndjekur programin e trajnimit për zbatimin e kurrikulës së re?

- 1) PO 2) JO

11. Nëse PO, sa është numri i ditëve të trajnimit që keni ndjekur për zbatimin e kurrikulës së re?

- 1) 5 -6 ditë 2) 7-8 ditë 3) 9-10 ditë. 4) 11+ ditë

Nr	12. Në këtë tabelë janë dhënë disa nga qëndrimet e shprehura, për mbështetjen që u është ofruar për mësimdhënës gjatë trajnimeve për kurrikulë.	Shprehni mendimin tuaj me √ në njërin nga pesë shkallët e vërtetësisë (për secilin konstatim/kërkesë nga nr.1-10)				
		Aspak e vërtetë (1)	Jo shumë e vërtetë (2)	Kam dilema/disi e vërtetë (3)	E vërtetë (4)	Shumë e vërtetë (5)
1	E mjaftueshme					
2	Me rezultate të kënaqshme					
3	Nxitëse (stimuluese)					
4	Praktike					
5	Humbje kohe					
6	E pavlefshme					
7	E mërzitshme					
8	E gabuar					
9	Tjetër (shëno):					
10	Tjetër (shëno):					

Nr	13. Sa shpesh keni qenë në gjendje të lexoni, të flisni apo konsultoheni me kolegë/ profesionistë dhe të merrni mbështetje për zbatimin e kurrikulës së re?	Shkalla e shpeshësisë së leximit, konsultimit dhe mbështetjes – përgjigju me √ në njërin nga pesë shkallët e shpeshësisë (për secilin konstatim/kërkesë nga nr.1-17)				
		Asnjëherë	1-2 herë	3-5 herë	6-8 herë	8+ herë
1	Leximi dhe shqyrtimi i: Dokumentit të kurrikulës (Komizës Kurrikulare dhe Kurrikulës Bërthamë)					
2	Programit mësimor të lëndës/ve që mbani					
3	Udhëzuesve të kurrikulës					
4	Botimeve të tjera për kurrikulë					
5	Publikimeve të tjera të MASHT-it për kurrikulë					
6	Konsultime dhe mbështetje nga drejtori i shkollës dhe zv.drejtori i shkollës					
7	Pedagogu i shkollës apo psikologu i shkollës					
8	Kryetari i aktivitetit profesional					
9	Kolegë të shkollës					
10	Kolegë nga shkollat tjera					
11	Trajneri i kurrikulës					
12	Lehtësues/trajner nga iniciativa dhe programe të tjera					
13	Zyrtar i arsimit në komunë					
14	Inspektor i arsimit					
15	Ekspert i arsimit					
16	Faqja e internetit MASHT					
17	Faqe tjera të internetit (shëno) _____					

14. Cili është vlerësimi juaj i përgjithshëm për mbështetjen që keni marrë nga udhëheqja e shkollës tuaj për zbatimin e kurrikulës së re? (rretho vetëm një nga shkallët e vlerësimit 1-5)

<i>E pamjaftueshme – asnjë mbështetje</i>	1	2	3	4	5	<i>E mjaftueshme – mbështetje maksimale</i>
---	---	---	---	---	---	---

PJESA III

PRANIMI APO BESIMI QË KENI PËR KURRIKULËN E RE, TË BAZUAR NË KOMPETENCA

Nr	15. Nga përvoja juaj me kurrikulën e re dhe informacionin që keni, si e shihni kurrikulën e re?	Shprehni mendimin tuaj me √ në njërin nga pesë shkallët e pajtueshmërisë (për secilin konstatim/kërkesë nga nr.1-15)				
		Aspak nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Kam dilema / disi pajtohem	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
1	Më e avancuar se kurrikula e mëparshme					
2	E qartë dhe e kuptueshme					
3	E lehtë për t'u zbatuar					
4	Substancialisht/ shumë ndryshe nga kurrikula e mëparshme					
5	Kërkon ndryshimin e qasjes së punës nga mësimdhënësit					
6	Ka pritshmëri tepër të larta					
7	Ka kërkesa të paarritshme					
8	Është fleksibël					
9	Kreative për mësimdhënës dhe nxënës					
10	Nxitëse për të mësuar					
11	E komplikuar dhe jo praktike					
12	E vështirë për t'u kuptuar					
13	E vështirë për t'u zbatuar					
14	Tepër sfiduese					
15	Ka ngarkesa të paarsyeshme					

Pjesa IV

PRAKTIKA E ZBATIMIT TË KURRIKULËS

Nr	IV/1. NDRYSHIMI NË QASJE	Shprehni mendimin tuaj me √ në njërin nga gjashtë shkallët e ndryshimeve në nivel shkolle (për secilin konstatim/kërkesë të lidhur me ndryshimet e bëra për zbatimin e kurrikulës së re në nivel shkolle, nga nr.1-19)					
		Për mua nuk janë të nevojshme ndryshimet	Konsiderohen ndryshime të nevojshme, por vendosëm të mos ndryshojmë	Kemi ndërmend të bëjmë ndryshime	Kemi bërë ndryshime të vogla	Kemi bërë ndryshime të moderuara	Kemi bërë ndryshime thelbësore
1	Riorganizimin e brendshëm të shkollës						
2	Monitorimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës						
3	Format e përkrahjes kolegjiale						
4	Mënyrat e punës në kuadër të aktivitetit profesional						
5	Mënyrat e qasjes ndaj të mësuarit të mësimdhënësve për kurrikulën e re						
6	Format e planifikimit mësimor – planet vjetore dhe planet tjera						
7	Shtirirjen e temave të programit mësimor dhe zërthimin e tyre në njësi mësimore						
8	Qasjen ndaj referimit në dokumente kurrikulare, në qëllime dhe parime						
9	Qasjen e integruar në planifikim dhe në mësimdhënie						
10	Praktikën e planifikimit për orë mësimore dhe të reflektimit						
11	Qasjen pedagogjike / aktivitetet e përdorura gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve						
12	Qasjen për përdorimin e teksteve dhe burimeve tjera mësimore						
13	Qasjet dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve						
14	Qasjen ndaj përdorimit të TIK-ut						
15	Rolin që nxënësit marrin në klasë						
16	Mënyrat e raportimit për prindër						
17	Përmbytjen e raporteve për prindër						
18	Qasjen ndaj shfrytëzimit të përveçshmërisë të kurrikulës së re						
19	Tjetër (shëno):						

15. Kur analizoni përvojën tuaj në zbatimin e kurrikulës së re, cilat sipas vlerësimit tuaj janë sfidat dhe problemet kryesore me të cilat jeni duke u ballafaquar në zbatimin e kurrikulës/ programeve të reja mësimore?

(Këtë pjesë nuk e plotësojnë drejtorët dhe zëvendësrektorët e shkollave. Drejtorët dhe zv.drejtorët kalojnë në pjesën V)

IV/3. Praktika të mësimdhënies, të lidhura me zhvillimin e kompetencave të nxënësve

Udhëzime për mësimdhënës: Lidhur me praktikën e mësimdhënies janë dhënë 20 konstatime (1-20), për secilin konstatim, ju duhet të jepni dy përgjigje. E para, ju duhet të shprehni mendimin për praktikën tuaj, në njërin nga 4 alternativat për përgjigje në pyetjen: **18.A. Deri në çfarë mase aspektet vijuese janë të dukshme (evizhente) në praktikën tuaj?** Dhe, e dyta për konstatimet e njëjta (1-20), ju duhet të përgjigjeni për njërin nga 4 alternativat në pyetjen: **18.B. Sa e shihni të vështirë t'i zbatoni në praktikë?**

Nr.	18. (A) Deri në çfarë mase aspektet vijuese janë të dukshme (evidente) në praktikën tuaj?	Shprehni mendimin për praktikën e juaj				19. (B) Sa e shihni të vështirë t'i zbatoni në praktikë?			
		Nuk është evidente. Nuk është diçka që unë e konsideroj si një aspekt i rëndësishëm i praktikës sime	Evidente në kohë, por jo diçka që unë ndihem se duhet të bëj gjithmonë	Shumë evidente, është e rëndësishme për mua që ta bëj shpesh këtë gjë	Shumë e qartë dhe evidente, me të vërtetë ka rëndësi për mua që ta bëj këtë vazhdimisht.	Shumë e vështirë	E vështirë	E lehtë	Shumë e lehtë
1	Unë i modifikoj praktikën e mësimdhënies me qëllim që nxënësit të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit dhe të shprehurit.								
2	Unë i angazhoj nxënësit që të shprehin në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, teksteve dhe formave tjera shprehëse.								
3	Unë i përkrah nxënësit që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative, mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.								
4	Unë i përkrah nxënësit në zhvillimin e kapaciteteve për t'iu qasur informatare dhe burimeve në mënyrë kritike, kreative (krijuese) dhe ndërvepruese.								
5	Nxënësit angazhohen dhe bëjnë gjëra praktike me njohuri në kontekste dhe situata nga jeta								
6	Nxënësit nxiten për të marrë vendime dhe veprime për të zgjidhur probleme në mënyrë të vetëdijshme për ndikimin dhe pasojat e tyre.								
7	Unë kam lexuar dhe përdorur hulumtimet e botuara për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies ndaj të mësuarit të nxënësve.								
8	Unë kujdesem që nxënësve t'u krijoj shprehje, kushte dhe mundësi për t'u përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës.								

9	Unë angazhohem me nxënës për të kultivuar vazhdimisht kërkshërinë edhe interesimin e tyre për të nxënë.								
10	Unë mbledh sistematikisht të dhëna për përparimin e nxënësve, i analizoj ato për të kuptuar dhe për të dhënë përkrahje për nxënës në mësim.								
11	Angazhohem që nxënësit të vetëdijesohen për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.								
12	Nxënësit përkrahen që të kuptojnë në mënyrë të plotë ndërvlerësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore.								
13	Nxënësit përgatiten që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.								
14	Unë punoj me prindër dhe komunitet me qëllim përfshirjen e nxënësve në jetën familjare dhe shoqërore.								
15	Nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për shëndetin e tyre, të kujdesen për veten dhe të kenë vetëbesim.								
16	Nxënësit nxiten të jenë të hapur dhe të kenë besim për të tjerët dhe të tjerët.								
17	Unë mbështetem në përvojën e kolegëve për t'u informuar me ndryshimet e mundshme në praktikën time të mësimdhënies.								
18	Unë angazhohem rreth nevojave të nxënësve në mësim dhe veprime në bazë të përgjegjësisë për të përkrahur zhvillimin maksimal të nxënësve								
19	Unë praktikoj përfshirjen e nxënësve në vendimet lidhur me format e mësimin dhe masat tjera rreth të nxënësve të tyre.								
20	Unë praktikoj punën me projekte me qëllim vlerësimin e nxënësve në më shumë se një kompetencë								

MUNDËSITË PËR ZBATIM EFEKTIV TË KURRIKULËS SË RE DHE NEVOJAT PËR MBËSHTETJE TË VAZHDUESHME

19. Si e parashikoni përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën tuaj?

20. Si mundeni ju, kolegët dhe shkolla juaj, ta bëni këtë proces të suksesshëm?

21. Nëse vlerësoni se duhet ndryshuar apo plotësuar ndonjë aspekt me rëndësi në programet e reja lëndore, të cilat ju i mbani, ju lutemi specifikojeni në pjesën në vijim:

22. Çfarë mbështetjesh specifike mendoni se janë të nevojshme për mësimdhënës që të zbatojnë me sukses programet e reja mësimore?

23. Nëse ka mbetur diçka pa u përmendur, e që ju mendoni se është me rëndësi të shtoni për kurrikulën e re dhe zbatimin e saj në praktikë, ju lutemi shtojeni në pjesën në vijim:

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Shtojca 2: Pyetjet udhëzuese për diskutim me drejtorët e shkollave, koordinatorë të cilësisë dhe kryetarë të aktiveve profesionale në shkolla

1. Cili është roli juaj në zbatimin e kurrikulës së re?
2. Si jeni informuar për kurrikulën e re dhe programet e reja mësimore?
3. Çfarë materialesh informuese për kurrikulën e re keni marrë nga MASHT-i, DKA-ja dhe partnerët tjerë?
4. Çfarë përkrahjesh profesionale keni marrë për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle? Nga kush?
5. Çfarë ndryshimesh keni bërë në shkollë për t'iu përgjigjur kërkesave të reja? Çfarë modeli riorganizimi keni përdorur, nëse keni përdorur? Po ndaj bashkëpunimit me prindër dhe komunitet?
6. Çfarë aktivitete profesionale keni organizuar në mbështetje të mësimdhënësve në shkollën tuaj për zbatimin e kurrikulës së re?
7. Si është monitoruar apo mentoruar stafi mësimdhënës në zbatimin e kurrikulës në shkollën tuaj? Kush ka qenë i përfshirë?
8. Si e definoni pranimin apo besimin e mësimdhënësve për kurrikulën e re? Sa ka ndikuar kjo në zbatimin e kurrikulës?
9. Si e definoni implementimin e suksesshëm të kurrikulës në shkollën tuaj? - Cilat kanë qenë sukseset/arritjet në zbatimin e kurrikulës së re? - Cilat kanë qenë problemet kryesore me të cilat jeni përballur?
10. Si e parashikoni përmirësimin e suksesshëm të zbatimit të kurrikulës në shkollën tuaj? Si mundeni ju dhe institucioni juaj ta bëni këtë proces të suksesshëm?
11. Çfarë përkrahjesh mendoni që janë qenësore për udhëheqje të suksesshme të zbatimit të kurrikulës për shkolla (drejtorë, koordinatorë të cilësisë dhe mësimdhënës)?
Pyetje përfundimtare: Po të kishte diçka që do të ndërronit në procesin e zbatimit të kurrikulës në dy-tri vitet e fundit, cila do të ishte ajo gjë? Pse? Ka diçka që do të shtonit në lidhje me procesin e implementimit të kurrikulës në Kosovë?

Shtojca 3: Pyetjet udhëzuese për diskutim me zyrtarët komunalë të arsimit

Pyetje udhëzuese
1. Cili është roli aktual i DKA-së në zbatimin e kurrikulës së re? Cilat janë ndryshimet kryesore që ka sjellë kurrikula e re në punën dhe organizimin e brendshëm të DKA-së?
2. Si janë prezantuar nga MASHT-i programet e reja mësimore në komuna dhe shkolla? Sa vlerësoni se shkollat kanë informacionin e duhur për programet e reja mësimore?
3. Çka mendoni, a ka pasur informim dhe konsultime të mjaftueshme nga MASHT-i me zyrtarë të arsimit, drejtorë të shkollave dhe mësimdhënës gjatë fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore?
4. Çka mendoni për rolin e MASHT-it në zbatimin e kurrikulës së re? A është i qartë roli, a duhet të ndryshojë ky rol dhe çfarë duhet të ndryshojë?
5. Çfarë materiale specifike / (pako informative, udhëzues, etj..) lidhur me kurrikulën/programet e reja mësimore janë përgatitur nga DKA në dy vitet e fundit dhe janë vënë në dispozicion të shkollave? (për: drejtues të shkollave, mësimdhënës, nxënës, prindër, shërbimin pedagogjik dhe psikologjik në shkolla, etj/) Sa vlerësoni se këto materiale kanë arritur në të gjitha shkollat e komunës suaj?
6. Si udhëhiqen dhe koordinohen nga DKA aktivitetet për zhvillim profesional të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës? Si e vlerësoni cilësinë e përkrahjes profesionale të ofruar, cilësinë e trajnimeve? Si është mbikëqyrur ky proces nga DKA? Si janë adresuar problemet eventuale të evidentuara gjatë këtij procesi?
7. Si janë zhvilluar përgatitjet për zbatimin e vlerësimit për shkallë kurrikulare (klasat 2, 7 dhe 11) për këtë vit shkollor?
8. Si monitorohet procesi i zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore? Cilat janë aspektet kryesore përmbajtësore që monitorohen? Kush e bën monitorimin? Cili është roli i DKA-sw në këtë proces? Çfarë raportesh vijnë në DKA?
9. Sipas mendimit tuaj, në ç'masë zbatohet autonomia e shkollës e paraparë me kurrikulën e re? Cilat janë sfidat kryesore? Si mund të tejkalohen ato?
10. Kur analizojmë situatën e përgjithshme lidhur me zhvillimet në përgatitjen dhe zbatimin e kurrikulës së re, me fokus në shkollat e komunës suaj, cilat janë arritjet kryesore që duhen veçuar? Dhe, cilat janë sfidat e problemet kryesore me të cilat jeni përballur më së shumti në këtë proces (DKA dhe shkollat), të cilat kërkojnë masa/ndërhyrje të shpejta?
11. Si e shihni evitimin e sfidave dhe problemeve të prezantuara lidhur me zbatimin e kurrikulës? Cilat janë masat kryesore që duhet ndërmarrë për të siguruar zbatim

të suksesshëm të kurrikulës? Nga kush priten këto masa/veprime? Dhe, si e shihni rolin e DKA-së në këtë proces?
12. Çfarë mbështetjesh mendoni se janë të domosdoshme për shkolla dhe komuna (drejtorë, mësimdhënës, koordinatorë, zyrtarë arsimorë) për të udhëhequr me sukses zbatimin e kurrikulës së re – plane programeve të reja mësimore? Çfarë ka planifikuar DKA të ofrojë mbështetje? Si vlerësoni që kjo mbështetje do të zbresë në praktikat e klasës dhe nxënësit do të përfitojnë nga ky proces?
13. Çfarë ndryshimesh prisni të ndodhin në sistemin arsimor si pasojë e zbatimit të kurrikulës së re? Çfarë ndryshimesh prisni të ndodhin në DKA, a duhet të ndryshojë roli i DKA-së për zbatimin e kurrikulës së re?
Pyetje përfundimtare: A keni diçka tjetër që do të shtoni në lidhje me procesin e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës? Sugjerime dhe rekomandime të tjera të nevojshme.

Shtojca 4: Pyetjet udhëzuese për diskutim me inspektorët e angazhuar në vlerësimin e performancës së shkollës dhe vlerësimin individual të performancës së mësimitdhënësve

Duku u nisur nga përvoja juaj në monitorimin e punës së shkollave dhe vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës:

Sa dhe si është duke u zbatuar kurrikula/programet e reja mësimore?

Cilat janë problemet dhe sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen shkollat dhe mësimitdhënësit në zbatimin e kurrikulës/programeve të reja mësimore?

Si mund të tejkalohen ato?

Duku u nisur nga përvoja që keni kaluar me shkollat në vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, cili është mendimi juaj:

Sa dhe si zbatohet autonomia e shkollës e paraparë me kurrikulën e re?

Cilat janë sfidat kryesore?

Si mund të tejkalohen ato?

Nga përvoja juaj me mësimitdhënës, nga vëzhgimet në orë mësimore për vlerësimin e performancës së shkollës, si dhe nga vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve, çfarë është mendimi juaj:

Sa ka ndryshuar qasja në mësimitdhënie në shkollat e Kosovës si rezultat i kurrikulës së re, të bazuar në kompetenca?

Cilat janë ndryshimet që vlerësoni se janë duke ndodhur në praktikat e klasës?

Sa vlerësoni se këto ndryshime janë duke u reflektuar në përparimin dhe arritjet e nxënësve?

Shtojca 5: Pyetjet udhëzuese për diskutim me zyrtarët arsimorë të MASHT-it

1. Çfarë është roli juaj, angazhimi juaj në zbatimin e kurrikulës së re të Arsimit Parauniversitar në Kosovë?
2. Sa dhe si është duke u udhëhequr zbatimi i kurrikulës së re në bazë të <i>Udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021</i> ? Sa jeni në dijeni që komunat dhe shkollat kanë pikë referimi këtë udhërrëfyes për të udhëhequr zbatimin e kurrikulës në nivel komune dhe shkolle? Si reflektohet udhërrëfyesi (2016 – 2021) në planet e divizioneve/sectorëve tuaj?
3. Si janë prezantuar programet e reja mësimore në komuna dhe shkolla (zyrtarë arsimorë, drejtorë të shkollave, mësimdhënës, etj.)? Sa vlerësoni se komunat dhe shkollat kanë informacionin e duhur për programet e reja mësimore?
4. Çfarë materiale specifike / (pako informative, udhëzues, etj..) lidhur me kurrikulën/programet e reja mësimore, janë përgatitur në dy vitet e fundit dhe vënë në dispozicion të komunave dhe shkollave (për: zyrtarë arsimorë, drejtues të shkollave, mësimdhënës, nxënës, prindër, shërbimin pedagogjik dhe psikologjik në shkolla, etj/) Sa vlerësoni se këto materiale kanë arritur në të gjitha komunat dhe shkollat e Kosovës?
5. Si udhëhiqen dhe koordinohen aktivitetet e mbështetjes profesionale që ofrojnë MASHT-i dhe partnerët mbështetës, në përkrahje për drejtorët, mësimdhënësit, koordinatorët, zyrtarët arsimorë në komuna lidhur me zbatimin e kurrikulës/programeve të reja mësimore? Si e vlerësoni cilësinë e përkrahjes profesionale të ofruar? Si është mbikëqyrur ky proces?
6. Si monitorohet procesi i zbatimit të kurrikulës së re – planeve dhe programeve të reja mësimore? Cilat janë aspektet kryesore përmbajtjesore që monitorohen? Kush e bën? Çfarë raportesh vijnë në sektorin tuaj? Kush i analizon ato dhe si adresohen kërkesat/nevojat e raportuara? Si raportohet në sektorët tjerë në MASHT-i? Si raportohet në DKA dhe shkolla?
7. Kur analizojmë situatën e përgjithshme lidhur me procesin e zbatimit të kurrikulës së re në shkallë vendi, cilat janë arritjet kryesore që duhet veçuar? Dhe, cilat janë sfidat e problemet kryesore me të cilat më së shumti përballen shkollat dhe komunat, të cilat kërkojnë masa/ndërhyrje të menjëhershme?
8. Si e shihni evitimin e sfidave dhe problemeve të prezantuara lidhur me zbatimin e kurrikulës? Cilat janë masat kryesore që duhet ndërmarrë për të siguruar zbatim të suksesshëm të kurrikulës? Nga kush priten këto masa/veprime? Dhe, si e shihni rolin tuaj në këtë proces?

9.	Çfarë mbështetjesh mendoni s janë të domosdoshme për shkolla dhe komuna (drejtorë, mësimdhënës, koordinatorë) për të udhëhequr me sukses zbatimin e kurrikulës së re – plane programeve të reja mësimore? Çfarë keni planifikuar të ofroni ju (departamenti apo divizioni juaj/ sektori juaj)? Si vlerësoni që kjo mbështetje do të zbresë në praktikat e klasës dhe nxënësit do të përfitojnë nga ky proces?
10.	Çfarë ndryshimesh prisni të ndodhin në sistemin arsimor si pasojë e zbatimit të kurrikulës së re? Si do ta përmirësojë kurrikula e re cilësinë e arsimit në Kosovë?
11.	Pyetje përfundimtare: A keni diçka tjetër që do të shtonit në lidhje me procesin e zbatimit të kurrikulës në shkallë vendi?

Shtojca 6: Pyetjet udhëzuese për diskutim me njohësit e arsimit dhe të reformës kurrikulare

A. Reforma kurrikulare	
1.	Çfarë ka qenë roli juaj, angazhimi juaj në reformën kurrikulare të bazuar në kompetenca – reformën kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë?
2.	Nga përvoja juaj me kurrikulën e re dhe informacionin që keni për kurrikulën e re, si e vlerësoni kurrikulën e re në krahasim me kurrikulën paraprake të bazuar në përmbajtje dhe objektiva mësimore?
3.	Çka mendoni, si është udhëhequr reforma kurrikulare në Kosovë? Dhe, si është duke u udhëhequr procesi i zbatimit të kurrikulave lëndore?
4.	Çka mendoni, a ka pasur informim dhe konsultime të mjaftueshme nga MASHT-i me DKA, drejtorë të shkollave dhe mësimdhënës gjatë fazës së përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të programeve të reja mësimore në shkallë vendi?
5.	Cili është mendimi juaj lidhur me pranimin/refuzimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca nga ana e mësimdhënësve? Si reflektohet pranimi/besimi në kurrikulën e re në praktikën e punës së shkollave dhe mësimdhënësve, në praktikën e punës me nxënës?
B. Zbatimi i reformës kurrikulare	
1.	Çka mendoni për rolin e MASHT-it në zbatimin e kurrikulës së re? A është i qartë roli, a duhet të ndryshojë ky rol? Çfarë mund të bëjë MASHT-i që të ndihmojë në zbatimin e kurrikulës së re?
2.	Çka mendoni për rolin aktual të Inspektoratit të Arsimit dhe të DKA-së në zbatimin e kurrikulës së re? A është i qartë roli, a duhet të ndryshojë ky rol? Çfarë mund të bëjë DKA që të ndihmojë në zbatimin e kurrikulës së re?
3.	Çka mendoni për rolin e drejtorëve të shkollave dhe menaxhmentit të mesëm (AP, KC, etj.) në zbatimin e kurrikulës së re? A është i qartë roli i tyre, si reflektohet në punën me mësimdhënës?
4.	Sipas mendimit tuaj, në ç'masë zbatohet autonomia e shkollës e paraparë me kurrikulën e re? Cilat janë sfidat kryesore? Si mund të tejkalohen ato?
5.	Nga përvoja juaj me mësimdhënës, a mendoni se ka ndryshuar qasja në mësimdhënie në shkollat e Kosovës si rezultat i kurrikulës së re?
C. Zhvillimi profesional	
6.	Sipas mendimit tuaj, a kanë bartësit e procesit të zhvillimit të kurrikulës dhe udhëheqësit arsimorë në nivel qendror dhe komunal përgatitjen e duhur akademike e profesionale për të udhëhequr, mbikëqyrur dhe përkrahur shkollat dhe mësimdhënësit në zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca?

7. Sipas mendimit tuaj, a kanë drejtuesit e shkollave dhe mësime dhënësit përgatitjen e duhur akademike e profesionale për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca në nivel shkolle?
8. A mendoni se drejtuesit e shkollave dhe mësime dhënësit janë të përgatitur përmes programeve për zhvillim profesional të ofruara nga MASHT, organizatat mbështetëse dhe DKA për zbatimin e kurrikulës së re?
9. A mendoni se duhet ndryshuar praktikën e zhvillimit profesional të drejtuesve të shkollave dhe mësime dhënësit për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca?
D. Parashikimi për vazhdimin e reformës kurrikulare dhe zbatimin e saj
10. Cilat janë ndryshimet domethënëse që kërkohen nga niveli qendror dhe lokal për të zbatuar në mënyrë efektive kurrikulën e re - në fazat tjera të zbatimit dhe rishikimit të kurrikulës?
11. Çfarë ndryshimesh kërkohen në organizimin e brendshëm të shkollave për të udhëhequr me sukses zbatimin e kurrikulës së re?
12. Çfarë duhet të ndryshojnë Fakultetet e Edukimit dhe njësitë tjera akademike që ofrojnë programi, kualifikimi për mësime dhënësit dhe drejtues të shkollave, për të siguruar përgatitjen e duhur akademike e profesionale për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca?
A keni diçka tjetër që do të shtonit në lidhje me procesin e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës së re? Sugjerime dhe rekomandime të tjera të nevojshme.

Shtojca 7: Listë kontrolli për analizë/ vlerësim të dokumentimit të institucionit arsimor/shkollës për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës

Pjesa I. Dokumentimi i shkollave për përgatitjen dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës	Pikët/ poenët e vlerësimit ³⁰	Komente, vërejtje, konstatime
1. Informimi për mundësitë dhe kërkesat e kurrikulës së re		
1.1. Institucioni arsimor/shkolla ka përgatitur materiale informuese për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me mundësitë dhe kërkesat e kurrikulën e re		
1.2. Materialet informuese kanë përshkrim të qartë dhe i kontribuojnë mjaftueshëm informimit për kurrikulën e re		
1.3. Shkolla ka dëshmi të përdorimit të materialeve informuese për kurrikulën e re të përgatitura nga MASHT, DKA ose partnerët tjerë mbështetës		
Pikët e vlerësimit (max. 9 pikë)		
2. Plani Zhvillimor i Shkollës		
2.1. Shkolla ka plan zhvillimor i cili përfshin edhe periudhën e vitit shkollor 2018/2019		
2.2. Analiza e planit zhvillimor përshkruan qartë gjendjen e shkollës në raport me fushat e cilësisë së performancës së shkollës.		
2.3. Plani Zhvillimor i Shkollës ka së paku një objektiv zhvillimor që lidhet me zbatimin e kurrikulës së re		
2.4. Plani Zhvillimor i Shkollës përfshin masa dhe aktivitetet konkrete për përgatitjen e shkollës dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re		
Pikët e vlerësimit (max. 12 pikë)		
3. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019		
3.1. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 është i ndërlidhur me Planin Zhvillimor të Shkollës		
3.2. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 ka pasqyrim të qartë të aktiviteteve		

³⁰ Vlerësimi bëhet për secilën dëshmi, kërkesë të këtij formulari. Vlerësimi me 3 pikë, tregon nivel të lartë të cilësisë së dëshmisë, me 2 pikë nivel mesatar, me 1 pikë nivel minimal, ndërsa me 0 evidentohet mungesa e dëshmive.

kryesore, përgjegjësve për aktivitete dhe periudhën e realizimit të tyre		
3.3. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 ka masa dhe aktivitetet konkrete për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re		
3.4. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 ka ndërlidhje të mirë me punën e organeve profesionale dhe qeverisëse të shkollës		
Pikët e vlerësimit (max. 12 pikë)		
4. Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës		
4.1. Shkolla ka raportin e VPSH sipas strukturës së raportit përmbledhës		
4.2. Raporti i VPSH, përveç tjerash, përmban edhe konstatimet përmbledhëse për gjendjen e shkollës në raport me kriteret dhe fusha të cilësisë së shkollës		
4.3. Në raportin e VPSH janë identifikuar përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në nivel të fushave të cilësisë		
4.4. Në raportin e VPSH janë dhënë rekomandime të qarta për masat që duhet ndërmarrë nga shkolla për të mënjeluar dobësitë e identifikuara		
4.5. Në raportin e VPSH janë dhënë rekomandime të qarta për masat që duhet ndërmarrë nga shkolla për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës së re		
Pikët e vlerësimit (max. 15 pikë)		
5. Plane vjetore dhe raporte pune të drejtuesve të shkollës dhe organeve qeverisëse (KDSH, KP, KN)		
5.1. Plani vjetor i punës së drejtorit /zv.drejtorit të shkollës përmban aktivitete lidhur me monitorimin dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës		
5.2. Plani vjetor i punës së drejtorit /zv.drejtorit të shkollës përmban aktivitete prindër dhe nxënës lidhur me zbatimin e kurrikulës		
5.3. Raporti i drejtorit/ zv.drejtorit të shkollës për monitorimin e zbatimit të kurrikulës pasqyron gjendjen dhe masat për zbatim të suksesshëm		
5.4. Planet e organeve qeverisëse të shkollës (KDSH, KP, KN) përmbajnë aktivitete që i kontribuojnë zbatimit të kurrikulës së re		
5.5. Raportet e punës së organeve qeverisëse të shkollës pasqyrojnë aktivitete, vendime, propozime, etj. në funksion të zbatimit të kurrikulës.		

5.6. Plani i punës për zhvillimin profesional të mësimehdhënësve – me fokus zhvillimin profesional me bazë në shkollë, përmban aktivitete lidhur me zbatimin e kurrikulës së re		
5.7. Raporti i shkollës për zhvillimin profesional të mësimehdhënësve pasqyron aktivitetet vjetore të shkollës të realizuara me mësimehdhënës në fushën zbatimit të kurrikulës së re		
Pikët e vlerësimit (max. 21 pikë)		
6. Plane vjetore dhe raporte pune të organeve profesionale të shkollës (Koordinatorit të cilësisë, Aktiveve profesionale, Pedagogut/psikologut të shkollës)		
6.1. Plani i punës së koordinatorit të cilësisë përmban aktivitete lidhur me përkrahjen e udhëheqjes së shkollës dhe aktiveve profesionale për zbatimin e zbatimit të kurrikulës		
6.2. Raporti i koordinatorit të cilësisë pasqyron aktivitetet mbështetëse të realizuara, gjendjen në zbatimin e kurrikulës dhe masat për zbatim të suksesshëm		
6.3. Planet e punës së aktiveve profesionale përmbajnë aktivitete lidhur me planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës, si dhe përkrahjen e mësimehdhënësve të aktivitetit profesional		
6.4. Planet e punës së aktiveve profesionale përmbajnë aktivitete lidhur me aktivitete të lira me nxënës, aktivitete ekstrakurrikulare dhe mësim plotësues/shtues		
6.5. Raportet e aktiveve profesionale pasqyrojnë aktivitetet e realizuara për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re, gjendjen në zbatimin e kurrikulës dhe masat për zbatim të suksesshëm		
6.6. Raportet e aktiveve profesionale pasqyrojnë analiza të lidhura me vlerësimin e nxënësve dhe përparimin e nxënësve në klasat që punojnë me programe të reja mësimore		
6.7. Raportet e aktiveve profesionale pasqyrojnë dëshmi të realizimit të aktivitetit të lira me nxënës, aktivitete ekstrakurrikulare dhe mësim plotësues/shtues		
6.8. Plani vjetor i punës së pedagogut/psikologut të shkollës përmban aktivitete lidhur me zbatimin e zbatimit të kurrikulës, përfshirë aktivitetet me mësimehdhënës, nxënës dhe prindër		
6.9. Raporti i pedagogut/psikologut të shkollës pasqyron aktivitetet realizuara që lidhen me zbatimin e kurrikulës së re, gjendjen dhe masat për zbatim të suksesshëm		

6.10. Raporti i pedagogut/psikologut pasqyron analiza të lidhura me vlerësimin e nxënësve dhe përparimin e nxënësve në klasat që punojnë me programe të reja mësimore		
Pikët e vlerësimit (max. 30 pikë)		

Pjesa II. Përmbledhje e pikëve të vlerësimit		Komente përmbledhëse
1. Materiale informuese të përgatitura nga shkolla për mësimdhënës, prindër, nxënës, lidhur me kurrikulën e re (max. 9 pikë)		
2. Plani Zhvillimor i Shkollës (max. 12 pikë)		
3. Plani vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor 2018/2019 (max. 12 pikë)		
4. Vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi i performancës së shkollës (max. 15 pikë)		
5. Plane vjetore dhe raporte pune që pasqyrojnë udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle (max.21 pikë)		
6. Plane vjetore dhe raporte pune të organeve profesionale të shkollës (Koordinatorit të cilësisë, Aktiveve profesionale, Pedagogut/psikologut të shkollës) (max. 30 pikë)		
Gjithsej pikë/poenë (max. 99) :		

Shtojca 8: Listë kontrolli për analizë të udhëzimeve metodologjike në programet mësimore lëndore

Pjesa I. Të dhënat e përgjithshme të programit mësimor			
Nr.	Aspektet kryesore	Përshkrimi / numri	Komente
1	Fusha kurrikulare / Lënda mësimore		
2	Klasa dhe numri i orëve mësimore javore		
3	Numri i temave të programit të lëndës		
4	Numri i rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL)		
5	Temave dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) iu paraprijnë Konceptet e fushës dhe rezultatet e të nxënit të fushës (RNF)		

Pjesa II. Analizë vlerësuese e udhëzimeve që ndërlidhen me planifikimin mësimor të mësimdhënësve		Pikët/ poenët e vlerësimit ³¹	Komente, vërejtje, konstatime
Plani dhe programi mësimor i lëndës:			
2.1. Udhëzimet metodologjike në programin mësimor të lëndës orientojnë mjaftueshëm shtrirjen e planifikimit mësimor brenda vitit mësimor			
2.2. Udhëzimet metodologjike në programin mësimor të lëndës ofrojnë informacione orientuese të mjaftueshme për planifikimin mësimor – respektimin e rendit logjik dhe përmbajtjesor të shtrirjes së temave dhe mbarështrimin e tyre brenda vitit mësimor.			
2.3. Udhëzimet metodologjike në programin mësimor të lëndës ofrojnë orientime të qarta dhe specifike për metodologjinë e mësimdhënies dhe nxënies			
2.4. Udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare ofrojnë mjaftueshëm informacione që mund t'i përdorin mësimdhënësit në planifikimin mësimor të tyre			
2.5. Udhëzimet për vlerësim në programin mësimor të lëndës ofrojnë mjaftueshëm informacione që mund ti përdorin mësimdhënësit në planifikimin mësimor – pjesën për metodologjinë e vlerësimit në planet dymujore / planet për periudha mësimore			

³¹ Vlerësimi bëhet për secilën dëshmi, kërkesë të këtij formulari. Vlerësimi me 3 pikë, tregon nivel të lartë të cilësisë së udhëzimeve që ndihmojnë drejtpërdrejtë planifikimin mësimor të cilin e bëjnë mësimdhënësit në shkolla, me 2 pikë nivel mesatar, me 1 pikë nivel minimal, ndërsa me 0 evidentohet mungesa e udhëzimeve në raport me kërkesat e këtij formulari.

2.6. Udhëzimet për materialet dhe burimet mësimore në programin mësimor të lëndës ofrojnë mjaftueshëm informacione që mund t'i përdorin mësimdhënësit në planifikimin mësimor – pjesën për burimet në planet dymujore / planet për periudha mësimore		
Pikët e vlerësimit (max. 18 pikë)		
Komente përmbledhëse: - Përparësitë/ anët e mira në udhëzimet metodologjike të programin mësimor të lëndës, që ndërliken me planifikimin mësimor të mësimdhënësve: - Mangësitë/ anët e dobëta në udhëzimet metodologjike në programin mësimor të lëndës që ndërliken me planifikimin mësimor të mësimdhënësve: - Propozime/rekomandime lidhur me ofrimin e udhëzimeve të nevojshme në programin mësimor të lëndës që ndërliken me orientimet për mësimdhënësin dhe lehtësimin e punës në procesin e planifikimit mësimor:		

Shtojca 9: Listë kontrolli për analizë /vlerësim të planifikimit mësimor

Dokumentimi i planifikimit mësimor	Pikët/ poenët e vlerësimit ³²	Komente, vërejtje, konstatime
1. Plani vjetor për lëndë mësimore		
1.1. Plani vjetor mbulon të gjitha temat mësimore të programit të lëndës mësimore dhe ka të përcaktuar numrin e orëve mësimore për tema mësimore		
1.2. Plani vjetor është harmonizuar me planet vjetore të lëndëve të fushës kurrikulare (p.sh. Plani vjetor i lëndës së Biologjisë klasa 7 me planet vjetore të lëndëve të fushës kurrikulare – Kimi dhe Fizikë, klasa 7)		
1.3. Numri i orëve mësimore të planifikuara për tema mësimore është në harmoni me numrin e përgjithshëm të orëve mësimore vjetore të lëndës mësimore për klasën përkatëse.		
1.4. Shtrirja e temave përgjatë periudhave të vitit mësimor siguron lidhjen logjike dhe përmbajtjesore të mbarështrimit të programit të lëndës mësimore		
1.5. Rezultatet për kompetenca që synohen të arrihen përmes kontributit të temave që zhvillohen për gjatë gjithë vitit mësimor janë të ndërlidhura me rezultatet e të nxënit për tema mësimore		
Pikët e vlerësimit (max. 15 pikë)		
2. Planet dymujore / planet për periudha mësimore (analiza bëhet për tri periudhat mësimore (nëse janë në dispozicion planet për të tri periudhat mësimore)		
2.1. Struktura e planit dymujor/plani për periudha mësimore përmban elementet kryesore të planifikimit për periudha mësimore (si: kontributin në RNK dhe RNF, temat mësimore, rezultatet e të nxënit për tema mësimore, njësitë mësimore, metodologjia e mësimdhënies, metodologjia e vlerësimit, ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me situata jetësore si dhe burimet e materialet e nevojshme).		
2.2. Planet për periudha mësimore mbulojnë temat mësimore sipas shtrirjes në planin vjetor dhe në përputhje me programin e lëndës mësimore.		
2.3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve në periudha mësimore kanë ndërlidhje me rezultatet e të		

³² Vlerësimi bëhet për secilën dëshmi, kërkesë të këtij formulari. Vlerësimi me 3 pikë, tregon nivel të lartë të cilësisë së dëshmisë, me 2 pikë nivel mesatar, me 1 pikë nivel minimal, ndërsa me 0 evidentohet mungesa e dëshmimeve / nuk ka mundur të dëshmohet/.

nxënit të lëndës mësimore për tema të periudhës përkatëse.		
2.4. Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve në periudha mësimore kanë ndërlidhje me rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore për tema të periudhës përkatëse.		
2.5. Rezultatet e të nxënit për tema mësimore të vendosura në planet e periudhave mësimore, janë në harmoni me temat përkatëse të programit të lëndës mësimore		
2.6. Njësitë mësimore të vendosura në planet e periudhave mësimore lidhen, përkatësisht janë zbërthyer në bazë të rezultateve të nxënit të lëndës mësimore për temë (RNL)		
2.7. Njësitë mësimore të vendosura në planet e periudhave mësimore janë të mjaftueshme dhe sigurojnë arritjen e rezultateve të lëndës mësimore për temë (RNL)		
2.8. Numri i orëve mësimore të përcaktuara për periudha mësimore është në harmoni me rezultatet e lëndës mësimore për temë dhe njësitë mësimore të planifikuara për tu realizuar përgjatë periudhave mësimore		
2.9. Metodologjia e mësimdhënies pasqyruar në planet e periudhave mësimore, përmban qasje metodologjike, metodat dhe teknikat të mësimdhënies interaktive që janë relevante për temën/at, rezultatet e të nxënit, njësitë mësimore dhe ndihmojnë nxënësit në arritjen e rezultateve të nxënit të planifikuara në kuadër të periudhave mësimore		
2.10. Metodologjia e vlerësimit e pasqyruar në planet e periudhave mësimore, përmban metodat, teknikat dhe instrumente relevante të vlerësimit që mund të përdoren për të vërtetuar nivelin e arritjeve të nxënësve dhe për të orientuar mbështetjen e të nxënit të nxënësve.		
2.11. Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore është bërë në mënyrë të drejtë dhe në harmoni me temën/at, përkatësisht njësitë mësimore të planifikuara për t'u zhvilluar brenda periudhës mësimore përkatëse		
2.12. Planifikimi i burimeve dhe materialeve të nevojshme që mësimdhënësi dhe nxënësit do ti shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të nxënit në periudhat përkatëse bërë në mënyrë të drejtë dhe në harmoni me temën/at, përkatësisht njësitë mësimore të planifikuara për t'u zhvilluar brenda periudhës mësimore përkatëse		
Pikët e vlerësimit (max. 36 pikë)		

3. Planifikimet për orë mësimore		
3.1. Modelet e planifikimit për orë mësimore përmbajnë kërkesat themelore për planifikimin e orës mësimore dhe pasqyrojnë kreativitetin e mësimeve në planifikimin e orës mësimore.		
3.2. Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore janë formuluar drejt dhe kanë ndërlidhje me temën dhe rezultatin e temës		
3.3. Kriteret e suksesit janë formular drejtë dhe në harmoni me rezultatet e të nxënësve të orës mësimore		
3.4. Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore është bërë në harmoni me njësinë mësimore, përkatësisht rezultatet e orës mësimore që synohen të arrihen		
3.5. Burimet dhe mjetet e konkretizimit që mësimeve do ti shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të nxënësve për orë mësimore janë në harmoni me përmbajtjen e njësive mësimore, rezultatin/et e njësive mësimore/orës mësimore.		
3.6. Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore tregon qartë atë që do të zhvillohet brenda orës mësimore dhe është në funksion të arritjes së rezultateve të nxënësve të orës mësimore		
3.7. Përshkrimi i metodologjisë vlerësimit për arritjen e rezultateve të nxënësve të orës mësimore tregon qartë se çka dhe si do të vlerësohet dhe siguron informatë kthyes për arritjet e nxënësve brenda orës mësimore		
3.8. Udhëzimet për detyra dhe punë të pavarur janë të qarta dhe të mjaftueshme për nxënësit		
3.9. Reflektimet për rrjedhën e orës mësimore janë objektive dhe ofrojnë orientime për vetëpërmirësim të mësimeve		
3.10. Modelet e planifikimit të orës mësimore pasqyrojnë kreativitetin e mësimeve në punën me nxënësit.		
Pikët e vlerësimit (max. 30 pikë)		
Pjesa II. Përmbledhje e pikëve të vlerësimit	Pikët/ poenët e vlerësimit	Komente përmbledh ëse
7. Plani vjetor për lëndë mësimore (max. 15 pikë)		
8. Planet dymujore / planet për periudha mësimore (max. 36 pikë)		
9. Planifikimet për orë mësimore (max. 30 pikë)		
Gjithsej pikë/poenë (max. 81):		

Shtojca 10: Listë kontrolli për analizë/ vlerësim të mostrave për planet individuale për arsim (PIA)

PLANI INDIVIDUAL I ARSIMIT (PIA)	Pikët/ poenët e vlerësimit ³³	Komente, vërejtje, konstatime
1. PJESA ADMINISTRATIVE		
1.1. Pjesa administrative e PIA-s përmban të dhënat për fëmijën: (emrin dhe mbiemrin e fëmijës dhe prindit, adresa dhe tel., gjuha e komunikimit, historiku i zhvillimit të fëmijës)		
1.2. Janë përshkruar qartë gjendja shëndetësore e fëmijës/ nxënësit, rekomandimet mjekësore, intervenimet, rehabilitimi, terapia, mjetet ndihmëse (për dëgjim, shkrim, lëvizje)		
1.3. Formulari përmban detajet e Institucionit arsimor ku fëmija/ nxënësi do të vijoje mësimin, përcaktimin e orarit, shërbimet brenda dhe jashtë institucionit		
Pikët e vlerësimit (max. 9 pikë)		
2. PJESA PEDAGOGJIKE		
2.1. Dokumenti përmban të dhëna për anëtarët e ekipit vlerësues dhe përshkrimin për nivelin e gjendjes aktuale të fëmijës si: aftësitë, shkathtësitë, prirjet dhe nevojat e fëmijës sipas të pesë fushave të zhvillimit,		
2.2. Qëllimi/et e përgjithshme të të nxënësit kanë orientim të qartë së çfarë synohet të arrihet si rezultat i punës pedagogjike me fëmijën/nxënësin brenda një periudhe të caktuar kohore (një vit shkollor).		
2.3. Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar rezultatet e pritshme		
2.4 Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar numri i orëve të përcaktuara		
2.5 Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar aftësitë dhe shkathtësitë e fëmijës në atë fushë/lëndë		
2.6 Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar nevojat e fëmijës për fushë/lëndë		

³³ Vlerësimi bëhet për secilën dëshmi, kërkesë të këtij formulari. Vlerësimi me 3 pikë tregon nivel të lartë të cilësisë së dëshmisë, me 2 pikë nivel mesatar, me 1 pikë nivel minimal, ndërsa me 0 evidentohet mungesa e dëshmive / nuk ka mundur të dëshmohet/.

2.7. Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar metodat e punës		
2.8. Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar format e punës		
2.9. Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar materialet didaktike dhe mjetet ndihmëse		
2.10. Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar format e mbështetjes që merr fëmija/nxënësi gjatë procesit mësimor		
2.11. Për secilën fushë të aktiviteteve/lëndë të individualizuar, janë shënuar metodat, teknikat e vlerësimit		
2.12. Vlerësimi i arritjes së rezultateve të të nxënit për lëndë/fusha të aktiviteteve është bërë në harmoni me rezultatet e të nxënit të përcaktuara me PIA		
Pikët e vlerësimit (max. 36 pikë)		
3. PJESA REHABILITUESE (nëse fëmija ka marr shërbime rehabilituese)		
3.7. Shërbimet rehabilituese janë përshkruar sipas qëllimit, llojit, institucioneve ofruese ,periudhën e ofrimit dhe vendin		
3.8. Vlerësimi dhe shkëmbimi i informatave nga ofruesit e shërbimeve rehabilituese përshkruan qartë cilësinë e shërbimeve të ofruara.		
Pikët e vlerësimit (max. 6 pikë)		
4. PLANIFIKIMI I TRANSICIONIT		
4.7. Planifikimi i tranzicionit i plotëson të gjitha kërkesat teknike të formatit të PIA-s		
4.8. Planifikimi i tranzicionit i plotëson të gjitha kërkesat profesionale dhe përmbajtjesore të formatit të PIA-s		
Pikët e vlerësimit (max. 6 pikë)		
5. RAPORTI I PËRGJITHSHËM VJETOR I VLERËSIMIT TË ARRITJES SË REZULTATEVE TË NXËNIT		
5.7. Raporti i përgjithshëm i vlerësimit i plotëson të gjitha kërkesat teknike të formatit të PIA-s		
5.8. Raporti përshkruan qartë se: Çka është arritur në drejtim të përmbushjes së qëllimeve vjetore të të nxënit, sa është mbështetur fëmija, a i kemi plotësuar vërtet nevojat individuale të nxënësit? A kanë qenë rezultatet e të nxënit reale? Çka është e rëndësishme që të ndryshohet apo të plotësohet në të ardhmen? Sa ia kemi dalë ta përkrahim fëmijën? Sa ka qenë ajo përkrahje e koordinuar dhe sistematike? Sa ka qenë funksional komunikimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm rreth fëmijës? Sa ka qenë e qartë ndarja e		

përgjegjësi ndërmjet aktorëve të ndryshëm? Çfarë ndryshimesh mund të nevojiten?		
Pikët e vlerësimit (max. 6 pikë)		
6. RISHIKIMI I PARË DHE RISHIKIMI I DYTË		
6.1. Nënshkrimet e ekipit hartues dhe data e hartimit të PIA-s		
6.2. Rishikimi i PIA, data dhe nënshkrimet e ekipit		
Pikët e vlerësimit (max. 6 pikë)		
Pjesa II. Përmbledhje e pikëve të vlerësimit	Pikët/poenë të vlerësimit	Komente përmbledhëse
3. Pjesa administrative (max. 9 pikë)		
4. Pjesa pedagogjike (max. 36 pikë)		
5. Pjesa rehabilituese (max. 6 pikë)		
6. Planifikimi i tranzicionit (max. 6 pikë)		
7. Raporti i përgjithshëm vjetor i vlerësimit të arritjes së rezultateve të nxënësve (max. 6 pikë)		
8. Rishikimi i parë dhe rishikimi i dytë (max. 6 pikë)		
Gjithsej Pikë/Poenë (max. 69):		

Shtojca 11: Lista e bashkëpunëtorëve të kurrikulës të përfshirë në analizën e planifikimit mësimor për zbatim të kurrikulës (për klasën përgatitore, klasat 2 dhe 7)

Fusha e kurrikulës	Lëndët mësimore	Emri dhe mbiemri
Gjuhët dhe komunikimi	1. Gjuhë shqipe	Zana Zeqiri
	2. Gjuhë angleze	Shkëndije Mejjini
	3. Gjuhë gjermane	Mentor Sahiti
Artet	4. Art figurativ	//
	5. Art muzikor	Behram Hasani
Matematika	6. Matematikë	Ibe Gashi
Shkencat natyrore	7. Biologji	Milazim Avdylaj
	8. Fizikë	Jakup Hoti
	9. Kimi	Shpetim Kastrati
Shoqëria dhe mjedisi	10. Histori	Donika Xhemajli
	11. Gjeografi	Fitim Humolli
	12. Edukatë qytetare	Sheribane Bahtiri
Jeta dhe puna	13. Teknologji me TIK	Zana Rudi
Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti	14. Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti	Bujar Selimaj
Kurrikula me zgjedhje	15. Kurrikula me zgjedhje	Agim Bujari Skender Mekolli
Klasa parafillore dhe klasa e dytë	Klasa parafillore dhe klasa e dytë	Mevludë Aliu Zehrije Plakolli Merita Hoxha Lirije Bytyçi
	Plani individual për arsim (PIA)	Sahare Reçica

Shtojca 12: Lista e hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës të përfshirë në analizën dhe shqyrtimin e dokumenteve dhe politikave arsimore që lidhen me reformën kurrikulare

Fushat e analizuara	Hulumtuesit që kanë kontribuar në fushat e analizuara
Përgatitja dhe udhëheqja e zbatimit të kurrikulës në shkolla	Haxhere Zylfiu Luljeta Shala Selim Mehmeti
Planifikimi mësimor në bazë të kurrikulës së re	Lirije Bytyqi Mevlude Aliu Zehrije Plakolli Sahare Reçica
Metodologjia e mësimdhënies	Ismet Potera Luljeta Shala Sahare Reçica Bekim Morina
Vlerësimi i nxënësve	Selim Mehmeti Bashkim Azemi Sahare Reçica Ismet Potera
Tekstet shkollore dhe materialet mësimore	Bashkim Azemi Arbnesha Mexhuani Safete Shala Ismet Potera
Kurrikula me zgjedhje	Agim Bujari Skender Mekolli
Baza e të dhënave	Dhurata Ahmeti, praktikante

Shtojca 13: Lista e institucioneve arsimore/shkollave pjesëmarrëse në studim

Komuna	Shkolla
1. Gjilan	1. SHFMU "Rexhep Elmazi"
	2. SHFMU "Vatra e Diturisë"
	3. IP "Ardhmëria II"
1. Kamenicë	4. SHFMU "Fan Noli"
	5. SHFMU "Abdullah Krashnica"
2. Ferizaj	6. SHFMU "Tefik Çanga"
	7. SHFMU "Jeronim de Rada"
	8. SHFMU "Ahmet Hoxha"
3. Hani i Elezit	9. SHFMU "Ilaz Thaçi"
4. Shtime	10. SHFMU "Hasan Prishtina"
	11. SHMU "Emin Duraku"
5. Prizren	12. SHFMU "Emin Duraku"
	13. SHFMU "Dy Dëshmorët"
6. Suharekë	14. SHFMU "Dëshmoret e Tivarit"
	15. SHFMU "17 Shkurti"
7. Gjakovë	16. SHFMU "Selman Riza"
	17. SHF "Kelmend Rizvanolli"
	18. Institucioni Parashkollor
8. Rahovec	19. SHFMU "Bajram Curri"
	20. SHFMU "Rudolf Walther"
	21. SHFMU "Isa Boletini"
9. Klinë	22. SHFMU "Azem Bejta"
	23. SHFMU "Ali Krasniqi"
10. Pejë	24. SHFMU "Xhemajl Kada"
	25. SHFMU "Dardania"
11. Mitrovicë	26. SHFMU "Bedri Gjinaj"
	27. SHFMU "Aziz Sylejmani"
12. Vushtrri	28. SHFMU "Andon Zako Çajupi"
	29. SHFMU "Bajram Curri"
13. Podujevë	30. SHFMU "Kongresi i Manastirit"
	31. SHFMU "Xheladin Rekaliu"

14. Fushë Kosovë	32. SHFMU "Daut Bogujevci"
	33. SHFMU "Mihal Grameno"
15. Prishtinë	34. SHFMU "Xhemail Mustafa"
	35. SHFMU "Pjetër Bogdani"
	36. SHFMU "Ganimete Tërbeshi"
	37. IP "Dielli"
16. Dragash	38. SHFMU "Ilmi Bahtijari"

Shtojca 14: Lista e pjesëmarrësve në fokus-grupe:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita
1	Selim Mehmeti	Fasilitues i diskutimit, hulumtues në IPK
2	Feime Llapashtica	Udhëheqëse e Divizionit për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT
3	Shqipe Gashi	Zyrtare për kurrikula
4	Arbër Salihu	Zyrtar për kurrikula
5	Lulavere Kadriu - Behluli	Udhëheqëse e Divizionit të arsimit gjithëpërfshirës në MASHT
6	Habib Aliu	Inspektorati i Arsimit në MASHT
7	Imrane Ramadani	Zyrtare për edukim parashkollor në MASHT
8	Ismet Potera	Hulumtues në IPK
9	Lirije Bytyqi	Hulumtuese në IPK
10	Bashkim Azemi	Hulumtues në IPK
11	Skender Mekolli	Hulumtues në IPK

Shtojca 15: Lista e pjesëmarrësve të intervistuar, pjesëmarrësve që kanë dhënë përgjigje në pyetjet udhëzuese përmes e-mailit

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita
1	Lindita Boshtrakaj	Njohëse e arsimit dhe reformës kurrikulare (pjesë e ekipit teknik për hartimin e Kornizës Kurrikulare)
2	Osman Buleshkaj	Njohës i arsimit dhe reformës kurrikulare (bashkëpunëtor i jashtëm i MASHT-it përmes projektit EU SWAP dhe kabinetit të ministrit)
3	Hajrije Devetaku - Gojani	Njohëse e arsimit dhe reformës kurrikulare (bashkautorë e dokumentit të Kornizës Kurrikulare (2001), bashkëpunëtore e MASHT-it në fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi)
4	Xhavit Rexhaj	Njohës i arsimit dhe reformës kurrikulare (bashkëpunëtor i jashtëm i MASHT-it përmes projektit EU SWAP)
5	Merita Shala	Njohëse e arsimit dhe reformës kurrikulare (anëtare e grupeve punuese në MASHT, ekspertë vendorë – me fokus në edukimin parashkollor)
6	Rinor Qehaja	Njohës i arsimit dhe reformës kurrikulare (i angazhuar në monitorim të zbatimit të reformës, në cilësi të OSHC-ve)
7	Habibe Buzuku	Zyrtare për trajnime (Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësuesve në MASHT)
8	Preng Gashi	Inspektor i Arsimit (SIA, Ferizaj)
8	Besa Halimi - Zagragja	Inspektore e Arsimit (SIA, Prishtinë)
9	Mejreme Nevzati	Inspektore e Arsimit (SIA, Prizren)
10	Refik Azemi	Zyrtar i arsimit / koordinator i cilësisë në DKA Mitrovicë
11	Fluter Këpuska	Zyrtare e arsimit / koordinator e cilësisë në DKA Gjakovë
12	Sadije Hajdini	Zyrtar i arsimit / koordinator i cilësisë në DKA Ferizaj
12	Lulzim Sahiti	Zyrtar i arsimit / koordinator i cilësisë në DKA Shtime
13	Lulzim Krasniqi	Udhëheqës për arsim në DKA Rahovec
14	Arben Zabeli	Zyrtar për arsimin e mesëm të ulët dhe gjithëpërfshirës – koordinator i Kurrikulës në nivel të DKA Skenderaj

15	Shqipe I. Rexhepi	Psikologe/ Koordinate p�r kurrikul� n� DKA Viti
16	Sear Dernjani	Shef i arsimit (koordinator komunal p�r cil�si) n� DKA Hani i Elezit
17	Halim Hoti	Koordinator i DKA-s� p�r zbatim t� KKK n� komun�n e Malishev�s
18	Sk�nder Susuri	Drejt�r i DKA-s� n� Prizren (n� koh�n e realizimit t� intervist�s)

Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi
Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 1000 copë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373.5.016

Kurrikula e bazuar në kompetenca : (përvojat
gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat
për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve)
/ Selim Mehmeti... et al. – Prishtinë : Instituti
Pedagogjik i Kosovës, 2019. – 320 f. : ilustr. ; 24
cm.

1.Mehmeti, Selim 2 Bytyçi, Lirije 3. Zylfiu
Haxhere 4. Potera, Ismet

ISBN 978-9951-591-47-8

ISBN 978-9951-591-47-8



9 789951 591478